



association for  
the prevention  
of torture

## International Detention Coalition

Human rights for detained refugees,  
asylum seekers and migrants



# MONITORIMI I MBAJTJES SË IMIGRANTËVE

Doracak praktik



Të drejtat autoriale © 2014, Asociacioni për Parandalimin e Torturës (APT) dhe Komisionari i Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materialet e përfshira në këtë publikim mund të citohen ose të riprodhohen lirish, me kushtin që të citohet burimi . Kërkesat për leje për të riprodhuar ose përkthyer publikimin duhet t'i adresohen APT-së dhe UNHCR-it.

#### VËREJTJE:

Përkthimi i këtij materiali nuk është zyrtar dhe është realizuar për nevojat e trajnimit:

“ Hyrje në fushën e mbaitjes së të huajve (standartet dhe monitorimi)”

Organizuar nga KRCT në partneritet me UNHCR



Ky Doracak është në dispozicion në internet në:  
<http://www.refworld.org/docid/53706e354.html> dhe në:  
[www.apr.ch/publications](http://www.apr.ch/publications)

# MONITORIMI I MBAJTJES SË IMIGRANTËVE

Doracak praktik



association for  
the prevention  
of torture



**International  
Detention Coalition**  
Human rights for detained refugees,  
asylum seekers and migrants

---

## FALENDERIME

Versionet fillestare të këtij Doracaku janë përgatitur nga Eve Lester, konsulent, dhe janë rishikuar nga Edouard Delaplace dhe Tanya Norton nga APT. Këshilli drejtues ka pasur në përbërje Barbara Bernath (APT), Alice Edwards (UNHCR), Grant Mitchell (KND), Tanya Norton (APT) dhe Ariel Riva (UNHCR). Hartuesit e Doracakut kanë përfituar nga konsultimet e gjerësishme me një numër të madh dhe një varg organesh ndërkombëtarë, rajonale dhe kombëtare dhe palë me interes, përfshirë organet monitoruese kombëtare dhe ndërkombëtare, Procedurat e Posaçme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, organizatash ndërkombëtare dhe shoqërinë civile. APT, KND dhe UNHCR u janë mirënjohës të gjithë ekspertëve të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në këtë publikim të ri.

# PARATHËNIE NGA KOMISIONERI I LARTË I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR REFUGJATËT

## Larg syve, por jo larg mendjes

Mbajtja e personave të cilët kanë ikur për ta shpëtuar jetën ose rrezikohen të përndiqen është shndërruar në një reagim rutinë për menaxhimin e kufijve nga qeveritë e disa shteteve, në vend të të qenit masë e jashtëzakonshme. Është posaçërisht alarmant fakti që nga kjo praktikë gjithnjë në rritje nuk përjashtohen as fëmijët dhe familjet, madje disa syresh kalojnë periudha të gjata duke qëndruar të mbyllur pas telave me gjemba ose grilave të hekurta. Shpeshherë, azilkërkuesit dhe refugjatët mbahen në mbajtje nëpër burgje të sigurisë së lartë së bashku me individë shumë të rrezikshëm, ose jetojnë në kushte që janë nën standarde dhe trajtohen njëlloj sikur të kishin kryer një vepër penale. Nganjëherë, ata “veçohen” nga shoqëria në kuptimin e plotë të fjalës duke u dërguar në zona të largëta, të tilla si shkretëtirat, zonat kufitare apo edhe ishuj të largët, që nuk mund të monitorohen dhe inspektohen rregullisht. Vendet dhe trajtimet e këtilla janë në kundërshti me të drejtën universale për të kërkuar azil, e drejtë kjo që përbën boshtin e punës së Zyrës sime.

Megjithëse migrimi i parregullt mund të sfidojë integritetin e kufijve, si dhe funksionimin efikas të sistemeve të azilit, qeveritë kanë detyrimin që t'i trajtojnë azilkërkuesit, si dhe migrantët, në mënyrë njerëzore dhe dinjitoze. Pavarësisht nga statusi i tyre i imigrimit ose azilit, azilkërkuesit dhe migrantët, sikundër gjithë qeniet njerëzore, kanë të drejtë të përfitojnë nga kodi i lashtë i *habeas corpus*, ose e drejta që të mos ndalohen në mënyrë arbitrare apo të paligjshme. Azilkërkuesit të cilët mbahen në ndalim janë ndër njerëzit në pozitën më të cënueshme me të cilët punonjësit e UNHCR-it kanë kontakt. Monitorimi siguron që ndërsa ata mund të jenë larg syve, rrethanat e tyre të mos jenë larg mendjes sonë.

Ky Doracak për monitorim është hartuar bashkërisht nga Zyra ime, Asociacioni për Parandalimin e Torturës (APT) dhe Koalicioni Ndërkombëtar mbi Ndalimin (KNN). Ai mëton të forcojë kapacitetin për monitorim të jo vetëm personelit mbrojtës të UNHCR-it, për të cilët monitorimi i qendrave të ndalimit përbën aktivitetet të rregullt dhe të rëndësishëm për mbrojtjen, por edhe të akterëve dhe organizmave tjerë me mandat kombëtar dhe/ose ndërkombëtar që të vizitojnë vendet e ndalimit të imigrantëve.

Parimet dhe standardet e përcaktuara në këtë Doracak janë të një natyre si parandaluese ashtu dhe korigjuuese. Monitorimi mund të ndihmojë në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut si ndaj individëve ashtu dhe në nivel sistemor, dhe mund të vë në dukje fushat ku kërkohet të bëhen përmirësime në mënyrë që të sigurohet respektimi i plotë i të drejtave themelore për trajtim dinjitoz dhe njerëzor. Hap i parë drejt parandalimit të abuzimit është qasja në qendrat e mbajtjes.

Duke ofruar një metodologji praktike për realizimin e monitorimit të vendeve të mbajtjes, dhe duke qenë i bazuar në standardet ndërkombëtare dhe rajonale më të fundit të të drejtave të njeriut dhe standardet e parapara me të drejtën për refugjatët, Doracaku shërben si udhëzues hap-pas-hapi të cilin monitoruesit mund ta përdorin dhe ta bartin me vete në vendet e ndalimit. Ai mund t'ju shërbejë qeverive dhe personelit të vendeve të ndalimit edhe si listë verifikimi për sa u përket praktikave më të mira e standardeve që duhet t'i zbatojnë në të gjitha fazat e procesit të mbajtjes. Doracaku i plotëson *Udhëzimet e UNHCR-it për kriteret dhe standardet që zbatohen në lidhje me mbajtjen e azilkërkuesve dhe alternativat ndaj mbajtjes (2012)*, dhe bazohet në ekspertizën dhe punën e madhe të APT-së dhe KNN-së në monitorimin e qendrave të mbajtjes, përkatësisht avokimin për alternativa tjera përveç mbajtjes. Jua rekomandoj Doracakun.



**António Guterres**

Komisionar i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

# PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES

<b>1. HYRJE NË DORACAK.....</b>	<b>19</b>
1.1 Përse të monitorohet? Përse ky Doracak? .....	21
1.2 Kujt i dedikohet ky Doracak?.....	22
<b>2. MBAJTJA NË KONTEKSTIN E IMIGRIMIT.....</b>	<b>27</b>
2.1 Përse mbahen imigrantët?.....	28
2.2 Kush ndalohet në mbajtje? .....	28
2.3 Në ç' vend mbahen imigrantët?.....	29
2.4 Për sa kohë mbahen imigrantët? .....	30
2.5 Kush i ndalon imigrantët në mbajtje? .....	30
2.6 Mbjajtja e imigrantëve dhe korniza ligjore ndërkombëtare .....	31
<b>3. MBAJTJA E IMIGRANTËVE: METODOLIGJIA E MONITORIMIT .....</b>	<b>35</b>
3.1 Monitorimi i vendeve të mbajtjes në kontekstin e imigrimit .....	36
3.2 Hartimi i strategjisë së monitorimit: Elementet kyçe.....	43
3.3 Përgatitja e vizitës .....	49
3.4 Realizimi i vizitës .....	54
3.5 Pas vizitës .....	74

---

#### **4. CILAT ASPEKTE TË MBAJTJES DUHEN SHQYRTUAR..... 89**

4.1 Mbjajtja dhe procedurat e imigrimit .....	89
4.2 Trajtimi dhe garancitë .....	113
4.3 Siguria, rendi dhe disiplina.....	123
4.4 Kushtet materiale .....	130
4.5 Aktivitetet .....	143
4.6 Kujdesi shëndetësor .....	159
4.7 Personeli / Kuadrot .....	172
4.8 Personat në pozitë të cënueshme/rrezik.....	179

#### **SHËNIME BIBLIOGRAFIKE..... 197**

#### **SHTOJCAT..... 207**

Shtojca I: Fjalorth i termave kryesore.....	207
Shtojca II: Materiale të përzgjedhura për referencë.....	213



# PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE.....	14
<b>1. HYRJE NË DORACAK.....</b>	<b>19</b>
1.1 Përse të monitorohet? Përse ky Doracak? .....	21
1.2 Kujt i dedikohet ky Doracak?.....	22
<b>2. MBAJTJAI NË KONTEKSTIN E EMIGRIMIT.....</b>	<b>27</b>
2.1 Përse mbahen imigrantët?.....	28
2.2 Kush mbahet? .....	28
2.3 Ku mbahen imigrantët?.....	29
2.4 Për sa kohë mbahen imigrantët? .....	30
2.5 Kush i ndalon imigrantët në mbajtje? .....	30
2.6 Mbajtja e imigrantëve dhe komiza ligjore ndërkombëtare .....	31
<b>3. MBAJTJA E IMIGRANTËVE: METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....</b>	<b>35</b>
3.1 Monitorimi i vendeve të mbajtjes në kontekstin e imigrimit .....	36
3.1.1 Sfidat e monitorimit të mbajtjes së imigrantëve .....	36
3.1.2 Çfarë do të thotë të monitorosh mbajtjen e imigrantëve?.....	37
3.1.3 Monitorimi i mbajtjes së imigrantëve: Cenueshmëritë.....	39
3.1.4 Sigurimi i qasjes për qëllime të monitorimit.....	40
3.2 Hartimi i strategjisë së monitorimit: Elementet kyçe.....	43
3.2.1 Të kuptuarit e kontekstit të gjithëmbarshtëm të mbajtjes së imigrantëve.....	43
3.2.2 Caktimi i synimeve dhe qëllimeve të qarta të monitorimit.....	44

3.2.3 Përcaktimi i kohëzgjatjes së gjithëmbarshme të programit të monitorimit.	44
3.2.4 Përzgjedhja e vendeve të mbajtjes tek të cilat duhet fokusuar.....	44
3.2.5 Natyra dhe kohëzgjatja e vizitave monitoruese.....	45
3.2.6 Shpeshtësia e vizitave monitoruese.....	46
3.2.7 Përbërja dhe madhësia e ekipit të monitoruesve.....	46
3.2.8 Bashkërendimi mes organeve vizituese.....	48
3.3 Përgatitja e vizitës .....	49
3.3.1 Hulumtimi, mbledhja dhe sistemimi i informatave.....	50
3.3.2 Përcaktimi i qëllimit(eve) specifike të vizitës.....	51
3.3.3 Të sigurohet që monitoruesit janë të përgatitur mirë .....	52
3.3.4 Të sigurohet përgatitja materiale dhe logjistike.....	52
3.4 Realizimi i vizitës _____	54
3.4.1 Biseda fillestare me kreun e qendrës.....	56
3.4.2 Inspektimi dhe vrojtimi i hapësirave.....	58
3.4.3 Shqyrtimi i regjistrave dhe dokumenteve tjera.....	60
3.4.4 Respektimi i i procedurave.....	60
3.4.5 Intervistat me personat në mbajtje .....	62
3.4.6 Intervistat me personelin.....	72
3.4.7 Takimi përfundimtar me kreun e qendrës.....	73
3.5 Pas vizitës.....	74
3.5.1 Realizimi i raportimit përmbyllës në ekip dhe për anëtarët .....	75
3.5.2 Analiza dhe dokumenti i brendshëm.....	76
3.5.3 Raportimi. ....	76
3.5.4 Dhënia e rekomandimeve. ....	79
3.5.5 Shpërndarja e raporteve.....	82
3.5.6 Veprimet përcjellëse pas raporteve dhe rekomandimeve.....	82
3.5.7 Vlerësimi dhe shqyrtimi i procesit të monitorimit.....	84
3.5.8 Strategjitë e mundshme të veprimeve pasuese shtesë.....	84

## 4. CILAT ASPEKTE TË MBAJTJES SË IMIGRANTËVE TË SHQYRTOHEN .... 89

4.1 Procedurat e mbajtjes dhe imigrimit.....	89
4.1.1 Procedurat e mbajtjes dhe qasja në alternativa ndaj mbajtjes.....	90
4.1.2 Qasja në avokat.....	94
4.1.3 Mbërritja dhe pranimi.....	96
4.1.4 Transferimet.....	102
4.1.5 Qasja në procedura të azilit/mbrojtjes.....	104
4.1.6 Kërkesat dhe ankesat.....	106
4.1.7 Lirimi dhe kujdesi i mëpastajmë.....	108
4.1.8 Procedurat e largimit, deportimit dhe riatdhesimit.....	110
4.2 Trajtimi dhe masat mbrojtëse.....	113
4.2.1 Tortura dhe keqtrajtimet tjera.....	114
4.2.2 Izolimi dhe mbyllja në vetmi.....	117
4.2.3 Mjetet e kufizimit fizik dhe përdorimi i forcës.....	120
4.3 Siguria, rendi dhe disiplina.....	123
4.3.1 Procedurat disiplinore.....	123
4.3.2 Inspektimet e jashtme.....	125
4.3.3 Ngacmimi dhe viktimizimi.....	127
4.3.4 Trajtimi i urgjencave.....	129
4.4 Kushtet materiale.....	130
4.4.1 Akomodimi.....	131
4.4.2 Ushqimi dhe uji i pijshëm.....	135
4.4.3 Kushtet hidrosanitare dhe higjienike.....	138
4.4.4 Veshmbathjet.....	140
4.4.5 Paratë e gatshme dhe gjësendet personale.....	141
4.5 Aktivitetet.....	143
4.5.1 Vizitat dhe komunikimi me botën e jashtme.....	143
4.5.2 Arsimiti dhe zhvillimi i shkathësive.....	148
4.5.3 Puna dhe veprimtaritë që paguhen.....	150
4.5.4 Ushtrimet në ajër të hapur, aktivitetet e kohës së lirë dhe kulturore.....	151
4.5.5 Besimi fetar.....	154
4.5.6 Mirëqenia dhe këshillimi.....	157

4.6 Kujdesi shëndetësor.....	159
4.6.1 Qasja në kujdes shëndetësor.....	159
4.6.2 Personeli mjekësor.....	165
4.6.3 Nevojat e veçanta të grave dhe foshnjave.....	167
4.6.4 Personat me probleme të shëndetit mendor.....	170
4.7 Personeli / kuadrot.....	172
4.7.1 Raportet mes personelit dhe personave në mbajtje dhe siguria.....	173
4.7.2 Punësimi, trajnimi dhe sjellja e personelit .....	176
4.8 Personat në pozitë të cenueshme/rrezikuar.....	179
4.8.1 Parimet themelore.....	179
4.8.2 Fëmijët.....	181
4.8.3 Fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë.....	184
4.8.4 Gratë .....	186
4.8.5 Personat me aftësia të kufizuara mendore ose fizike.....	189
4.8.6 Personat e trafikuar.....	191
4.8.7 Viktimat e torturës dhe traumës .....	192
4.8.8 Personat pa shtetësi .....	193
4.8.9 Personat LGBTI.....	194

## **SHËNIME BIBLIOGRAFIKE..... 197**

## **SHTOJCAT ..... 207**

Shtojca I: Fjalorth i termave kryesorë.....	207
Shtojca II: Materiale të përzgjedhura për referencë .....	213

## Lista e kutive

Kutia 1.1 Mbajtja e imigrantëve.....	20
Kutia 1.2 Qëllimet e Doracakut.....	26
Kutia 2.1 Udhëzimet e UNHCR-it mbi mbajtjen .....	32
Kutia 3.1 Monitorimi .....	36
Kutia 3.2 Aspektet e mbajtjes që duhen monitoruar.....	38
Kutia 3.3 Qasja në vendet e mbajtjes.....	41
Kutia 3.4 Parimet udhëheqëse të monitorimit.....	42
Kutia 3.5 Shpeshtësia e vizitave.....	47
Kutia 3.6 Profili i ekipit monitorues.....	48
Kutia 3.7 Biseda fillestare me kreun e qendrës.....	57
Kutia 3.8 Konsideratat e sigurisë.. ..	59
Kutia 3.9 Regjistrat .....	61
Kutia 3.10 Mbrojtja e burimeve dhe informatave.....	63
Kutia 3.11 Përzgjedhja e personave të cilët do intervistohen .....	66
Kutia 3.12 Hyrja në intervistë .....	68
Kutia 3.13 Shënimet përkujtuese.....	69
Kutia 3.14 Aparatet e regjistrimit.....	70
Kutia 3.15 Përkthyesit. ....	71
Kutia 3.16 Pas vizitës .....	75
Kutia 3.17 Dokumentimi i brendshëm.....	77
Kutia 3.18 Pesë parimet e përgjithshme të raportimit.....	78
Kutia 3.19 Modeli SMART i dyfishtë .....	81
Kutia 3.20 Vlerësimi i i vizitës së monitorimit.....	85

## LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

- KADNJ** Konventa amerikane për të drejtat e njeriut e OSHA (Organizata e Shteteve Amerikane) (1969)
- PSH.KADNJ** Protokolli shtesë i Konventës amerikane për të drejtat e njeriut në fushën e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore (1988)
- KADNJ.P** Karta afrikane (Unioni Afrikan) për të drejtat e njeriut dhe të popujve (1981)
- APT** Asociacioni për Parandalimin e Torturës
- PKK** Protokolli i OKB kundër kontrabandimit të emigrantëve nga toka, deti dhe ajri, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit ndërkombëtar të organizuar (Protokolli kundër kontrabandimit) (2000)
- PKT** Protokolli i OKB për parandalimin, frenimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit ndërkombëtar të organizuar (Protokolli kundër trafikimit) (2000)
- KPP** Korpusi i parimeve të OKB-së për mbrojtjen e të gjithë personave të cilët ndodhen në çfarëdo forme të mbajtjes ose burgimit (1988)
- PTHTB** Parimet themelore të OKB-së për trajtimin e të burgosurve (1990)
- PTHFAZ** Parimet themelore të OKB-së për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët e zbatimit të ligjit (1990)
- RRB** Rregullat e OKB-së për trajtimin e grave të burgosura dhe masat alternative për gratë në burgim (“Rregullat e Bangkokut”) (2010)
- KKT** Komisioni i OKB-së Kundër Torturës
- KMZZL** Kodi i mirësjelljes i OKB-së për zyrtarët e zbatimit të ligjit (1979)
- CCPR** Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut
- DKR** Deklarata e Kartagjenës për refugjatët (1984)
- CEDAW** Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (1979)
- KEDR** Komisioni i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor
- KDESK** Komisioni i OKB-së për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
- KDTHBE** Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000)

- [KMKIE](#) Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës
- [KPM](#) Konventa e OKB-së për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe të anëtarëve të familjeve të tyre (1990)
- [KIE](#) Këshilli i Evropës
- [KIE-NJUJKD](#) Njëzetë udhëzimet e KIE për kthimin e detyruar (2005)
- [KPT](#) Komisioni Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera çnjerëzore ose poshtëruese
- [KDF](#) Konventa e OKB-së për drejtat e fëmijës (1989)
- [KP-KDF](#) Komentet e përgjithshme për Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës (1989)
- [RRZDNH](#) KNKK, Rregullat zakonore të së drejtës ndërkombëtare humanitare
- [OAU](#) Konventa e UA-së që rregullon aspektet e veçanta të problemeve të refugjatëve në Afrikë (1969)
- [KDKAK](#) Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2006)
- [KSR](#) Konventa mbi statusin e refugjatit (1951)
- [KSPSH](#) Konventa mbi statusin e personave pa shtetësi (1954)
- [DM](#) Asambleja Botërore Mjekësore –Deklarata e Maltës mbi grevat e urisë (1991) (e rishikuar në 1992 dhe 2006)
- [DT](#) Asambleja Botërore Mjekësore –Deklarata e Tokios (1975) (e rishikuar në 2005 dhe 2006), Udhëzime për mjekët në lidhje me trajtimin e torturës dhe trajtimet e tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese apo ndëshkimit në lidhje me mbajtjen dhe burgimin
- [KEDNJ](#) Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (1950)
- [KEPT](#) Konventa evropiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese (1987)
- [RREB](#) Rregullat evropiane të burgjeve (2006)
- [UTDB](#) Trusti për të Drejta të Barabarta, Udhëzime për mbrojtjen e personave pa shtetësi nga ndalimi arbitrar (2012)
- [EU-RD](#) Bashkimi Evropian, Direktiva 2013/33/BE për përcaktimin e standardeve minimale për pranimin e parashtruesve të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare (2013)
- [KNAPNT](#) Konventa ndëramerikane e OSHA-s për parandalimin dhe ndëshkimin e torturës (1985)
- [KNAPNCDHNG](#) Konventa ndëramerikane e OSHA-s për parandalimin, ndëshkimin dhe

- çrrënjosjen e dhunës ndaj gruas (1994)
- [PNDCP](#) Pakti ndërkombëtar i OKB-së për të drejtat civile dhe politike (1966)
- [PNDESK](#) Pakti ndërkombëtar i OKB-së për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (1966)
- [KNMPZHF](#) Konventa ndërkombëtare e OKB-së për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë (2006)
- [KNKK](#) Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
- [KNN](#) Koalicioni Ndërkombëtar mbi Ndalimin
- [ILO](#) Organizata Ndërkombëtare e Punës
- [IOM](#) Organizata Ndërkombëtare për Migrim
- LGBTI** Lesbike, homoseksual, biseksual, transgjijor dhe ndërgjijor
- OJQ** Organizatë joqeveritare
- IKDNJ** Institucion kombëtar për të drejtat e njeriut
- [MKP](#) Mekanizmi kombëtar parandalues, sipas PFKKT
- [OAS](#) Organizata e Shteteve Amerikane
- [OHCHR](#) Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
- [OHCHR-UT](#) Parimet dhe udhëzimet që rekomandohen nga OHCHR në lidhje me të drejtat e njeriut dhe trafikimin me njerëz (Udhëzimet e OHCHR-it mbi trafikimin) (2010)
- [PFKKT](#) Protokoll i fakultativ i OKB-së për Konventën e OKB-së kundër torturës (2002)
- [PPMPPLA](#) Parimet dhe praktikatat më të mira të OSHA/KNADNJ për mbrojtjen e personave të privuar nga liria në Kontinentin Amerikan (2008)
- [PMPSMKSH](#) Parimet e OKB-së për mbrojtjen e personave me sëmundje mendore dhe përmirësimin e kujdesit të shëndetit mendor (1991)
- [PEM](#) Parimet e OKB-së për etikën mjekësore (1982)
- [PSR](#) Protokoll i OKB-së në lidhje me statusin e refugjatit (1967)
- [RMMPL](#) Rregullat e OKB-së për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria (1990)
- [RRMS](#) Rregullat minimale standarde të OKB-së për trajtimin e personave të burgosur (1955)
- [NKPT](#) Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës, sipas PFKKT
- [RP.për Torturën](#) Raportuesi i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për torturën dhe trajtimet a dënimit tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese
- [RPDNJM](#) Raportuesi i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut e migrantëve
- [RPTP](#) Raportuesi i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për trafikimin e personave,



---

veçanërisht të grave dhe fëmijëve

[DUDNJ](#) Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (1948)

[KBKKT](#) Konventa e OKB-së kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (1984)

[UNHCR](#) Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë

[UNHCR-DG](#) Udhëzimet e UNHCR-it mbi kriteret dhe standardet që zbatohen në lidhje me ndalimin e azilkërkuesve dhe alternativat e ndalimit (2012)

[UNICEF](#) Fondi i OKB-së për Fëmijët

[EGAD](#) Grupi punues i OKB-së për ndalimin arbitrar

[EMA](#) Shoqata Mjekësore Botërore

[PË](#) Parimet e Yogyakarta'tas mbi aplikimin e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor (2007)



# 1 HYRJE NË DORACAK

“ *Nuk ka asnjë dëshmi empirike se mbajtja pengon imigrimin e parregullt apo i dekurajon personat nga kërkimi i azilit.*

Tryeza botërore e diskutimit për alternativat ndaj mbajtjes së azilkerkuesve, refugjatëve, imigrantëve dhe personave pa shtetësi: Përfundimet e përmbledhura, UNHCR/OHCHR, korrik 2011.

“ *Imigrantët të cilët janë në mbajtje janë në një gjendje posaçërisht të cenueshme, ngaqë mund të mos e dinë gjuhën dhe për këtë arsye mund të mos e kuptojnë përse janë në mbajtje, apo të jenë në dijeni të mënyrave të kontestimit të ligjshmërisë së mbajtjes tyre [...] imigrantëve në mbajtje u mohohen shpesh garancitë kryesore procedurale, siç janë qasja në kohë në avokat, shërbimet e përkthimit me gojë dhe shkrim, kujdesi i nevojshëm mjekësor, mundësia e kontaktimit të familjes apo përfaqësuesve konsullor dhe mënyrat e ankimit ndaj mbajtjes.*

Raportuesi i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut për migrantët, Këshilli për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së, A/HRC/20/24, §15, prill 2012.

**MBAJTJA E IMIGRANTËVE** nënkupton heqjen e lirisë së një personi, zakonisht me karakter administrativ, për ndonjë shkelje të pretenduar të kushteve të hyrjes, qëndrimit ose banimit në shtetin pritës.

E drejta për liri dhe siguri është e drejtë themelore e njeriut që është pasqyruar në ndalesën ndërkombëtare të ndalimit arbitrar dhe mbështetet nga e drejta për liri të lëvizjes. Ndërsa Shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë hyrjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj në territorin e tyre, kjo e drejtë duhet të ushtrohet duke i respektuar standardet e të drejtave të refugjatëve dhe të drejtave të njeriut.<sup>1</sup>

Sot, shfrytëzimi i mbajtjes së imigrantëve si mjet për menaxhimin e migracionit është në rritje në një numër të madh të vendeve. Mbajtja e azilkërkuesve dhe imigrantëve<sup>2</sup> paraqet një sfidë në rritje për të drejtat e njeriut në mbarë botën, pavarësisht se sipas të drejtës ndërkombëtare mbajtja lejohet vetëm nëse është e domosdoshme, e arsyeshëm dhe proporcionale me qëllimin legjitim që dëshirohet të arrihet dhe vetëm pasi të jetë konstatuar se alternativat më pak shtrënguese nuk janë të përshtatshme në çdo rast individual. Në realitet, azilkërkuesit dhe migrantët ngandonjëherë bëhen subjekt i mbajtjes arbitrar dhe/ose të paligjshëm. Ata mund mbahen pa procedura të duhura ose në kushte që nuk i plotësojnë standardet minimale dhe janë të papërshtatshme për rrethanat e tyre të veçanta. Ndërsa praktikat dhe kushtet e mbajtjes dallojnë shumë nga njëri shtet në tjetrin, madje edhe nëpër qendrat e ndryshme të mbajtjes që ndodhen në të njëjtin shtet, problem endemik në kontekstin e migracionit është se mbajtja mund ta ketë efektin e mohimit të qasjes në procedura që janë vendimtare për zgjidhjen e statusit të imigrimit të personit në mbajtje, qoftë në mënyrë të qëllimshme ose jo, gjë që shpesh ka pasoja të mëdha në kuptimin e të drejtave të njeriut. Në lidhje me këtë, shqyrtimi administrativ dhe/ose gjyqësor i formave të ndryshme të mbajtjes së imigrantëve mund të mos jetë në dispozicion. Në praktikë, shumë qeveri nuk i marrin parasysh në mënyrë të duhur ose adekuate nevojat e veçanta për mbrojtje apo pozitën e cënueshme të kategorive të caktuara të imigrantëve në mbajtje.<sup>3</sup>

Duke qenë se ndodhen jashtë vendit të origjinës, ose vendit shtetësinë e të cilit e kanë, dhe nuk e njohin kontekstin ligjor, madje as gjuhën zyrtare, imigrantët në mbajtje janë në pozitë të cenueshme. Atyre mund t'u është dashur të bëjnë rrugë të gjatë dhe traumatike për të arritur deri në atë shtet, duke përfshirë në rastin e refugjatëve dhe ikjen nga vendi i origjinës për shkak të përndjekjes, shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut apo konfliktit.

Në fund, ndalimi i imigrantëve karakterizohet shpesh me mungesë ose pamjaftueshmëri të mbikëqyrjes së pavarur, sidomos në zonat kufitare. Në disa vende, mbajtja e imigrantëve ka qenë historikisht një nga fushat më të paqarta të administratës publike .

## 1.1 PËRSE TË MONITOROHET? PËRSE KY DORACAK

Transparenca dhe mbikëqyrja e pavarur e administratës publike të një Shteti janë elementë vendimtarë të çdo sistemi që bazohet në parimet e demokracisë dhe sundimit të ligjit. Kjo vlen sidomos kur është fjala për monitorimin pushtetit që Shteti ka për t'i hequr lirinë çdokujt, dhe atë jo vetëm në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve. Mbajtja përbën heqje të lirisë. Kështu, ajo duhet të bëhet në përputhje me garancitë përkatëse të parapara me të drejtën ndërkombëtare. Në këtë kontekst, qëllimi kryesor i këtij Doracak është që të sigurojë një vegël praktike për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve për monitorim dhe/ose inspektim të organizatave dhe individëve që vizitojnë vendet e mbajtjes së imigrantëve.

Vetë fakti që vendet e mbajtjes së imigrantëve vizitohen nga organizma monitorues mund të hedhë dritë mbi botën deri tani të errët të mbajtjes dhe të kontribuojë në rritjen e transparencës e llogaridhënies dhe forcimin e besimit të publikut. Veç kësaj, këto vizita mund të kenë po ashtu dhe efekt të rëndësishëm në parandalimin dhe pakësimin e rrezikut të shkeljeve të të drejtave të njeriut të tilla si tortura dhe trajtimi çnjerëzor e poshtërues.

Parakusht themelor i monitorimit është që ai duhet të realizohet në suaza të një *qasjeje parandaluese*, që mëton t'i shmangë shkeljet e të drejtave të njeriut qoftë individuale qoftë sistemore përpara se të ndodhin ato.

Monitorimi i mbajtjes ngërthen njëherësh edhe një *qasje korrigjuese*, duke vënë theksin mbi fushat ku nevojiten të bëhen përmirësime. Në praktikë, kjo do të thotë se Doracaku ofron një metodologji praktike për identifikimin dhe dokumentimin e situatave ku kushtet e mbajtjes së imigrantëve nuk i plotësojnë standardet ndërkombëtare minimale. Në suazat e këtij fushëveprimi të gjerë, ky Doracak do të mundësojë që vizitat monitoruese të jenë koherente, efektive, të pavarura dhe të bazuara në dëshmi, me shpresën se do të çojnë në përmirësimin e kushteve të ndalimit të imigrantëve dhe shmangien e rreziqeve të mbajtjes arbitrare ose të kundërligjshme, torturës dhe formave tjera të keqtrajtimit, dhe të *kthimit mbrapsht*.<sup>4</sup>

Vizitat parandaluese janë pjesë e dialogut të vazhdueshëm dhe konstruktiv me autoritetet përkatëse, në kuadër të të cilit jepen rekomandime konkrete për përmirësimin e sistemit të mbajtjes në afat të shkurtër dhe të gjatë. Ato mund të realizohen paraprakisht në vend se të jenë në reagim ndaj ndonjë rasti a ankese të veçantë. Vizitat mund të bëhen në çdo kohë, madje edhe kur nuk ka probleme të dukshme.

Është me rëndësi të mbahet parasysh se madje edhe vizitat me qëllim të studimit të ndonjë dosje individuale mund të shpalojë informacione për ekzistimin e problemeve më sistemore apo strukturore dhe, në veçanti, në kontekstin e imigracionit mund të shpalojë çështje të ndryshme lidhur me përshtatshmërinë e mekanizmave për referim në procedura të azilit ose procedura të tjera.

## 1.2 KUJT I DEDIKOHET KY DORACAK?

Ky Doracak i dedikohet çdokujt dhe çdo institucioni që realizon vizita në vendet e mbajtjes së imigrantëve. Ekzistojnë lloje të ndryshme të monitorimit varësisht nga mandati dhe qëllimi i organit të monitorimit. Disa organizma përqendrohen në trajtimin e rasteve ose kërkesave individuale, derisa tjerët kanë një qasje më të përgjithësuar duke i shqyrtuar problematikat sistemore dhe strukturore

Në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve, qasje në qendrat e mbajtjes së imigrantëve kanë një numër i organizmave monitorues gjithëherë e më i madh. Këtu përfshihen në radhë të parë UNHCR-i, si dhe organet tjera ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të paraqitura më poshtë:

## NIVELI NDËRKOMBËTAR

### ☞ **Nënkomisioni i OKB-së për Parandalimin e Torturës (NKPT):**

Protokolli fakultativ i Konventës së OKB-së kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (PFKKT)<sup>5</sup> përcakton një sistem të dyfishtë të vizitave parandaluese "të ndërmarra nga organe të pavarura ndërkombëtare (NKPT) dhe kombëtare (MKP-të) në vendet ku njerëzit janë ose mund të jenë privuar nga liria, me qëllim të parandalimit të torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese." NKPT përbëhet nga 25 ekspertë të pavarur dhe mund të monitorojë vendet e mbajtjes, duke përfshirë ato të mbajtjes së imigrantëve, në çdo shtet palë të PFKKT.

☞ **UNHCR:** Në kuadër të përgjegjësisë për mbikëqyrjen e zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare në lidhje me azilkërkesit dhe refugjatët, si dhe në pajtim me mandatin e tij për mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve, UNHCR-i ka një rol të veçantë në monitorimin e mbajtjes së imigrantëve. Statuti i UNHCR-it i vitit 1950 u bën thirrje të gjitha Shteteve që të bashkëpunojnë me Zyrën në ushtrimin e funksioneve të saj, ndërkohë që Shtetet Palë të Konventës së vitit 1951 lidhur me statusin e refugjatëve (KSR) dhe/ose Protokollit të vitit 1967 janë në të vërtetë të obliguara të bashkëpunojnë me Zyrën, përfshirë duke i siguruar UNHCR-it qasje në vendet e mbajtjes, si edhe te azilkërkesit dhe refugjatët në mbajtje.<sup>6</sup>

☞ **Procedurat e posaçme të Këshillit për të Drejtat e Njeriut** mund t'i vizitojnë vendet e mbajtjes së imigrantëve.<sup>7</sup> Këtu përfshihen Raportuesit e posaçëm për torturën, për të drejtat e njeriut për migrantët, për trafikimin personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, si dhe Grupi punues për mbajtjen arbitrare (GPNA). Këta mekanizma mund të realizojnë vizita në vend vetëm me autorizimin paraprak të shtetit në fjalë.

---

☞ **Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq** (KNKK), në kuadër të rolit të tij për vizitimin e të burgosurve të luftës, ka qenë organi kryesor që ka monitoruar vendet e mbajtjes në kontekstin e konflikteve të armatosura. Më vonë, mandati i tij u zgjerua duke i bërë të mundur edhe vizitimin e personave në mbajtje me miratim të qeverisë gjatë trazirave apo tensioneve të brendshme. Këtu përfshihen gjithashtu dhe vendet e ndalimit të imigrantëve.

## NIVELI RAJONAL

---

☞ **Komisioni Afrikan**, përfshirë Raportuesin e posaçëm për refugjatët, azilkërkuesit dhe personat e zhvendosur brenda vendit në Afrikë dhe Raportuesin e posaçëm për burgjet dhe kushtet e mbajtjes në Afrikë.

☞ **Komisioni Ndëramerikan për të Drejtat e Njeriut**, përfshirë mekanizmat e raportimit për të drejtat e migrantëve dhe për të drejtat e personave të privuar nga liria.

☞ **Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës** (KPT) është organi i parë i cili është ngritur enkas për qëllimin e realizimit të vizitave parandaluese në të gjithat vendet e mbajtjes në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë vendet e mbajtjes së imigrantëve. KPT i ka realizuar vizitat e tij të para në vitin 1990.<sup>8</sup>

## NIVELI KOMBËTAR<sup>9</sup>

---

☞ **Mekanizmat kombëtarë parandalues** (MKP): Shtetet palë të PFKKT-së janë të obliguara që të kenë, emërojnë ose ngritin MKP për parandalimin e torturës që janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të vet dhe kanë numër të mjaftueshëm të punonjësve. Shtetet Palë janë të obliguara që t'u sigurojnë MKP-ve qasje në të gjitha vendet e mbajtjes. Këtu përfshihen doemos vendet e mbajtjes së imigrantëve. Në këto raste, MKP ka mandat të drejtpërdrejtë për të bërë vizita të paparalajmëruara në vendet e mbajtjes dhe për të dhënë rekomandime në lidhje me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. MKP-të pritet ta plotësojnë në masë të konsiderueshme monitorimin e mbajtjes së imigrantëve. Në të vërtetë, një numër i konsiderueshëm i



MKP-ve tashmë e kryejnë këtë rol, madje në disa raste kanë efekt të konsiderueshëm. Sipas nenit 19(c) të PFKKT-së, MKP mundën po ashtu “të dorëzojnë propozime dhe vrojtime lidhur me projektligjet apo ligjet ekzistuese.”

⇒ **Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut** (IKDNJ) kanë mandat të gjerë për monitorimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe ato që lidhen me vendet e mbajtjes. Shpesh, ato kanë role aktive të monitorimit, përfshirë në kontekst të mbajtjes së imigrantëve. Disa sosh kanë prodhuar literaturë dhe dokumentacion të çmuar për mbajtjen e imigrantëve dhe përbëjnë burim të rëndësishëm në zhvillimin e çdo programi të monitorimit. Shumë qeveri e kanë caktuar një IKDNJ si MKP në kuadër të PFKKT-së.

⇒ **Organizatat joqeveritare (OJQ)** në disa vende janë të autorizuara që të monitorojnë vendet e ndalimit. Zakonisht, monitorimi nga ana e shoqërisë civile karakterizohet nga një shkallë e madhe e pavarësisë nga autoritetet. Për shkak të pavarësisë së tyre, gjetjet dhe raportet e tyre shpesh fitojnë publicitet të madh. Megjithatë, baza ligjore për monitorim mund të jetë shpesh e dobët, e bazuar në marrëveshje gojore ose me shkrim me ministritë përkatëse, ose madje dhe me ndonjë ministër individual. Kjo bën që monitoruesit të jenë të varur nga vullneti politik i autoriteteve. Në disa vende, mungesa e fondeve madje edhe për t'i mbuluar shpenzimet e udhëtimit mund ta bëjë detyrën e monitorimit të vazhdueshëm shumë sfiduese për grupe të tilla të pavarura .

⇒ **Deputetët** në shumicën dërrmuese të vendeve kanë kompetenca të gjera për t'i vizituar vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë edhe imigrantët.<sup>10</sup> Në disa vende, kjo përfshin dhe të drejtën për vizita të paparalajmëruara.

Asnjë prej mekanizmave ekzistues nuk veprojnë në një vakum dhe të gjithë kanë një vlerë të veçantë për t'i shtuar sistemit kompleks të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se organet që kryejnë vizita në vendet e mbajtjes duhet të gjejnë mënyra të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit, e në disa raste madje edhe raporteve. Shumë sosh tashmë i bashkërendojnë aktivitetet e tyre shumë mirë.

## 1.2 QËLLIMET E DORACAKUT

Qëllimet specifike të Doracakut janë:

- Të shërbejë si vegël praktike që do t'ju ndihmojë organeve vizituese për t'i monitoruar të gjitha aspektet e mbajtjes së imigrantëve;
- Të përmirësojë cilësinë, qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë e monitorimit të mbajtjes së imigrantëve;
- Të sigurojë kornizë dhe pikarritje universalisht të zbatueshme për monitorimin e kushteve të mbajtjes së imigrantëve, ndërsa monitoruesit inkurajohen që të jenë të vëmendshëm ndaj veçantive të situatës të cilën e monitorojnë;
- T'u mundësojë organeve vizituese që t'i identifikojnë imigrantët të cilët mbahen në ndalim dhe të cilët kanë ose mund të kenë të drejtë për mbrojtje ndërkombëtare ose mënyra tjera të rregullimit të statusit të tyre, si dhe të sigurojnë se po u plotësohen nevojat e veçanta;
- Të japë udhëzime për intervenimet pasuese, përfshirë ngritjen e mekanizmave për referim tek organizatat dhe ofruesit përkatës të shërbimeve;
- Të promovojë praktika të monitorimit me bashkëpunim dhe që plotësojnë njëri-tjetrin mes organeve të ndryshme vizituese në nivel kombëtar, si dhe mes organeve rajonale dhe ndërkombëtare.

## 2 MBAJTJA NË KONTEKSTIN E IMIGRIMIT

“ Për të mos e cenuar të drejtën e personave për liri dhe siguri dhe për t'i mbrojtur nga arbitrariteti, mbajtja e imigrantëve duhet të parashihet me ligj dhe të bëhet vetëm kur një gjë e tillë është e domosdoshme, e arsyeshme dhe proporcionale me qëllimet që duhet të arrihen.

Raportuesi i posaçëm për të drejtat e njeriut për migrantët. A/HRC/20/24, §9 prill 2012.

“ Nëse duhet bërë mbajtja administrative, parimi i proporcionalitetit përcakton që ai të përdoret vetëm si mjet i fundit. Duhet të respektohen kufizimet ligjore strikte dhe të parashihen masa mbrojtëse gjyqësore. Arsyet e dhëna nga shtetet për ta justifikuar mbajtjen, sikurse domosdoshmëria e identifikimit të imigrantit me status të parregullt, rreziku i arratisjes ose lehtësimi i largimit të një imigranti të parregullt të cilit i është dorëzuar urdhri për largim, duhet të përcaktohen dhe të renditen në mënyrë shteruese në legjislacion.

GPKN, Raport për seancën e trembëdhjetë të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, A/HRC/13/30, janar 2010.

Mbajtja e imigrantëve është përgjithësisht administrative për nga natyra (megjithëse në disa kontekste mund të bëhet pas shqiptimit të dënimit penal). Ndryshe nga paraburgimi në sistemin e drejtësisë penale, ai nuk ka si qëllim të jetë ndëshkues qoftë në kuptim të qëllimit ose efektit. Pra, është detyrë e shtetit që privimin nga liria ta zbusë për aq sa të jetë e mundshme duke siguruar që trajtimi dhe kushtet e mbajtjes të jenë dinjitoze dhe në pajtim me statusin jopenal të imigrantëve në mbajtje.

## 2.1 PËRSE MBAHEN NJERËZIT?

Ndonëse mbajtja e imigrantëve mund të jetë e lejueshme në raste individuale, qeveritë japin shpesh arsytetime të gjëra politike për mbajtjen sistematike të azilkërkuesve dhe imigrantëve që vënë në hije standardet ndërkombëtare të përpiluara me kujdes si dhe kushtin e vlerësimit të domosdoshmërisë së mbajtjes për secilin rast veç e veç.<sup>11</sup> Arsyetimet e tilla politike përfshijnë zakonisht pretendimet për ruajtjen e sovranitetit, kontrollin e kufijve, sigurinë kombëtare, sigurinë publike, si dhe deportimin ose dëbimin. Ndërsa këto konsiderata politike formojnë sfondin për shumë politika qeveritare të mbajtjes ato nuk mund të përdoren për të mbështetur mbajtjen e njëtrajtshme dhe të gjithëmbarshme të azilkërkuesve dhe imigrantëve. Mbajtja përdoret kohë pas kohe dhe si mjet për kufizimin e pjesëmarrjes apo angazhimit në shoqëri (si në aspektin social ashtu dhe atë ekonomik) pengimin e bashkimit familjar, parandalimin ose pengimin e asaj që perceptohet si migrim i pamërituar ose i paarsyetuar, dhe si mjet për kufizim të qasjes në avokatë, procedurat e azilit/imigrimit, dhe tek të tjerët në komunitet. Këto arsytetime të gjera të politikave për mbajtje nuk janë në përputhje me kornizën ligjore ndërkombëtare.

## 2.2 KUSH MBAHET ?

Personat të cilët mbahen në vendet e mbajtjes së imigrantëve mund të përfshijnë refugjatë, azilkërkues, azilkërkues të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil, persona pa shtetësi, persona të trafikuar, migrantë të kontrabanduar, apo migrantët e parregullt në përgjithësi. Njerëzit mund të mbahen për shkak të shkeljes së kushteve të qëndrimit (p.sh. shkelje të ndalesës së të drejtës për punë, arratisje nga një procedim për azil ose tejkalim i periudhës së qëndrimit); për shkak se janë subjekt i akuzave penale ose kundërvajtjeve tjera administrative që kanë të bëjnë me, për shembull, hyrjen apo qëndrimin e paautorizuar a të parregullt; ose për shkak të procedurave të dëbimit/deportimit.

Personat në mbajtje mund të jenë burra dhe gra të pamartuar, si edhe fëmijë, përfshirë fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë, dhe familjet. Përvoja e mbajtjes së imigrantëve është dëshmuar se shkakton probleme të rënda të shëndetit fizik dhe mendor dhe mund t'i nxisë ose përkeqësojë disa cënueshmëri ekzistuese, sidomos për personat me nevoja të veçanta. Në të gjitha situatat e mbajtjes së imigrantëve, organet vizituese kanë një rol të rëndësishëm në monitorimin e sigurisë, trajtimit dhe nevojave të shëndetit mendor dhe fizik të personave të ndaluar, si dhe nevojave të tyre për përfaqësim dhe mbështetje.

## 2.3 NË Ç' VEND MBAHEN NJERËZIT?

“Vendet e mbajtjes së imigrantëve” përfshijnë çdo vend ku personi privohet nga liria e tij/saj në bazë të statusit të tij/saj imigrimit. Vendet e këtylla mund të përfshijnë:

- qendrat e posaçme të mbajtjes së imigrantëve;
- qendra e largimit ose transitit;
- qendrat e mbyllura për pritje ose procedim;
- qendrat gjysmë të hapura dalja nga të cilat është e lejuar ose mund të lejohet;
- aeroportet, portet, zonat transit dhe “zonat ndërkombëtare”, objektet nëpër limane, ishujt;
- automjetet, aeroplanët, anijet ose mjetet tjera të transportit ujor;
- burgjet, qelitë e policisë ose stacionet policore;
- burgjet ose qelitë për personelin ushtarak, ose bazat ushtarake;
- shtëpitë, hanet, hotelet dhe vendet tjera në komunitet nga të cilat banorët nuk mund të largohen;
- institucionet psikiatrike dhe spitalet;
- magazinat që nuk janë në përdorim ose hapësirat e kompanive private të sigurimit;
- ose çdo vend tjetër ku njerëzit privohen fizikisht nga liria.

Pavarësisht nga vendi i mbajtjes në të cilin mbahet imigranti i ndaluar, vendndodhja e personit në mbajtje duhet të regjistrohet në një regjister

qendror, dhe pasi të jetë ndaluar në mbajtje ai/ajo ka të drejtë të informojë anëtarët e familjes ose personat tjerë përkatës përkitazi me vendndodhjen e tij/saj të saktë<sup>12</sup> dhe vendin e mbajtjes, si dhe për çdo transfer të mëvonshëm. Natyra ose vendndodhja e vendit të n nuk duhet që në asnjë rast të përbëjë pengesë për ushtrimin e ndonjëres nga të drejtat e imigrantit të ndaluar.

## 2.4 PËR SA KOHË Mbahen NJERËZIT?

Kohëzgjatja e mbajtjes dallon shumë. Në disa juridiksione, kornizat ligjore kombëtare janë shumë tolerante, duke bërë të mundur që njerëzit të mbahen në ndalim për periudha shumë të gjata kohore dhe madje nganjëherë për afat të pacaktuar. Disa nga shembujt më flagrantë të mbajtjes në afat të pacaktuar kanë lindur në kontekstin e praktikave *ad-hoc* të mbajtjes. Nëse mbajtës bëhet vetëm për qëllime të largimit, kohëzgjatja ka më shumë të ngjarë që të jetë më e shkurtër dhe të jetë e arsyeshme për atë kohë sa zgjat procedimi i deportimit ose të mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme largimi. Megjithatë, nëse mbajtja bëhet për tërë kohën sa zgjasin procedurat administrative dhe/ose gjyqësore ose largimi nuk është i mundur, ajo mund të stërzgjatet dukshëm. Në disa juridiksione, periudha fillestare e mbajtjes për qëllime të kontrollit shëndetësor, të identitetit a të sigurisë pasohet nga një vendim gjyqësor ose **kuazigjyqësor** për lirim ose vazhdimin e mbajtjes .

Kohëzgjatja e mbajtjes duhet të jetë gjithnjë çështje me interes për monitoruesit, dhe jo vetëm për shkak të efekteve të dëmshme në shëndetin mendor dhe fizik të personave në mbajtje të cilët mbahen në ndalim për afat të gjatë ose të pacaktuar.<sup>13</sup> Njëherazi, do të ishte e rrezikshme të supozohet se në qoftë se mbajtja është afatshkurtër, ajo është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kohëzgjatja maksimale e mbajtjes së imigrantëve duhet të përcaktohet me ligj.<sup>14</sup>

## 2.5 KUSH NDALON?

Autoritetet publike të angazhuara në praktikën e ndalimit dhe mbajtjes së imigrantëve mund të përfshijnë policinë, zyrtarët e burgjeve, autoritetet e imigrimit, rojet kufitare,<sup>15</sup> ushtrinë dhe forcat e sigurisë, ose flotën dhe rojën bregdetare. Gjithashtu, disa shtete ua

nënkontraktojnë funksionin e ndalimit dhe mbajtjes së imigrantëve kompanive private, që janë shpesh kompani që menaxhojnë me burgjet.<sup>16</sup>

Ndonëse gama e agjentëve të ndalimit/mbajtjes ngre pikëpyetje të rëndësishme sa i përket llogaridhënies, në asnjë rast nuk mund të pretendohet se Shteti heq dorë ose zhvesh veten nga përgjegjësia për të siguruar pajtueshmërinë e ndalimit/mbajtjes në territorin ose nën juridiksionin, kompetencën ose kontrollin efektiv të tij me standardet ligjore ndërkombëtare dhe vendore.<sup>17</sup> Disa aspekte të menaxhimit të mbajtjes, përfshirë objektin ose administrimin e objektit të mbajtjes, mund të menaxhohen dhe drejtohen nga kompanitë private. Këto kompani private mund të besojnë se nuk janë objekt i mbikëqyrjes në të njëjtën mënyrë sikurse institucionet publike apo shtetërore. Është me rëndësi që bashkëpunëtorët e tillë privat të informohen se llogaridhënia dhe mbikëqyrja e respektimit të të drejtave e njeriut shtrihet në të gjitha objektet e -mbajtjes, pavarësisht nëse ato menaxhohen privatisht ose publikisht. Për më tepër, ajo çfarë është po ashtu e qartë është se autoritetet përgjegjëse kombëtare nuk mund t'i kontraktojnë detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e refugjatëve sipas së drejtës ndërkombëtare dhe vazhdojnë të mbajnë përgjegjësi sipas të drejtës ndërkombëtare. Kështu, shtetet duhet të sigurojnë se mund të mbikëqyrin në mënyrë efektive veprimtarinë e kontraktorëve privatë, përfshirë nëpërmjet sigurimit të mekanizmave adekuat të pavarur të monitorimit dhe llogaridhënies.<sup>18</sup>

## 2.6 MBAJTJA E IMIGRANTËVE DHE KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR

E drejta ndërkombëtare parasheh që kufizimi i lirisë dhe përdorimi i masës së jashtëzakonshme të mbajtjes të lejohen vetëm kur janë ligjor dhe joarbitrar. Kriteri i ligjshmërisë nënkupton që çdo kufizim i lirisë, përfshirë mbajtjen, mund të shqiptohet vetëm për shkaqe të parapara me ligj dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj.<sup>19</sup> Prandaj, çdo mbajtje e imigrantëve e cila nuk është përcaktuar shprehimisht në ligjet e brendshme të Shteteve do të jetë doemos i paligjshëm dhe i palejueshëm.

Ndërkohë, ndalesa për mbajtjen në mënyrë arbitrare<sup>20</sup> përcakton që të merren disa masa mbrojtëse shtesë për të siguruar paanshmëri dhe mosdiskriminim. Në radhë të parë, mbajtja duhet të jetë në shërbim të


një qëllimi legjitim. "Qëllimet legjitime" në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve janë të njëllajta për azilkërkuesit dhe migrantët sikurse dhe për gjithë të tjerët: kur dikush paraqet një rrezik për arratisje nga procedura e ardhme ligjore ose proceset administrative apo kur dikush përbën rrezik për veten ose sigurinë publike.<sup>21</sup> Penalizimi i hyrjes së parregullt të azilkërkuesve dhe migrantëve "e tejkalon interesin legjitim të shteteve"<sup>22</sup> gjithmonë dhe, për rrjedhojë, do të jetë arbitrar.


Në radhë të dytë, edhe në qoftë se supozohet se shteti ka një qëllim legjitim për shqiptimin e mbajtjes, çdo mbajtje e imigrantëve duhet të jetë e domosdoshme, e arsyeshme dhe proporcionale<sup>23</sup> në të gjitha rrethanat e rastit.<sup>24</sup> Për këtë kërkohet të bëhet vlerësimi individual i secilit rast të mbajtjes së imigrantëve. Kështu, të gjitha vendimet e mbajtjes në grup ose mbajtjes diskriminuese të azilkërkuesve dhe emigrantëve janë arbitrare. Këto kritere të domosdoshmërisë, arsyeshmërisë dhe proporcionalitetit zbatohen njëllaj për të gjithë personat të cilët janë objekt i çfarëdolloj mbajtjeje. Ato zbatohen për të gjithë personat të cilët janë objekt i mbajtjes në imigrim, pavarësisht nga statusi i tyre i imigrimit.<sup>25</sup>

Në fund, mbajtja duhet t'u nënshtrohet rishikimeve kuptimplota, të zbatueshme dhe të pavarura periodike.<sup>26</sup>

## **KUTIA 2.1 UDHËZIMET E UNHCR-it MBI MBAJTJEN**

Në rastin e personave të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, Udhëzimet e UNHCR-it për kriteret dhe standardet që zbatohen në lidhje me mbajtjen e azilkërkuesve dhe alternativat ndaj mbajtjes të vitit 2012 përcaktojnë rregulla ndërkombëtare që rregullojnë vendimet për mbajtjen e personave të tillë dhe standardet e trajtimit për të cilin kanë të drejtë ata, gjegjësisht:

 **Udhëzimi 1:** E drejta për të kërkuar azil duhet të respektohet.

 **Udhëzimi 2:** E drejta për liri dhe siguri dhe e drejta për liri të lëvizjes zbatohen për azilkërkuesit.



- 
- **Udhëzimi 3:** Mbatjtja duhet të jetë në përputhje me dhe e lejuar me ligj.
- 
- **Udhëzimi 4:** Mbatjtja nuk duhet të jetë arbitrare, dhe çdo vendim për mbatjtje duhet të jetë i bazuar në vlerësimin e rrethanave të veçanta të personit që ndalohe në mbatjtje.
- 
- **Udhëzimi 4.1:** Mbatjtja është masë e jashtëzakonshme dhe mund të arsyetohet vetëm në qoftë se i shërben një qëllimi legjitim.
- 
- **Udhëzimi 4.2:** Mbatjtja mund të përdoret si mjet i fundit vetëm kur të konstatohet se është e domosdoshme, i arsyeshme në të gjitha rrethanat dhe proporcional me qëllimin legjitim.
- 
- **Udhëzimi 4.3:** Duhet të merren në konsideratë alternativat tjera përpos mbatjtjes.
- 
- **Udhëzimi 5:** Mbatjtja nuk duhet të jetë diskriminuese.
- 
- **Udhëzimi 6:** Mbatjtja në afat të pacaktuar është arbitrare dhe kohëzgjatja maksimale e mbatjtjes duhet të jetë e përcaktuar me ligj.
- 
- **Udhëzimi 7:** Vendimi për mbatjtje ose zgjatjen e mbatjtjes duhet t'u nënshtrohet garancive procedurale minimale.
- 
- **Udhëzimi 8:** Kushtet e mbatjtjes duhet të jenë njerëzore dhe dinjitoze.
- 
- **Udhëzimi 9:** Rrethanat dhe nevojat e veçanta të azilkërkuesve individual duhet të merren parasysh.
- 
- **Udhëzimi 10:** Mbatjtja duhet t'i nënshtrohet monitorimit dhe inspektimit të pavarur.

Kuadri ligjor kombëtar që rregullon mbajtjen ofron kontekst të rëndësishëm për nevojat e monitorimit. Monitoruesit nuk do të jenë gjithmonë në gjendje që të vlerësojnë nëse mbajtja në një rast të caktuar është arbitrare ose e paligjshme; vlerësimi i tillë duhet bërë në dritën e ligjit ashtu dhe të fakteve dhe është zakonisht çështje për gjykatat. Megjithatë, edhe në qoftë se një vlerësim i tillë i tejkalon kapacitetet ose kompetencat e monitoruesve, është me rëndësi që ata t'i njohin standarde ligjore të aplikueshme dhe të kenë parasyh rrezikun që personat në mbajtje mund të jenë duke u mbajtur në mënyrë arbitrare ose të kundërligjshme në vendet e mbajtjes së imigrantëve.

Në mënyrë të veçantë, nëse konstatohet se mbajtja në një rast individual ka qenë arbitrare ose i kundërligjshme sipas ligjit vendor ose të drejtës ndërkombëtare, ose kur dihet se mbajtja e tillë është pjesë e një problemi më të përhapur ose sistemik, privimi nga liria duhet të kuptohet jo vetëm si shkelje e ndalesës së mbajtjes arbitrare ose të kundërligjshme, por edhe në kontekstin e ekzistimit të rrezikut të shtuar për shkelje të tjera të të drejtave të personave në mbajtje, duke përfshirë torturën dhe format tjera të keqtrajtitimit.

# 3 MBAJTJA E IMIGRANTËVE: METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Për monitorimin e mbatjes së imigrantëve kërkohet që në strategjinë e monitorimit të merren parasysh specifikat e regjimit të ndalimit (pjesët 3.1 dhe 3.2).

Vizitimi i vendeve të mbatjes është mënyra kryesore për të marrë informata të dorës së parë për sa i përket trajtimit të personave në mbajtje, kushteve të tyre dhe funksionimit të vendeve të mbatjes. Realizimi i këtyre vizitave është proces në tre hapa që përfshin:

- 
- Përgatitja e vizitës (pjesa 3.3)

---

  - Realizimi i vizitës (pjesa 3.4)

---

  - Veprimet pasuese pas vizitës (pjesa 3.5)

## 3.1 MONITORIMI I VENDEVE TË MBAJTJES NË KONTEKSTIN E IMIGRIMIT

### 3.1.1 Sfidat e monitorimit të mbajtjes së imigrantëve

Një nga sfidat kryesore të monitorimit efektiv të mbajtjes së imigrantëve është se kuadri ligjor në fuqi në disa vende mund të mos i plotësojë standardet minimale ndërkombëtare kundër mbajtjes arbitrare dhe të kundërligjshme. Kjo do të thotë se problem kryesor për personin në mbajtje mund të jetë para së gjithash vet mbajtja. Kjo është arsyeja pse ky Doracak e cilëson monitorimin e faktit të mbajtjes arbitrare dhe të kundërligjshme, si dhe mundësive të mbajtjes së stërzgatur dhe/ose në afat të pacaktuar në veçanti, si një gjë po aq të rëndësishme sa dhe trajtimi dhe kushtet e mbajtjes, e që janë në të vërtetë të ndërlidhura në mënyrë të pandashme me njëra-tjetrën. Sigurisht që organet vizituese nuk kanë rëndom kompetencë që të urdhërojnë lirin e një personi në mbajtje. Në këtë kuptim, roli i tyre kufizohet zakonisht në dhënien e rekomandimeve dhe përcjelljen e rasteve. Në të vërtetë, ata mund të japin rekomandime duke identifikuar, dokumentuar dhe raportuar për efektet e përvojës së mbajtjes (të tilla si kohëzgjatja e mbajtjes apo qasja në procedura) tek personat e mbajtur dhe, për rrjedhojë, mangësitë në kornizën ligjore mbi mbajtjen. Referimet tek organet tjera që kanë autoritetin dhe rolin për të ndërmjetësuar në emër të personave të cilët janë nëmbajtje mund të jetë pjesë e strategjisë së veprimeve pasuese.

Sfidat tjera në lidhjen me përmasat e problemit, përfshirë numrin e njerëzve të cilët janë nëmbajtje dhe numrin e vendeve të mbajtjes.

#### MONITORIMI

Në këtë Doracak, “monitorimi” përshkruan procesin e verifikimit periodik ose të rregullt të mbajtjes së imigrantëve përmes vizitave në vendet e mbajtjes. Verifikimi mund të përfshijë gjithë kategoritë e imigrantëve të cilët mbahen në një a më shumë lloje të mbajtjes, ose vetëm disa sosh, dhe mund të bëhet për një çështje të caktuar ose të jete vizite me gjithëpërfshirëse.

Vendet e mbajtjes së imigrantëve që ndodhen në zona të largëta ose të paqasshme përbëjnë po ashtu sfidë më vete. Në disa kontekste sifidë është po ashtu mohimi i qasjes në vendet e mbajtjes së imigrantëve, ose qasja e kufizuar, dhe duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të strategjisë së monitorimit.

### 3.1.2 Çfarë nënkuptohet me monitorimin e mbajtjes së imigrantëve?

Disa organizata realizojnë vizita me qëllim të studimit të ndonjë dosje individuale, që mund të shpalosë informata rreth çështjeve më sistemore apo strukturore dhe në kontekstin e emigracionit në veçanti mund të ngritë pikëpyetje rreth përshtatshmërisë së mekanizmave të referimit për azil ose procedura të tjera.

Element thelbësor në çdo sistem të monitorimit janë vizitat e shpeshta, të paparalajmëruara të organeve të pavarura në vendet ku mbahen azilkërkuesit dhe imigrantët. Vizitat e tilla jo vetëm që sigurojnë njëfarë llogaridhënie, porse i shërbejnë edhe një qëllimi të rëndësishëm parandalues të tillë si minimizimi i rreziqeve të *kthimit mbrapsht*, deportimit ilegal ose të kundërligjshëm,<sup>27</sup> torturës apo keqtrajtimit. Nga ana tjetër, organet vizituese mund t'i lajmërojnë vizitat paraprakisht në mënyrë që të sigurojnë praninë e personit përgjegjës për qendrën. Paralajmërimi i vizitës mund të shërbejë për ndërtimin e një dialogu konstruktiv me autoritetet që bazohet në respekt dhe besim të ndërsjellë. Vendimi për llojin e vizitës që duhet bërë, dhe kur duhet bërë ajo, është element i rëndësishëm i një strategjie afatgjatë të monitorimit. Me kalimin e kohës qasja e zbatuar mund të sjellë një ndryshim në kulturën e organit përgjegjës për mbajtje. Të gjitha vizitat duhet të pasohen nga raporte me shkrim për autoritetet e mbajtjes dhe të tjerët, dhe të shoqërohen me rekomandime. Tipar themelor i monitorimit është se ai zhvillohet në kontekstin e një qasje parandaluese, që mëton shmangien e shkeljeve të të drejtave të njeriut para se ato të ndodhin. Në kuadër të monitorimit të mbajtjes së imigrantëve mund të shqyrtohen gjithë aspektet e mbajtjes, ose vetëm disa sosh, duke mbajtur parasysh se ata janë të ndërlidhur dhe në varësi të kontekstit munden të përforcojnë ose edhe të dëmtojnë a të dobëcojnë mbrojtjet nga shkeljet e standardeve. Qëllimi është të

---

identifikohen shqetësimet sistemore apo strukturore.

### **KUTIA 3. ASPEKTET E MBAJTJES QË DUHEN MONITORUAR**

Monitorimi shqyrton aspektet e mëposhtme të mbajtjes:

- Kuadrin ligjor që përcakton bazën për mbajtjen e imigrantëve.
- Kuadrin administrativ që rregullon zbatimin e skemës së mbajtjes së imigrantëve në nivel operacional.
- Kushtet e jetesës së imigrantëve të cilët mbahen në ndalim.
- Regjimin e mbajtjes sa u përket aktiviteteve.
- Trajtimin dhe kujdesin ndaj imigrantëve në mbajtje.
- Punën, organizimin dhe menaxhimin e përditshëm të vendit të mbajtjes dhe efektin tek personat në mbajtje, si edhe personeli.
- Qasjen e imigrantit në mbajtje në kujdes, këshilla dhe ndihmë profesionale, përfshirë: • shërbime shëndetësore; • UNHCR-i, organizatat tjera ndërkombëtare ose joqeveritare dhe/ose asistencë konsullore; • ndihmën juridike.
- Qasjen e imigrantit në mbajtje në: • familjen; • procedurat e azilit dhe imigrimit; • informata lidhur me të drejtat e tyre dhe bazën për mbajtjen e tyre; • mekanizma efektiv të ankimit dhe mjeteve juridike pranë një autoriteti gjyqësor.<sup>28</sup>
- Cilësinë dhe natyrën e raporteve mes imigrantëve në mbajtje, personelit, menaxhmentit dhe autoriteteve të mbajtjes; dhe
- Marrëdhëniet e personelit me personat në mbajtje dhe kushtet e punës së personelit.

Duke i monitoruar gjithë këto aspekte të mbajtjes së imigrantëve, që së bashku japin një pasqyrë të kushteve të përgjithshme të mbajtjes dhe trajtimit të të ndaluarve, është e mundur të përcaktohet nëse mjedisi ku mbahen të ndaluarit paraqet rrezik për shkelje të të drejtave të njeriut dhe çfarë hapash duhet të ndërmerren nga autoritetet për të reaguar ndaj këtyre rreziqeve.

Është me rëndësi të mbahet mend se problemet nuk mund të zgjidhen vetëm me vizita. Disa nga shkaqet rrënjësore të problemeve mund të gjenden në legjislacion, politikat publike apo vetë institucionet.

### 3.1.3 Monitorimi i mbajtjes së imigrantëve: Cenueshmëritë

Imigrantët e nëmbajtje janë në pozitë të cenueshme në shumë aspekte. Në përgjithësi, imigrantët në mbajtje privohen nga liria për periudha kohore të pacaktuara si rezultat i mungesës apo statusit të paqartë të imigrimit. Kjo mungesë informatash në lidhje me situatën e tyre individuale i vë ata në pozitë edhe më të cenueshme. Ata ndodhen jashtë vendit të tyre të origjinës ose vendbanimit të mëhershëm; ata shpesh nuk e flasin gjuhën dhe mund të mos kenë mbështetje të fortë nga familja apo komuniteti. Përveçse ndjehen të pasigurt në mjedisin e mbajtjes, ndjenja e tyre e pasigurisë përkeqësohet shpesh dhe më nga droja për të ardhmen që i pret dhe në ç'vend do të jetë kjo e ardhme. Gjithashtu, ata mund të besojnë me të drejtë apo gabimisht se njerëzit që ushtrojnë pushtet mbi ta duke i ndaluar në mbajtje e kanë në dorë të vendosin të ardhmen e tyre. Ekziston një rrezik real që ata që ndodhen në pjesën e sipërme të këtij ekuacioni të pushtetit mund t'i keqpërdorin implikimet e vërteta ose të perceptuara të një disbalanci të tillë të pushtetit.

Veç kësaj, monitoruesit duhet të jenë posaçërisht të vëmendshëm ndaj çështjes së cenueshmërive të shumta. Imigrantët në mbajtje tashmë ndodhen në një situatë të cenueshme, që mund të përkeqësohet edhe më tej për personat me nevoja të veçanta apo kategoritë e rrezikuara (sikurse gratë, fëmijët, përfshirë fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë, grupet e ndryshme etnike/fisnore/shoqërore që mbahen së bashku, viktimat e torturës ose traumës, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, personat LGBTI, apo ata me nevoja urgjente mjekësore).<sup>29</sup>



### 3.1.4 Fitimi i qasjes për qëllime të monitorimit

Ky Doracak u dedikohet kryesisht organeve vizituese që kanë tashmë qasje te personat në mbajtje dhe vendet e mbajtjes së imigrantëve të paraparë me ligj ose duke u mbështetur në një mandat, memorandum mirëkuptimi ose marrëveshje ekzistuese apo të krijuar enkas.<sup>30</sup>

Nëse është dhënë autorizimi, është thelbësore që kushtet e qasjes të përshkruhen në mënyrë të qartë me shkrim për të siguruar që natyra dhe shtrirja e qasjes të jetë e qartë për të gjitha palët.

Përveç kësaj, varësisht nga strategjia dhe mandati i monitoruesve mund të diskutohet mundësia e sjelljes së pajisjeve elektronike siç janë aparatet fotografike ose pajisjet e regjistrimit. Kjo duhet të vlerësohet me shumë kujdes kundrejt nevojave dhe të shqyrtohet nëse do të ketë vërtet një vlerë të shtuar për arritjen e qëllimeve.

Madje dhe në rastin e mandateve më të gjera, organet vizituese duhet të sigurojnë që ta përdorin autorizimin e tyre me respekt dhe në mënyrë strategjike. Shumëçka do të varet nga forca dhe stabiliteti i mandatit, marrëveshja e arritur me autoritetet sa i përket qasjes, lloji i vendit të mbajtjes dhe çështjet që adresohen.

### 3.3 QASJA NË VENDET E MBAJTJES

Duke u mbështetur në mandatet ekzistuese dhe standardet e monitorimit, negocimi i kushteve të qasjes duhet të adresojë dhe të përfshijë për aq sa të jetë e mundur sa vijon:

#### ➤ Qasja në vendet e mbajtjes:

- qasje e pakufizuar në të gjitha vendet e mbajtjes;
- liria për t'i zgjedhur vendet e mbajtjes që do vizitohen;
- liria për të zgjedhur pjesë të caktuara të vendit të mbajtjes për të vizituar

#### ➤ Qasja tek personat në mbajtje:

- intervista private me imigrantët në mbajtje pa praninë e dëshmitarëve, po të jetë e nevojshme dhe me ndihmën e përkthyesit;
- qasja tek të gjithë personat në mbajtje të cilët ndodhen në vendin e mbajtjes;
- liria e përzgjedhjes së personave në mbajtje të cilët do intervistohen;
- garancitë se nuk do të urdhërohen, zbatohen, lejohen apo tolerohen sanksione ndaj asnjë personi në mbajtje i cili komunikon me organin vizitues, apo anëtarë të familjes së tij/saj; dhe
- mundësia për të bërë vizita pasuese

#### ➤ Qasja tek personeli dhe tek të tjerët të cilët punojnë në vendin e mbajtjes:

- intervista private me punonjësit, po të jetë e nevojshme dhe me ndihmën e përkthyesit.

#### ➤ Qasja në të gjitha informatat në dispozicion:

- gjithë informatat rreth imigrantëve në mbajtje, përfshirë regjistrat e pranimit dhe të dhënat mjekësore dhe dokumentet tjera në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave;
- koha, kohëzgjatja dhe paralajmërimi i vizitave;
- vizitat mund të bëhen me ose pa paralajmërim;
- vizitat e paralajmëruara mund të bëhen me lajmërim paraprak të shkurtër, lirinë për të vendosur për kohën dhe kohëzgjatjen e vizitës, duke mbajtur parasysh gjatë gjithë kohës nevojën për të respektuar mbarëvajtjen e operimit të vendit të mbajtjes.

#### ➤ Veprimet pasuese pas vizitave, përfshirë qëllimin për përpilimin e një raporti (publik ose të brendshëm) rreth gjetjeve të vizitave.

### **KUTIA 3. PARIMET UDHËHEQËSE TË MONITORIMIT**

Gjatë monitorimit duhet të mbahen parasysh disa çështje të përgjithshme, gjegjësisht: të kuptuarit e kontekstit, të qenit në dijeni të standardeve dhe mos tejkalimi i mandatit. Për më tepër, organet vizituese duhet që gjatë tërë kohës t'i mbajnë parasysh dhe respektojnë disa parime udhëzuese të monitorimit. Në vijim janë dhënë parimet udhëzuese që konsiderohen si të domosdoshme për realizimin efektiv të përgjegjësisë së monitorimit, posaçërisht në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve. Respektimi i këtyre parimeve udhëzuese minimizon rrezikun që procesi i monitorimit të jetë joefektiv apo që pa dashje të shtojë tensionet dhe ankthin në një mjedis të mbajtjes së imigrantëve:

- Mos shkakto dëm!
- Përdor arsyen e shëndoshë
- Respekto autoritetet dhe personelin përgjegjës
- Respekto personat të cilët janë privuar nga liria
- Ji i besueshëm
- Respekto konfidencialitetin
- Respekto sigurinë
- Ji konsistent, këmbëngulës dhe i durueshëm
- Ji i saktë dhe preciz
- Ji i paanshëm, objektiv dhe i pavarur
- Ji i ndjeshëm
- Ji profesional dhe sillu me integritet
- Ji i dukshëm

### **RESPEKTO PARIMIN “MOS SHKAKTO DËM”**

Imigrantët të cilët mbahen në mbajtje janë në një pozitë posaçërisht të cënueshme dhe monitoruesit duhet ta kenë gjithmonë parasysh sigurinë e tyre, duke siguruar që të mos ndërmarrin ndonjë veprim apo masë që mund ta rrezikojë një person apo grup personash. Në veçanti në rastet e pretendimeve për torturë apo keqtrajtim, duhet mbajtur parasysh parimin e konfidencialitetit, sigurisë dhe ndjeshmërisë.

## 3.2 HARTIMI I STRATEGJISË SË MONITORIMIT: ELEMENTËT KYÇ

Për ta maksimizuar ndikimin parandalues të monitorimit të mbajtjes, konteksti specifik i imigrimit duhet të merret parasysh që në fazë të hershme, sidomos kur organet vizituese të jenë duke përcaktuar strategjinë e tyre të monitorimit, përfshirë programin e vizitave.

Gjatë hartimit të strategjisë së monitorimit duhet të merren parasysh elementet e mëposhtme.

### 3.2.1 Të kuptuarit e kontekstit të përgjithshëm të mbajtjes së imigrantëve

Monitoruesit duhet të kërkojnë dhe të mbledhin sa më shumë informata në lidhje me kontekstin social, politik dhe ligjor në të cilin bëhet mbajtja e imigrantëve. Kjo nënkupton:

- Kuptimi i kuadrit ligjor kombëtar përkitazi me mbajtjen: ai mund të ndihmojë në identifikimin e instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që vendi në fjalë i ka ratifikuar dhe për të verifikuar nëse këto instrumente janë pasqyruar në ligjet kombëtare.
- Të kuptuarit e asaj se kush ndalohet në mbajtje dhe kush jo: a ndalohen në mbajtje kryesisht azilkërkuessit, personat pa shtetësi, personat e trafikuar, imigrantët e parregullt, ose persona të tjerë për arsye të imigracionit? Një gjë e tillë mund të shpallë shumë informata për atë nëse alternativat e mbajtjes dhe procedurat e verifikimit para mbajtjes po zbatohen në mënyrë efektive. Po kështu, ekipi do të duhet të marrë në konsideratë nëse kohorta e personave në mbajtje i përket pjesërisht, kryesisht ose tërësisht një grupi njerëzish me përkatësi të caktuar kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare. Kjo do t'u mundësojë monitoruesve që t'i kuptojnë më mirë dhe t'u përgjigjen nevojave dhe dinamikës së personave në mbajtje.

### 3.2.2 Caktimi i synimeve dhe qëllimeve të qarta të monitorimit

Në kuptimin e përgjithshëm, synim i programit të monitorimit të mbajtjes është të sigurohet se imigrantët në mbajtje:

- nuk mbahen në ndalim në mënyrë arbitrare ose të kundërligjshme;
- kanë qasje efektive në mbrojtje dhe procedurat e tjera të imigracionit; dhe
- mbahen në kushte që plotësojnë standardet minimale ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Monitorimi është proces i cili mund të jetë i kushtueshëm dhe të kërkojë punë intensive, andaj është më rëndësi që të hartohet një strategji monitorimi me qëllime të qarta dhe të arritshme ashtu që të mos dështojë për shkak të ambicieve të tepruara. Këto qëllime duhet të përcaktohen në mënyrë sa më specifike që të jetë e mundshme, dhe në një mënyrë të atillë që të japin rezultate të matshme. Më pas mund të caktohen qëllime më të hollësishme në kuadër të përgatitjes për ndonjë vizitë të caktuar.

### 3.2.3 Përcaktimi i kohëzgjatjes së gjithëmbarshme të programit të monitorimit

Është e dëshirueshme që cikli i vizitave monitoruese të planifikohet për një afat kohor sa më të gjatë, dhe që ato të jenë sa më të shpeshta që të jetë e mundur, përfshirë vizitat përcjellëse dhe të sërishme. Ky cikël i plotë duhet të jetë mjaftueshëm i gjatë aq sa të mundësojë monitorimin dhe shqyrtimin e qëndrueshmërisë së ndryshimit.

### 3.2.4 Përzgjedhja e vendeve të mbajtjes tek të cilat duhet fokusuar

Organi vizitues mund ta përpilojë një listë fillestare të të gjitha vendeve ku mund të mbahen azilkërkuesit dhe imigrantët. Vendet e tilla mund të përfshijnë, mes tjerash: qendrat e posaçme të imigrimit, qendrat e largimit ose transitit, qendrat e mbyllura të pranimit apo procedimit, qendrat gjysmë të hapura; aeroportet; zonat ndërkombëtare, automjetot, aeroplanët, anijet ose mjotet tjera, burgjet, stacionet

policore, shtëpitë, hanet, institucionet psikiatrike apo ndonjë vend tjetër ku njerëzit mund të privohen fizikisht nga liria (shih pjesën 2.3). Është me rëndësi të mbahet mend se imigrantët shpesh mbahen në ndalim në lokacione të largëta.

Duhet të monitorohen fazat e ndryshme të mbajtjes së imigrantëve, siç janë pikat e mbërritjes dhe objektet kufitare (përfshirë portet ose aeroportet ndërkombëtare), proceset e transferimit, qendrat e nisjes dhe largimit, dhe në disa raste qendrat e pritjes së imigrantëve të dëbuar që ndodhen në vendin e origjinës apo ndonjë vend tjetër të tretë.

Përzgjedhja e vendeve për t'i vizituar mund të bëhet në bazë të rreziqeve (si potenciale ashtu dhe të vërteta) që u kanosen njerëzve të cilët mbahen në vendet për mbajtjen e imigrantëve, apo me qëllim të mbulimit të objekteve kryesore të mbajtjes ku mbahen pjesa më e madhe e personave të ndaluar. Këtu mund të përfshihen vendet:

- rreth të cilave ka pak informacione;
- ku ka shumë persona në situatë të cenueshme;
- ku një numër i madh azilkërkesish dhe imigrantësh privohen nga liria, siç janë zonat ndërkombëtare, portet detare ose aeroportet;
- me rrezikshmëri të lartë, d.m.th. histori të dokumentuar mirë të problemeve (sikurse ankesa të kohëve të fundit, raporte të organizatave të tjera).

### 3.2.5 Natyra dhe kohëzgjatja e vizitave monitoruese

Siç u vu në dukje më herët, në dritën e specifikave të mbajtjes së imigrantëve, disa vizita do të duhet të bëhen pa paralajmërim për të minimizuar rreziqet e *kthimit mbrapsht*, deportimit të detyruar ose të torturës a keqtrajtimit. Vizitat e paparalajmëruara janë po ashtu të dobishme në kuptimin e pakësimit të gjasave që objekti ku janë të vendosur personat në mbajtje të përmirësohet përkohësisht për qëllime të vizitës (p.sh. trajtimi ndaj personave në mbajtje, shërbimi i ushqimit ose kushtet e përgjithshme të mbajtjes). Organet vizituese do të duhet të vendosin nëse do të bëjnë vetëm vizita të paparalajmëruara ose një kombinim të atyre të paparalajmëruara dhe vizitave të lajmëruara paraprakisht. Kohëzgjatja e vizitave do të varet nga variabla të shumta, përfshirë madhësinë e vendeve dhe nëse do ketë nevojë për përkthim,

e që mund ta dyfishojë kohën e nevojshme për realizimin e një interviste. Sido që të jetë, monitoruesit do të duhet ta kenë një shkallë fleksibiliteti në mënyrë që të sigurojnë se mund të reagojnë ndaj problemeve apo incidenteve të papritura.

### 3.2.6 Shpeshësia e vizitave monitoruese

Përvoja tregon se vizitat monitoruese do të jenë shumë më efektive si mjet për parandalimin e torturës, keqtrajtimit a të *kthimit mbrapsht* dhe për arritjen e përmirësimit të qëndrueshëm në të gjitha këto aspekte, në qoftë se ato ndodhin shpesh.

### 3.2.7 Përbërja dhe madhësia e ekipit monitorues

Gjersa ky Doracak promovon metodologjinë e punës ekimore si praktikë më të mirë, organizata të caktuara mund ta kenë praktikë standarde që të dërgojnë një monitorues të vetëm apo ekip në përbërje të dy personave, varësisht nga burimet dhe konsideratat tjera. Madhësia e ekipit të monitoruesve do të varet gjithashtu dhe nga disa faktorë që lidhen me fushëveprimin e vizitës. Sidoqoftë, qasja e paraqitur në këtë Doracak duhet ta orientojë vizitën. Kjo përfshin qëllimet e vizitës, sasinë dhe cilësinë e informatave që ekipi i ka tashmë në dispozicion, si dhe madhësinë e vendit të mbajtjes dhe numrin e personave në mbajtje. Në të gjitha rastet duhet që të identifikohet gjithmonë një person i cili do të udhëheqë me ekipin dhe të jetë përgjegjës për bashkërendimin e vizitës.

Është e dëshirueshme që ekipi i monitoruesve të ketë në përbërje persona me përgatitje profesionale nga më të ndryshmet, si edhe tipare personale të tilla si aftësi të dëgjimit dhe ndjeshmëri ndaj diversitetit kulturor. Përparësi e madhe do të jetë po ashtu që ekipi të ketë balanc gjinor, dhe në këtë kontekst të veçantë është me rëndësi që në përbërjen e organit vizitues të ketë njerëz me përkatësi të ndryshme etnike dhe fetare. Për më tepër, ekipi i monitoruesve do të përfonte tejet shumë nga prania e anëtarëve me aftësitë përkatëse gjuhësore (madje edhe në qoftë se ata nuk janë të rrjedhshëm dhe ende do të ketë nevojë për përkthim) në radhët e tij, meqë kështu do ta kenë më të lehtë që të fitojnë besimin e personave të ndaluar.





### 3.5 SHPESHTËSIA E VIZITAVE

Vendimet sa i përket shpeshësisë së vizitave që duhet t'i bëhen një vendi të mbajtjes do të varen nga disa faktorë, duke përfshirë:

- Llojin e objektit ku mbahen imigrantët e ndaluar dhe kohëzgjatjen e pritshme të mbajtjes në atë vend. Vendet të cilat duhen vizituar më shpesh përfshijnë:
  - vendet në të cilat kryhen intervistat dhe procedurat e pranimit, të tilla si zonat ndërkombëtare, pikat kufitare dhe portet detare, ngaqë në këto vende procedohen shpesh një numër i madh imigrantësh;
  - vendet në të cilat bëhen në mënyrë rutinore deportimet dhe largimet, ngaqë në këto vende mbahen shpesh njerëz të cilët janë subjekt i procedurave të përshpejtuara që rritin rrezikun e kthimit mbrapsht;
  - vendet në të cilat personat e ndaluar mbahen për periudha të gjata kohore;
  - vendet në të cilat mbahen zakonisht personat ndaj të cilëve është ngritur akuzë penale ose të cilët janë dënuar për vepër penale (duke përfshirë burgjet, stacionet policore, furgonët e policisë dhe qelitë), si për faktin se mund të shpijnë në përzierjen e imigrantëve në mbajtje me persona të dënuar për vepra penale ashtu edhe për shkak se personeli mund të mos i ketë aftësitë e nevojshme për t'i trajtuar imigrantët në mbajtje.
- Nëse ekipi vizitues kupton që ndaj imigrantëve në mbajtje të cilët kanë folur me pjesëtarët e ekipit monitorues mund të ketë sanksione. Në raste të tilla, do të jetë me rëndësi që të bëhen vizita të shpeshta pasuese apo të ndërmerren menjëherë veprime tjera.
- Çështjet tjera për t'u marrë në konsideratë përfshijnë mandatin dhe kapacitetin e përgjithshëm të organit vizitues. Për shembull, mandatet e disa organeve mund të ngërthejnë shumë lloje të vendeve dhe mund të jetë e nevojshme që refugjatët, azilkërkuesit dhe imigrantët të integrohen në kuadër të një strategjie më të gjerë.

### **KUTIA 3. PROFILI I EKIPIT MONITORUES**

- laramani të përgatitjes profesionale (profesionistë shëndetësorë, psikosocial, ekspertë ligjorë, ekspertë për fëmijët dhe të komunikimit)
- atributet personale (ndjeshmëri ndaj aspekteve kulturore, aftësi të të dëgjuarit)
- balanc i duhur gjinor
- laramani të përkatësive etnike ose fetare
- aftësi përkatëse gjuhësore

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet që në radhët e ekipit monitorues të përfshihen:

- Persona me përgatitje profesionale në fushën e imigrimit ose të së drejtës së refugjatëve, të cilët i njohin standardet e mbrojtjes që zbatohen në kontekstin e ndalimit të imigrantëve;
- Profesionistë të kualifikuar shëndetësorë, për të vlerësuar çështjet shëndetësore veçanërisht të ndjeshme në lidhje me imigrantët në mbajtje;<sup>31</sup>
- Përkthyes po të jetë e nevojshme, në veçanti për ta pasur të mundur realizimin e bisedave private me imigrantët në mbajtje kur një gjë e tillë është e mundshme;
- Njerëz me përgatitje tjera profesionale të dobishme, duke përfshirë punonjësit socialë, ekspertë dhe psikologë të fëmijëve.

### **3.2.8 Bashkërendimi mes organeve vizituese**

Siç është vënë tashmë në dukje, praktika e mbajtjes së imigrantëve ka shënuar rritje të shpejtë në disa vende. Kjo sjellë në shprehje nevojën për bashkërendim dhe bashkëpunim gjatë monitorimit, ku organet që monitorojnë mbajtjen e imigrantëve e plotësojnë njëri-tjetrin dhe shmangin dyzimet, mundësisht nëpërmjet një rrjeti të formalizuar. Në këtë mënyrë, aspektet kritike të funksionit të monitorimit mund të ushtrohen përmes, për shembull, një sistemi efektiv të referimeve dhe planifikimit me vend të orareve të vizitave.

Bashkëndimi po ashtu vjen në shprehje në fazën e veprimeve pasuese; organet vizituese duhet t'i shmangin dyzimet në fazën përcjellëse, përveç nëse kanë vendosur ta bëjnë një gjë të tillë në mënyrë të vetëdijshme. Kjo mund të bëhet sidomos problematike nëse rekomandimet e organeve të ndryshme për ndryshim nuk përkojnë.<sup>32</sup>

Nëse monitorimin e realizon një organ kombëtar, duhet mëtuar që të ketë bashkëndim dhe me organet rajonale dhe ndërkombëtare të tilla si organet përgjegjëse për traktatet e OKB-së lidhur me të drejtat e njeriut, UNHCR-i, Procedurat e posaçme të Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, KNKK-ja, apo organet rajonale të monitorimit të tilla si KPT (shih pjesën 1). Në mënyrë të veçantë, PFKKT thekson nevojën për kontakt të drejtpërdrejtë ndërmjet MKP-ve dhe NKPT-së.

Bashkëndimi do të rrisë përfundimisht efikasitetin e programit të monitorimit dhe njëherësh ta bëjë të duket më efikas në sytë e autoriteteve.

### 3.3 PËRGATITJA E VIZITËS

Përgatitja e vizitës ka rëndësi kyçe. Madje vizitat që nuk planifikohen ose përgatiten siç duhet, ose nuk i përmbushin standardet dhe parimet e monitorimit, ose nuk realizohen në përputhje me metodologjinë e monitorimit, mund të sjellin dëme. Për përgatitjen e mirëfilltë të një vizite monitoruese duhet t'u kushtohet kohë elementëve të mëposhtëm:

- Hulumtimi, mbledhja dhe sistemimi i informatave;
- Përcaktimi i qëllimit(eve) të vizitës;
- Përgatitja e ekipit për detyrat e tyre kolektive dhe individuale përkatëse;
- Sigurimi i përgatitjes materiale dhe logjistike.

### 3.3.1 Hulumtimi, mbledhja dhe sistemimi i informatave

- Familjarizimi me normat e standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Mbledhja e informatave lidhur me kontekstin e mbajtjes së imigrantëve;<sup>33</sup>
- Mbledhja e informatave specifike rreth vendit që do të vizitohet.

#### **Informatat specifike rreth vendit përfshijnë:**

- ligjet dhe rregulloret, duke përfshirë rregullat e brendshme dhe çdo rregullore specifike për grupet në pozitë posaçërisht të cenueshme (shih Pjesën 4.8);
- kapaciteti i vendit, numri dhe kategorizimi i imigrantëve në mbajtje sipas gjinisë, moshës, cenueshmërisë së veçantë (si më sipër), si dhe hollësitë përkitazi me personat e tjerë në mbajtje të cilët mbahen në atë vend;
- hollësitë rreth autoriteteve përgjegjëse, menaxhimit dhe personelit, si dhe vijat e llogaridhënies (duke përfshirë organogramin, po të jetë e mundur);<sup>34</sup>
- statusin aktual të imigrimit të personave në mbajtje, sikurse numri i kërkesave për azil, informatat rreth të sapoardhurve,<sup>35</sup> rreth atyre kërkesat e të cilëve janë në pritje ose janë finalizuar, shqyrtimeve, ankesave ose mjeteve tjera juridike të shteruara, atyre që janë në pritje të largimit/deportimit, personave në mbajtje për shkak të shkeljes së kushteve të qëndrimit, si dhe informata rreth kohëzgjatjes së mbajtjes;
- hollësitë rreth gjuhëve që i flasin imigrantët në mbajtje (për të përcaktuar nëse do të ketë nevojë për përkthim dhe sa përkthyes do të nevojiten, si edhe nëse mund të ketë tensione etnike, kulturore ose fetare që duhet të faktorizohen gjatë përzgjedhjes së përkthyesve);<sup>36</sup>
- informatat që janë marrë gjatë vizitave të mëparshme ose nga burime të tjera (organet e tjera kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare që kanë vizituar vendin, OJQ-të, mediat, personat nëmbajtje të cilët janë liruar, familjet e ish të mbajturve apo të personave të cilët janë

aktualisht në mbajtje, avokatët, mjekët, shoqatat bamirëse, vullnetarët të cilët punojnë në vendet embajties etj.);

- gjithë informatat tjera gjegjëse.

Monitoruesit duhet të mbledhin në mënyrë proaktive informata nga burime të ndryshme, përfshirë përmes kontaktimit paraprak të autoriteteve për informata faktike.

Veç kësaj, mund të jetë shumë e dobishme që monitoruesit të takohen me akterët tjerë<sup>37</sup> të cilët janë në kontakt të rregullt me personat e ndaluar dhe që për këtë arsye mund të kenë informata të dobishme për t'i ndarë me monitoruesit. Kontakti fillestar ballë për ballë mund të bëhet përpara ose gjatë vizitës, me mundësinë e realizimit të vizitës pasuese në një fazë të mëvonshme.

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, do të jetë e nevojshme të bëhet sistemimi, kategorizimi dhe prioritizimi i çështjeve të cilat duhet të adresohen dhe burimet nga të cilat do të duhet të mblidhen dhe më tej informata. Përfundimisht, informatat do t'i mundësojnë ekipit që vizitën ta realizojë në suazat e çështjeve më të rëndësishme dhe të përcaktojë qëllimet e vizitës.

### **3.3.2** Përcaktimi i qëllimit(eve) specifik të vizitës

Është tejet e rëndësishme që qëllimet e vizitës të përcaktohen qartë që në fillim. Këto mund të jenë:

- kuptimi dhe analizimi i mënyrës së funksionimit të vendit të mbajtjes së imigrantëve dhe identifikimi i problemeve të veçanta;
- përqendrimi në një temë të veçantë (monitoruesit mund të kenë pranuar ose dëgjuar ankesa rreth një çështjeje të caktuar, si kohëzgjatja e mbajtjes së imigrantëve apo mungesa e qasjes në kujdes mjekësor);
- vizitë pasuese për të verifikuar ndonjë aspekt të veçantë të mbajtjes, rastet individuale ose zbatimin e rekomandimeve të mëparshme nga ana e organit ose organet tjera.

Gjithashtu, qëllimi(et) do të ndryshojnë në varësi të mandatit të organit vizitues dhe qëllimet e përgjithshme të strategjisë së monitorimit, si dhe çështjet dhe shqetësimet që identifikohen gjatë fazës përgatitore dhe nevojiten të adresohen.

### **3.3.3** Të sigurohet që monitoruesit janë përgatitur mirë

Pjesë me rëndësi e përgatitjes së vizitës monitoruese është natyrisht që të sigurohet se monitoruesit janë të përgatitur mirë qoftë për detyrat si ekip, qoftë për detyrat individuale që u janë caktuar, përfshirë përkatësi(t). Përgjegjësinë për këtë e mban udhëheqësi i ekipit, ashtu si edhe çdo anëtar i ekipit.

#### **Secili anëtar i ekipit duhet:**

- të jetë i familjarizuar me synimet, qëllimet, planin e punës, detyrat dhe orarin e vizitës monitoruese;
- të jetë i informuar mirë rreth standardeve ligjore dhe çështjeve operacionale që përbëjnë shqetësim në vendin e mbajtjes të cilin ata do ta vizitojnë;
- të marrë përsipër përgjegjësinë për mbledhjen, shqyrtimin dhe këmbimin e hollësive të dokumentacionit paraprakisht, duke marrë parasysh njohuritë dhe aftësitë e specialistëve; dhe
- të jetë i përgatitur mirë për atë që mund të pritët, duke qenë njëherësh mendjehapur dhe, në veçanti, të jetë i vetëdijshëm për gjendjen psikologjike potencialisht shumë të brishtë në të cilën mund të jenë ca ose shumë prej imigrantëve të ndaluar.

### **3.3.4** Të sigurohet përgatitja materiale dhe logjistike

#### **Dokumentet dhe pajisjet**

Është me rëndësi të sigurohet që monitoruesit t'i sjellin me vete pajisjet e duhura, letërnjoftimet dhe kopjet e të gjitha kredencialeve të nevojshme, lejet dhe dokumentet e identifikimit për realizimin e vizitës. Këto mund të përfshijnë kartelat e identifikimit dhe/ose letra nga autoriteti përkatës, një kopje të ligjit që i jep qasje organit vizitues, letërkëmbimin përkatës, si dhe numrat e telefonit të personave kryesorë kontaktues për njoftimin e menjëhershëm për çështje urgjente ose në rast të ndonjë problemi me qasjen.

Dokumentet tjera mund të përfshijnë listën e verifikimit përkitazi me kushtet e mbajtjes<sup>38</sup>, të përgatitur për të shërbyer si mjet për garantimin e mbledhjes së standardizuar të informatave nga ana e ekipit, dhe broshura për personat në mbajtje me informata rreth organit vizitues dhe mandatit të tij në gjuhët përkatëse. Këto dokumente mund të jenë të dobishme për aq kohë sa të përdoren në mënyrë fleksibile.

### **Dukja dhe kodi korrekt i veshjes**

Menaxhimi i perceptimeve ka rëndësi jetike në kontekstin e monitorimit të mbajtjes. Monitoruesit jo vetëm që duhet të jenë objektiv, të paanshëm dhe të pavarur, por që gjithashtu të perceptohen si të tillë. Ata duhet t'ua bëjnë të ditur pavarësinë e tyre personelit dhe personave në mbajtje, për shembull duke ua përshkruar mandatin dhe metodologjinë e organit vizitues. Gjithashtu, monitoruesit mund të bartin ndonjë formë të dukshme identifikimi (sikurse jelek apo kartelë), dhe të sigurojnë që identifikimi të duket qartazi dhe mund të dallohet lehtësisht nga format e identifikimit që i mbajnë autoritetet dhe/ose personeli. Është me rëndësi që monitoruesit të lënë përshtypjen se ata janë të autorizuar për të qenë aty, dhe ta bëjnë të qartë pavarësinë e tyre nga autoritetet dhe menaxhmenti.

Veç kësaj, kodi “korrekt” i veshjes ka implikime kulturore, duke qenë se mund të sjellë pasoja të mundshme si në lidhje me personat në mbajtje ashtu dhe autoritetet.<sup>39</sup> Nuk ka ndonjë rregull të artë që vlen njësoj për çdo vend apo situatë, por është me rëndësi jetike që monitoruesit të vishen me respekt dhe në përputhje me kontekstin. Nëse njerëzit ndihen të respektuar, ata kanë më shumë gjasa që të tregojnë respekt ndaj të tjerëve.

## Përgatitja logjistike

Organet vizituese duhet të ndajnë kohë të mjaftueshme e të jenë fleksibël me aranzhimin e vizitës dhe të mos e nënvlerësojnë përgatitjen logjistike të nevojshme për planifikimin e një vizite monitoruese. Kjo përfshin si vijon:

- Nëse është e nevojshme, paralajmërimi i vizitës dhe caktimi i datave (nga ana e grupit të monitoruesve dhe menaxhmentit të vendit të mbajtjes);
- Të sigurohet se vendi i mbajtjes është i qashtë në ato data (p.sh. ndryshimet stinore të motit mund të vështirësojnë qasjen në vendet e mbajtjes);
- Verifikimin e aspekteve të sigurisë në rajonet në konflikt ose përndryshe të pasigurta;
- Verifikimin se çfarë lejohet të sillet në objekt, si pajisjet e inçizim ose kompjuterike (disa objekte kanë kufizime ose kërkojnë verifikimin paraprak);
- Organizimin i udhëtimit dhe akomodimit;
- Sigurimin e përkthyesve dhe aranzhimet e udhëtimit dhe akomodimit për ta, sipas nevojës.

## 3.4 REALIZIMI I VIZITËS

Realizimi i vizitës është faza kryesore në procesin e monitorimit.

Për ta shqyrtuar kushtet e mbajtjes dhe trajtimin e personave në mbajtje në mënyrën e duhur, monitoruesit duhet të bëjnë verifikimin e burimeve të ndryshme të informatave (proces i njohur si “trekëndëzim”), ngaqë asnjë informatë nuk duhet të merret si e mirëqenë. Burimet përfshijnë:



- Pikëpamjet e personave të ndaluar;
- Pikëpamjet e autoriteteve, personelit dhe profesionistëve të ndryshëm të cilët kujdesen për personat e ndaluar;
- Vëzhgimet dhe analizat e vet monitoruesve.



## Trekëndëzimi i informatave

Zakonisht, vizitat përfshijnë hapat e mëposhtëm, ku disa prej tyre janë të ndër-këmbueshëm:

- Biseda fillestare me kreun e qendrës;
- Përmbledhja për objektet dhe e vëzhgimeve të bëra;
- Shqyrtimi i regjistrave dhe i dokumenteve të tjera;
- Vëzhgimi i procedurave;
- Intervistat me personat në mbajtje;
- Intervistat me personelin;
- Biseda përfundimtare me kreun e qendrës.

Rëndësia që i kushtohet secilit hap do të varet nga lloji i vizitës. Megjithatë, vëzhguesit nuk duhet ta marrin këtë radhitje si një model të ngurtë, por duhet të jenë të përgatitur që të jenë fleksibël dhe të reagojnë ndaj çfarëdo situatë me të cilën përballen, duke i ndryshuar planet e tyre dhe ecurinë e punës sipas nevojës.

### 3.4.1 Biseda fillestare me kreun e qendrës

Vizita në qendrën e imigrimit duhet të fillojë me një bisedë në mes të organit vizitues dhe personit përgjegjës, apo zëvendësit të tij. Ky është hapi i parë në krijimin e një dialogu me autoritetet. Kjo vizitë mund të lajmërohet paraprakisht ose të jetë e paparalajmëruar. Nëse lajmërohet paraprakisht, shumë formalitete fillestare mund të kryhen përpara vizitës, ndonëse është gjithëherë e udhës që gjatë vizitës disa aspekte të ritheksohen dhe përsëriten sërish me kujdes.

Në qoftë se organi vizitues ka realizuar tashmë disa vizita monitoruese në vendin në fjalë pa hasur në ndonjë pengesë serioze, formalitetet hyrëse mund të kufizohen në mirësjellje dhe përditësimet themelore dhe, në qoftë se programi i monitorimit nuk ka pësuar ndonjë përshtatje specifike, zotimit se vizita do të realizohet në të njëjtën mënyrë si në të kaluarën.

---

Po të jetë e nevojshme, ekipi mund të vendosë që të ndahet më dysh, ku një ose dy anëtarë (ku zakonisht përfshihet dhe udhëheqësi i ekipit) takohen me kreun ose drejtorin e qendrës, ndërsa të tjerët fillojnë vizitën substanciale dhe verifikojnë menjëherë zonat me rrezik më të lartë (të tilla si njësitë e izolimit dhe hapësirat e trajtimit shëndetësor, që përbëjnë hapësira ku kanë të ngjarë të ndodhin abuzimet e të drejtave të njeriut).

Në fund, monitoruesit duhet të bien dakord për kohën, datën dhe vendin e takimit përfundimtar me drejtorin, gjatë të cilit ata do t'i paraqesin përmbledhjen e rezultateve<sup>40</sup> të vizitës dhe ngritin të gjitha çështjet që kërkojnë vëmendjen e drejtorit urgjentisht.

### KUTIA 3. BISEDË FILLESTARE ME KREUN E QENDRËS

Biseda fillestare është një ndër burimet (e shumta) të informatave. Ky diskutim ofron mundësi të rëndësishme për:

- Prezantimin e organit vizitues, mandatit të tij dhe të anëtarëve të ekipit.
- Sqarimin e synimeve dhe qëllimit të vizitave monitoruese, dhe të vizitës në fjalë në veçanti.
- Bërjen të ditur të kohëzgjatjes së paraparë të vizitës (përfshirë kohën rezervë ashtu që të ketë fleksibilitet për të reaguar ndaj zhvillimeve të papritura).
- Sqarimin e metodave të punës, duke përfshirë posaçërisht:
  - atë çfarë ekipi pret që të jetë në gjendje të bëjë dhe ku pritet që të jetë në gjendje të shkojë,
  - se pavarësia e vërtetë dhe ajo e perceptuar e ekipit është element i qenësishëm i vizitës, duke nënvizuar nevojën për të lëvizur lirisht të pashoqëruar nëpër tërë qendrën e mbajtjes,
  - mënyrën në të cilën do të punojë ekipi (p.sh. nëngrupe të ndryshme shkojnë në pjesë të ndryshme të objektit),
  - se gjithë intervistat duhet të jenë private,
  - se parimet e privatësisë dhe konfidencialitetit udhëheqin me punën e ekipit monitorues dhe përdorimin e informatave që mbliiden, qoftë të dokumentuara ose nëpërmjet dëshmime verbale.
- Ofrimin e garancive se monitoruesit do të sillen në mënyrën e duhur gjatë vizitës dhe se do të mbajnë parasysh rregullat e brendshme dhe procedurat e aspektet e sigurisë. Marrja e informatave rreth këtyre rregullave dhe procedurave (p.sh. në rast zjarri, trazire etj.).
- Kërkimin e informatave të fundit dhe specifike (për shembull, nëse ka pasur ndonjë ndryshim a ngjarje domethënëse ose nëse në qendër janë të vendosur të ndaluar me nevoja të veçanta).
  - Për ta pyetur personin përgjegjës për qendrën për mendimin e tij lidhur me sfidat me të cilat përballen gjatë punës dhe zgjidhjet e mundshme.

### 3.4.2 Inspektimi dhe vrojtimi i hapësirave

Gjatë vizitës së parë, është posaçërisht me rëndësi që të inspektohen të gjitha hapësirat e objektit. I tërë ekipi mund t'i bëjë një vizitë të shkurtër të përgjithshme tërë objektit. Ajo mund të realizohet me drejtorin ose një zyrtar i cili mund të japë informata të dobishme rreth planit të objektit dhe ofrimit të shërbimeve. Mund të jetë e dobishme që të hidhet në letër plani i objektit apo të merret plani ekzistues, që mund të shërbejë si mjet i dobishëm gjatë intervistat me personat në mbajtje dhe personelit, përfshirë për qëllime të verifikimit të kryqëzuar të informatave.

Vizitimi i hapësirave do t'u mundësojë monitoruesve që të krijojnë përshtypjen fillestare për hapësirat fizike, si dhe atmosferën dhe disponimin e përgjithshëm në objekt. Vizita mund të përfshijë sa vijon:

- Objektin dhe planin e tij;
- Masat e sigurisë fizike (të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë rrethojat, dyert dhe muret e sigurisë, ndarjet midisi pjesëve të ndryshme të qendrës së mbajtjes);
- Hapësirat e pranimit (për personat në mbajtje si dhe vizitorët);
- Hapësirat për fjetje;
- Hapësirat e dushave dhe toaleteve;
- Hapësirat për gatimin e ushqimit dhe ngrënie;
- Hapësirat e lavanterisë;
- Hapësirat për këshillim dhe kujdes mjekësor;
- Hapësirat për këshillim ligjor;
- Hapësirat për lutje fetare;
- Hapësirat për vizita;
- Hapësirat e brendshme dhe të jashtme për aktivitete rekreative;
- Biblioteka dhe hapësirat e qeta për lexim e studim;
- Hapësirat e punës dhe punëtoritë;
- Hapësirat e dedikuara për personelin;
- Dhomat e veçimit, dhoma e sigurt dhe hapësirat tjera disiplinore dhe për menaxhim të brendshëm.

Gjatë vazhdës së vizitës së përgjithshme, monitoruesit mund të marrin shënime rreth çështjeve të veçanta, përfshirë identifikimin e personave në pozitë të cenushme për t'i intervistuar privatisht më vonë gjatë pjesës së mbetur të vizitës.

Pas vizitës të përgjithshme, monitoruesit mund të mbajnë një mbledhje të shkurtë dhe private, dhe po të jetë nevoja të ndahen në grupe më të vogla sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë së gjithsecilit, dhe hapësirat e caktuara (të tilla si hapësirat e pranimit, kujdesit mjekësor) mund të vizitohen sërish dhe kushtet të inspektohen në mënyrë më të thuktë.

Të gjitha informatat e mbledhura gjatë vizitës fillestare të hapësirave duhet të verifikohen përkarsi informatave që janë dhënë gjatë intervistave private me personat e ndaluar dhe personelin. Për shembull, monitoruesit mund t'i pyesin personat e ndaluar dhe personelin se cilat janë tri hapësirat më të mira dhe më të këqija në objekt dhe për çfarë arsye.

### **KUTIA 3. ASPEKTET E SIGURISË PËR T' U MARRË NË KONSIDERATË**

Pothuajse në të gjitha qendrat e imigrantëve do të ketë rregulla të shkruara që kanë për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e sigurisë dhe rendit. Si propozim i përgjithshëm, do të ishte gjë e matur që të respektohen rregullat e brendshme. Sidoqoftë, monitoruesit do të duhet të bëjnë kujdes nëse për ndalimin ose kushtëzimin e qasjes në ndonjë vend të caktuar apo pjesë të tij, apo tek ndonjë person i caktuar në mbajtje ë , jepet si arsyetim siguria.

Ndonëse statusi jopenal i personave të cilët mbahen në qendrat e mbajtjes së imigrantëve flet vet për gjendjen e sigurisë, kjo nuk do të thotë se nuk ka rreziqe të lidhura me sigurinë. Në çdo vend të mbyllur ku njerëzit mbahen kundër vullnetit të tyre, sidomos në vendet ku janë evidente efektet negative të privimit të lirisë, mund të shtohen tensionet dhe siguria personale mund të përbëjë problem, siç është rasti me zjarret ose trazirat. Vendet e mbajtjes së imigrantëve nuk përbëjnë përjashtim, sidomos aty ku politikat dhe praktikatat e mbajtjes çojnë në shkallë të lartë ankthi dhe pasigurie.

Çdo kufizim i mëpastajmë i këshilluar nga ana e personelit duhet të dëshmohej si i domosdoshëm për monitoruesit. Në fund të fundit, monitoruesit, dhe kryesisht udhëheqësi i ekipit, mbajnë përgjegjësinë për të vendosur se çfarë do të bëjnë

### 3.4.3 Shqyrtimi i regjistrave dhe dokumenteve tjera

Regjistrat dhe dokumentet e tjera janë burime të rëndësishme të informatave rreth personave në mbajtje dhe vendit të mbajtjes. Shqyrtimi i këtij dokumentacioni në fillim të vizitës (ose paraprakisht, po të jetë e mundshme) mund të jetë i dobishëm për monitoruesit, sidomos nëse vizita do të zgjasë disa ditë me radhë. Informatat e fituara nga shqyrtimi i dokumentacionit mund të verifikohen më pas gjatë vizitës, po të jetë e nevojshme.

Për ta kuptuar sa më qartë dhe më mirë që të jetë e mundur regjimin e dhe funksionimin e përditshëm të vendit, vëzhguesit mundën që, si hap i parë, të kërkojnë qasje në (dhe, po të jetë e mundur, t'i kërkojnë kopjet) :

- Rregullat e brendshme të vendit të mbajtjes: a janë në dispozicion në disa prej gjuhëve që i flasin personat në mbajtje?
- A janë postuar orare ku tregohen kohët e shujtave dhe aktiviteteve tjera? A janë ato në dispozicion në disa nga gjuhët që i flasin personat e ndaluar?
- Oraret e punës së personelit (po të jetë e mundshme, të tregojnë strukturën/profilin, numrin dhe kategorizimin e personelit sipas gjinisë).

Nëse janë bërë pretendime për keqtrajtim, do të jetë e dobishme që t'u referohet sërish këtyre informatave.

Monitoruesit duhet ta kenë gjithmonë parasysh mundësinë që të dhënat në regjistra të jenë falsifikuar ose ndryshuar. Veç kësaj, monitoruesit duhet të verifikojnë edhe në se ka regjistra tjerë që përdoren në qendrën e mbajtjes.

### 3.4.4 Respektimi i procedurave

Monitoruesit duhet të jenë në gjendje që t'i vëzhgojnë dhe kuptojnë proceset e punës në mjediset e hapësirave të mbajtjes. Shqyrtimi i proceseve dhe të dhënave zyrtare dhe krahasimi i tyre përkashtimit të vrojtimit të monitoruesve dhe dëshmitë rreth asaj që ndodh në praktikë, do të ndihmojë për të përcaktuar në se ka ndonjë shqetësim të madh.

### **KUTIA 3. REGJISTRAT**

Regjistrat dhe protokollet që do të jenë me interes të veçantë në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve përfshijnë:

- Regjistrat e hyrje-daljeve të personave në mbajtje, duke përfshirë llojin e statusit të imigrimit (nëse kanë paraqitur kërkesë për azil);
- Protokollet për vlerësimin e rreziqeve dhe cenueshmërive të caktuara;
- Protokollet për qasje në procedurat e mbrojtjes dhe imigrimit;
- Protokollet për qasje në këshillim dhe përkrahje nga jashtë;
- Nëse ka të tilla, regjistrat e masave disiplinore ose të izolimit të vetmuar që janë shqiptuar;
- Regjistrat mjekësorë;
- Regjistri i incidenteve dhe/ose ngjarjeve (sikurse përdorimi i forcës);
- Protokollet për iniciimin e ankesave;
- Regjistrat e liritimit dhe deportimit/largimit.

Monitoruesit mund t'i verifikojnë procedurat, oraret e punës dhe oraret e aktiviteteve, dhe mund të mbajnë shënime për ditën dhe kohën e orarit të punës apo aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë vizitës monitoruese. Nëse gjatë vazhdës së vizitës nuk monitorohen orare të punës apo aktivitete të caktuara që janë cilësuar si problematike, mund të jetë e udhës që të caktohet një vizitë pasuese ose e sërishme.

Si shembull, monitoruesit mund të vendosin që t'i vëzhgojnë proceset në fazën e mbërritjes, pranimit dhe regjistrimit. Për azilkërkuessit dhe personat pa shtetësi në veçanti kjo është një prej aspekteve më të ndjeshme.





### 3.4.5 Intervistat me personat në mbajtje

Pjesa më e rëndësishme e vizitës është koha që kalohet duke biseduar me personat në mbajtje dhe duke i dëgjuar drejtpërsëdrejti mendimet e tyre lidhur me kushtet dhe trajtimin gjatë mbajtjes në ndalim. Intervista shërben për hetim objektiv të çështjeve me ndjeshmëri dhe kompleksitet të konsiderueshëm. Gjatë intervistës duhet treguar ndjeshmëri, respekt, dhe duhet bërë përshtatje në varësi të faktorëve kulturor, fetar, të moshës, të diversitetit dhe atyre gjinor.

Kur intervistohen imigrantët në mbajtje, është me rëndësi të mbahet mend se ata ndodhen në një mjedis jashtëzakonisht jonormal që ka shumë të ngjarë të ketë efekte negative në unin dhe mirëqenien e tyre. Siç theksohet në këtë Doracak, çdo person i privuar nga liria ndodhet në pozitë të cenueshme, dhe çdo vend i mbajtjes është një mjedis ku individët janë të cenueshëm përkarshi autoriteteve. Efektet që ndalimi mund t'i ketë tek imigrantët janë: stresi akut, ankthi dhe frika; humbja e nocionit të kohës; shkarjet apo bllokimet e kujtesës; mendimet obsesive; përkeqësimi i çrregullimeve ekzistuese të shëndetit mendor; çrregullimi i stresit pas traumës (CSPT); depresioni dhe sjellja e dhunshme, përfshirë vetëlëndimin. Personat e ndaluar të cilët janë prekur nga këto efekte apo në ndonjë mënyrë tjetër mund të duken si të hutuar.

Bisedat e mëtejme shoqërore apo jozyrtare me personat në mbajtje janë pjesë e çmueshme e ndërtimit të besimit, si dhe mbledhjes së informatave.

#### **Intervistat grupore**

Vlera e intervistave grupore për një vizitë monitoruese është se mundësojnë kontakt me më shumë persona të ndaluar. Megjithatë, meqë nuk ka konfidencialitet, në intervista në grup përjashtohet mundësia e diskutimit të çështjeve më të ndjeshme (të tilla si trajtimi, marrëdhëniet me personelin dhe personat në mbajtje tjerë). Veç kësaj, ekziston rreziku që një ose dy persona të dominojnë si “udhëheqës” të grupit dhe të flasin në emër të tjerëve, nganjëherë për shkak se e flasin gjuhën vendore dhe për këtë arsye mund të kenë trajtim të veçantë ose privilegje nga personeli. Intervistat grupore më vete nuk janë adekuate.

### **KUTIA 3.1 MBROJTJA E BURIMEVE DHE INFORMATAVE<sup>41</sup>**

Gjatë vazhdës së vizitës, monitoruesve mund t'ju duhet që t'i rishqyrtojnë strategjitë ekzistuese për mbrojtjen e burimeve. Personat në mbajtje duhet të pyeten se a janë të shqetësuar për sigurinë e tyre. Nëse po, atëherë udhëheqësi i ekipit duhet t'i sqarojë strategjitë e ekipit për mbrojtjen e burimeve të informatave. Në varësi të situatës, këtu mund të përfshihet intervistimi i një mostre përfaqësuese të njerëzve për të siguruar që të mos mund të identifikohen burimet e veçanta të informatave shumë të ndjeshme, ose mbajtja e informatave personale veçmas nga dëshmitë. Gjatë intervistimit të një personi, intervistuesit nuk duhet asnjëherë t'u referohen në mënyrë eksplicite deklaratave të ndonjë personi tjetër. Gjithashtu, intervistuesit duhet ta kërkojnë kontributin e personit në mbajtje dhe pastaj të vlerësojë nëse është e nevojshme dhe e përshtatshme që të bëhet një vizitë kthyesë si masë mbrojtëse ndaj sanksioneve dhe ndëshkimeve.

Bisedat në grup janë të dobishme për identifikimin e problemeve të përbashkëta, identifikimin e udhëheqësve jozyrtarë dhe për ta kuptuar atmosferën e përgjithshme në vendin e mbajtjes, disponimin e personave në mbajtje, dinamikën e popullsisë dhe kulturën e punës së institucionit. Duke qenë se qendrat e mbajtjes së imigrantëve janë shpesh mjedise të përziera në kuptimin e gjinisë dhe përfshijnë grupe familjesh, mund të jetë e dëshirueshme që intervistat të realizohen në nëngrupe, me burrat dhe gratë veç e veç, si dhe me bashkësitë familjare ose me grupet në bazë të vendit të prejardhjes, gjinisë apo moshës.

Do të ishte e udhës që kohëzgjatja e intervistave në grup të përcaktohet paraprakisht. Ndërsa bisedat duhet të lihen që të rrjedhin lirisht, në qoftë se ato dalin jashtë teme mund të devijojnë nga detyra e monitorimit dhe të marrin tepër kohë. Pas prezantimit të përgjithshëm të monitoruesve dhe mandatit të trupit vizitues, intervista në grup duhet të fillojë me një pyetje të hapur për gjithë anëtarët e grupit që të tregojnë perceptimet e tyre të problemeve kryesore në vendin e mbajtjes. Kjo ka rëndësi sidomos në rastet kur është fjala për vizitën e parë të monitorimit. Përgjigjet mbas gjase do të shpien në pyetje të mëtejme, disa prej të cilave mund të bëhen menjëherë, ndërsa të tjerat mund të bëhen në intervista private.

Kur vizitat e monitoruesve të jenë bërë më të rregullta, intervistat në grup mund të jenë më të përqendruara. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se në qendrat e mbajtjes ka lëvizje të vazhdueshme të personave në mbajtje, e që është faktor që mund të ndikojë në masë të konsiderueshme në dinamikën e grupit, si edhe shqetësimet individuale e kolektive. Ashtu si me gjithë informatat tjera, informatat e mbledhura në intervistat në grup duhet të verifikohen në mënyra të tjera: gjatë intervistave private, përmes vëzhgimeve të vetë ekipit, nëpërmjet dëshmimeve të dokumentuara dhe duke u konsultuar me burime të tjera.

### **Intervistat private dhe menaxhimi i pritshmërive**

Intervista private me personin në mbajtje ofron mundësi për jo vetëm mbledhjen e informatave lidhur me përvojat e tij/saj të përditshme gjatë mbajtjes në ndalim, por edhe për të gjetur se si. Siç është vënë në dukje më parë, imigrantët zakonisht mbahen me rastin e hyrjes apo qëndrimit të parregullt në territorin e një shteti, shtetësinë apo lejen e qëndrimit të përhershëm të të cilit nuk e kanë. Në vend se të ketë kohëzgjatje fikse, kohëzgjatja e mbajtjes varet shumë nga rrethanat e paparapara të lidhura me identitetin dhe/ose statusin e imigrimit të personit, madje edhe nëse ligji parasheh kohëzgjatjen maksimale të mbajtjes. Personat në mbajtje mund ta kenë të vështirë që t'i kuptojnë arsyet dhe përgjegjësinë e lidhur me këtë pasiguri, dhe kjo mund të kontribuojë në perceptimin që liria e tyre është subjekt i një pushteti diskrecional në duart e cilitdo që ata e perceptojnë si person në pozitë me autoritet dhe ndikim. Kjo shkakton që personi në mbajtje të ndihet edhe më i dobët dhe i pafuqishëm karshi personelit, menaxhmentit dhe autoriteteve të larta dhe po ashtu mund të shkaktojë që ata të kenë prirje të larta karshi ekipit të monitoruesve. Përveç nëse trupi vizitues të cilit i përket ekipi ka autoritet gjyqësor ose kuazigjyqësor, ekipi duhet të ketë kujdes të mos krijojë iluzione tek personat në mbajtje me perceptime ose supozime se ata kanë kompetenca të tilla. Është përgjegjësia e intervistuesit që t'i menaxhojë këto prirje në mënyrë profesionale, të vendosur dhe me kujdes, duke u kushtuar vëmendje kufizimeve në kohë dhe burime, si dhe duke mbajtur parasysh nevojën për fleksibilitet dhe që personave në mbajtje t'u jepet mundësi e mjaftueshme për t'i artikuluar shqetësimet e tyre. Është po ashtu me rëndësi që intervista të mos përbëjë pengesë për qasjen e të intervistuarit në ndonjë të drejtë apo shërbim (si koha e vakteve, koha e vizitave, apo qasja në bibliotekë).

## Pëlqimi për intervistën dhe konfidencialiteti

Për informacionet për raste individuale që mblidhen gjatë një interviste kërkohet pëlqimi i informuar dhe i qartë i personit në mbajtje. Ai/ajo duhet të informohet për qëllimin specifik të mbledhjes së të dhënave dhe mënyrën në të cilën ato do përpunohen pas intervistës. Kjo ka të bëjë në veçanti me atë nëse këto informata do të ndahen me ndonjë palë të tretë. Në parim, informatat personale duhet të trajtohen si konfidenciale dhe duhet të shpalosen vetëm në përputhje me qëllimin dhe kushtet specifike për të cilat ai/ajo ka rënë dakord.

Në të njëjtën kohë dhe pavarësisht nga pëlqimi, monitoruesit vazhdojnë të mbajnë përgjegjësinë për vlerësimin e rreziqeve ndaj personit që i jep informatat dhe për peshimin e rreziqeve të mundshme kundrejt dobive që do t'i sjellë përpunimi i të dhënave personale të personave në mbajtje. Kujdes të shtuar duhet pasur gjatë komunikimit me fëmijët, atij nëpërmjet përkthyesve, ose me njerëz analfabetë. Në lidhje me këtë, monitoruesit duhet gjithmonë të anojnë në anën e mbrojtjes dhe në rastin e fëmijëve të marrin parasysh interesin e tyre më të lartë. Për këtë mund të kërkohet që të ndërmerren hapa shtesë për të siguruar anonimitetin.

Praktikë e rekomanduar është hartimi i "formularit të pëlqimit të informuar" për të dokumentuar se gjithë të sipërpërmendurat i janë sqaruar personit i cili do të intervistohet dhe se personi ka dhënë pëlqimin për intervistën. Formulari mund të përmbajë një kuti të cilën personi mund ta shënjojë për të bërë të ditur se ai/ajo ka rënë dakord që t'i përdoret emri apo që hollësitë e rastit të tij/saj të përdoren në kushte anonimiteti.

## Kush e bën intervistimin?

Janë dy opsione: ose të bëhen intervista individuale ose intervista në çift. Puna në çifte ka përparësinë e të qenit më përkrahëse, efektive dhe e përgjegjshme, dhe njëherësh ofron njëfarë sigurie në rast të ndonjë incidenti të sigurisë. Është e këshillueshme që detyrat të ndahen qartë (si, për shembull, njëri bën pyetjet, ndërsa tjetri mban shënime). Nuk rekomandohet që grupi i intervistuesve të ketë më shumë se tre persona (përfshirë përkthyesin), ngaqë një gjë e tillë do ta frikësonte personin në mbajtje dhe intervista do jetë më vështirë të menaxhohet.



### **KUTIA 3.1 PËRZGJEDHJA E PERSONAVE QË DO INTERVISTOHEN**

Varësisht nga qëllimet e vizitës, gjatë fazës së planifikimit duhet merret në konsideratë kombinimi i strategjive të përzgjedhjes së personave që do intervistohen, si për shembull:

- “metoda e përzgjedhjes së rastit”: për shembull, vrojtimi gjatë vizitës fillestare të objektit (p.sh. nëpër oborre) për t’i identifikuar personat të cilët mund të jenë me interes për t’i intervistuar më vonë ose privatisht; përzgjedhja e rastësishme nga regjistri (p.sh. një në çdo pesë persona);
- duke marrë si bazë kritere të veçanta si, për shembull, përzgjedhja e të sapoardhurve, personave të caktuar në pozitë të cënueshme, personat në mbajtje për të cilët janë raportuar raste lëndimi ose vetëlëndimi, lëndime “aksidentale”, përdorimi të forcës dhe masa të izolimit; ose përzgjedhja e rastësishme nga regjistri.

Siç është përmendur tashmë, përbërja gjinore e ekipit vizitues është konsideratë e rëndësishme. Kjo gjë ka veçanërisht rëndësi në intervistat private. Në raste të pretendimeve për përdhunim, abuzim seksual dhe lloj tjetër dhune, viktimat, qofshin burra apo gra, duhet ta kenë të mundshme të zgjedhin se a duan të intervistohen nga një burrë apo grua. Meqë intervistuesi mund të mos e dijë paraprakisht që do të ketë pretendime të tilla, është e udhës që personat në mbajtje të pyeten përpara intervistës nëse do të parapëlqenin të intervistohen nga një intervistues mashkull apo femër dhe, aty ku është e nevojshme, nëse duan të kenë përkthyes mashkull apo femër, dhe që kjo kërkesë të akomodohet për aq sa të jetë e mundur.

### **Përzgjedhja e personave që do të intervistohen**

Në disa raste, monitoruesit do të duhet që të zgjedhin se me kënd do zhvillojnë intervista individuale. Ata të cilët përzgjidhen duhet t’i përfaqësojnë sa më tepër që të jetë e mundur kategoritë e ndryshme të personave të ndaluar që mbahen në atë vend. Në objekte të vogla me pak njerëz, rekomandohet zbatimi i parimit “o të gjithë, o asnjë”<sup>42</sup>, ashtu që personat në mbajtje të mbrohen nga të qenit të etiketuar si të zgjedhurit ose ata të cilët kanë kërkuar të flasin me monitoruesit apo vëzhguesit. Gjithashtu, monitoruesit duhet të kenë kujdes që të mos flasin vetëm me ata individë të cilët kanë kërkuar të kontaktojnë me ta<sup>43</sup>, ose të cilët i kanë propozuar personeli. Megjithatë, asnjë person në

mbajtje nuk duhet të ndjehet i detyruar për të folur me monitoruesit.

Në procesin e përzgjedhjes, është e dobishme që të identifikohen rreziqet brenda qendrës së imigracionit. Për shembull, personat të cilët janë nga një shtet dhe/ose i përkasin një pakice të caktuar për të cilën është raportuar se po diskriminohet duhet të përfshihen gjithmonë, sidomos në rastet kur vizita ka në fokus diskriminimin.

### **Ku duhet të realizohet intervista?**

Në lidhje me gjithë nga sa u përmend më sipër, përzgjedhja e vendit ku do të realizohet intervista private është vendimtare. Ai duhet të jetë i sigurtë dhe të japë një ndjesi të këtyllë, të respektojë dinjitetin e personit, të jetë një vend ku nuk mund të dëgjohet ajo çfarë do thuhet dhe të jetë mjaftueshëm i veçuar nga hapësirat tjera ashtu që të ketë privatësi dhe konfidencialitet. Duhet të shmangen vendet ku ndodhen personeli dhe menaxhmenti si, për shembull, zyrat e tyre, dhe intervistuesit nuk duhet të ndjehen të detyruar që të marrin udhëzime nga ta në lidhje me vendin ku duhet të mbahet intervista. Pyetni personin në mbajtje se ku dëshiron të takohet me ju. Personit të mbajtur mund t'i bëhet me dije sa rëndësi ka për intervistuesin që personi në mbajtje të intervistohet në një vend ku ai ndihet sa më i sigurt dhe rehat. Varësisht nga objektet, këto vende mund të përfshijnë dhomat e këshillimit me avokatët, hapësirat ku jetojnë personat në mbajtje (por jo ato të përbashkëta ose vendet ku mund të jenë të pranishëm dhe persona tjerë), dhomat për aktivitete rekreative ose për vizita, oborret ose hapësirat e jashtme për aktivitete rekreative, ose biblioteka.

### **Fillimi i intervistës**

Në fillim të intervistës me një person në mbajtje, intervistuesi duhet së pari të prezantohet, ta prezantojë anëtarin tjetër (nëse ka të tillë) dhe organin vizitues të cilit i përkasin, si dhe përkthyesin nëse ai/ajo është i pranishëm në intervistë. Në këtë pjesë pjesëtarët e ekipit të intervistuesve duhet të fitojnë besimin e personave në mbajtje dhe t'i bëjnë ata që të ndjehen rehat. Personave në mbajtje duhet t'u jepet mundësi e arsyeshme për t'u prezantuar dhe për ta treguar përvojën e tyre. Në kuadër të pjesës së hyrjes në intervistë, intervistuesit mundën gjithashtu që t'i inkurajojnë aktivisht dhe t'i ftojnë personat në mbajtje për të bërë pyetje dhe kërkuar sqarime kurdo gjatë vazhdës së intervistës.



Pjesa hyrëse e intervistës mundet të:

- Nënvizohet pavarësia e organit vizitues;
- Të shpjegohen qëllimi dhe parametrat e vizitës së monitoruesve;
- Të sqarohet se çfarë mund të bëjë dhe çfarë nuk mund të bëjë ekipi, ashtu që personat në mbajtje të mos kenë shpresa apo pritje joreale (si, për shembull, se ekipi mund të ndikojë në zgjidhjen e rastit ose të statusit të imigrantit);
- T'u përkujtohet personave në mbajtje se kjo paraqet mundësi të rëndësishme për t'i dhënë informata ekipit të monitoruesve;
- Të sqarohet se për çdo ankesë apo pretendim që bëhet do të jetë doemos e nevojshme që informatat të verifikohen dhe vërtetohen përmes intervistave tjera ose duke i shqyrtuar dokumentet;
- Të sqarohet se çdo veprim dhe verifikim pasues do të bëhet vetëm nëse personi në fjalë pajtohet shprehimisht me këtë dhe në një mënyrë që nuk e cenon të drejtën e personit në privatësi dhe konfidencialitet.<sup>44</sup>

## Realizimi i intervistës

Gjatë intervistimit të personave në mbajtje, monitoruesit duhet të kenë kujdes me gjuhën dhe shprehjet që i përdorin. Ata duhet të flasin me një gjuhë të qartë, të thjeshtë, që nuk lë vend për dykuptimësi, ndërsa sjelljet t'i kenë të relaksuara dhe me respekt. Këshillohet që monitoruesit të kenë kujdes për të mos bërë supozime rreth personave me të cilët janë duke folur dhe, në vend të qenit kritik, të jenë të vëmendshëm ndaj gjërave që mund të perceptohen si zbulurime, ekzagjerime ose të pavërteta. Është e rëndësishme të mos kufizohet apo ndikohet përgjigja e personit të ndaluar. Kështu, rekomandohet që të bëhen pyetje të hapura në vend se sugjестive, d.m.th. që monitoruesi të nxjerrë informata nga personi në mbajtje dhe jo t'i fus atij ide në kokë. Intervistuesit duhet të jenë të qatshëm që të kërkojnë më shumë hollësi dhe ta bëjnë të njëjtën pyetje në mënyra të ndryshme (gjë që mund të jetë si në dobi të

përkthyesit ashtu dhe personit nëje. Gjatë vazhdës së intervistës, monitoruesit duhet të mundohen që ta orientojnë personin në mbajtje tek një çështje e veçantë, por që të jenë njëherësh të hapur që diskutimi të marrë tjetër drejtim. Nëse dilet jashtë çështjes e cila po hetohet, mund të jetë e nevojshme që çështja të lihet anash aty për aty dhe të shtrohet përsëri për diskutim dikur më vonë.

Është e rëndësishme që të pranohet dhe menaxhohet mosbesimi, dyshimi dhe rezervimet, çfarëdo qoftë arsyeja e tyre (e tillë si mosfunksionimi burokratik dhe korrupsioni). Personi nëmbajtje mund të ketë dyshime dhe rezerva të mëdha ndaj monitoruesve, dhe madje me arsye. Një gjë e tillë jo vetëm që mund t'i ndikojë në raportet e personit në mbajtje me personelin dhe menaxhmentin, por të prekë po ashtu dhe aftësinë e ekipit të monitoruesve për të krijuar raporte të mira dhe mirëbesim me personin në mbajtje gjatë intervistës private.

Përveç nëse ka ndonjë qëllim të veçantë dhe urgjent, intervista private do duhej që të përfshijë përgjithësisht tërë gamën e problemeve që i prekin personat në mbajtje dhe të shërbejë për t'i dokumentuar vrojtimit dhe përvojën e vetë personit në mbajtje, si ato pozitive ashtu dhe ato negative.

## SHËNIMET PËRKUJTUESE

Përpilimi i një liste kontrolli për intervistat në person apo në grupe, që të shërbejë më tepër si shënim përkujtues se sa si kornizë zyrtare, është mënyrë shumë e dobishme për të siguruar se po mbulohen të gjitha çështjet me rëndësi. Megjithatë, intervistesit duhet të sigurojnë që t'i kushtojnë gjithmonë kohë të mjaftueshme dhe fleksibilitet mundësisë së personave në mbajtje që të flasin më lirshëm dhe spontanisht rreth shqetësimeve të tyre. Në lidhje me këtë, monitoruesit duhet të mbajnë parasysh që nëse u përmbahen në mënyrë të ngurtë dhe mekanike listave të kontrollit, intervista mund të bëhet jo vetëm tepër zyrtare dhe e shkëputur por dhe të rrezikojë që t'u ngjasojë më shumë marrjeve në pyetje dhe hetimeve. Kjo duhet shmangur me çdo kusht.

### **KUHA 3.1 APARATET E REGJISTRIMIT**

Nëse organit vizitues i është lejuar të sjellë aparate të regjistrimit<sup>45</sup> në vendin e mbajtjes (aparate fotografike, telefona celularë, diktafonë apo kamera), intervistuesi do të duhet që krahas dobive të regjistrimit elektronik të pjesshëm apo të tërë informatave që mblidhen të mendojë dhe për rreziqet që mund të lindin nga një gjë e tillë. Rreziqet (dhe dobitë) mund të jenë të lidhura me mbrojtjen e personave në mbajtje: burimet e informatës mund të identifikohen më lehtë, përmbajtja është më e cenueshme, ekziston rrezik që aparatet e regjistrimit të konfiskohen, madje edhe nëse janë lejuar të përdoren. Në aspektin pozitiv, regjistrimi elektronik/digjital mund të ofrojë mbrojtje shtesë. Regjistrimi i intervistave mund ta gjallërojë ose frenojë diskutimin, sepse nëse intervistuesit nuk i duhet ta mbajë kokën të ulur duke mbajtur shënime të hollësishme ai/ajo do të ketë më shumë gjasa për të krijuar raport të mirë me personin në mbajtje dhe, kështu, regjistrimi ose mund ta përshpejtojë ritmin e intervistës ose të bëjë që personi në mbajtje të ngurrojë që të flasë për çështje të ndjeshme. Sidoqoftë, është e domosdoshme që të kërkohet dhe merret pëlqimi i personit në mbajtje (qoftë me shkrim ose i regjistruar). Nuk duhet harruar po ashtu që personit në mbajtje duhet t'i bëhet e ditur se ai/ajo mund të kërkojë që të fiken aparatet e regjistrimit në çdo kohë. Monitoruesit nuk guxojnë kurrë të përdorin aparate të fshehta të regjistrimit

### **Puna me përkthyes<sup>46</sup>**

Qasja në përkthyes të besueshëm dhe të pavarur ka rëndësi vendimtare në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve. Varësisht nga gjuhët që i flasin personat në mbajtje (po ashtu dhe personeli e personat tjerë të cilët mund të disponojnë me informata përkatëse) është shpesh e domosdoshme që ekipi i monitoruesve të shoqërohet nga një a më shumë përkthyes. Përkthyesit duhet të përzgjidhen me kujdes, duke mbajtur parasysh jo vetëm balancin gjinor dhe kompetencën profesionale por edhe aspektet fetare dhe kulturore që mund të ndikojnë në cilësinë e intervistës. Në veçanti, intervistuesit duhet që të kenë kujdes jashtëzakonisht të madh që të mos i përdorin si përkthyes personelin e qendrës së paraburgimit apo vendeve të mbajtjes, persona tjerë në mbajtje, miq apo familjarë ose, thënë ndryshe, njerëz të cilët mund të mos kenë përvojë dhe objektivitet, ose të kenë ndonjë interes të tyrin në rezultatin e intervistës.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që roli i përkthyesit të jetë i qartë, si gjatë diskutimeve me autoritetet përgjegjëse të vendit të mbajtjes ashtu dhe gjatë intervistave private me personat në mbajtje. Përkthyesi nuk drejton diskutimet dhe, si i tillë, duhet të jetë i dukshëm si për intervistuesin ashtu dhe për personin në mbajtje, porse të ulet anash.<sup>47</sup>

Puna me përkthyes është aftësi më vete që kërkon bërjen e pyetjeve të qarta dhe koncize dhe dëgjim perceptiv. Saktësia e përkthimit ka rëndësi vendimtare. Mënyra e formulimit të pyetjes dhe vija e argumentimit nga ana e intervistuesit mund të ketë efekt të madh tek respondentit dhe përkthyesi duhet të dijë t'i dallojë ngjyrimet. Personi në mbajtje jo vetëm që duhet të ketë besim tek intervistuesi, por t'i besojë po ashtu dhe përkthyesit. Në këtë kuptim, intervistuesi ka përgjegjësinë që t'i vendosë rregullat themelore dhe të menaxhojë intervistën, si dhe t'ia bëjë të ditur personit në mbajtje se edhe përkthyesi po ashtu ka detyrimin e konfidencialitetit. Ndonëse mund të duket sikur gjë e ditur, është me rëndësi të mbahet parasysht që takimi zhvillohet mes intervistuesit dhe personit në mbajtje. Prandaj, intervistuesi duhet të përqendrohet që të vendosë kontakt me sy dhe raporte me personin në mbajtje, jo përkthyesin.

### **KUTIA 3.1 PËRKTHYESIT**

Përkthyesit janë të obliguar të respektojnë privatësinë dhe konfidencialitetin. Përzgjedhja e tyre duhet të bëhet në bazë të dinamikës së vendit të mbajtjes, duke përfshirë dallimet sociale, kulturore, fetare dhe politike. Varësisht nga situata, mund të paraqitet nevoja për verifikimin me kujdes të së kaluarës së përkthyesit. Në mjedise të mbyllura, posaçërisht në zona të izoluara, përkthyesit mund të shndërrohen ose në persona shumë të pushtetshëm ose shumë të rrezikuar (ose të dyja) për shkak të informatave konfidenciale tek të cilat kanë qasje. Si rrjedhojë, mund të jetë e nevojshme që të konsiderohet menaxhimi i këtyre çështjeve si, për shembull, nëpërmjet rotacionit të rregullt të përkthyesve ose duke siguruar që të mos përdoren të njëjtit përkthyes që i përdorin personeli dhe menaxhmenti i vendit të ndalimit. Po të jetë e mundshme, monitoruesit duhet të gjejnë kohë për t'u njoftuar më mirë me përkthyesit dhe për të krijuar raporte me ta.

Në fund, intervistuesi duhet që gjatë gjithë kohës të jetë vigjilent ndaj komunikimit joverbal (ndonëse duhet pasur kujdes që të mos nxirren përfundime apo domethënie të gabuara) dhe dinamikës delikate ndërmjet përkthyesit dhe personit në mbajtje, përfshirë gjuhën e trupit, mimikat e fytyrës dhe kontaktin me sy (apo mungesën e tij). Edhe këtu është me rëndësi të mbahet parasysh se shumë persona në mbajtje mund ta njohin në njëfarë mase gjuhën kryesore të intervistës, megjithëse ndihen më mirë të flasin nëpërmjet përkthyesit. Për shembull, ata mund ta kuptojnë gjuhën por nuk ndihen rehat që ta flasin.

### **3.4.6** Intervistat me personelin

Personeli mund të intervistohet për të marrë informatat parësore ose për qëllime të verifikimit ose krahasimit të çështjeve të cilat i kanë ngritur personat e ndaluar ose të tjerët. Shumica e teknikave dhe parimeve të intervistimit të personave në mbajtje vlejnë dhe për intervistat me personelin. Mirëqenia e personelit dhe menaxhmentit jo vetëm që është e rëndësishme në vetvete, por ka gjithashtu ndikim të drejtpërdrejtë tek ndjenja e mirëqenies dhe sigurisë së personave në mbajtje. Personeli dhe menaxhmenti nuk janë privuar nga liria, megjithatë ata mund të jenë të ngarkuar dhe të shqetësuar, madje mund të kenë qenë viktimë të sjelljes agresive ose të dhunshme. Natyrisht, edhe ata vetë mund të kenë kryer ose heshtur para akteve të kërcënimit, keqtrajtimit ose neglizhimit. Ata mund të jenë krenarë për dhe t'ju pëlqejë puna që bëjnë, ose të mendojnë se bëjnë punë jo falënderuese, që nuk paguhet sa duhet, madje edhe depressive.

Në përgjithësi, personeli i kryen dy funksione: ruajtja e rendit dhe e sigurisë dhe ofrimi i shërbimeve. Se a kryhen këto funksione nga dy grupe të ndryshme të personelit apo jo varet nga madhësia dhe natyra e vendit të mbajtjes. Me interes për ekipin e monitoruesve do të jenë informatat rreth të dyja funksioneve. Ca pjesëtarë të personelit mund të jenë më të rezervuar se të tjerët dhe mund ta shohin ekipin e monitoruesve si kërcënim. Megjithatë, është me rëndësi që të mos hiqet dorë. Sjellja dhe gatishmëria e personelit karshi monitorimit hetues mund të tregojë një rrëfim në vetvete, duke nxjerrë në pah kulturën e punës në vendin e mbajtjes. Nuk duhet të

harrohet asnjëherë që pjesëtarët e personelit janë pjesë e pandashme e jetës së përditshme të personave të mbajtur.

Ekipit të monitoruesve do t'i duhet që ta gjykojë vetë situatën, megjithatë mund të jetë e përshtatshme që me ca punonjës të realizohet një intervistë në grup, pa e anashkuar hierarkinë. Parimet për këto intervista duhet të jenë në të njëjtat vija si ato të intervistave në grup me personat në mbajtje. Në veçanti, ato ofrojnë një mundësi për identifikimin e personave me të cilët mund të realizohen intervista në person. Nëse ndonjë pjesëtar i personelit i afrohet ekipit dhe kërkon intervistë private, arsyeja për këtë mund të jetë se ata dëshirojnë të ndajnë informata të ndjeshme me ekipin. Njëherësh, mund të jetë fjala për masë mbrojtëse nga dikush që druhet se mund të ketë qenë subjekt i akuzave për keqtrajtim. Sido që të jetë, ekipi duhet të sigurojë që të mos realizojë intervista private vetëm me ata pjesëtarë të personelit të cilët kërkojnë të intervistohen. Kjo për shkak se personeli po ashtu mund të ketë nevojë të mbrohet nga sanksionet dhe ndëshkimet.

Ngjashëm, një pjesëtar i personelit mund të kërkojë takim me anëtarët e ekipit monitorues jashtë vendit të mbajtjes. Ekipi duhet t'i shqyrtojë kërkesat e tilla me kujdes, meqë mund të lindë nevoja për të marrë masa për mbrojtjen e pjesëtarit në fjalë. Për shembull, ekipi duhet të ketë kujdes që të mos i kushtojë vëmendje të tepërt personit në fjalë në vendin e mbajtjes dhe të zgjedhë një vend të përshtatshëm ku mundësia e përcjelljes është minimale. Duhet të merren të njëjtat masa për mbrojtjen e identitetit dhe informatave si në rastin e personave në mbajtje.

### 3.4.7 Takimi përfundimtar me kreun e qendrës

Për shkak të rëndësisë që dialogu konstruktiv ka për funksionin e monitorimit, çdo vizitë monitoruese duhet të përmbillet me një takim me drejtorin ose personin përgjegjës për qendrën e mbajtjes. Ky takim është me rëndësi në shumë aspekte: për mirësjellje, për kumtimin e gjetjeve kryesore, për identifikimin e çështjeve që duhen të përcillen dhe për të paraqitur rastet që kërkojnë intervenim të menjëhershëm për të parandaluar *kthimin mbrapsht*, torturën a format e tjera të keqtrajtitimit. Ekipi i monitoruesve duhet të mblidhet paraprakisht dhe të bie dakord për rendin e ditës dhe përmbajtjen e takimit. Takimi duhet të mbahet në një orë të caktuar paraprakisht në fund të vizitës monitoruese.

Gjatë takimit përfundimtar, ekipi duhet t'i paraqesë drejtorit një përmbledhje të gjetjeve të tyre kryesore.<sup>48</sup> Përgjigja e drejtorit jep mundësi për ta kuptuar më mirë kulturën e punës në vendin e mbajtjes. Nëse drejtori është i hapur për dialog, kjo mund ta stimulojë një diskutim ku ai/ajo do t'i shprehë pikëpamjet e veta lidhur me kushtet e qendrës së mbajtjes dhe të personave në mbajtje, si dhe arsyet për mangësitë. Meqë hapi i radhës është hartimi i raportit dhe dhënia e rekomandimeve, do të jetë e dobishme që drejtorit t'i jepet mundësia për ta thënë mendimin e vet lidhur me përmirësimet që duhen të bëjnë dhe në ç'mënyrë mund të bëhen ato. Monitoruesit mund ta informojnë drejtorin për datën në të cilën pritet të jetë i gatshëm raporti dhe kujt tjetër do t'i dërgohet.

Nëse ekipi i monitoruesve ka identifikuar probleme serioze, përfshirë këtu dëshmi të *kthimit mbrapsht*, mohimit të qasjes në mbrojtje ose procedura të azilit, ose abuzime të të drejtave të njeriut, këto duhen adresuar përmes autoriteteve përgjegjëse. Në radhë të parë, kjo do të shërbejë si masë mbrojtje ndaj rrezikut që personave në mbajtje ose personelit i cili ka dhënë informata t'u shqiptohen sanksione ose ndëshkime. Në radhë të dytë, çështjet që kanë të bëjnë me *kthimin mbrapsht* dhe qasjen në procedura zakonisht trajtohen nga autoritetet e imigracionit në nivel qendror.

Nëse nuk është identifikuar asnjë problem specifik, takimi përfundimtar me drejtorin mund të mbahet vetëm sa për formalitet dhe të jetë më bisedimor për nga natyra.

### 3.5 PAS VIZITËS

Vizita monitoruese nuk është qëllim në vetvete, por duhet parë më tepër si pjesë e një procesi që synon përmirësimin e trajtimit të imigrantëve të ndaluar dhe kushteve të mbajtjes së tyre. Vizita si e tillë realizohet kryesisht për qëllime të mbledhjes së informatave. Ndonëse nuk duhet nënvlerësuar asnjëherë rëndësia që prania e një trupi vizitues ka si masë parandaluese, në shumë raste veprimet dhe vizitat pasuese janë po aq të rëndësishme në mos më shumë. Vizita duhet të shërbejë për të analizuar hendekun mes asaj që pritet dhe situatës aktuale. Është mu ky hendek që duhet të përcillet edhe më tej, sepse ndryshimet e mirëfillta mund të bëhen mu në këtë aspekt.

### 3.5.1 Realizimi i raportimit përmbyllës në ekip dhe raportimeve përmbyllëse për anëtarët

#### Raportimi përmbyllës i ekipit

Rekomandohet që ekipit të mblidhet gjatë kohës sa është duke u zhvilluar vizita për raportime të ndërmjetme me qëllim të krahasimit dhe trekëndëzimit të informatave (krahasimi i njërit burim kundrejt tjerëve), si dhe pas përfundimit të vizitës për të diskutuar dhe rënë dakord për gjetjet. Udhëheqësi i ekipit ka rol të madh në nxitjen e raportimeve përmbyllëse dhe sigurimin e koherencës së vizitës. Zakonisht, ai/ajo mban përgjegjësinë për të marrë shënime gjatë raportimeve përmbyllëse.

#### Raportimet përmbyllëse individuale dhe në grup

Siç është vënë në dukje më sipër, vizitat në vendet e mbajtjes së imigrantëve mund të jenë jashtëzakonisht të vështira dhe nganjëherë të kenë ndikim të madh tek monitoruesit, sidomos nëse anëtarëve të ekipit monitoruesit u rastis të takojnë njerëz të cilët janë në pikëllim të thellë apo kryejnë akte protestimi apo vetëlëndimi, apo incident tjetër të papritur krizash.

#### **KUTIA 3.1 PAS VIZITËS**

Si rregull i përgjithshëm, pas vizitës, organi vizitues duhet që të:

- bëjë raportimin përmbyllës në ekip dhe raportimet përmbyllëse të anëtarëve;
- shqyrtojë dhe analizojë gjetjet e vizitës dhe të përgatitë një dokument për përdorim të brendshëm;
- të përpilojë në kohë një raport të jashtëm për autoritetet përgjegjëse, ku paraqiten gjetjet e organit vizitues dhe jepen rekomandime konkrete;
- monitorojë për së afërmi zbatimin e rekomandimeve.



Po të jetë e mundur, është e këshillueshme që anëtarët të trajnohen në strategjitë e menaxhimit të krizave, gjë që vë edhe më shumë në dukje rëndësinë e raportimit përmbyllës. Të gjithë monitoruesit duhet ta kenë obligative që të vijojnë këto seanca, madje edhe në qoftë se ca anëtarë ose i tërë ekipi nuk tregojnë shenja lodhjeje ose shqetësimi. Idealisht, seancat përmbyllëse duhet të bëhen individualisht dhe si grup, dhe të mbahen nga profesionistë të kualifikuar dhe me përvojë.

### **3.5.2** Analiza dhe dokumenti i brendshëm

Ekipi vizitues duhet t'i sistemojë dhe analizojë gjithë informatat e mbledhura gjatë vizitës monitoruese dhe të përgatisë një dokument të brendshëm. Mund të jetë e nevojshme që dokumenti i brendshëm të përpilohet në një formë që mundëson analizë krahasuese të praktikave, modeleve dhe trendeve (pozitive dhe negative) të vrojtuar nëpër vizitat e ndryshme të shumta ose me kalimin e kohës. Ai përbën raportin më të plotë të vizitës së organit vizitues dhe do shërbejë si një burim vital për vizitat e mëpastajme. Ai duhet të jetë i strukturuar mirë, të bëhet kujdes me referencat dhe të analizohet në mënyrë të thuktë ashtu që të jetë sa më i qasshëm që të jetë e mundur për vizitat e mëvonshme. Informatat të cilat nuk analizohen në mënyrë adekuate apo që nuk sistemohen në mënyrë logjike humbasin shumë shpejt.

Duke u bazuar në dokumentin e brendshëm, organi vizitues mund t'i shqyrtojë informatat e mbledhura kundrejt caqeve të standardeve përkatëse ligjore dhe/ose praktikave të mira. Nëse kjo nuk është vizita e parë, atëherë duhen të përmenden treguesit e përmirësimit apo përkeqësimit që nga vizita e fundit.<sup>49</sup>

### **3.5.3** Raportimi

Raportet janë ndër mjetet më të rëndësishme në dispozicion të organit vizitues për mbrojtjen e personave në mbajtje dhe përmirësimin e gjendjes së tyre. Megjithëse kompetencat e organeve vizituese nuk përfshijnë zakonisht zbatimin, kompetenca e organit vizitues për të nxjerrë një raport dhe për të dhënë rekomandime është e rëndësishme. Ky është një atribut i njohur i mandateve të tyre, qoftë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar. Raportet e tilla sigurojnë një bazë për dialog me qeverinë për çështjet me interes dhe shërbejnë si pikëreferim

### KUTIA 3.17 DOKUMENTI I BRENDSHËM

Dokumenti i brendshëm duhet të përfshijë:

- informata të përgjithshme faktike rreth qendrës së imigracionit;
- informata të përgjithshme rreth vet vizitës, përfshirë emrat e anëtarëve, datën, kohëzgjatjen e vizitës, synimet dhe qëllimet;
- Informatat kryesore që janë marrë gjatë vizitës (p.sh. problemet kryesore të identifikuara, analizat dhe gjetjet kryesore, veprimeve pasuese nga ana e autoriteteve dhe organit vizitues, çështjet që duhet të përcillen ose verifikohen gjatë vizitës së ardhshme monitoruese);
- shpeshësinë e rekomanduar të vizitave (përfshirë datën tentative të vizitës së ardhshme) dhe listën e kontakteve;
- informata konfidenciale të cilat nuk planifikohen të ndahen me të tjerët por që duhen regjistruar me qëllim të përdorimit për vizitat e mundshme pasuese.

i vazhdueshëm për veprimet e ardhme. Preferohet që vendimet për të nxjerrë raporte publike të merren përpara vizitës dhe komunikimit me autoritetet, megjithëse mund të ndodhë që më vonë të paraqiten arsye të mira për mospublikimin e raporteve të tilla.<sup>50</sup>

Organi vizitues duhet të përcaktojë strategjinë e vet në lidhje me raportimin, e që do të varet nga rrethanat në të cilat zhvillohet monitorimi dhe çështjet që mund të shpërfaqen. Në fund, organi vizitues duhet të sigurojë që autoritetet e mbajtjes të informohen rreth rezultateve të vizitave të tij dhe, në këtë kuptim nuk mjafton të bëhen vetëm informime me gojë.

Të gjitha raportet duhet të bazohen në materiale të dokumentuara me kujdes të çdo vizite veç e veç. Përmbajtja është çështje që e vendosë organi vizitues. Megjithatë, ata duhet të raportojnë përbërjen e ekipit të monitorimit, datën dhe kohën e vizitave, arsyen për realizimin e vizitave dhe vizitave pasuese. Raportet e tyre duhet të kenë datën. Ata duhet të përfshijnë qëllimet e vizitës (vizitave), dhe një përmbledhje të metodologjisë së monitorimit, duke përfshirë teknikat e verifikimit dhe krahasimit

### KUTIA 3.18 PESË PARIMET E PËRGJITHSHME TË RAPORTIMIT

- 1 Saktësia dhe preciziteti;
- 2 Zbulimi i informatave vetëm me pëlqim të qartë dhe të informuar, dhe sipas nevojës;
- 3 Koherenca e gjuhës dhe e terminologjisë;
- 4 Në kohë;
- 5 Të orientuar në veprime.

Ato duhet që të paktën t'i përmbledhin gjetjet kryesore tematike (pozitive dhe negative), të kategorizuara sipas shkallës së seriozitetit dhe urgjencës së problemeve dhe rekomandimet përkatëse dhe, sipas nevojës, raportimin përkatës për zbatimin e tyre.

Mund të ketë lloje të ndryshme të raporteve, si në vijim:

#### Raportet për vizitat

Nëse organi vizitues ka si qëllim të nxjerrë raporte individuale për secilën vizitë, këta zakonisht do të paraqesin gjetjet kryesore të ekipit të monitorimit, si dhe çdo çështje të ngritur në bisedën e fundit me drejtorin. Raportet e tilla plotësohen përgjithësisht me forma tjera të raportimit dhe për këtë arsye mund të jenë relativisht të shkurtër. Ç'është më e rëndësishmja, ata duhet të nxirren sa më shpejt që të jetë e mundur pas vizitës, dhe të përmbajnë rekomandime e t'i nënvizojnë dobitë e angazhimit dhe dialogut konstruktiv.

#### Raportet periodike

Raportet periodike mund të paraqesin dhe përvijojnë:

- vizitat në një vend të caktuar gjatë një periudhe kohore, ose
- vizitat që u janë bërë vendeve të ndryshme për një periudhë të caktuar kohore.

Ata ofrojnë të dhëna statistikore dhe një pasqyrë të përmbledhur të situatës, si dhe një analizë të përgjithshme të respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut.

Ata mund të përmbajnë një listë të rekomandimeve të bëra dhe/ose të zbatuara gjatë një periudhe të caktuar. Periudha e raportimit do të varet nga mandati, rrethanat dhe praktikat e trupit vizitues. Ata mund të jenë mujor, tremujor, gjashtëmujor dhe të përvitshëm.<sup>51</sup>

### **Raportet tematike**

Në vend të pasqyrimit të rezultateve të përgjithshme të një vizite ose të një serë vizitash monitoruese, raport tematike ofrojnë analizë të një çështje të caktuar (të tillë si qasje në kujdes mjekësor), ose një varg çështjesh të përzgjedhura (të tilla si qasja në kujdes mjekësor dhe personat me cenueshmeri të veçanta).

### **Raportet për urgjenca apo incidente**

Ndonjëherë mund të jetë e përshtatshme të përgatiten raporte emergjente apo në lidhje me ndonjë incident, për rastet ku nevojiten veprime urgjente për çështje të veçanta të tilla si trazirat apo grevat e urisë.

#### **3.5.4 Dhënia e rekomandimeve**

Rekomandimet nuk janë qëllim në vetvete, ashtu sikundër vizitat monitoruese. Formulimi i rekomandimeve kuptimplota mund të jetë një nga pjesët më të vështira të një vizite monitoruese. Rekomandimet duhet të jenë të qarta, specifike dhe konkrete. Sa më i qartë dhe më konkret të jetë rekomandimi, aq më shumë ka të ngjarë që të zbatohet. Dokumentimi i plotë e sistematik dhe analizimi i kushteve do bëjnë të mundur që të formulohen rekomandime të qarta dhe specifike.

Rekomandimet duhet t'u drejtohen autoriteteve të duhura ose, thënë ndryshe, atyre zyrtarëve të cilët kanë kompetenca për t'i bërë ndryshimet dhe rregullimet e nevojshme në mënyrë që rekomandimet të kenë efekt. Nëse shkaqet kryesore të problemit qëndrojnë diku tjetër, rekomandimet mund të kenë një qasje në shumë nivele ku problemi trajtohet si në aspektin operativ ashtu dhe atë sistemor.

Për sa i përket përmbajtjes dhe tonit, rekomandimet duhet të formulohen duke pasur parasysh audiencën e synuar. Në vend se gjykues ose moralizues, ata duhet të jenë praktik dhe lehtësues. Rekomandimet jepen me qëllim të bërjes së ndryshimeve për njerëzit jeta e të cilëve ndikohet drejtpërdrejt nga përvoja e mbajtjes.

Pa bërë kompromis me standardet minimale, dhe duke pasur parasysh se vendi i mbajtjes ka të ngjarë të vazhdojë së funksionuari,<sup>52</sup> në rekomandime duhet t'u kushtohet rëndësi si vijon:

- Ndjeshmëria dhe kompleksiteti i çështjeve të veçanta në mjedisin e mbajtjes, si dhe nevoja për fleksibilitet gjatë adresimit të tyre;
- Problemet kryesore në qendrën e mbajtjes, si dhe prioritetet përkatëse të menjëhershme;
- Nevoja për caktimin e një afati kohor të qartë dhe të arritshëm për zbatimin e rekomandimeve (i menjëhershëm, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë);
- Nevoja për zgjidhje kreative për problemet e veçanta;
- Roli i rekomandimeve në kontribuimin për zhvillimin dhe ruajtjen e standardeve;
- Mundësia që për zbatim efektiv të kërkohen trajnime dhe/ose asistencë teknike; dhe
- Mundësia e ripërsëritjes së rekomandimeve të bëra nga organet e tjera (për shembull, organizmat vizitues rajonal dhe ndërkombëtarë) kur është e nevojshme - kjo mund t'i përforcojë rekomandimet dhe të rritë gjasat për zbatimin e tyre.

Cilësia dhe dobishmëria e rekomandimeve të përpiluara pas vizitave në vendet e ndalimit mund të vlerësohet kundrejt 10 kriterëve të modelit të dyfishtë SMART, që janë të ndërlidhura dhe përforcojnë reciprokisht njëri/tjetrin.<sup>53</sup>



### KUTIA 3.1 MODELI I DYFISHTË S.M.A.R.T.

**S**pecific: Çdo rekomandim adreson vetëm një çështje specifike.

**M**atshëm: Vlerësimi i zbatimit të secilit rekomandim duhet të jetë sa më i lehtë që të jetë e mundur.

**A**rritshëm: Çdo rekomandim duhet të jetë realist dhe i realizueshëm.

**R**ezultati në fokus: Veprimet e sugjeruara duhet të shpijnë në rezultate konkrete.

**T**afat kohor: Për çdo rekomandim duhet të jepet afat realist i zbatimit.

**+**

**S**ugjeron zgjidhje: Kurdo që të jetë e mundshme, në kuadër të rekomandimeve duhet të propozohen zgjidhje të realizueshme.

**M**err parasysh prioritizimin, radhitjen dhe rreziqet: Në rast të rekomandimeve të shumta, së pari duhet të adresohen ato më urgjente. Rekomandimet më pak urgjente mund të lihen për raportet e mëpastajmë të radhës.

**A**rgumentuara: Rekomandimet duhet të bazohen në dëshmi dhe analizë të cilësisë së lartë dhe objektive. Ato duhet t'u referohen standardeve përkatëse.

**R**eagim ndaj shkakut të vërtetë: Rekomandimet duhet të adresojnë shkaqet e problemeve, jo simptomat.

**T**argetuar: Rekomandimet duhet t'u drejtohen institucioneve dhe/ose akterëve specifik, jo "autoriteteve", në mënyrë që përgjegjësia për zbatimin e tyre të jetë e qartë.

### 3.5.5 Shpërndarja e raporteve

Audiençë kryesore e raporteve do të jenë autoritetet. Megjithatë, mund të jetë po ashtu e rëndësishme që raportet të bëhen publike, pa cenuar privatësinë dhe konfidencialitetin. Koha e publikimit është vendim strategjik të cilin do të duhet ta marrë organi vizitues. Raportet mund t'u shpërndahen akterëve tjerë, në veçanti atyre që mund të ndikojnë, mbështetin dhe/ose monitorojnë zbatimin e rekomandimeve. Këtu përfshihen për shembull OKB-ja dhe agjencitë e mekanizmat rajonal, zyrtarët e pushtetit lokal dhe deputetët, OJQ-të dhe akterët tjerë të shoqërisë civile.

Varësisht nga strategjia e komunikimit e organit monitorues, raportet ose përmbledhje të tyre mund të vihen në dispozicion për mediat. Në këtë rast, do të jetë me rëndësi të monitorohet reagimi dhe përgjigjet e autoriteteve. Kjo do të ndihmojë në planifikimin e veprimeve pasuese.

### 3.5.6 Veprimet pas raporteve dhe rekomandimeve

Është e dëshirueshme që autoritetet të nisin një dialog konstruktiv me trupin vizitues sa u përket gjetjeve të raportit dhe zbatimit të rekomandimeve. Ka mënyra të ndryshme për ndërmarrjen e veprimeve pasuese, ku disa janë sistematike për nga natyra, ndërsa tjerat janë ndërhyrje të individualizuara ose të bazuara në raste. Më poshtë janë dhënë disa sugjerime të strategjive që mund të përdoren:

#### **Të kërkohet përgjigje me shkrim lidhur me raportet**

Është e dëshirueshme që autoritetet të japin përgjigje me shkrim në lidhje me ndonjë raport dhe rekomandimet e tij, duke shpalosur dallimet në këndvështrime sa u përket fakteve dhe respektimit të standardeve ligjore. Në kontekstin e disa mandateve të monitorimit, autoritetet janë të obliguara të përgjigjen. Është e rëndësishme që të jepet një afat kohor i arsyeshëm për përgjigjen. Se çfarë përbën "afat të arsyeshëm" do të varet nga rrethanat, në veçanti serioziteti i çështjeve të ngritura dhe urgjenca me të cilën ato duhet të adresohen.



Përgjigja është njëherësh tregues i gatishmërisë së autoriteteve për zbatimin e rekomandimeve. Natyra dhe përmbajtja e kësaj përgjigje mund t'i shërbejë trupit vizitues si udhërrëfyes në kuptimin e dialogut pasues, përshtatjeve që mund të jenë të nevojshme të bëhen për vizitat e ardhshme, ose nevojës së menjëhershme dhe të ngutshme për një vizitë pasuese, qoftë pa paralajmërim ose me njoftim të shkurtër. Cdo garanci për zbatimin e ndonjë rekomandimi është për t'u përsëritur dhe duhet të shenjohej për ta përcjelljé gjatë vizitës së ardhshme monitoruese ose nëpërmjet një rrjeti të monitorimit të bashkërenduar.

Gjithë letërkëmbimi mes autoriteteve dhe organit vizitues duhet të bëhet në përputhje me konventat dhe protokollat lokale për komunikim me shkrim, duke përdorur sipas nevojës gjuhë dhe adresime zyrtare.

### **Vizitat pasuese**

Vizitat pasuese janë vendimtare për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve dhe për të konstatuar se në çfarë përmase realiteti në terren përkon me garancitë e dhëna nga autoritetet në nivel të lartë.

### **Organizimi i takimeve dhe tryezave të diskutimit me autoritetet kryesore**

Takimet dhe tryezat pasuese të diskutimit me autoritetet kryesore duhet të planifikohen me kujdes dhe në mënyrë të matur.

Gjatë planifikimit duhet të parashihen pengesat për zbatimin e rekomandimeve dhe arsyet e këtyre pengesave. Gjatë këtij procesi duhet të krahasohet perspektiva e zbatimit të rekomandimeve kundrejt konsideratave sociale, ekonomike, ligjore dhe politike dhe nëse zbatimi është ose perceptohet të jetë në interes të autoriteteve. Kjo do të ndihmojë në hartimin e strategjive që i rritin në maksimum gjasat e zbatimit.

Gjetjet dhe rekomandimet mund të prezantohen dhe diskutohen në mënyrë të qartë, të paanshme dhe profesionale. Dialogu duhet të bazohet në dëshmi dhe fakte, me kushtin që të respektohen parimet e mbrojtjes që i ngërthen maksima "mos dëmto". Po të jetë nevoja, mund

të ripërsëritet natyra e lejes për realizimin e vizitave monitoruese (e cila duhet të jetë e qasshme për qëllime të referimit në të, po të kërkohet një gjë e tillë).

### **3.5.7** Vlerësimi dhe rishikimi i procesit të monitorimit

Që procesi i monitorimit të vendeve të mbajtjes së imigrantëve të jetë efektiv, puna dhe ndikimi i monitorimit duhet të vlerësohen dhe rishqyrtohen rregullisht për të nxjerrë mësim nga procesi dhe për t'i bërë ndryshimet e nevojshme. Ky Doracak ka për qëllim që t'ju ndihmojë përdoruesve të cilëve u dedikohet të caktojnë synime, qëllime dhe detyra të qarta të monitorimit dhe rezultate të matshme.

Në kuadër të vlerësimit të një vizite monitoruese ose programi të monitorimit duhet të shqyrtohen të gjitha aspektet dhe fazat e procesit. Duhet të vlerësohet metodologjia dhe zbatimi i saj në faza të ndryshme. Në kuptim të gjerë, vlerësimi duhet të na sigurojë përgjigje në pyetjet në vijim:

Proceset e monitorimit të organizuara dhe përgatitura siç duhet që t'ua bëjnë të mundur organeve vizituese të japin përgjigje të konsideruara dhe konkrete në gjithë këto pyetje. Megjithatë, vlerësuesit duhet të mbajnë parasysh faktin që ndryshimet në kontekstin e mbrojtjes prirën të jenë graduale dhe jo të befta. Si i tillë, procesi i vlerësimit dhe rishikimit duhet të bëhet periodikisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të mund të matet ndikimi me kalimin e kohës.

### **3.5.8** Strategjitë e mundshme të veprimeve pasuese shtesë

Përveç procesit të monitorimit, organet mund të konsiderojnë përpilimin e strategjive tjera shtesë për veprime pasuese, të tilla si ato që sugjerohen në vijim.

## KUTIA 3.2 VLERËSIMI I VIZITËS MONITORUESE

- Çfarë kemi bërë?
- Çfarë kemi arritur?
- A kemi bërë mirë punën?
- Çfarë ndryshimi kemi sjellë?
- Si e dimë që kjo ka ndodhur?

Pas këtyre përgjigjeve, duhet dhënë përgjigje dhe në pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë dimë tani e që nuk e kemi ditur më parë?
- A ka pasur hendeqe dhe mangësi në procesin tonë të monitorimit?
- A ka pasur mundësi që nuk janë shfrytëzuar?
- Çfarë mund të bëjmë më mirë?
- Çfarë ndryshimi do të sillte një gjë e tillë?

### Shqyrtimi i ligjeve dhe/ose udhëzimeve administrative e rregulloreve

Në disa vende, angazhimi i mëpastajmë i organeve vizituese mund të përfshijë pjesëmarrjen në rishikimin e ligjeve kombëtare dhe/ose udhëzimeve administrative e rregulloreve, të tilla si ligjet për imigracionin dhe azilin. Për shembull, UNHCR-i dhe disa IKDNJ (përfshirë komisionet për të drejtat e njeriut dhe zyrat e avokatit të popullit) punojnë me qeverinë në këtë nivel. Në PFKKT, kompetenca e MKM-ve për të “paraqitjen e propozimeve dhe vrojtimeve në lidhje me legjislationin ekzistues apo projektligjet” përshkruhet si “kompetencë minimale”<sup>54</sup>

### Intervenimet dhe referimet individuale

Në raste të rrezikut të pashmangshëm të deportimit ose largimit që mund të rezultojë në *kthim mbrapa* ose shkelje tjera të së drejtës ndërkombëtare, mund të jetë nevoja që organi vizitues të bëjë intervenime individuale. Po kështu, rreziku i pashmangshëm i torturës apo keqtrajtimit tjera mund të shkaktojë nevojën për një ndërhyrje individuale. Megjithëse çështjet e tilla janë pjesë e funksionit të gjerë të

monitorimit dhe raportimit të trupit vizitues, rreziqet e tilla kanë shumë të ngjarë që të sjellin në pah për intervenime që shkojnë përtej funksionit “tradicional” të monitorimit dhe raportimit.

Çfarëdo qoftë kapaciteti i tyre për të bërë intervenime individuale, të gjitha organet vizituese duhet të hartojnë një politikë dhe sistem efektiv të referimeve.

## **Avokimi**

Varësisht nga fushëveprimi i kompetencave të organit vizitues për të vizituar vendet e mbajtjes për qëllime të monitorimit, mund të jetë si e nevojshme ashtu dhe e përshtatshme që paralelisht me funksionin e monitorimit të hartohen dhe strategji të avokimit. Strategjitë e avokimit duhet të dizajnohen asisoj që ta plotësojnë funksionin e monitorimit, për të ngritur zërin rreth gjetjeve të organit vizitues me qëllim të përbushjes së mbrojtjeve të nevojshme dhe të zbatimit të rekomandimeve.

Avokimi mund të realizohet nëpërmjet përdorimit strategjik të nismave publike, forumeve dhe rrjeteve të shoqërisë civile (p.sh. KNN), OKB-së dhe/ose forumeve rajonale (p.sh. Grupi Punues për Ndalimin Arbitrar, Këshilli i OKB-së për Drejtat e Njeriut dhe mekanizmat tjerë për të drejtat e njeriut).

## **Mediat**

Zakonisht, autoritetet janë shumë të kujdesshme kur është fjala për raportimet në media. Këshillohet që organet vizituese t'i përdorin mediat në mënyrë të kujdesshme dhe strategjike dhe të flasin vetëm për çështje që bien në fushën e tyre të kompetencës dhe përgjegjësisë. Faktet duhet të jenë të qarta dhe të sakta, si dhe duhet të bëhet dallimi mes raporteve e pohimeve në njëërën anë dhe gjetjeve në anën tjetër. Komentarët duhet të analizohen me kujdes, të jenë të fokusuar, të balancuar dhe të mund të mbrohen. Rekomandohet që organet vizituese të përpilojnë udhëzime lidhur me kontaktet me mediat.

Në disa raste mund të jetë e udhës të angazhohen trupa dhe mekanizma ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut.<sup>55</sup> Për shembull, në rastet individuale prej vendeve që e njohin kompetencën e një organi të traktatit të OKB-së për të drejtat e njeriut për pranimin dhe shqyrtimin e komunikimeve individuale,<sup>56</sup> mund të iniciohen procedura të ankimit. Ky është një proces kompleks i cili kërkon shterimin e të gjitha mjeteve ligjore vendore në dispozicion, dhe mund të duhen shumë vite deri në zgjidhjen e çështjes. Megjithatë, është krijuar një jurisprudencë ndërkombëtare dhe rajonale gjithnjë në rritje që lidhet me mbajtjen e imigrantëve.<sup>57</sup> Në kontekstin e largimit të imigrantëve, masat e përkohshme kanë qenë të një rëndësie të veçantë në rastet kur deportimi ose largimi është i pashmangshëm dhe mund të jetë pasojë *kthimi mbrapsht*. Përveç procedurave të komunikimit individual, organet vizituese mund ta konsiderojnë të udhës që rezultatet e tyre t'i ndajnë përmes procesit të Rishikimit Periodik Universal që realizohet nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, ose nëpërmjet procedurës së raportimit periodik të organeve të traktateve të OKB-së që monitorojnë zbatimin e traktateve të të drejtave të njeriut nga Shtetet Palë. Gjithashtu, organet vizituese mund të zgjedhin që t'i ndajnë informatat me procedurat e posaçme të OKB-së, të tilla si RP-të me mandate tematike për torturën dhe MDNJ, ose procedura të posaçme me mandate për vende të caktuara.

### Shqyrtimi gjyqësor

Disa organe vizituese vendore, në veçanti institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, kanë kompetenca kuazigjyqësore, madje ndonjëherë edhe gjyqësore. Ata mund të pranojnë dhe hetojnë ankesa, urdhërojnë ose rekomandojnë lirimin e personave të ndaluar në mënyrë arbitrare ose të kundërligjshme dhe/ose të urdhërojnë ose rekomandojnë pagimin e kompensimit. Në raste tjera, trupi vizitues mund të posedojë informata që janë bazë për fillimin e një procedure ligjore ose mund të jenë vendimtare për suksesin e çështjes. Në këto situata, hapi i duhur për t'u bërë është referimi dhe bashkëpunimi me avokatët, veçanërisht në qoftë se trupi vizitues has në rezistencë për zbatimin e rekomandimeve të tij.

---

Intervenimet para gjykatave nga ana e organizatave dhe subjekteve të tilla si UNHCR-i dhe IKDNJ-të janë një mjet i rëndësishëm përmes të të cilit mund të zhvillohen standardet e mbrojtjes dhe të nxitet zbatimi i njëtrajtshëm i së drejtës ndërkombëtare për refugjatët dhe të drejtat e njeriut.

### **Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi**

Organet e monitorimit mund të marrin në konsideratë po ashtu edhe promovimin dhe kontributin në trajnimin e personelit i cili punon në fushën e ndalimit të imigrantëve, për të rritur njohuritë dhe për të ndikuar pozitivisht në qëndrimet dhe sjelljet e tyre.

# 4 CILAT ASPEKTETË NDAUMITTË IMIGRANTËVE DUHET TË SHQYRTOHEN

Pjesa 4 mund të lexohet si pjesë më vete. Duke u mbështetur në standardet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me mbajtjen e imigrantëve, kjo pjesë propozon caqe, konsiderata praktike dhe udhëzime të përgjithshme për aspektet e veçanta të mbajtjes së imigrantëve që mund të shqyrtohen në kuadër të vizitës së monitorimit. Ajo shërben si referencë e lehtë në standardet përkatëse ndërkombëtare përkarshi çështjeve që shfaqen rëndom në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve.

Burimet u referohen të drejtave universale dhe rajonale të njeriut dhe traktateve të së drejtës së refugjatëve e instrumenteve të ligjeve të buta<sup>58</sup>. Lista nuk është shteruese, mirëpo janë përzgjedhur dispozitat më relevante dhe specifike. Standardet e përgjithshme të të drejtave të njeriut sikurse mosdiskriminimi, ndalesa e mbajtjes arbitrare, dhe trajtimi njerëzor e dinjitoz i personave në mbajtje vlejné për tërë këtë pjesë por nuk janë renditur ndaras.

## 4.1 PROCEDURAT E MBAJTJES DHE IMIGRIMIT

Synimi i kësaj pjese është të shqyrtojë mënyrën në të cilën shqiptohet masa e mbajtjes dhe në ç'mënyrë u jepen personave në mbajtje informatat dhe qasja në procedurat e nevojshme për të reaguuar ndaj rrethanave që kanë çuar në mbajtjen e tyre. Këta janë hapat e parë vendimtarë të përvojës së një personi i cili ndalohet në mbajtje dhe të ketë ndikim dramatik në mënyrën se si ai/ajo e përjeton mbajtjen, qoftë në afat të shkurtë apo të gjatë.

### 4.1.1 Procedurat e mbajtjes dhe qasja në alternativa të mbajtjes

Shqyrtimi i bazës ligjore për mbajtjen është vendimtar për ta kuptuar natyrën dhe efektet e kushteve të mbajtjes. Kjo nuk nënkupton që organet vizituese të bëjnë analizë të plotë të kornizës ligjore në lidhje me mbajtjen në mënyrë që të mund t'i monitorojnë vendet e mbajtjes së imigrantëve. Në të vërtetë, në shumë juridiksione është bërë tashmë një punë voluminoze për këto çështje. Përkundrazi, njohja me bazën ligjore mbi mbajtjen ose mungesën e saj është pikënisje e rëndësishme për monitorim efektiv.

E drejta ndërkombëtare parasheh që kufizimet e lirisë dhe përdorimi i jashtëzakonshëm i masës së mbajtjes të lejohen vetëm kur janë të ligjshme dhe joarbitrare. Me fjalë tjera, çdo kufizim i lirisë, përfshirë mbajtjen, mund të bëhet vetëm për baza të parapara me ligj dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj.

Ndalesa e mbajtjes arbitrare përcakton disa masa mbrojtëse shtesë për të siguruar drejtësi dhe mosdiskriminim. Në radhë të parë, mbajtja duhet t'i shërbejë një qëllimi legjitim. “Qëllime legjitime” në kontekstin e mbajtjes të imigrantëve janë të njëjta për azilkërkuesit dhe migrantët ashtu si edhe për gjithë të tjerët: kur ka rrezik për arratisje nga procedurat e ardhshme ligjore ose proceset administrative apo kur dikush përbën rrezik për veten ose sigurinë publike.

Në radhë të dytë, duke supozuar se shteti ka një qëllim legjitim, çdo mbajtje duhet të jetë e domosdoshme, e arsyeshme dhe proporcionale në të gjitha rrethanat e rastit. Këto kushte zbatohen për gjithë personat në mbajtje, pavarësisht nga statusi i refugjatit, azilkërkuesit apo ndonjë status tjetër i imigracionit.

Në fund, mbajtja duhet t'u nënshtrohet rishikimeve periodike kuptimplota, të zbatueshme dhe të pavarura.



Ekipi i monitorimit nuk do të jetë gjithmonë në gjendje që të vlerësojë nëse mbajtja në ndonjë rast të caktuar është bërë në mënyrë arbitrare ose të kundërligjshme. Megjithatë, kur ka historik të praktikave të mbajtjes arbitrare apo të kundërligjshme, kjo mund të jetë tregues i një rreziku sistemor ose në rritje të mbajtjes arbitrare dhe të kundërligjshme të migrantëve tjerë në mbajtje.

Për shtjellimin më të thuktë të standardeve përkatëse, shih Pjesën 2.6 për kornizën ndërkombëtare ligjore.

## 1 Mbajtja e imigrantëve është masë e jashtëzakonshme dhe lejohet vetëm për shkaqe të parapara me ligj dhe në përputhje me procedurat e autorizuara me ligj

**Burim:** [PNDPC](#) 9(1), 12(1); [KPM](#) 16(1), 16(4), 39; [KDF](#) 37(b); [KDKAK](#) 14(1); [KSR](#), Art. 31(1); [BPP](#) 2; [UNHCR-UN](#) 3; [KADNJP](#) 6, 12; [ACHR](#) 7(1), (2), (3); [KEDNJ](#) 5; [KDTHE](#) 6; [DPBE](#) Recitali (15); [PPMMPPLKA](#) III(1), (2); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §85

### Këshilla për monitoruesit:

- A ka bazë ligjore (në ligjin kombëtar) për mbajtjen e personave ?
- A është mbajtja praktikë e jashtëzakonshme dhe a përdoret vetëm si mjet i fundit? Verifikoni statistikat për mbajtjen e imigrantëve: çfarë përqindje e personave të cilët mund të ndalohen në mbajtje në të vërtetë mbahen/lirohen?
- A u jepen personave në mbajtje urdhra individual për mbajtje në kohën e ndalimit në mbajtje ose brenda një afati sa më të shpejtë që të jetë e mundur pas ndalimit në mbajtje?
- A pranojnë personat në mbajtje arsyetime me shkrim për vendimin fillestar mbi mbajtjen e tyre në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë?

---

## 2 Vendimet mbi mbajtjen u nënshtrohen shqyrtimeve periodike, dhe personat në mbajtje kanë të drejtë kuptimplote për të kundërshtuar apo për t'u ankuar ndaj vendimit mbi mbajtjen

**Burimet:** [PNDCP](#) 9(5); [KP-KDF](#) 6(61-63), GC 10(83); [KPM](#) 16(6), (8), (9); [BPP](#) 11(3), 37; [UNHCR-UN](#) 3(17); [ACHR](#) 7(5)-(6), 25(1); [KADNJ](#) 7; [KEDNJ](#) 5; [KDTHE](#) 6; [DPBE](#) Recital (15); [PPMPPPLKA](#) V; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §86.

### Këshilla për monitoruesit:

- A informohen në kohë personat në mbajtje mbi të drejtën e tyre për ta kundërshtuar ligjshmërinë e mbajtjes së tyre? A ka në dispozicion mjete juridike efektive?
- Sa shpesh rishqyrtohet një vendim individual mbi mbajtjen (rregullsia, shpeshësia dhe cilësia, nga kush, me çfarë kompetencash)?
- Cila është procedura e shqyrtimit? A informohen personat në mbajtje rreth kësaj procedure në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë?
- A është i pavarur organi shqyrtues? A është vendimi i tij i ekzekutueshëm?
- A bëhet shqyrtimi në mënyrë automatike apo duhet të kërkohet? A është i individualizuar?
- A kanë personat në mbajtje qasje në informata përkitazi me ecurinë e kërkesës së tyre?
- A u ofrohet fëmijëve të pashoqëruar apo të ndarë ndihmë lidhur me procedurat e shqyrtimit?

---

## 3 Ndalimi për mbajtje shqiptohet për afate kohore strikte, dhe personat në mbajtje lirohen nëse kalon afati maksimal i paraparë për mbajtjen

**Burimet:** [UNHCR-UN](#) 6; [GPNA-D5](#) P7; [PPMPPPLKA](#) III (1); [DPBE](#) Recital (16); [KPT/Inf](#) (97) 10 §27

### Këshilla për monitoruesit:

- A ekziston një afat kohor maksimal i paraparë me ligj për mbajtjen dhe në rastin individual? Çfarë ndodh nëse kalon ky afat kohor në rastin e një personi në mbajtje?
- A ndalohen në mbajtje fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë? Nëse po, për

çfarë kohëzgjatje?

- Cila është kohëzgjatja aktuale e mbajtjes (mesatarisht, më e gjata)?

---

#### **4 Përpara shqiptimit të vendimit mbi ndalimin për mbajtje së pari shikohen alternativat ndaj mbajtjes**

Burimet: [UNHCR-UN 4.3](#); [PPMPPPLKA III\(4\)](#); [DPBE Recital \(15\)](#)

**Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë alternativa ndaj mbajtjes janë në dispozicion? A janë ato në dispozicion në kuptimin e plotë? Me çfarë baze?
- A përmban urdhri për mbajtje arsyetimin se përse nuk është përdorur ndonjë masë tjetër alternative?
- Ndaj çfarë numri të njerëzve janë shqiptuar masa alternative ndaj mbajtjes për një periudhë të caktuar kohore? Sa njerëz janë ndaluar në mbajtje gjatë së njëjtës periudhë?
- A ka pasur privime të lirisë në lidhje me masat alternative ndaj mbajtjes në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe joarbitraritetit?
- A ka mekanizma të ankimit/shqyrtimit periodik të alternativave ndaj mbajtjes, për të siguruar që ato të mos përbëjnë privime arbitrare të lirisë ose shkelje tjera të të drejtave të refugjatëve, azilkërkuesve ose migrantëve?
- Me çfarë bazë u jepet qasje në alternativat ndaj mbajtjes personave të cilët ndodhen në pozitë të cënueshme?

---

#### **5 Personat në mbajtje ose anëtarët e familjes së tyre të cilët lirohen në mesin e komunitetit si alternativë ndaj mbajtjes pajisen me dokumentet e nevojshme të identifikimit dhe/ose lirimit/qëndrimit si masë mbrojtëse ndaj ndalimit të sërishëm për shkaqe të mungesës së dokumentacion, dhe kanë qasje në shërbime**

Burimet: [UNHCR-UN 4.3](#)

**Këshilla për monitoruesit:**

- A pajisen personat në mbajtje dhe anëtarët e familjes së tyre me dokumente zyrtare të përkohshme të identifikimit?
- A pajisen personat të cilët lirohen me dokumente të përkohshme të identifikimit që lejojnë qëndrimin në shtet?
- A respektohen këto dokumente nga autoritetet?

### 4.1.2 Qasje në avokat

Imigrantët në mbajtje kanë të drejtë të kenë qasje në një avokat me kualifikimet e duhura për t'i këshilluar dhe për t'i ndihmuar ata si në lidhje me mbajtjen ashtu dhe procedurat përkatëse të mbrojtjes dhe/ose imigrimit. Kështu, personat në mbajtje duhet të informohen automatikisht për të drejtën e tyre për këshillim dhe ndihmë juridike dhe t'u mundësohet të kenë qasje të shpejtë në të. Përveç ofrimit të këshillave juridike, avokatët mund të kenë rol të rëndësishëm në parandalimin e torturës dhe *kthimit mbrapsht*. Nëse ndihma juridike falas mund t'u vihet ose është në dispozicion të personave në mbajtje, disponueshmëria e ndihmës të tillë duhet të bëhet e ditur në mënyrë efektive si pjesë e procesit.

Personave në mbajtje duhet t'u jepet kohë dhe hapësirë adekuate për konsultim ligjor dhe komunikim. Komunikimet dhe konsultimet e tilla duhet të bëhen pa vonesë apo censurë dhe në konfidencialitet të plotë.

---

## 1 Personat në mbajtje kanë qasje në avokat me kualifikimet e duhura

**Burimet:** [PNDOP](#) 14(3)(b), (d); [KPM](#) 18(3)(b), (d); [KDF](#) 37(d); [KDF](#) GC 6; [KSR](#) 16(2); [UNHCR-UN](#); [BPP](#) 11(1) 17, 18; [RRSM](#); [GPNA-D5](#) p.2; [ACHR](#) 8(2)(d), (e); [PPMMPLKA](#) V; [KADNJ](#) 7; [KEDNJ](#) 6; [RREB](#) 23.1 & 98; [KDTHE](#) 47; [DPBE](#) 9.7; [KPT/Inf](#) (97) 10 §30, 31; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §82, 87

### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë imigrantët në mbajtje qasje në avokat që nga fillimi i ndalimit të tyre?
- A kanë fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë qasje në avokat?
- Sa shpesh i vizitojnë avokatët?
- A ofrojnë privatësi dhe konfidencialitet dhoma ose hapësirat e tjera që përdoren për konsultime ligjore?
- A ka sistem të avokatit kujdestar apo ndonjë mekanizëm tjetër për sigurimin e qasjes në këshilla juridike në kohë?
- A kanë personat në mbajtje ndonjë shqetësim lidhur me cilësinë e ndihmës juridike?

## 2 Imigrantët të cilët ndalohen në mbajtje informohen menjëherë në lidhje me të drejtën e tyre për qasjes në ndihmë juridike në çdo fazë të procedurës

Burimet: [PNDGP](#) 14(3)(b), (d); [KPM](#) 18(3)(d); [KDF](#) 37(d); [KSR](#) 16(2); [UNHCR-UN](#) 7; [BPP](#) 11(1) 17, 18; [RRSM](#) 93; [GPNA-D5](#) f.2; [ACHR](#) 8(2)(d), (e); [KEDNJ](#) 6; [PPMMPPLKA](#) V; [KADNJP](#) 7

### Këshilla për monitoruesit:

- A u vihet në dispozicion këshillim dhe ndihmë juridike falas imigrantëve në mbajtje? Nëse ndihma nuk është falas, a ka ndonjë sistem të përfaqësimit ligjor pro bono?
- Kur dhe në ç'mënyrë informohen personat në mbajtje në lidhje me të drejtën për të pasur avokat? A bëhet kjo në një gjuhë të qasshme për ta?
- Sa/çfarë përqindje e personave në mbajtje kanë përfituar nga ndihma juridike falas gjatë 3–6 muajve të fundit?
- Sa personave në mbajtje u është refuzuar kërkesa për ndihmë juridike falas ose janë deklaruar se nuk i plotësojnë kriteret për të përfituar?

## 3 Imigrantët në mbajtje kanë qasje të lehtë dhe të papenguar tek përfaqësuesit e tyre ligjorë

Burimet: [BPP](#) 11(1), 17, 18; [RRSM](#) 93, 94; [RPJDL](#) 18(a); [PPMMPPLKA](#) V; [RREB](#) 23.3; [DPBE](#) 9.7; [KPT/Inf](#) (97) 10 §31; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §82

### Këshilla për monitoruesit:

- A ka qasje të pakufizuar dhe pa pagesë në telefon, faks dhe/ose email për komunikim me përfaqësuesit ligjor? A janë bisedat private?
- A janë në dispozicion pa pagesë përkthyes të kualifikuar dhe të paanshëm nëse paraqitet nevoja për shërbime të përkthimit?
- A ka pasur ndonjë rast të vonesave në qasjen në avokat?

---

#### 4 Avokatët mund të jenë të pranishëm në të gjitha intervistat me zyrtarët qeveritarë apo agjentët e tyre

Burimet: [RRSM](#) 93; [BPP](#) 11; [KPT/Inf](#) (97) 10 §31

##### Këshilla për monitoruesit:

- A mund të jenë avokatët të pranishëm gjatë intervistave me zyrtarët apo procedurave zyrtare?
- Cila është procedura për kërkimin e një avokati? A ka vonesa dhe, nëse po, cilat janë pasojat për këtë?

---

#### 5 Imigrantët në mbajtje dhe avokatët e tyre njoftohen me shkrim paraprakisht për të gjitha intervistat, shqyrtimet, seancat e ankesave dhe vendimet lidhur me proceset dhe procedurat e mbajtjes, mbrojtjes, imigritimit dhe largimit

Burimet: [KPM](#) 16(5), 18(3); [BPP](#) 11(2), 13; [PPMMPLKA](#) V

##### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë përmbajtje kanë informatat me shkrim të cilat u jepen personave në mbajtje dhe avokatëve të tyre?
- A janë në një gjuhë të cilën e kupton personi në mbajtje?

### 4.1.3 Mbërritja dhe pranimi

Arrestimi dhe mbajtja janë shkak i një ankthi dhe pasigurie të madhe tek azilkërkuesit dhe migrantët, dhe mund të përkeqësojnë cënueshmërinë e tyre. Është thelbësore që personat në mbajtje të trajtohen me respekt dhe t'u bëhen me dije gjithë të drejtat. Personat në mbajtje duhet të pajisen me mjete për të kontaktuar me familjen, avokatë, personelin e UNHCR-it dhe përfaqësuesit konsullor,<sup>59</sup> si të jetë më e përshtatshme, që në momentin e heqjes së lirisë. Në qoftë se personat në mbajtje trajtohen në një mënyrë që minimizon ndjenjën e tyre të cënueshmërisë duke i bërë të ndihën të respektuar dhe sa më të sigurt që është e mundur, ata kanë më shumë të ngjarë që ta përballojnë mirë përvojën e ndalimit në mbajtje, si dhe të bashkëpunojnë me personelin dhe menaxhmentin. Mënyra se si personat në mbajtje i përjetojnë këto faza fillestare do të ndikojë në mënyrë dramatike në mënyrën se si ata përjetojnë mbajtjen në ndalim në përgjithësi, qoftë në afat të shkurtër apo më të gjatë. Faza fillestare

e mbërritjes dhe pritjes është gjithashtu një mundësi e rëndësishme për të siguruar që personat në mbajtje të regjistrohen si duhet në një regjistër dhe që personat me nevoja të veçanta që janë në mbajtje të identifikohen.

Në fund, por jo për nga rëndësia, është e rëndësishme që të gjithë personat e ndaluar në mbajtje të mund t'i nënshtrohen një kontrolli mjekësor me rastin e mbërritjes, i cili bëhet nga personeli shëndetësor, në mënyrë private dhe me përkthyes nëse është nevoja.

## 1 Personat në mbajtje informohen sistematikisht me rastin e arritjes, me shkrim dhe një mënyrë/gjuhë të cilën ata e kuptojnë, rreth arsyeve të arrestimit ose mbajtjes së tyre

Burimet: [PNDOP](#) 9(2), 14(3)(a); [KPM](#) 16(5); [BPP](#) 10, 14; [ACHR](#) 7(4), 8(2)(b); [KEDNJ](#) 5; [RREB](#) 38; [PPMMPLKA](#) V

### Këshilla për monitoruesit:

- Në ç'mënyrë personat në mbajtje informohen rreth arsyeve për mbajtjen? A regjistrohet kjo dhe si regjistrohet?
- A u jepen personave në mbajtje informata mbi procedurat e mbajtjes?
- A u jepen informatat rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me mbajtjen dhe qendrën e mbajtjes?
- Si jepen këto informata?
- A jepen informatat në një gjuhë dhe formë të kuptueshme për personin në mbajtje? (përfshirë personat të cilët nuk dinë shkrim-lexim)

## 2 Të gjithë imigrantët në mbajtje këshillohen automatikisht për të drejtën e tyre për të kërkuar azil dhe mbrojtje ndaj kthimit mbrapsht

Burimet: [UDHR](#) 14; [UNHCR-UN](#) 1; [ACHR](#) 22(7); [KADNJP](#) 12(3); [KDTBHE](#) 18; [KSR](#) 33; [KDF](#) 22; [PKK](#) 19; [AT.P](#) 14; [UNHCR-UN](#) 1

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë informata u jepen personave në mbajtje? Në çfarë forme?
- A jepen informatat në një gjuhë dhe formë të cilën e kupton personi në mbajtje? (përfshirë personat të cilët nuk dinë shkrim-lexim)





---

### 3 Ekziston një regjistër mbi ndalimet në mbajtje ku regjistrohen identiteti, data dhe baza për mbajtjen, autoriteti kompetent që është përgjegjës për ndalimin në mbajtje, dhe të cilin e nënshkruajnë personat në mbajtje

**Burimet:** [ICPPED](#) 17(3); [RRSM](#) 7(1); [GPNA-D5](#) P4; [PPMMPPLKA](#) IX(2); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §85; [RREB](#) 15.1

#### Këshilla për monitoruesit:

- A mbahet ky regjistra në mënyrë sistematike dhe strikte? A ka shënime të mangëta?
- Çfarë lloj informatash regjistrohen në regjistrin mbi mbajtjet? A përfshihen sa vijon: të dhënat themelore personale dhe biometrike, urdhri i vlefshëm i mbajtjes, hollësitë rreth dokumenteve dhe mënyrave tjera të konstatimit të identitetit, emrat e mbiemrat dhe informatat e kontaktit të anëtarëve të familjes, gjuha të cilën e flet person në mbajtje dhe nëse është përdorur përkthyes i kualifikuar dhe i paanshëm pa pagesë, arsyeja e dhënë nga ana e personit në mbajtje për qëndrimin apo ardhjen në territorin e atij shteti, a ka aplikuar person në mbajtje për mbrojtje ndërkombëtare/azil, a ka personi në mbajtje nevoja të veçanta?

---

### 4 Kontrolli fizik bëhet vetëm kur një gjë e tillë është e domosdoshme për sigurinë e personelit dhe imigrantëve në mbajtje, dhe kryhen duke respektuar dinjitetin e personit. Kontrollimi me zhveshje i personit në mbajtje bëhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme nga ana e personit të trajnuar të së njëjtës gjini sikundër personi në mbajtje.<sup>60</sup>

**Burimet:** [PNDCP](#) , 10; [BR](#) , 21; [KPT/Inf](#) (99) 12; [RREB](#) ; [PPMMPPLKA](#) XXI

#### Këshilla për monitoruesit:

- Cilat janë procedurat për kontrollimin fizik me rastin e pranimit dhe ato të mëvonshme?
- A kryhen kontrollimet nga personeli i së njëjtës gjini?
- A kanë kryer trajnime të veçanta personeli që kryen kontrollimin e personave në mbajtje?
- Si kryhen kontrollimet e grave dhe nga kush?
- A ka procedura të veçanta që rregullojnë kontrollimet fizike të personave në mbajtje të cilët/cilat i përkasin komunitetit LGBTI?

- A përdoren metoda alternative të përshtatshme të skanimit?

## 5 Imigrantët në mbajtje veçohen nga të tjerët p.sh. personat e paraburgosur për vepra penale)

Burimet: [PNDPCP](#) 10(2)(a); [KPM](#) 17(2); [BPP](#) 8; [RRSM](#) 8(b); [RPJDL](#) 17; [GPNA-D5](#) P9; [UNHCR-UN](#) 8; [EXCOM](#) 44(f); [ACHR](#) 5(4); [PPMMPPLKA](#) XIX; [KPT/Inf](#) (97) 10 §28

### Këshilla për monitoruesit:

- Cili është procesi për të siguruar që imigrantët në mbajtje të mos mbahen bashkë me personat e dënuar?
- Nëse imigrantët në mbajtje mbahen në qendër të paraburgimit, në ç'vend mbahen ata, p.sh. në ndonjë pavijon ose pjesë të objektit të dedikuar enkas për këtë?
- Cila është procedura për t'i mbrojtur personat në mbajtje nga vetëlëndimet ose për t'i identifikuar ata të cilët mund të jenë të rrezikuar nga të tjerët? A bëhet ndonjë vlerësim gjatë natës së parë të mbajtjes në ndalim?

## 6 Të gjithë personat në mbajtje ekzaminohen me rastin e pranimit nga profesionistë shëndetësor të kualifikuar, privatisht dhe me ndihmën e përkthyesve, si të jetë më e përshtatshme

Burimet: [RRSM](#) ; [UNHCR-UN](#) §48(vi); [PPMMPPLKA](#) IX(3); [KPT/Inf](#) (97) 10 §30, 31; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §82

### Këshilla për monitoruesit:

- A ekzaminohen sistematikisht personat në mbajtje nga profesionistë shëndetësor të kualifikuar me rastin e arritjes?
- A janë të pranishëm përkthyes të kualifikuar dhe të paanshëm pa pagesë?
- A identifikohen, vlerësohen dhe adresohen problemet fizike dhe mjekësore?

## 7 Gjithë personat në mbajtje informohen sa u përket të drejtave të tyre, rutinave, shërbimeve, rregullave dhe procedurave

Burimet: [BPP](#) 13, 14; [RRSM](#) 35; [GPNA-D5](#) P4 and 8; [RPJDL](#) 6, 24, 25; [PPMMPPLKA](#) IX(1); [KPT/Inf](#) (97) 10 §30 [KPT/Inf](#) (2009) 27 §84

### Këshilla për monitoruesit:

- 
- Si jepen informatat rreth të drejtave dhe procedurave (pano, libërtha dhe materialet tjera informative)?
  - A u jepet personave në mbajtje sistematikisht ndonjë dokument ku sqarohen procedurat që zbatohet ndaj tyre dhe ku janë të përcaktuara të drejtat me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë?
  - A ka në dispozicion përkthyes të kualifikuar dhe të paanshëm pa pagesë?
  - Në cilat gjuhë janë të disponueshme rregulloret përkitazi me vendin mbajtjes? A janë ato të qasshme për personat të cilët nuk dinë shkrim-lexim?
- 

## 8 Personat në mbajtje mund të telefonojnë familjen dhe përfaqësuesit ligjorë privatisht

Burimet: [BPP](#) 16(1), 19; [RRSM](#) 37; [GPNA-D5](#) P2; [RPJDL](#) 61; [PPMMPPLKA](#) XVIII; [KPT/Inf](#) (97) 10 §31

### Këshilla për monitoruesit:

- A informohen personat në mbajtje rreth të drejtave të tyre dhe a u lejohej ta thërrasin në telefon familjen dhe përfaqësuesin ligjor? Në ç'mënyrë?
  - A u vihen në dispozicion telefona pa pagesë? A lejohen thirrjet ndërkombëtare? Me çfarë shpeshtësie?
  - A regjistrohen në regjistër kontaktet e bëra dhe koha dhe data e tyre? A mund të zhvillohet bisedat privatisht?
- 

## 9 Personat në mbajtje mund ta kontaktojnë UNHCR-in dhe/ose zyrtat konsullore ose misionin diplomatik privatisht dhe pa pagesë, dhe ky kontakt regjistrohet

Burimet: [KPM](#) 16(7); [PKK](#) 16(5); [BPP](#) 16(2); [RRSM](#) ; [RPJDL](#) ; [DPBE](#) 18.2 (b); [UNHCR-UN](#) 8 (vii); [GPNA-D5](#) p.2; [OHCHR-TG](#) 6(3); [PPMMPPLKA](#) V; [KPT/Inf](#) (97) 10 §31; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §83, 87

### Këshilla për monitoruesit:

- A informohen personat në mbajtje përkitazi me të drejtat e tyre dhe a u lejohej që ta kontaktojnë UNHCR-in dhe/ose një zyrë konsullore ose mision diplomatik? Në ç'mënyrë?
- A u mundësohet qasja në telefona? A mund të bëjnë thirrje pa pagesë? Sa shpesh mund të bëjnë thirrje telefonike personat në mbajtje?

- A regjistrohen në regjistër kontaktet me UNHCR-in dhe/ose ndonjë zyrë konsullore a mision diplomatik, përfshirë datën dhe kohën e tyre?
- A janë paraparë masa për mbrojtjen e refugjatëve dhe azilkërkuesve nga kontakti ose vizitat e autoriteteve nga vend i tyre i prejardhjes ose vendbanimi i përhershëm?
- A janë të gjithë zyrtarët ndalues në dijeni të kornizës së veçantë për mbrojtjen e azilkërkuesve dhe refugjatëve në këtë kuptim?

---

**10 Përfaqësuesit ligjorë, UNHCR-i dhe/ose organizatat tjera me mandate përkatës njoftohen menjëherë përkitazi me mbajtjen**

Burimet: [KDF](#) 22(b); [RRSM](#) 38; [GPNA-D5](#) f.10

**Këshilla për monitoruesit:**

- A posedojnë autoritetet ndaluese listë të përditësuar të profesionistëve përkatës të cilët mund t'i kontaktojnë?
- A njoftohen rregullisht UNHCR-i dhe akterët tjerë përkatës përkitazi me të arriturit e ri?
- A vihen menjëherë në dispozicion të personit në mbajtje informatat lidhur me qasjen në përfaqësues ligjor dhe/ose UNHCR-in ose organizatë tjetër me mandate përkatës?

---

#### 4.1.4 Transferi(et)

Personat në mbajtje mund të transferohen nga një vend i mbajtjes në një tjetër ose largohen/lirohen. Çfarëdo qofshin arsyet për transferim, kjo duhet të bëhet me respekt dhe në përputhje me procedurat përkatëse, duke përfshirë informimin paraprak të personave në mbajtje për datën e transferimit dhe vendin në të cilin do të transferohen, për t'ju dhënë kohë të mjaftueshme që ta informojnë familjen dhe këshilltarët ligjorë.

---

### 1 Personave në mbajtje u jepet lajmërim paraprak adekuat për transferet e planifikuara, dhe hollësitë e arsyt e transferit regjistrohen

**Burimet:** [ICPPED](#) 18(1)(d); [RRSM](#) 44(1), (3); [RPJDL](#) 21, 22; [BPP](#) 16(1); [PPMMPPLKA](#) IX(4)

#### **Këshilla për monitoruesit:**

- Si informohen personat në mbajtje përkitazi me transferet e planifikuara? A janë të sakta informatat që u jepen?
- A regjistrohen data, koha dhe qëllimi i transferit?
- Sa kohë përpara lajmërohet personi në mbajtje?
- A munden ta kundërshtojnë transferimin personat në mbajtje?
- Si munden personat në mbajtje ta informojnë përfaqësuesin e vet ligjor paraprakisht në lidhje me transferimin?
- A kanë personat në mbajtje mundësi për ta kontaktuar familjen, për t'i bërë gati gjësendet personale dhe të përgatiten për transferimin?
- Të verifikohet nëse ka pasur ndonjë transferim të personave në mbajtjenë momentin e fundit para se të ndodhin vizitat e lajmëruara (nga monitoruesit, inspektorët, avokatët, të tjerët).

## 2 Transferimet bëhen në mënyrë të sigurt dhe dinjitoze, në kushte të përshtatshme dhe duke mbajtur parasysh situatën e personave me nevoja të veçanta, siç janë fëmijët, gratë shtatzëna, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara

Burimet: [PPMMPPLKA IX\(4\)](#); [RREB 32](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- Si bëhet transferimi (me automjete, autobusë)?
- Kush është përgjegjës për transferimin? A kanë përcjellje nga personeli i specializuar?
- A përdoren metoda të kufizimit fizik (pranga ose mjete tjera)?
- A është mjete i transportit që përdoret i sigurt, i pastër dhe i rehatshëm? A është i pranishëm mjeku ose profesionist i kualifikuar shëndetësor? Çfarë ndodhë nëse ka urgjencë mjekësore?
- A janë automjetet të pajisura në një mënyrë që mundëson që ata të mos ekspozohen publikisht gjatë transferit?
- Sa të shpeshta dhe adekuate janë ndalimet që bëhen gjatë transitit/transferit (banjë, ushqim, pushim, bujtje, koha e faljes, koha e lojës për fëmijët)?
- A transportohen veçan burrat, gratë dhe fëmijët (përveç rasteve kur janë të afërm)?
- A ka mbrojtje nga sulmet seksuale gjatë transferit?
- A bëhen aranzhime praktike për personat me nevoja të veçanta (p.sh. fëmijët, gratë shtatzëna, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara)?
- A kanë ndikuar transferet në qasjen në procedura, përfaqësues ligjor, UNHCR-in, familjen ose rrjetet sociale?
- A kanë monitoruesit qasje tek të transferuarit?

---

#### 4.1.5 Qasja në procedurat e azilit/mbrojtjes

Mungesa e qasjes në procedura të drejta dhe efikase të azilit/mbrojtjes shton rrezikun e mbajtjes së zgjatur dhe të panevojshëm, dhe të kthimit mbrapsht. Gjithashtu, qasja në procedura të tilla ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si imigrantët në mbajtje e përjetojnë mbajtjen, posaçërisht për shkak të efektit që ka në ndjenjën e tyre të sigurisë.

Në çdo vend të mbajtjes, duhet të ketë protokolle uniforme për të siguruar që personat në mbajtje të këshillohen rreth të drejtave të tyre dhe të mund të përfitojnë nga procedurat e azilit/mbrojtjes dhe imigracionit, nëse personat në mbajtje shprehin dëshirën që të bëjnë një gjë të tillë .

Kjo pjesë duhet të lexohet në lidhje me të drejtën e qasjes në avokat (shih 4.1.2. më sipër)

---

### **1 Personat në mbajtje informohen rreth të drejtës së tyre për të kërkuar azil dhe për të pasur qasje në format e tjera të mbrojtjes, dhe kanë qasje efektive në këto procedura sipas nevojës.**

**Burimet:** [UDHR](#) 14; [UNHCR-UN](#) 1; [ACHR](#) 22(7); [KADNJP](#) 12(3); [KDTHBE](#) 18; [KDF](#) 22; [PKK](#) 19; [AT.P](#) 14

#### **Këshilla për monitoruesit:**

- A informohen personat në mbajtje rreth së drejtës së tyre për të aplikuar për azil ose për forma tjera të mbrojtjes, sikundër procedurat e përcaktimit të pashtetësisë, format shtesë ose subsidiare të mbrojtjes?
- Si u vihen këto informata në dispozicion personave në mbajtje?
- A ka mekanizma për identifikimin e personave të cilët kanë nevojë për mbrojtje?  
A janë të dispozicion dhe të qasshme procedurat e azilit/mbrojtjes për imigrantët në mbajtje?

## 2 Informatat rreth procedurave të tjera të imigrimit janë në dispozicion

Burimet: [AT.P](#) 6(2)(a); [BPP](#) 13

### Këshilla për monitoruesit:

- A u jepen personave në mbajtje informata rreth opsioneve në dispozicion (siç janë kthimi vullnetar, leje qëndrimi i përkohshëm ose procedurat e ripranimit)?
- A kanë qasje imigrantët në mbajtjetë cilët janë persona të trafikuar në procedurat në fuqi (p.sh. azil, mbrojtja e dëshmitarëve, vizat për periudhën e reflektimit, tjerat)? Në ç'mënyrë?
- Çfarë procedurash ekzistojnë për t'i identifikuar personat e trafikuar?

---

## 3 Imigrantët në mbajtje kanë qasje adekuate dhe efektive në informata

Burimet: [BPP](#) 10, 11(2), 13; [AT.P](#) 6(2)(a), 6(3)(b); [PPMMPPLKA V](#), IX(1); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §93

### Këshilla për monitoruesit:

- A përballen imigrantët në mbajtje me vonesa në pranimin e njoftimeve, dokumentacionit rreth ankimit për akomodimin, paraqitjen në seanca dëgjimore të lidhura me mbajtjen e tyre në dalim?
- A e lehtësojnë personeli i vendit të mbajtjes paraqitjen e personave në mbajtje në intervista, shqyrtime dhe séance të shqyrtimit të ankesave? A u jepen personave në mbajtje formularët e duhur të aplikimit për nevojat e shprehura nga ta dhe kohë e mjaftueshme për t'i plotësuar formularët? A garantohet konfidencialiteti?
- A ka afate të posaçme të aplikimit për azil/mbrojtje për personat në mbajtje për shkak të faktit që ata mbahen në ndalim?



---

#### 4.1.6 Kërkesat dhe ankesat

Në të gjitha vendet e mbajtjes duhet të ketë procedura të paraqitjes së kërkesave dhe ankesave të brendshme që janë lehtësisht të qasshme, si dhe procedura të jashtme për të paraqitur kërkesa dhe ankesa konfidenciale pa censurë. Personat në mbajtje duhet të informohen rreth këtyre procedurave dhe të kuptojnë si mund t'i ndjekin ato. Kështu, procedura efektive e ankimit do t'u sigurojë personave në mbajtje një mënyrë që të diskutojnë apo kontestojnë çdo aspekt të kushteve mbajtjes si imigrantë. Ajo duhet të jetë e qartë dhe e drejtë në aspektin procedural, të respektojë privatësinë dhe konfidencialitetin dhe të prodhojë rezultate konkrete për personat në mbajtje.

---

#### 1 Imigrantët në mbajtje mund të ankohen për çdo aspekt të mbajtjes së tyre në ndalim përmes një procedure të brendshme efektive të ankimit.

**Burimet:** [RRSM](#) 35, 36(1); [RPJDL](#) 72-78; [PPMMPPLKA](#) VII; [RREB](#) 70.1

##### **Këshilla për monitoruesit:**

- A ekziston një procedurë e brendshme e ankimit dhe a është e qasshme?
- A respektohen privatësia dhe konfidencialiteti? Në ç'mënyrë?
- Sa ankesa janë paraqitur në 3/6/12 muajt e fundit?
- Sa është raporti midis këtij numri dhe numrit mesatar të personave të cilët mbahen në qendrën e mbajtjes?
- A ekzistojnë masa për adresimin e këtyre ankesave?

## 2 Personat daluar në mbajtje kanë qasje në një procedurë të jashtme konfidenciale të ankimit

Burimet: [BPP](#) 33; [RRSM](#) 36; [RPJDL](#) 75-76; [PPMMPPLKA](#) VII

### Këshilla për monitoruesit:

- A ekziston një procedurë e jashtme e ankimit dhe a është e qasshme ajo?
- A respektohen privatësia dhe konfidencialiteti? Në ç'mënyrë?
- A janë në gjendje personat të cilët nuk dinë shkrim-lexim ose të cilët flasin gjuhë të huaja që të paraqesin ankesa në praktikë?

## 3 Çdo kërkesë ose ankesë hetohen në mënyrë të paanshme, trajtohet menjëherë dhe zgjidhet pa vonesa të tepërta

Burimet: [BPP](#) 7, 33(4); [RRSM](#) 36(4); [PPMMPPLKA](#) VII

### Këshilla për monitoruesit:

- A janë procedurat e kërkesave dhe ankesave në përputhje me standardet e paanshmërisë dhe drejtësisë? A janë transparente? A janë të paanshme?
- A zgjidhen ankesat brenda një kohe të arsyeshme që adreson thelbin e ankesës?
- Cili është rezultati më i shpeshtë i tyre?
- Çfarë përqindje e ankesave është vendosur në favor të ankuesit?

## 4 Personat në mbajtje nuk bëhen subjekt i kërcënimeve, sanksioneve dhe ndëshkimeve për shkak se kanë paraqitur kërkesë apo ankesë

Burimet: [BPP](#) 33(4); [RREB](#) 70.4

### Këshilla për monitoruesit:

- A janë kërcënuar dhe shkurajuar personat në mbajtje që të mos paraqesin ankesë?
- A ka pasur raportime apo pretendime për kërcënime, sanksione, ndëshkime apo hakmarrje?

---

#### 4.1.7 Lirimi dhe kujdesi i mëpastajmë

Në sistemin e burgjeve, zakonisht dihet data në të cilën do të lirohet personi dhe, kështu, person i ndaluar dhe rrjeti i tij/saj mbështetës mund të bëjnë plane. Në konspektin e mbajtjes së imigrantëve, pikë mbarimi i mbajtjes është më i paqartë. Rrallëherë ndodh që imigrantët në mbajtje ta dinë se në ç'datë do të lirohen, apo nëse do t'u kërkohet që të kthehen në vendin e tyre të origjinës ose të vendbanimit të përhershëm, apo nëse do t'ju duhet të kthehen a të udhëtojnë në ndonjë vend të tretë. Ndërsa koha kalon, imigrantët në mbajtje shpesh nuk e dinë nëse po afrohen së ardhmes së dëshiruar apo asaj së cilës i druhen. Kjo pasiguri mund të shpie në një kombinim të shpresës në njërin anë dhe frikës në anën tjetër. Kështu, në vend se të ulen, stresi dhe ankthi i imigrantëve në mbajtje vetëm se shtohen gjersa mbajtja i afrohet fundit. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të mbahet mend se të personat në mbajtje të cilët lirohen nga mbajtja mund të besojnë se ajo çfarë po ndodh në të vërtetë është që po i largojnë nga vendi. Prandaj, është e domosdoshme që procedurat e liritimit, largimit dhe deportimit të menaxhohen që të tëra me respekt, ndjeshmëri dhe humanitet. Cilido qoftë rezultati përfundimtar, imigranti në mbajtje duhet të jetë në gjendje që të integrohet në shoqërinë pritëse ose të riintegrohet në vendin e tij/saj të origjinës ose vendbanimit të mëhershëm.

## 1 Personat e ndaluar përgatiten në mënyrë adekuate për lirimin dhe jetën e tyre në komunitetin pritës

Burimet: [RRSM](#) 60(2), 61, 64 [RPJDL](#) 53, 79, 80

### Këshilla për monitoruesit:

- Si informohen personat e ndaluar përkitazi me lirimin e tyre? A lajmërohen më herët?
- A u sigurohen personave të ndaluar të cilët janë në trajtim shëndetësor medikamentet e duhur, si edhe dosja mjekësore, pot ë jetë e nevojshme dhe një listë e shërbimeve sociale/mjekësore përkatëse? A bëhet referimi tek këto shërbime në rastet kur një gjë e tillë vlerësohet si e nevojshme?
- A përgatitet një plan lirimi për rastet e personave të ndaluar të cilët duhet të dërgohen në institucione mjekësore/psikiatrike?
- A udhëzohen personat e liruar që të kontaktojnë këshilltarë ligjorë dhe/ose grupe lokale mbështetëse?
- A pajisen personat të cilët lirohen me dokumentet përkatëse për ta parandaluar ndalimin e sërishëm?

## 2 Ekziston një procedurë standarde dhe me shkrim e liritimit

Burimet: [RRSM](#) 7(1)(c), 43; [RPJDL](#) 21(c), (d), 22

### Këshilla për monitoruesit:

- A ndiqet kjo procedurë? A ka përjashtime? Përse?
- A u kthehen personave të ndaluar gjësendet personale (përfshirë paranë e gatshme)?  
A ka kohë për t'i krahasuar gjësendet personale kundrejt inventarit të përgatitur me rastin e pranimit?
- A njoftohen familjet e personave të ndaluar paraprakisht? Në c' mënyrë, dhe sa kohë përpara? A sigurohet transport i sigurt për personin e ndaluar dhe/ose familjen?

---

#### 4.1.8 Procedurat e largimit, deportimit dhe riatdhesimit<sup>61</sup>

Praktikat e largimit dhe deportimin mund të shpijnë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, madje në disa raste edhe vdekjen e personit i cili deportohet, në qoftë se nuk përmbushen garancitë e duhura për të siguruar që autoritetet të procedojnë me siguri dhe dinjitet. Në veçanti, gjatë procedurave të largimit, imigrantët e ndaluar janë në pozitë tepër të cenueshme dhe të ekspozuar ndaj rrezikut të keqtrajtimit dhe torturës.<sup>62</sup> Monitorimi i praktikave të largimit dhe deportimit mund të shërbejë si garanci e rëndësishme kundër keqtrajtimit dhe kthimit mbrapsht. Është tejet e rëndësishme që përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik të jenë të përcaktuara qartë dhe të monitorohen.

Veç kësaj, është po ashtu e domosdoshme që procedurat të menaxhohen me respekt, ndjeshmëri dhe humanitet dhe të zhvillohet në mënyrë të sigurt dhe dinjitoze. Imigrantëve në mbajtje duhet t'u jepet njoftim paraprak adekuat përkitazi me deportimin ose largimin dhe mundësi e arsyeshme për t'u përgatitur. Gjithashtu, duhet të ketë garanci procedural për të siguruar që urdhrat për largim të mos e cenojnë ndalesën kundër *kthimit mbrapsht*.

Kjo pjesë duhet të lexohet në lidhje me të drejtën e qasjes për avokat (shih Pjesën 4.1.2), qasjes për azil/mbrojtje procedurat tjera të imigracionit (shih Pjesën 4.1.5) dhe mjetet e kufizimit fizik dhe përdorimit të forcës (shih Pjesën 4.2.3).

## 1 Imigrantëve në mbajtje u jepet njoftim paraprak adekuat përkitazi me largimin dhe deportimin, përfshirë arsyet dhe destinacionin<sup>63</sup>

Burimet: [BPP](#) 16; [PPMMPLKA](#) V; [KPT/Inf](#) (2003) 35 §41; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §95; [CoE-TGFR](#) 4, 15; [DPBE](#) 8.3 (d)

### Këshilla për monitoruesit:

- Kur, ku dhe në c' mënyrë imigrantët në mbajtje njoftohen se do të largohen? A bëhet njoftimi në një mënyrë apo formë të cilën ata mund ta kuptojnë?
- Kur bëhen largimet/deportimet? Në çfarë ore, date dhe rrethanash janë bërë së fundmi largimet/deportimet (p.sh. natën, në fundjavë, gjatë ditëve të punës, festave zyrtare)? Të verifikohet në veçanti për largime dhe reagime kontraverze të personave të ndaluar.
- Të verifikohen çështjet e sigurisë (sikundër largimi në zona të cilat njihen sit ë frekuentuara nga trafikantët, në orë të çuditshme ose në lokacione të rrezikshme)
- A informohen personat në mbajtje për arsyet e largimit/deportimit?
- A u jepet personave në mbajtje mundësi për t'i bërë përgatitjet e nevojshme para largimit, siç janë kontaktimi i anëtarëve të familjes, organizatave që ndihmojnë në riintegrimi, dhe qasja në internet për të ndihmuar në bërjen e përgatitjeve të nevojshme me rastin e mbërritjes në vendin e destinacionit?

---

## 2 Imigrantëve në mbajtje u jepet kohë adekuate për ta informuar avokatin, vizitorët dhe familjen e miqtë për datën e largimit/deportimit ose riatdhesimit nga vendi

Burimet: [BPP](#) 16; [PPMMPLKA](#) V; [KPT/Inf](#) (2003) 35 §41; [CoE-TGFR](#) 15

### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë imigrantët në mbajtje kohë të mjaftueshme për të kontaktuar dhe informuar rrjetin mbështetës të tyre (avokatin, familjen, miqtë, personat e tjerë të ndaluar)? Në c' mënyrë (telefon, email, faks etj.)? A inkurajohen ta bëjnë këtë?
- A ndërmerren masa paraprake për t'ju ndihmuar imigrantëve në mbajtje që ta organizojnë kthimin, sidomos në aspektin familjar, të punës dhe

---

psikologjik?

---

### 3 Ekzistojnë sisteme për të siguruar që imigrantët e ndaluar të ekzaminohen nga personeli shëndetësor (para dhe gjatë deportimit), që janë në gjendje të udhëtojnë dhe që do u kthehen posedimet<sup>64</sup>

Burimet: [RRSM](#) 43; [RPJDL](#) 35; [CoE-TGFR](#) 16; [KPT/Inf](#) (2003) 35 §39

#### Këshilla për monitoruesit:

- A vizitohen imigrantët e ndaluar nga ndonjë profesionist shëndetësor para largimit/deportimit? A regjistrohet kjo në ndonjë regjistër?
- A bëhen përgatitje për qasjen në kohë në shërbime të këshillimit dhe përgatitje tjera për deportim ose largim?
- A ndihmohen ata nga psikologët dhe punëtorët social të cilët janë përgjegjës për përgatitjen e imigrantëve të ndaluar për deportim?
- A u kthehen personave të ndaluar gjësendet personale para nisjes? A munden ata t'i marrin ato?
- A është gjatë procesit të deportimit i pranishëm një mjek ose profesionist shëndetësor?

---

### 4 A ka garanci procedurale për të siguruar që urdhrat për largim dhe deportim nuk shkelin ndalesën për kthim mbrapsht

Burimet: [KSR](#) 33; [CAT](#) 3; [KDF](#) 22; [OAU](#) II(3); [CoE-TGFR](#) 2(3); [ACHR](#) 22(8); [KPT/Inf](#) (2003) 35 §30; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §93-95; [DPBE](#) 8.3(d)

#### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë personat e ndaluar qasje në gjithë procedurat në dispozicion, përfshirë procedurat e ankimit dhe shqyrtimit?
- A ekziston një regjistër i posaçëm për urdhrat për largim/deportim? A regjistrohen të dhëna lidhur me rrjedhën e ngjarjeve në çdo rast të largimit/deportimit?
- A përcaktohen/vlerësohen të gjitha kërkesat për azil/mbrojtje plotësisht dhe individualisht para zbatimit të urdhrave për largim?



## 5 Pretendimet për sulme ndaj personave të ndaluar, përfshirë përdorimin e forcës së tepërt të mbështetur me dëshmi mjekësore, hetohen në mënyrë të thuktë me qëllim të ndjekjes

Burimet: [CCLEO](#) 8; [PPMMPPLKA](#) XXIII(3); [KPT/Inf](#) (2003) 35 §32-40; [CoE-TGFR](#) 19

### Këshilla për monitoruesit:

- A ka ankesa dhe pretendime për përdorim të forcës së tepërt? Si janë menaxhuar ato?
- Çfarë metodash të kufizimit fizik janë përdorur? Të verifikohet autorizimi, domosdoshmëria, mbikëqyrja, monitorimi mjekësor, lloji i forcës ose mjetit të kufizimit fizik të përdorur.
- Çfarë ndodh me fëmijët të cilët nuk largohen nga vendi? A është e mundur që të bëhen aranzhime për ribashkimin e tyre me anëtarët e tjerë të familjes të cilët po largohen nga vendi?

---

## 6 Rojet përcjellëse sillen me respekt ndaj personave të ndaluar dhe kanë të kryera trajnime të posaçme

Burimet: [PNDPCP](#) 10(1); [BPP](#) 1; [KPT/Inf](#) (2003) 35 §42<sup>65</sup>

### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë kryer rojet përcjellëse trajnime të posaçme? Çfarë lloj trajnimesh?
- A ka roje përcjellëse gra?

## 4.2 TRAJTIMI DHE GARANCITË

Në çdo vend të ndalimit, personat në mbajtje ndodhen në pozitë të cenushme karshi shtetit dhe autoriteteve që janë drejtpërdrejt përgjegjëse për mbajtjen e tyre. Kështu, ekziston gjithmonë rreziku që imigrantët e ndaluar do t'i nënshtrohen torturës (si psiqike ashtu dhe fizike) ose keqtrajtimeve tjera gjatë mbajtjes në ndalim. Trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës mund të shfaqet në formë të keqtrajtimeve sikurse keqpërdorimi i masave disiplinore dhe sanksioneve/ndëshkimeve, përdorimi i pavend i metodave të kufizimit fizik ose përdorimi i forcës së tepërt. Gjithashtu, atom und të paraqiten si rrjedhojë e kushteve shumë të vështira të ndalimit ose përdorimit të izolimit të vetmuar.

Përveç këtyre rreziqeve të torturës apo keqtrajtimeve tjera në vendin e ndalimit, monitoruesit duhet të kenë po ashtu parasysh që azilkërkuesit dhe imigrantët e ndaluar mund të qenë subjekt i formave të ndryshme të keqtrajtimit para nisjes nga vendlindja e tyre dhe/ose para ndalimit, gjatë arrestit apo transferit. Si viktimave të abuzimeve të këtilla, azilkërkuesit dhe imigrantët e ndaluar kërkojnë kujdes dhe vëmendje të veçantë nga ana e autoriteteve, por gjithashtu dhe nga ana e monitoruesve gjatë bashkëbisedimit të tyre me ta.

Është thelbësore të sigurohet që të gjitha sferat e praktikës së ndalimit të imigrantëve të jenë të rregulluara dhe të administruara siç duhet dhe të shoqërohen me garancitë dhe masat mbrojtëse të nevojshme. Për më tepër, duhet të ketë mjete juridike efektive në dispozicion për imigrantët e ndaluar të cilët janë viktimat e torturës apo keqtrajtimeve të tjera, mjete juridike që përfshijnë ndërprerjen e shkeljes, kompensim, dëmshpërblim dhe masat për parandalimin e përsëritjes.

#### **4.2.1 Tortura dhe keqtrajtimet e tjera<sup>66</sup>**

Tortura dhe keqtrajtimi, pavarësisht se a ka ndodhur në të shkuarën apo tash, është një nga çështjet më të vështira për t'u trajtuar në çdo mjedis të ndalimit.

Tortura dhe keqtrajtimi janë absolutisht të ndaluara dhe nuk mund të justifikohen në asnjë rrethanë.

Tortura dhe keqtrajtimi mund të shfaqen në forma nga më të ndryshmet, duke përfshirë për shembull abuzimin seksual ose privimin nga ushqimi, gjumi apo komunikimi. Është me rëndësi të kihet parasysh se mund të ketë praktika të cilat mund ta vështirësojnë zbulimin e torturës ose formave të tjera të keqtrajtimit dhe që mund të shkaktojnë pasoja afatgjata psikologjike. Viktimat e torturës dhe/ose keqtrajtimit mund të vuajnë nga trauma, depresioni dhe pasoja tjera emocionale ose psikologjike.

Në këtë kontekst, është me rëndësi të pranohet se të imigrantët në mbajtje mund të kenë rënë pre e torturave apo keqtrajtimit në momente të ndryshme: në vendin e tyre të origjinës, gjatë rrugëtimit të tyre si imigrantë, gjatë arrestimit ose transferimin në vendin e destinacionit, si dhe brenda vetë vendit të ndalimit. Përvoja e ndalimit në vetvete mund t'i përkeqësojë disa nga simptomat e viktimave.

Për këtë arsye, intervistat private paraqesin një moment tejet delikat. Për viktimën e torturës apo traumës, të folurit për atë çfarë i ka ndodhur mund të jetë një përvojë jashtëzakonisht shqetësuese dhe poshtëruese, dhe ekipet e monitorimit duhet që të tregojnë kujdes të posaçëm ndaj kësaj. Kjo do të thotë që ata të krijojnë një ide se kur duhet ndaluar ose pezulluar intervistën, sa larg mund të shkojnë me pyetjet dhe kur duhet të bëjnë referime për intervenime specialiste. Veç kësaj, kjo nënkupton që personit në mbajtje duhet t'i bëhet e ditur në mënyrë shumë të qartë ajo çfarë ekipi monitorues mund të bëjë me informata dhe të kërkohet pëlqimit i viktimës.

Përveç në rastet kur organi vizitues ka kompetenca gjyqësore ose kuazigjyqësore, ai duhet që me pëlqimin e individit t'ua referojë me pretendimet individuale për torturë ose keqtrajtim autoriteteve përkatëse për hetim administrativ ose penal.

Në fund, është me rëndësi që të mbahet parasysh parimi i moskthimit (*non-refoulement*) që ua ndalon shteteve palë ta kthejnë mbrapsht ndonjë person në vendin ku ai/ajo mund të jetë në rrezik që të përndiqet, torturohet ose keqtrajtohet në mënyra tjera që shkaktojnë dëme serioze dhe të pariparueshme. Ky parim është pranuar gjerësisht si rregull i së drejtës zakonore ndërkombëtare.

## 1 Asnjë imigrant në mbajtjenuk i nënshtrohet torturës ose trajnimeve a dënimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, duke përfshirë respektimin e parimit të moskthimit mbrapsht<sup>67</sup>

Burimet: [KBKKT](#) 2, 16; [PNDCP](#) 7; [KSR](#) 33; [KPM](#) 10; [RRSM](#) 27, 31; [ACHR](#) 5(2); [KADNJF](#) 5; [IACPPT](#) 1, 6; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §93-95

### Këshilla për monitoruesit:

- A ankohen personat në mbajtje për trajtimin e tyre në vendin e ndalimit?
- A ka pretendime për torturë ose keqtrajtim gjatë arrestimit ose transferit?

---

## 2 A ekziston një protokoll për trajtimin e rasteve ku personi në mbajtje **zbulon informata rreth keqtrajtimit, torturës apo mizorisë së mëhershme**

Burimet: [KPT/Inf](#) (2009) 27 §96

### Këshilla për monitoruesit:

- A përmbajnë historikët e rasteve vlerësime gjithëpërfshirëse të torturës/traumave?
- A ka plane të kujdesit për personat e ndaluar të cilët i janë nënshtruar torturës dhe traumave numri, përmbajtja, zbatimi)?
- Çfarë të dhëna statistikore janë në dispozicion lidhur me ata që janë identifikuar si persona me histori të torturës dhe/ose traumës?
- A ka mbështetje të përshtatshme për fëmijët në këto rrethana?

---

## 3 Ekzaminimi fillestar i imigrantëve të ndaluar është **përshtatur për mundësinë që personi i ndaluar mund të ketë qenë viktimë e torturës apo traumës**

Burimet: [PNDOP](#) 10(1); [BPP](#) 24; [RRSM](#) 24; [PPMPPPLKA](#) IX(3); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §96

### Këshilla për monitoruesit:

- A i nënshtrohen personat në mbajtje një ekzaminimi mjekësor me rastin e arritjes? A është i pranishëm një përkthyes i kualifikuar?
- A janë trajnuar profesionistët shëndetësorë në trajtimin e viktimave të torturës apo keqtrajtimit?
- A janë në dispozicion regjistrat mjekësorë? A regjistrohen rastet specifike në një regjistër të veçantë?

#### 4 Ekziston një protokoll për të reaguar ndaj pretendimeve të tanishme për torturë ose keqtrajtim

Burimet: [BPP](#) 7, 33; [RPJDL](#) 72-78, 87; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §96

##### Këshilla për monitoruesit:

- A shpalesë regjistri i ankesave ankesat për torturë apo keqtrajtime tjera? Nëse po, cilat kanë qenë reagimet, mosreagimet dhe veprimet pasuese?
- A hetohen pretendimet për keqtrajtim menjëherë dhe në mënyrë efektive?
- A garantohet konfidencialiteti i ankesave? Në ç'mënyrë?
- A ka dëshmi të sanksioneve/ndëshkimeve pas ankesave?

#### 5 Nëse bëhet një pretendim për torturë ose keqtrajtim, viktima i nënshtrohet ekzaminimit fizik dhe psikologjik nga një zyrtar mjekësor i pavarur sa më shpejtë që të jetë e mundshme

Burimet: [BPP](#) 24; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §96

##### Këshilla për monitoruesit:

- A ka listë të zyrtarëve mjekësorë të pavarur?
- A kanë bërë zyrtarët mjekësorë trajnime të posaçme në dokumentimin e torturës ose keqtrajtimit?

#### 4.2.2 Izolimi dhe mbyllja në vetmi

Izolimi është një masë me të cilën një person (ose grup personash) mbahet veçmas nga personat e tjerë të ndaluar dhe ka kontakt të kufizuar ose asnjë kontakt me ta dhe me botën e jashtme.<sup>68</sup> Masat e tilla mund të përdoren si sanksion disiplinor, ose si masë e menaxhimit të sjelljes (në rast të vetëlëndimit ose rrezikut të vetëvrasjes). Gjithashtu, ato përdoren shpesh për qëllime të sigurisë të tilla si ndarja e individëve LGBTI (shih 4.8.9) veçan. Në të gjitha rastet, një ndarje e tillë duhet vetëm të ndodhë si mjet i fundit, kur është absolutisht e domosdoshme për të shmangur një kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë të vetëlëndimit, lëndimit të tjerëve ose shkatërrimit të pronës, si dhe për kohën më të shkurtër të mundshme. Megjithatë, në disa situata izolimi përdoret si teknikë për pengimin apo parandalimin e qasjes së individëve ose grupeve të individëve në

këshilltar ligjor, familjarët dhe miqtë, apo burime të tjera të këshillimit apo mbështetjes së jashtme.

Izolimi, sidomos në rastin e izolimit të gjatë të vetmuar, mund të përbëj trajtim a dënim mizor, çnjerëzor ose poshtëruës apo madje edhe të kualifikohet si vepër e ndaluar e torturës.<sup>69</sup> Kështu që, izolimi duhet të shqyrtohet dhe të analizohet nga afër nga ekipet e monitoruesve.

---

## **1 Përdorimi i izolimi/izolimit të vetmuar është i rregulluar, përdoret vetëm si mjet i fundit dhe për periudhën më të shkurtër të mundshme**

**Burimet:** [BPTP](#) 7; [RRSM](#) 31; [BR](#) 21(b); [RPJDL](#) 67; [PPMMPPLKA](#) XXII(3); [RREB](#) 60.5

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Përse përdoret veçimi ose izolimi? (si dënim, masë e menaxhimit të sjelljes, për mbrojtje, për rastet e rrezikut të vetëvrasjes ose vetëlëndimit?)
- Sa persona të ndaluar janë izoluar brenda një periudhë të caktuar? Ku ndodhet personi i cili ka qenë i izoluar?
- A izolohehen të miturit?
- A izolohehen personat e tjerë në pozitë të cenueshme?
- Cila është kohëzgjatja mesatare e izolimit?
- Cilat janë kushtet e hapësirës ku bëhet izolimi dhe a janë në përputhje me kushtet e ndalimit human?
- A ekzistojnë alternative tjera përveç izolimit?

---

## 2 **Vendimi për ta izoluar një person në mbajtjeose grup të personave në mbajtje merret në raste të jashtëzakonshme, me bazë të qartë dhe i nënshtrohet shqyrtimit të pavarur**

Burimet: [PPMMPPLKA XXII\(3\)](#); [RPJDL 67](#); [RRSM 30\(2\)\(3\)](#)

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Cila është procedura për izolimin? (Kush vendosë? Me çfarë baze?)
- A informohen personat e ndaluar për arsyet e vendimit për izolimin e tyre në një mënyrë që ata e kuptojnë?
- A mbahet një regjistër i izolimit?
- Sa shpesh u nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore personat e ndaluar në izolim?
- A ka procedurë të ankimit?

---

## 3 **Izolimi i personit në mbajtje monitorohet për çdo ditë, përfshirë nga ana e një mjeku të pavarur, për të përcaktuar mirëqenien fizike, emocionale dhe psikologjike të tij/saj**

Burimet: [RRSM 32](#); SR Torture §100

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë procedure e monitorimit ekziston?
- A vizitohen personat e ndaluar në izolim çdo ditë nga mjeku?
- A mund të kërkojnë personat e ndaluar në izolim të shohin mjekun?

---

## **Të drejtat dhe privilegjet e personave në mbajtjetë cilët ndodhen në izolim respektohen**

Burimet: [PNDCP 10 §1](#); [RRSM 35](#)

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A ka cenuar izolimi ose veçimi ndonjë të drejtë procedurale të personit të ndaluar?
- Çfarë ndalesash ose kufizimesh ekzistojnë, nëse ka të tilla, sa u përket të drejtave që i gëzojnë personat e ndaluar?

### 4.2.3 Mjetet e kufizimit fizik dhe përdorimi i forcës

Në kontekstin e ndalimit të imigrantëve, është me rëndësi jetike që personelit dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit ta kuptojnë dhe respektojnë statusin jopenal të imigrantëve të ndaluar dhe karakterin jondëshkues të ndalimit të tyre.

Mjetet e kufizimit fizik të tilla si prangat, ose në raste të veçanta, përdorimi i forcës, në këtë kontekst janë të kufizuara me ligj dhe zbatohen vetëm kur është e domosdoshme, e arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin legjitim të ruajtjes së sigurisë dhe rendit në vendin e ndalimit, ose kur rrezikohet siguria personale apo dëmtimi i pronës. Format kimike ose mjekësore të kufizimit në përgjithësi janë të paligjshme.

Përdorimi i kufizimeve tek fëmijët duhet të ndalohet shprehimisht, përveç nëse vlerësohet dhe konstatohet se një gjë e tillë në interesin më të mirë të fëmijës.

#### **1 Përdorimi i forcës kundër imigrantëve në mbajtjepërdoret në raste të jashtëzakonshme dhe rregullohet shprehimisht me ligj, si dhe kufizohet për qëllime të vetëmbrojtjes ose masave tjera të nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe sigurisë**

Burimet: [RRSM](#) 54(1); [BPUFF](#) 4; [PPMMPPLKA](#) XXIII; [RREB](#) 64, 65, 66

#### **Këshilla për monitoruesit:**

- A ka legjislacion dhe rregullore për përdorimin e forcës në kontekstin specifik të ndalimit të imigrantëve? A i di personeli ato?
- Çfarë trajnimesh kanë vijuar personeli për përdorimin e këtyre masave?



## 2 Kur një situatë mund të kërkojë përdorimin e forcës, vendi i ndalimit i jep prioritet përpjekjeve për ta qetësuar situatën me strategji të menaxhimit jot ë dhunshëm të konfliktit

Burimet: [BPUFF](#) 4; [PPMMPLKA](#) XXIII(2)

### Këshilla për monitoruesit:

- A përfshijnë trajnimet e personelit strategji për qetësimin e situatave të tensionuara?
- A ka ndonjë shembull kur këto janë përdorur me sukses?
- Si kanë reaguar personeli në menaxhimin e krizave?

## 3 Përdorimi arbitrar, abuziv ose përndryshe përdorimi i tepërt i forcës nga ana e zyrtarëve të zbatim it të ligjit është vepër penale

Burimet: [BPUFF](#) 7; [PPMMPLKA](#) XXIII(3); [RREB](#) 69

### Këshilla për monitoruesit:

- A mbajnë dhe a përdorin personeli armë? (sikurse armë zjarri ose shkop polici)? Nëse po, çfarë janë ato? A janë të trajnuar personeli në përdorim të armëve?
- A mund të identifikohen personeli qoftë me emër e mbiemër qoftë me numër të punonjësit?
- A ka ndonjë dëshmi të përdorimit të forcës së tepërt ta joproportionale?

## 4 Përdorimi i forcës dokumentohet dhe raportohet në tërësi në një regjistër të posaçëm për incidentet dhe në dosjet individuale të personave të ndaluar, si dhe ekzistojnë procedura efektive të shqyrtimit

Burimet: [RRSM](#) 54(1); [BPUFF](#) 6, 22; [PPMMPLKA](#) XXIII(3)

### Këshilla për monitoruesit:

- Si regjistrohen rastet e përdorimit të forcës? A ka proces të shqyrtimit?
- Kur përdoret forcë kundër personave të ndaluar? Ku? Përse?
- Cili është procesi i referimit për ekzaminim mjekësor?

---

## 5 Përdorimi i instrumenteve dhe metodave të kufizimit fizik është rregulluar shprehimisht me ligje dhe rregullore

Burimet: [KBKKT](#) 16; [PME](#) 5; [RRSM](#) 33, 34; [RPJDL](#) 63-65; [PPMMPPLKA](#) XXIII(1); [RREB](#) 68; [BR](#) 21(c)

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë politika dhe rregullore ka lidhur me përdorimin e mjeteve të kufizimit?
- Përdorimi i mjeteve të kufizimit kufizohet në: a. arratisjen e paligjshme gjatë transferit, b. arsye mjekësore, c. parandalim i lëndimit, vetëlëndimit, dëmtimit të pronës.
- Çfarë mjete të kufizimit fizik përdoren gjatë deportimit/largimit?
- A përdoren mjetet e kufizimit gjatë ekzaminimeve ose trajtimeve mjekësore ose stomatologjike (si, për shembull, në rastin e grave të cilat lindin), intervistave ose seancave dëgjimore?
- A ekzistojnë dëshmi për përdorimin e mjeteve të kufizimit te fëmijët ose gratë shtatzëna?

---

## 6 Përdorimi i kufizimit fizik monitorohet dhe personat e ndaluar ekzaminohen nëse kërkojnë një gjë të tillë

Burimet: [RRSM](#) 34; [BPUFF](#) 5(c); [PME](#) 5

### Këshilla për monitoruesit:

- Kush monitoron përdorimin e mjeteve të kufizimit (të verifikohet nëse është fjala për menaxhmentin, mjekun ose shqyrtim gjyqësor)?
- Cili është procesi i referimit për ekzaminim mjekësor?

## 4.3 SIGURIA, RENDI DHE DISIPLINA

Ndonëse është e domosdoshme që siguria, parashikueshmëria dhe rendi të ruhen në një vend të ndalimit të imigrantëve, rregullat dhe procedurat disiplinore duhet të kenë një prekje të lehtë e të përshtatshme lidhur me statusin jo kriminal të imigrantëve në mbajtje.

Gjithashtu, për të siguruar sigurinë dhe mbarëvajtjen e jetës së komunitetit është vendimtare të sigurohet se ka një mekanizëm të përshtatshëm të llogaridhënies. Këtu përfshihen të siguruarit që standardet dhe kufizimet janë të përcaktuara me ligj ose rregullore ligjore, vendimet të jenë subjekt i rishikimit dhe të ketë program të inspektimit rregullt dhe rigoroz.

Kështu, ekipet e monitorimit do të duhet të shqyrtojnë hollësisht masat mbrojtëse dhe reagimet institucionale dhe të shqyrtojnë si shkaqet ashtu dhe pasojat e problemeve të tilla si ngacmimi dhe viktimizimi.

### 4.3.1 Procedurat disiplinore

Në kontekstin e ndalimit të imigrantëve, për ruajtjen efektive të sigurisë dhe rendit të mirë është më se e dëshirueshme dhe e dobishme që sjellja e të burgosurve të menaxhohet para së gjithash përmes një skeme që në mënyrë të përshtatshme shpërblen sjelljen e mirë në vend se të dënojë sjelljen e papranueshme. Megjithatë, është e rëndësishme të mbajnë në mend se në praktikë skemat e shpërblimit shpejt mund të shëndërrohen në ndëshkuese nëse nuk menaxhohen si duhet dhe shpërblimet ipen në mënyrë arbitrare apo tërhiqen.

Është shumë e rëndësishme që ekipi të jetë i vetëdijshëm për dallimet mes një sistemi disiplinor në kontekstin e burgjeve dhe rregullat e brendshme në një mjedis të ndalimit të imigrantëve. Në këtë dritë duhet të shqyrtohet regjistri në të cilin regjistrohen të gjitha shkeljet e rregullave të brendshme dhe procedurat e sanksionet pasuese.

## **1 Ruajtja e disiplinës dhe rendit bëhet gjithherë në përputhje me rregullat dhe vetëm për atë që është e nevojshme për të siguruar rendin dhe mbarëvajtjen e jetës së komunitetit**

Burimet: [RRSM](#) 27; [BPP](#) 30; [PPMMPPLKA](#) XXIII(1); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §88; [RREB](#) 56.1, 2; 57.1, 2

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A janë rregullat të qarta dhe në dispozicion në disa gjuhë?
- A janë vendosur rregullat e brendshme në vende të përbashkëta dhe a i dinë personat e burgosur dhe personelit se cilat janë ato?
- A janë të përcaktuara me ligj apo rregullore ligjore?
- Kush i përcakton sanksionet dhe me çfarë baze?
- Të çfarë natyre janë sanksionet e shqiptuara?
- A ka personi ndaluar mundësinë që ta mbrojë veten?

---

## **2 Procedurat disiplinore janë subjekt i rishqyrtimit dhe ankimit**

Burimet: [PPMMPPLKA](#) XXII(1); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §88

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Si funksionon mekanizmi i ankimit?
- Sa ankesa janë vendosur në favor të personit në mbajtje?

---

## **3 Hollësitë për gjithë masat disiplinore regjistrohen në një regjistër disiplinor, duke përfshirë datën dhe hollësitë e shkeljes së pretenduar disiplinore, datën dhe hollësitë e seancës dëgjimore dhe arsyet e vendimit, datën dhe hollësitë e rishqyrtimit dhe arsyet e vendimit, datën, hollësitë dhe kohëzgjatjen e masës disiplinore të shqiptuar**

Burimet: [RPJDL](#) 19, 70

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A është i saktë dhe a mbahet si duhet regjistri i masave disiplinore?
- Çfarë natyre dhe kohëzgjatje kanë sanksionet (llojet, kohëzgjatja mesatare dhe maksimale)? A janë masat disiplinore të kufizuara në kohë?
- Sa është numri total i sanksioneve të shqiptuara? A ka dëshmi të vendimtarjes arbitrare apo jokonsistente?

---

#### 4 Sanksionet disiplinore që zbatohen ndaj fëmijëve janë të përshtatshme për rrethanat dhe cenueshmeritë e tyre të veçanta

Burimet: [KDF](#) 37(a); [RPJDL](#) 70

##### Këshilla për monitoruesit:

- A ka raste të zbatimit të procedurave disiplinore ndaj fëmijëve (numri, periudha)?
- Çfarë masa janë ndërmarrë?

#### 4.3.2 Inspektimi i jashtëm

Sistemet e inspektimit të jashtëm janë të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të imigrantëve në mbajtje. Duhet të ketë një mekanizëm të inspektimit dhe mbikëqyrjes së rregullt të pavarur të administrimit të vendeve të mbajtjes së imigrantëve dhe të trajtimit të tyre. Fushëveprimi i inspektimeve duhet të shtrihet në të gjitha aspektet e ndalimit të imigrantëve.

---

#### 1 Vendi i mbajtjesdhe administrimi i tij mbikëqyren dhe inspektohen rregullisht nga ana e një autoriteti kompetent tjetër që nuk është autoriteti ndalues

Burimet: [BPP](#) 29(1); [RRSM](#) 55; [RPJDL](#) 14, 72-74; [PPMPPPLKA](#) XXIV; [RREB](#) 93.1

##### Këshilla për monitoruesit:

- Kush i inspekton vendet e mbajtjes të imigrantëve? Çfarë autoriteti ka ai?
- Sa shpesh kryhen inspektimet?
- Cila është fusha e veprimit të inspektimeve?
- A ka raporte të inspektimit?

---

#### 2 Inspektorët emërohen dhe i japin llogari një autoriteti inspektues/mbikëqyrës dhe kompetencat e tyre përfshijnë inspektimin e të gjitha vendeve të ndalimit dhe shqyrtimin e zgjidhjen e ankesave e parashtresave

Burimet: [BPP](#) 29(1); [RRSM](#) 36, 55; [RPJDL](#) 72-78

##### Këshilla për monitoruesit:

- Kush i emëron inspektorët?
- Çfarë përbërje kanë ekipet e inspektimit? (p.sh. bilanci gjinor dhe kapacitetet profesionale)?
- Çfarë mandati dhe autoriteti kanë ata?

---

### 3 Personat e ndaluar kanë të drejtë për të komunikuar në mënyrë të papenguar dhe në konfidencialitet të plotë me inspektorët

Burimet: [BPP](#) 29(2); [RRSM](#) 36(2); [RPJDL](#) 73; [BR](#) 25(1)

#### Këshilla për monitoruesit:

- A mund të komunikojnë personat e mbajtur lirshëm me inspektorët? A ndodh kjo rregullisht? Cili është procesi?
- A respektohen privatësia dhe konfidencialiteti?

#### 4.3.3 Ngacmimi dhe viktimizimi

Ngacmimi dhe format e tjera të viktimizimit janë forma të dhunës të cilat gjithashtu ndikojnë në një sërë të të drejtave tjera të njeriut. Ata mund të paraqiten si problem në kuptimin e marrëdhënieve mes personelit dhe personave të ndaluar, si dhe marrëdhënieve mes vetë pjesëtarëve të personelit dhe në mesin e personave të ndaluar. Të gjitha format e ngacmimit dhe viktimizimit kanë ndikim negativ në një mjedis të burgimit. Efekti kumulativ ose mosreagimi adekuat mund të përbëjë shkelje të të drejtave të njeriut, përfshirë trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës. Në të gjitha rastet duhet të ndërmerren veprimet e duhura.

---

### 1 Personeli dhe personat e mbajture dinë se ngacmimi dhe viktimizimi është i ndaluar, i dinë të drejtat e tyre dhe se si mund t'u qasen atyre

Burimet: [BPP](#) 1; [PNDOP](#) 10

#### Këshilla për monitoruesit:

- A ka politikë kundër ngacmimit dhe viktimizimit?
- Sa i përhapur është problem i ngacmimit dhe viktimizimit?
- A është trajnuar personeli lidhur me ngacmimin dhe viktimizimin?

- A janë përfshirë personat e ndaluar në hartimin e strategjive për trajtimin e ngacmimit dhe formave tjera të viktimizimit?
  - A mbrohen personat e mbajtur nga vëmendja dhe trysia e padëshiruara seksuale, ose shfrytëzimi?
- 

## 2 Personeli janë të trajnuar për të identifikuar dhe për të reaguar ndaj incidenteve të ngacmimit ose viktimizimit sa më herët që të jetë e mundshme, dhe si dhe për t'i identifikuar personat ose grupet të cilët mund të jenë në pozitë posaçërisht të cenueshme

Burimet: [PPMMPPLKA XX](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A mbështetet personi në vërtetimet dhe informatat nga të tjerët personat e ndaluar, personeli, familja dhe miqtë – për identifikimin e individëve ose grupeve të cilët mund të jenë në pozitë posaçërisht të cenueshme ndaj ngacmimit dhe viktimizimit?
  - A janë personeli në gjendje të identifikojnë dhe të ulin tensionet ndërmjet personave të ndaluar të kombësive, etnive ose përkatësive fetare të ndryshme?
  - A janë personeli të pranishëm në të gjitha pjesët e vendit të ndalimit në një masë që është e përshtatshme për vendin?
- 

## 3 Në rastet e pretendimeve për ngacmim dhe viktimizim reagohe në kohë, ato hetohen në mënyrën e duhur dhe korrigjohen në mënyrë të përshtatshme

Burimet: [ÇoE-TGFR](#) 10.6; [RRSM](#) 36; [RPJDL](#) 76-77; [PPMMPPLKA](#) IX(3), V; [BR](#) 5(1); [BPP](#) 7.1, 33.4; [UNHCR-UN](#) 8, 9.3

### Këshilla për monitoruesit:

- A menaxhohet ngacmimi dhe viktimizimi nga ana e personelit përmes procedurave disiplinore për personelin?
- Çfarë mundësi të ankimit kanë në dispozicion viktimat? Çfarë rezultate sjellin ato?
- A dokumentohen pretendimet në mënyrën e duhur?
- A respektohet privatësia dhe konfidencialiteti?

### 4.3.4 Trajtimi i emergjencave

Në çdo vend ku njerëzit janë të privuar nga liria e tyre, përfshirë vendet e mbajtjes së imigrantëve, është e nevojshme të ketë gatishmëri ndaj emergjencave. Shkaqet e një emergjence apo krize mund të jenë të brendshme, të jashtme, të rastësishme, nga pakujdesia, të qëllimshme, apo fatkeqësitë natyrore. Në një vend të ndalimit të imigrantëve qëndrojnë njerëzit të cilët janë të privuar nga liria (ndonjëherë numër i madh syresh) dhe kanë pak mundësi për ta mbrojtur veten në rast emergjence. Në disa vendet, politika dhe praktikat që zbatohen për vendet e mbajtjes së imigrantëve bëjnë që këto vende të shndërrohen në “enë nën tryzni” të stresit dhe ankthit të cilat mundën herë pas here të shpërthejnë në protesta, trazira dhe shqetësime të tjera dhe akte të dhunës, duke përfshirë vetëlëndimin.

---

#### 1 Ekziston një politikë gjithëpërfshirëse e gatishmërisë ndaj emergjencave në vendin e mbajtjes, që parasheh angazhimin e personelit dhe personave në mbajtje dhe synim parësor ka sigurinë e imigrantëve në mbajtje, personelit dhe të gjithë vizitorëve

Burimet: [PPMMPPLKA XXIII\(1\)](#)

##### Këshilla për monitoruesit:

- A minimizon projektimi dhe struktura e vendit të mbajtjes të imigrantëve rrezikun nga zjarri dhe rreziqet tjera (p.sh. rrjedhjet e lëndëve kimike) dhe fatkeqësitë natyrore (p.sh. uragan, vërshime) dhe siguron evakuimin e sigurt të objektivit?
- Cili është ndikimi i politikës së tillë në jetën e përditshme?
- A janë trajnuar personeli për strategjitë e menaxhimit të krizave?
- A është i pajisur vendi i mbajtjes me pajisjet e përshtatshme sikurse sisteme të alarmit, altoparlantë dhe pajisje për shuarjen e zjarrit? A është e lehtë qasja në to? A testohen këto pajisje rregullisht dhe a janë funksionale?
- A janë trajnuar personeli për përdorimin e këtyre pajisjeve?
- A ka sisteme alternative të komunikimit në rast se është e pamundur të përdoren sistemet e zakonshme të komunikimit (p.sh. për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike)?



- A ka qenë efektiv zbatimit i politikës në rast të ndonjë emergjence ose krize që ka ndodhur së fundmi?
- 

## 2 **Është e mundshme të sillet mbështetje shtesë, përfshirë personel të shërbimit të emergjencave, negociatorë/ bashkëbisedues të pavarur dhe personel mjekësor**

Burimet: [CoE-TGFR](#) 10.3

**Këshilla për monitoruesit:**

- A mund të sillet mbështetje shtesë me paralajmërim të shkurtër?
  - A ka qenë efektive në rastin e ndonjë emergjence ose krize që ka ndodhur së fundmi?
- 

## 3 **Ekzistojnë procedura të qarta të evakuimit në rast të emergjencave dhe kryhen simulime të rregullta të zjarrit dhe evakuimit, si dhe janë paraparë masa të veçanta për personat në pozitë të cënueshme**

Burimet: [RPJDL](#) 32

**Këshilla për monitoruesit:**

- A bëhen rregullisht testime të alarmit të zjarrit, simulime të zjarrit dhe simulime tjera të evakuimit në rast emergjencash?
- A gëzojnë mbrojtje shtesë fëmijët dhe grupet tjera në pozitë posaçërisht të cënueshme?

## 4.4 KUSHTET MATERIALE

Kur i heq lirinë një personi, shteti merr përgjegjësi për plotësimin e nevojave jetike të atij personi të tilla si ushqimi dhe strehimi. Është detyrë e shtetit që heqjen e lirisë ta lehtësojë sa më shumë që të jetë e mundur, duke siguruar që mjedisi dhe kushtet e ndalimit të respektojnë dinjitetin dhe statusin jopenal të imigrantëve të ndaluar. Kjo nënkupton "shmangien e përdorimit të burgjeve dhe objekteve të projektuara për këtë qëllim ose që operojnë si burgje" (UNHCR- UN 8) dhe "se objektet e imigrantëve të jenë të projektuara posaçërisht për qëllimin të cilit i shërbejnë" (Standardet e KPT-së, Ekstrakt nga Raporti 7). Gjithashtu, kujdes i shtuar gjatë projektimit dhe planit të objektivave duhet t'i kushtohet vëmendje që të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur përshtypjen e një mjedisi të burgimit. Kjo do të thotë se si mjedisi i mbajtjes ashtu dhe kushtet e jetesës duhet të jenë të mira në çdo aspekt. Kështu, akomodimi, instalimet sanitare, higjiena, uji i pijshëm, ushqimi, veshmbathjet, shtretërit, mbajtja e sigurt dhe qasja në gjësendet personale duhet që të gjitha të jenë të një standardi të përshtatshëm dhe të ofrojnë siguri dhe respekt për dinjitetin e personave të ndaluar. Përveç kësaj, plani dhe hapësirat fizike të objekteve të ndalimit duhet të sigurojnë që të gjithë personat e ndaluar ta kenë privatësinë e duhur.

### 4.4.1 Akomodimi

Akomodimi i përshtatshëm është aspekt i qenësishëm për çdo person të ndaluar, përfshirë azilkërkuesit dhe imigrantët e ndaluar, kur është fjala për kushtet e tyre materiale të mbajtjes. Është më se e natyrshme që ai të ketë ndikim të madh në mënyrën se si ata ndjehen dhe varet mes tjerash nga lloji dhe sipërfaqja e akomodimit, pastërtia e tij, koha që ata kalojnë në të ose mundësia që ai ofron për të ruajtur jetën familjare.

Sa u përket fëmijëve, duke përfshirë fëmijët azilkërkues ose imigrantë të pashoqëruar apo të ndarë, është e rëndësishme që ata të mbahen ndaras nga të rriturit me të cilët nuk kanë lidhje familjare.

Madhësia, ndriçimi natyror ose artificial, numri i të personave të ndaluar në një dhomë të caktuar dhe orenditë janë kushtet kyçe që duhet të vëmikohen nga ekipet monitoruese.

Duke pasur parasysh natyrën e ndalimit të imigrantëve, personat e mbajtur nuk duhet të qëndrojnë të mbyllur në dhomat e tyre gjatë tërë ditës, por të jenë në gjendje të lëvizin lirisht brenda objektit .

---

## 1 Numri i personave në mbajtjenuk e tejkalon kapacitetin maksimal të lejuar të shtretërve në vendin e ndalimit

Burimet: [RRSM](#) 9(1); [PPMMPPLKA](#) XVII

**Këshilla për monitoruesit:**

- Cili është kapaciteti maksimal i vendit?
- Sa është numri i personave të ndaluar në të?

---

## 2 Madhësia e dhomës(ave) është adekuate dhe mundëson akomodim të një personi për dhomë përveçse në rastet e çiftëve dhe familjeve

Burimet: [RRSM](#) 9(1); [PPMMPPLKA](#) XII(1); [KPT/Inf](#) (97) 10 §29; [RREB](#) 18; 96

**Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë madhësie kanë dhomat (metra katror për person)?
- Sa persona janë të vendosur në një dhomë?
- A merren parasysh nevojat e personave në pozitë të cenueshme?
- Në rastet e dhomave më shumë persona, a merren parasysh aspektet kulturore/etnike/fetare?

---

## 3 Hapësirat e fjetjes për të gjithë imigrantët në mbajtjen mirëmbahen, janë të sigurta, të pastra dhe të pajisura me orendi adekuate

Burimet: [RRSM](#) 10; [PPMMPPLKA](#) XII(2); [KPT/Inf](#) (97) 10 §29; [RREB](#) 19.2; [DPBE](#) Recitali (18), (17)

**Këshilla për monitoruesit:**

- A janë fëmijët, përfshirë fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë, të vendosur ndaras nga të rriturit me të cilët nuk kanë asnjë lidhje?
- A kanë të gjithë personat e ndaluar shtratin, dyshekun, dhe çarçafë/batanijet e tyre?
- Si është e mobiluar dhoma?

- Në rastet e dhomave të fjetjes për shumë persona, a kanë personat e ndaluar dollapë të vetët që mund të kyçen me çelës?

---

#### 4 Dhomat kanë ndriçim natyror dhe qarkullim të mirë të ajrit

Burimet: [RRSM 11\(a\)](#); [PPMMPPLKA XII\(1\)](#)

Këshilla për monitoruesit:

- A ka ndriçim natyror në dhomë?
- A mund të hapen dritaret?
- A ofrojnë dritaret ndriçim të mjaftueshëm për lexim dhe punë?

---

#### 5 Ndiriçimi artificial është i mjaftueshëm për t'ju mundësuar personave në mbajtjeqë të lexojnë ose punojnë

Burimet: [RRSM 11\(b\)](#)

Këshilla për monitoruesit:

- A mund t'i ndalin dhe kyçin prizat e dritave në dhomat e tyre të fjetjes personat e ndaluar?

---

#### 6 Ka ngrohje dhe/ose ftohje, ventilim adekuat, të sigurt dhe që është në përputhje me kusht klimatike, që është funksional

Burimet: [RRSM 10](#); [PPMMPPLKA XII\(1\)](#)

Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë temperature kanë dhomat?
- A funksionon ngrohja dhe ventilimi?
- A mund ta kontrollojnë ngrohjen, ftohjen dhe ventilimin personat e ndaluar?

---

#### 7 Çifteve u jepet akomodim i përshtatshëm, përfshirë çifteve që mund të kenë cenueshmeri të posaçme sikurse çiftet e pamartuara ose LGBTI

Burimet: [UNHCR-UN 9](#); [PPMMPPLKA XIX](#)

Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë akomodimi sigurohet për çiftet?
  - A ka ndonjë dëshmi të diskriminimit të kategorive të caktuara të çifteve (të pamartuar, LGBTI)?
- 

## 8 Sigurohet akomodim për familjet, dhe ai është i përshtatshëm dhe i sigurt për fëmijët

Burimet: [RRSM](#) 8(d); [PPMMPPLKA](#) XIX; [DPBE](#) 12, 18.2 (a)

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë akomodimi u sigurohet familjeve?
  - A vendosen fëmijët në të njëjtin vende me të rritur me të cilët nuk kanë lidhje familjare?
- 

## 9 Gratë dhe burrat nuk flenë në të njëjtën dhomë

Burimet: [RRSM](#) 8(a), 23; [UNHCR-UN](#) 8 §48(v); [PPMMPPLKA](#) XIX

### Këshilla për monitoruesit:

- A u sigurohen grave hapësira të veçanta të fjetjes?
  - A garantohet privatësia e tyre?
  - A sigurohet siguria e tyre?
- 

## 10 Personat në mbajtje kanë çarçafë e mbulesa të pastra

Burimet: [RRSM](#) 19; [PPMMPPLKA](#) XII(1); [RREB](#) 21

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë çarçafë Kutia e mbulesa u jepen personave në mbajtje rastin e arrijtes? A janë ato të përshtatshme për kushtet klimatike?
- Sa shpesh ndërrohen çarçafët?
- Kush është përgjegjës për larjen e çarçafëve?
- A duken dhe a mbajnë erë të pastër çarçafët e mbulesat?

## ① Në rastet kur imigrantët mbahen në vende të ndalimit penal, p.sh. burgje ose stacione policore, ata nuk mbahen bashkë me personat e ndaluar sipas së drejtës penale

**Burimet:** [PNDCP](#) 10(2)(a); [KPM](#) 17(2); [BPP](#) ; [RRSM](#) 8(b); [RPJDL](#) ; [GPNA-D5](#) f.9; [UNHCR-UN](#) 8 §48(iii); [EXCOM](#) 44(f); [PPMMPPLKA](#) XIX; [KPT/Inf](#) (97) 10 §27, 28

### Këshilla për monitoruesit:

- A mbahen imigrantët e ndaluar veçmas nga personat në mbajtje sipas së drejtës penale? A mbahen p.sh. në një krah ose pjesë të veçantë të objektit?
- A ndalohen aty për periudha të zgjata të mbajtjes? A mbahen në raste të jashtëzakonshme (p.sh. për shkak të potencialit të ditur për dhunë?

## 4.4.2 Ushqimi dhe uji i pijshëm

Në kontekstin e ndalimit të imigrantëve, realizimi i së drejtës për ushqim është çështje e shëndetit dhe sigurisë, si dhe e respektimit të dinjitetit të qenieve njerëzore. Duhet të sigurohet ushqim me vlera ushqyese të përshtatshme për moshën, shëndetin dhe përkatësinë kulturore/fetare. Dieta të veçanta për gratë shtatzëna ose nënat gjidhënëse duhet të jenë në dispozicion. Hapësirat në të cilat përgatitet dhe hahet ushqimi duhet të plotësojnë standardet themelore të higjienës dhe pastërtisë. Pra, personave të mbajtur duhet të u ofrohet një dietë e mjaftueshme, e shëndetshme, e larmishme dhe e ekuilibruar, pa pagesë.

Atyre duhet t'u lejohet po ashtu që të porosisin ushqim nga jashtë me shpenzimet e tyre, qoftë përmes administratës ose familjes e miqve.

Veç kësaj, angazhimi në përzgjedhjen dhe përgatitjen e ushqimit është një aktivitet ditor i rëndësishëm që është domethënës dhe shoqëror. Ajo i mund të shërbejë si mënyrë për të krijuar apo për t'i ripërtërirë kontaktet me komunitetin nga vendi i origjinës në vendin pritës. Për më tepër, një gjë e tillë i shërben ruajtjes, përmirësimit ose pajisjes me shkathtësi të rëndësishme jetësore që është e domosdoshme pas lirimimit apo largimit.

## 1 Imigrantëve në mbajtjeu ofrohet ushqim i mjaftueshëm me vlera ushqyese dhe dietë e larmishme dhe e ekuilibruar pa pagesë

Burimet: [RRSM](#) 20(1); [UNHCR-UN](#) 8 §48(xi); [PPMMPPLKA](#) XI(1); [RREB](#) 22

### Këshilla për monitoruesit:

- A është ushqimi në sasi të mjaftueshme, cilësor dhe i llojlojshëm?
- A plotësohen nevojat e veçanta dietetike (vegjetarianë, fetare ose mjekësore)?
- Kush vendosë për menynë? A kanë ndonjë rol në këtë personeli mjekësor?
- Cili është buxheti ditor për ushqimin?
- Çfarë mendimi kanë personat në mbajtje për ushqimin? Çfarë shije ka ai?
- A munden personat në mbajtjet të blejnë ushqim Brenda objektit? Si janë çmimet në krahasim me ushqimit që blihet jashtë?

## 2 Shujtat dhe pijet/uji shërbehen në intervale të rregullta

Burimet: [RRSM](#) 20; [PPMMPPLKA](#) XI; [RREB](#) 22.4

### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë qasje personat në mbajtjenë ujë të pijshëm gjatë tërë kohës? Çfarë ngjyre, ere dhe shije ka uji?
- Sa shujta në ditë u shërbehen në mbajtjet të ndaluar? Në çfarë intervale?
- A përgatitet dhe shërbehet ushqimit në kushte higjienike? A shërbehet në mënyrë të bukur? A shërbehet në mënyrë të respektueshme?
- Ku hahen shujtat? A ka ndonjë regjistër të shujtave?

## 3 Personat e ndaluar kanë mundësi për ta gatuar vetë ushqimin

Burimet: [BR](#) 5

### Këshilla për monitoruesit:

- A mund ta gatujnë personat në mbajtje ushqimin e tyre vetë? A mund ta bëjnë këtë çdoherë?
- Prej ku dhe në c' mënyrë e sigurojnë ushqimin për të gatuar personat në mbajtje?

- A kanë qasje në ushqim jashtë orarit të ngrënies?

---

#### **4 Vlerat ushqyese të ushqimit për gratë shtatzëna dhe nënat gjdhënëse janë të mjaftueshme për një standard të përshtatshëm shëndetësor për nënat dhe fëmijët**

**Burimet:** [CEDAW](#) 12(2); [BR](#) 48; [UNHCR-UN](#) 8 §48(xi); [PPMMPPLKA](#) XI(1)

##### **Këshilla për monitoruesit:**

- A ka konsiderata të veçanta ushqimore për gratë shtatzëna ose nënat të cilat kanë fëmijë në gji?

---

#### **5 Kërkesat e veçanta dietetike fetare, kulturore dhe të tjera në lidhje me ushqimin respektohen plotësisht**

**Burimet:** [BPTP](#) 3, 6; [PPMMPPLKA](#) XI(1)

##### **Këshilla për monitoruesit:**

- Në ç'masë merren parasysh kërkesat e veçanta dietetike, përfshirë në lidhje me ruajtjen, përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit?
- A kanë mundësi personat në mbajtjeqë t'i kumtojnë nevojat e tyre të posaçme dietetike?
- A ka ndonjë dëshmi të diskriminimit?
- A këshillohen përfaqësuesit fetarë gjatë marrjes në konsideratë të çështjeve lidhur me ushqimin?

---

#### **6 Zyrtari mjekësor bën inspektime të rregullta të mënyrës së ruajtjes, sasisë, cilësisë, përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit dhe jep këshilla përkatëse**

**Burimet:** [RRSM](#) 26(1)(a); [RREB](#) 22.6

##### **Këshilla për monitoruesit:**

- A është i njoftuar zyrtari mjekësor me zinxhirin e ushqimit?
- A jep ai/aji rekomandime në lidhje me vlerat ushqyese të ushqimit?
- A zbërthehen menytë sipas vlerave ushqyese?



## 7 Hapësirat për gatimin e ushqimit, sallat e ngrënies dhe pajisjet për ngrënie janë të sigurta, të pastra, higjienike, të ventiluara dhe mirëmbajtura mirë

Burimet: [RRSM](#) 14; [PPMMPPLKA](#) XI(1)

### Këshilla për monitoruesit:

- Në ç'vend hahet ushqimi?
- Si shërbehet ushqimi?
- A janë hapësirat e gatimit/kuzhinat të pastra, higjienike dhe në gjendje funksionale?
- A inspektohen hapësirat e gatimi rregullisht në aspektin shëndetësor dhe të sigurisë?
- A kanë personat e ndaluar qasje në to?

### 4.4.3 Kushtet hidrosanitare dhe higjienike

Higjiena personale është çështje e shëndetit dhe e respektit për veten dhe të tjerët. Gjithashtu, higjiena personale mund të jetë e ndërlidhur me praktika fetare që duhet të respektohen.

Për më tepër, qasja në kushte të duhura hidrosanitare dhe në hapësira për të bërë dush e banjo është thelbësore si mënyrë e zvogëlimit të përhapjes së mundshme të sëmundjeve në mesin e personave të mbajtur dhe personelit. Siç parashihet në RRSM 13, "duhet të sigurohen instalime të përshtatshme të dushave dhe banjove ashtu që çdo të burgosuri t'i mundësohet dhe t;i kërkohet që të bëjë banjo ose dush, në temperaturë të përshtatshme për klimën dhe aq shpesh sa të jetë e nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës së përgjithshme sipas stinës dhe rajonit gjeografik, por të paktën një herë në javë në një klimë të butë".

Prandaj, autoritete duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qasje të instalimeve të pastra hidrosanitare dhe të banjove. Gjithashtu, ato duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të veçanta të grave, fëmijëve të vegjël dhe foshnjave.

---

## 1 Personat në mbajtje kanë qasje të menjëhershme dhe të pakufizuar në hapësira hidrosanitare që mirëmbahen mirë, janë të pastra, në gjendje të mirë dhe private

Burimet: [RRSM 12](#); [PPMPPPLKA XII\(2\)](#); [RREB 19.3](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A janë funksionale hapësirat hidrosanitare, higjienike dhe për larje?
- A ka hapësira hidrosanitare të veçanta për gratë dhe për burrat?
- Sa është raporti i tualeteve me numrin e personave të ndaluar?
- A ka qasje në to gjatë natës?
- A sigurohet privatësi?
- A ka hapësira të veçanta për gratë dhe personat tjerë në pozitë të cenushme?
- A janë në dispozicion materialet dhe pajisjet për pastrim?

---

## 2 Personat në mbajtjekanë qasje në hapësira adekuate për të bërë dush dhe banjo, në një temperaturë të përshtatshme për klimën dhe aq shpesh sat ë jetë e nevojshme për higjienën e përgjithshme

Burimet: [RRSM](#) 13; [RREB](#) 19.4

### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë personat në mbajtjeqasje në ujë (të ftohtë dhe të ngrohtë) gjatë tërë kohës?
- Çfarë ngjyre dhe ere ka uji?
- A ka numër të mjaftueshëm të hapësirave për të bërë banjo?
- A ka hapësira të veçanta për dush dhe banjo për gratë dhe burrat?
- A ka ndonjë dëshmi diskriminimi në kuptimin e qasjes së grupeve pakicë në hapësirat e banjove? A ka privatësi nëpër banjo?

---

## 3 Të gjithë personat në mbajtjefurnizohen falas me produkte higjienike të nevojshme për shëndetin, pastërtinë dhe dinjitet themelor

Burimet: [RRSM](#) 15, 16; [PPMMPPLKA](#) XII(2); [RREB](#) 19.6

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë lloj artikujsh u shpërndahen personave në mbajtje(burra/gra) me rastin e arrijtes?
- A plotësohen në mënyrë adekuate nevojat e gjinive të ndryshme dhe nevojat e tjera të veçanta? A u jepen grave pako higjienike?
- Në c; mënyrë dhe me çfarë shpeshësie personat në mbajtjemund të marrin furnizime të reja?

---

## 4 Foshnjat dhe fëmijët e vegjël kanë sasi të mjaftueshme të pelenave

Burimet: [KDF](#) 37(c); [RRSM](#) 15; [PPMMPPLKA](#) XII(2)

### Këshilla për monitoruesit:

- A ka në dispozicion pelena pa pagesë?
- Kush është përgjegjës për furnizimin me pelena?
- Në rast të pelenave të shumëpërdorshe, a sigurohen pajisje shtesë për larjen e tyre?

#### 4.4.4 Veshmbathjet

Njerëzit të cilët ndalohen në mbajtje si imigrantë nuk mbahen sit ë dënuar dhe duhet të kenë të drejtë t'i veshin rrobat e veta. Megjithatë, atyre duhet t'u sigurohen veshmbathje në qoftë se nuk kanë rroba të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Ato duhet jenë të përshtatshme, në dispozicion, të qasshme në mënyrë të lehtë dhe të sigurt, të përshtatshme për klimën, të përshtatshme në aspektin kulturor, të pastra, t'i shërbejnë qëllimit për të cilin do përdoren, dhe gjithherë jodiskriminuese.

Për më tepër, personat në mbajtjejo vetëm që duhet të kenë veshmbathje të përshtatshme po duhet të kenë po ashtu qasje në lavanderi ose shërbimeve të lavanderisë dhe sapun, në mënyrë që veshjet të mund të lahen rregullisht.

---

### 1 Personat në mbajtjeje kanë të lejuar që t'i veshin rrobat dhe këpucët e tyre

Burimet: [KPM](#) 17(1); [RRSM](#) 88(1); [RREB](#) 97; [UNHCR-UN](#) 8(x)

#### Këshilla për monitoruesit:

- A mund t'i veshin personat në mbajtjeveshmbathjet e tyre?
- A munden personat në mbajtjet'i veshin veshmbathjet e tyre në seanca dëgjimore dhe termine tjera jashtë vendit të ndalimit?

---

### 2 Nëse personi në mbajtjenuk posedon veshmbathje, atij i sigurohen rroba dhe këpucë të përshtatshme, në sasi të mjaftueshme dhe që i përgjigjen kontekstit

Burimet: [RRSM](#) 17; [PPMMPPLKA](#) XII(3); [RREB](#) 20, 97

#### Këshilla për monitoruesit:

- Po të jetë e nevojshme, a u sigurohen personave në mbajtjeveshmbathje të përshtatshme me rastin e arritjes?
- A janë veshmbathjet të përshtatshme për kushtet klimatike?
- Nëse sigurohen veshmbathjet, si duken ato? A u përgjigjen veshmbathjet nevojave fetare dhe kulturore të personave të caktuar?

- A janë veshmbathjet të përshtatshme për qëllime të ndryshme të përdorimit, p.sh. punë ose sport?
- A dallojnë veshmbathjet që u jepen personave në mbajtje ato që u jepen personave të dënuar në të njëjtin juridiksion?
- Prej nga sigurohen veshmbathjet?
- A janë rrobat, këpucët dhe ndërresat e brendshme që u jepen personave në mbajtjetë përshtatshme, përfshirë ato që u jepen fëmijëve, grave shtatzëna dhe personave me aftësi të kufizuara?
- A kanë të veshura rroba të përshtatshme, të pastra dhe që i shërbejnë qëllimit të përdorimit personat të cilët lirohen, deportohen ose riatdhesohen?

### 3 Personat në mbajtje kanë qasje të plotë në hapësirat dhe shërbimet e lavanderisë

#### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë personat në mbajtje qasje në lavanderi? Në çfarë kushte dhe me çfarë shpeshtësie?
- A janë hapësirat e lavanderisë dhe tharjes së rrobave të sigurt, të ndriçuar mirë, të pastra, të ventiluara mirë dhe në gjendje të mirë pune?
- A u sigurohet personave në mbajtjesapun?

#### 4.4.5 Paratë e gatshme dhe gjërat personale

Një nga efektet kryesore të heqjes së lirisë është humbja e autonomisë individuale. Kështu, imigrantët në mbajtje janë shpesh të privuar nga e drejta apo mundësia për të bërë madje dhe zgjedhje dhe vendime të thjeshta rreth jetës së tyre të përditshme, faktor ky që mund të ndikojë negativisht në ndjenjën e respektit për vetveten dhe dinjitetin. Në lidhje me këtë, është e detyrueshme që të sigurohet se çdo ndërhyrje në autonominë individuale është minimale dhe se kufizimet janë vendosur vetëm në atë masë sa është e nevojshme për të ruajtur sigurinë dhe rendin në mesin e komunitetit. Qasja në para të gatshme dhe gjëra personale dhe përdorimi i tyre përbëjnë një shembull të tillë.

---

## 1 Ka rregulla të qarta dhe të qasshme me lehtësi sa i përket mbajtjes së gjësendeve personale me rastin e pranimit në vendin e mbajtjes

Burimet: [RRSM](#) 43; [RPJDL](#) 35; [RREB](#) 31

### Këshilla për monitoruesit:

- A përvijojnë rregullat e vendit të ndalimit procedurat për mbajtjen dhe kthimin e gjërave personale?
- A janë personat në mbajtjedhe personeli në dijeni të rregullave dhe rregulloreve në fuqi?
- A bëhet me rastin e pranimit inventarizimi i parasë së gatshme dhe gjësendeve personale?
- A u jepet personave në mbajtjenjë kopje e regjistrit të tyre financiar?

---

## 2 Personat në mbajtjekanë qasje të lehtë në dollapë me çelës për ruajtjen e gjësendeve të vlefshme dhe gjerave tjera personale që nuk i kanë dorëzuar për ruajtje

Burimet: [RRSM](#) 43(1); [RPJDL](#) 35

### Këshilla për monitoruesit:

- Në c' mënyrë dhe vend ruhen gjësendet me vlerë? A kanë qasje personat e ndaluar në gjësendet e tyre me vlerë?
- A ka pasur raste të vjedhjes? Si janë regjistruar ato? A janë hetuar?

---

## 3 Imigrantët në mbajtjekanë qasje në paratë e tyre të gatshme ose mund t'i marrin me vete paratë e gatshme dhe gjësendet tjera personale jashtë vendit të ndalimit

Burimet: [RRSM](#) 43(3)

### Këshilla për monitoruesit:

- Cila është procedura për marrjen e parave të gatshme nga autoritetet?
- A është arkëtari i vendit të ndalimit i autorizuar për të pranuar para të gatshme nga familje ose miqtë e personit të ndaluar?
- Si regjistrohen depozitat e parave të gatshme?

---

## 4.5 AKTIVITET

Shkalla e ekzistimit dhe e inkurajimit institucional të një regjimi të aktiviteteve të larmishme dhe të përshtatshme të aktiviteteve (përfshirë qasjen në botën e jashtme dhe aktivitete kuptimplota) është një tregues i fortë i një mjedisi të ndalimit ku në mënyrë aktive mëtohet të minimizohen rreziqet që lidhen me heqjen e lirisë. Megjithatë, gama e aktiviteteve do të varet nga kohëzgjatja e qëndrimit. Monitoruesit mund të kontrollojnë nëse janë ndarë burime të mjaftueshme për këtë dhe nëse janë bërë aranzhime adekuate për vizita familjare, aftësim profesional, punë dhe aktivitete që paguhen, ushtrime në natyrë, kohën e lirë dhe aktivitetet kulturore dhe e drejta për të praktikuar fenë.

Në të vërtetë mungesa e aktiviteteve kuptimplota është një nga aspektet më të përhapura dhe të dëmshme të ndalimit të imigrantëve. Ajo buron nga pikëpamja se ndalimi i imigrantëve është praktikë që ka nevojë të përqendrohet vetëm në "kontroll" dhe ku mirëqenia e ardhme e imigrantit të mbajtur nuk shihet si përgjegjësi sociale. Si rezultat, hapat për përgatitjen e imigrantit në mbajtje për jetën jashtë mjedisit të ndalimit, çfarëdo që të jenë ata, nuk duhet të trajtohen si çështje e dorës së dytë. Nëse ndodh kjo, efektet e dëmshme të mërzitjes, pafuqisë dhe mungesës shpresës ka të ngjarë të shndërrohen problem social dhe mjekësor të madh, të kushtueshëm, dhe të vazhdueshëm, si brenda ashtu dhe jashtë vendit të ndalimit, veçanërisht në rastet kur personi mbahet ose është ndaluar ne mbajtje për kohë të gjatë.

### 4.5.1 Vizitat dhe komunikimi me botën e jashtme

Vizitat nga familja dhe të tjerët janë një e drejtë, jo privilegj. Ato janë një burim i rëndësishëm që shërben jo vetëm për t'u ndihmuar imigrantëve në mbajtjetë përballen me gjendjen e tyre dhe pasigurinë e rrethanave në të cilat ndodhen, por edhe për t'u ndihmuar që të përgatiten për jetën pas mbajtjes, qoftë në vendin e destinacionit ose të azilit, ose në vendin e origjinës. Megjithatë, realiteti në vendet e mbajtjes të imigrantëve është i tillë që vizitat e anëtarëve të familjes janë në praktikë të vështira. Megjithatë, parimi udhëheqës duhet të jetë nxitja e kontaktit me botën e jashtme dhe duhet të jetë subjekt i vetëm kufizimeve të sigurisë dhe kjo

vetëm nëse ka prova të një natyre bindëse. Ekipet monitoruese duhet ta shohin me shqetësim praktikën e themelimit të vendeve të mbajtjes në zona të largëta ose ndryshe të paarrtshme që e bëjnë mundësinë e pranimit të vizitorëve jopraktike ose të pamundur.

Si rrjedhojë, përmes vizitave dhe mjeteve të tjera të komunikimit, imigrantët e mbajtur duhet ta kenë të mundur që të mbajnë kontakte me këshilltarin ligjor, familjen dhe miqtë, grupet mbështetëse, përfaqësues fetarë, punonjësit social dhe profesionistët mjekësor. Gjithashtu, ata duhet ta kenë të lehtë qasjen në shërbimet e gjurmimit të UNHCR-it, KNKK, Kryqit/Gjysmëhënës së Kuqe dhe, me iniciativën e tyre, shërbime konsullore.

Azilkërkuesit të cilët mbahen në ndalohen në mbajtje duhet ta kenë të mundur që të kenë kontakte të rregullta (përfshirë edhe përmes telefonit apo internetit, kur është e mundur) dhe të pranojnë vizita nga të afërmit, miqtë, si dhe organizatat fetare, ndërkombëtare dhe/ose joqeveritare, nëse dëshirojnë. Në veçanti, duhet të garantohet qasja në dhe nga ana e UNHCR-it.

---

## **1 Vendi i mbajtjes është i qasshëm në mënyrë të arsyeshme për vizita të rregullta nga familja, miqtë dhe grupet mbështetëse të komunitetit**

Burimet: [BPP](#) 20

**Këshilla për monitoruesit:**

- Ku ndodhet vendi i ndalimit?
- Sa është larg vendi i ndalimit nga transporti publik?
- A ofrohet ndonjë mbështetje financiare ose materiale për lehtësimin e vizitave, në veçanti nga familjet?

---

## **2 Personat në mbajtje kanë të drejtë në vizita nga familjarët dhe të tjerët**

Burimet: [BPP](#) 19; [UNHCR-UN](#) 8 (vij); [RREB](#) 24.1; 99; [DPBE](#) 10.4; [PPMMPLKA](#)

XVIII

**Këshilla për monitoruesit:**



- A janë njoftuar personat në mbajtjet të drejtën e tyre që të pranojnë vizita? A u janë dhënë informatat në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë?
- Kur dhe me çfarë shpeshtësie mund të zhvillohen vizitat?
- Sa zgjasin vizitat e tilla?
- Nga kush (përveç familjarëve të afërt) mund të pranojnë vizita personat në mbajtje?
- A janë refuzuar/parandaluar ndonjëherë vizitat?

### 3 Për pranimin e vizitorëve janë siguruar hapësira të mjaftueshme, dhe vizitimi i personave në mbajtje inkurajohet aktivisht nga personeli dhe menaxhmenti

Burimet: [RRSM](#) 92; [RREB](#) 24.4

Këshilla për monitoruesit:

- Si janë kushtet e hapësirave të vizitave (vizita të hapura ose të mbyllura)?
- Sa salla (nëse ka të tilla) janë në dispozicion për vizita?
- A respektohet privatësia dhe konfidencialiteti i vizitave?

### 4 Vizitat bashkëshortore nga bashkëshorti/ja ose partneri/ja lejohen dhe inkurajohen

Burimet: [PNDCP](#) 10(1), 17, 23; [PPMPPPLKA](#) I

Këshilla për monitoruesit:

- A mundësojnë hapësirat e dedikuara për vizita vizitat bashkëshortore?
- A ka ndonjë dëshmi të diskriminimit ndaj çifteve të pamartuara dhe/ose çifteve LGBTI?

### 5 Komunikimi me familjen dhe miqtë në shtetin e ndalimit dhe në shtetet e origjinës lehtësohet

Burimet: [PNDCP](#) 17; [UNHCR-UN](#) 8 (vii); [RPJDL](#) 60, 61; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §87; [RREB](#) 24.5

Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë sistemi ekziston?

- A mund të komunikojnë lirshëm me botën e jashtme personat në mbajtje? Në ç'mënyrë? Me çfarë shpeshësie?
  - A ka ndonjë politikë ose protokoll që përcakton kriteret e komunikimit me botën e jashtme?
  - A kanë personat në mbajtjeqasje në email dhe internet?
- 

## **6 Personat në mbajtje kanë qasje të lehtë tek UNHCR-i, KNKK dhe/ose Kryqi i Kuq ose organizatat tjera dhe, me iniciativë të tyre, te zyrtarët konsullor ose misionet diplomatike**

**Burimet:** [KPM](#) 16(7); [UNHCR-UN](#) 8 (vii); [GPNA-D5](#) f.2, 10; [DPBE](#) 10.3; [KPT/Inf](#) (97) 10 §31; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §83, 87; [RREB](#) 37

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A vizitohen personat në mbajtje nga zyrtarët e UNHCR-it?
  - A vizitohen personat në mbajtje nga personeli i KNKK-së dhe/ose Kryqit/Gjysmëhënës së Kuqe?
  - A mbrohen personat në mbajtje nga përpjekjet e padëshiruara të zyrtarëve konsullorë për t'i kontaktuar ata?
  - A mbështeten personat në mbajtje në kontaktimin e ndonjë misioni konsullor nëse këta të fundit nuk i përgjigjen kërkesës së tyre?
- 

## **7 Personat në mbajtje kanë qasje të lehtë në telefon (për të bërë telefonata me një çmim të arsyeshëm dhe privatisht) dhe për të pranuar thirrje telefonike të pamonitoruara dhe të pacensuruara në çdo kohë**

**Burimet:** [BPP](#) 18(3), 19; [UNHCR-UN](#) 8 (vii); [RPJDL](#) 61; [PMMPLKA](#) XVIII; [KPT/Inf](#) (97) 10 §31

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A mund të bëjnë personat në mbajtje thirrje telefonike private? Sa shpesh (shpeshësia, kohëzgjatja, numri i telefonave në gjendje të mirë pune, respektimi i dallimit të zonave kohore)?
- Cili është sistemi i pagesës?

## 8 Personat në mbajtjekanë qasje të përditshme dhe të pacensuruar në gazeta, televizion dhe/ose radio

Burimet: [RRSM](#) 39, 90; [RPJDL](#) 62; [PPMMPPLKA](#) XVIII; [KPT/Inf](#) (97) 10 §29; [RREB](#) 24.10; 24.12; 99 (c)

### Këshilla për monitoruesit:

- A u vihen në dispozicion personave në mbajtjegazeta/revista? Në gjuhë të cilat ata i kuptojnë? A janë pa pagesë?
- A ka TV dhe/ose radio? Nëse po, në çfarë gjuhe?

## 9 Personat në mbajtjemund të dërgojnë dhe të pranojnë postë nga/tek familja dhe miqtë, me shpenzime publike pot ë jetë e nevojshme

Burimet: [BPP](#) 19

### Këshilla për monitoruesit:

- Cilët janë hapat për dërgimin e një letre?
- Si mund t'i sigurojnë materialet e nevojshme (letër, zarfe, pulla postare) personat e ndaluar?
- A janë pullat postare pa pagesë?
- A monitorohen, censurohen ose kufizohen në mënyrë tjetër letrat dhe paketot? Nëse po, me çfarë baze?

---

## 4.5.2 Arsimimi dhe zhvillimi i shkathtësive

Arsimimi, përfshirë aftësimin dhe arsimin profesional, është një element i rëndësishëm në përgatitjen e të imigrantëve në mbajtje për riintegrimin në shoqëri, kudo që të ndodhë kjo, dhe për të stimuluar zhvillimin e tyre personal. Gjithashtu, arsimimi mund të plotësojë nevojat e veçanta të popullatës së personave në mbajtje, të tilla si mësimi i shkrim-leximit, ose mësimi i gjuhës vendore ose *lingua franca*.

Nëse në vendet e mbajtjes të imigrantëve mbahen fëmijë, ata kanë të drejtë në të paktën arsimin fillor pa marrë parasysh statusin e tyre apo kohëzgjatjen e qëndrimit në ndalim. Është e parapëlqyeshme që fëmijët t'i vijojnë mësimet jashtë vendit të ndalimit, në shkollat lokale.

Pasiguria e kohëzgjatjes së mbajtjes të imigrantëve dhe e së ardhmes së tyre nuk duhet t'ua ndalojë ose pengojë që t'i hyjnë një gjëje të tillë, meqë personat në mbajtje mund ta mbarojnë arsimimin pas lirit dhe sido që të jetë arsimimi ka një vlerë të qenësishme si aktivitet kuptimplotë dhe stimulues.

---

### 1 Shkollimi ofrohet në përputhje me nevojat e identifikuar, duke përfshirë për shembull mësimin e shkrim-leximit për personat në mbajtje analfabetë

**Burimet:** [RRSM](#) 77(1); [UNHCR-UN](#) 8 (xiii); [PPMMPPLKA](#) XIII; [RREB](#) 28; [DPBE](#) 14

#### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë lloj shkollimi ofrohet? Në cilat gjuhë?
- A u mësohet gjuha vendore ose *lingua franca* të gjithë personave të ndaluar?
- A mund të marrin pjesë në aktivitete edukative gjithë personat e ndaluar që shprehin dëshirë për këtë?
- A ofrohet qasja në arsim në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese?
- A përshtatën orët e mësimin në varësi të nevojave individuale?
- A është shkrim-leximi aspekt që verifikohet me rastin e arritjes së personave në vendin e ndalimit? Nëse po, si bëhet kjo? Kush e bën testimin? Cili është procesi?

- Kush i mban orët e shkrim-leximit?
- A ndahen fonde të veçanta për shkollim?
- A kompensohet shkollimi ose aftësimi profesional?

## 2 Mundësitë për shkollim përfshijnë aftësim profesional të dizajnuar për ruajtjen ose përmirësimin e shkathtësive dhe pjesëmarrjes së fuqisë punëtore

Burimet: [KDF 28\(1\)\(b\)](#); [KPM 17\(7\)](#); [AT P 6\(3\)\(d\)](#); [RPJDL 42-44](#); [BR](#) ; [ACHR AP 13\(3\)\(b\)](#); [PPMMPPLKA XIII](#); [DPBE 12](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë personat në mbajtjeqasje në aftësim profesional? A angazhohen mësimdhënës ose trajnues të jashtëm për mbajtjen e mësimëve ose aftësimit?
- A përmendet status i imigrimit të personit në diplomat ose certifikatat arsimore që u jepen personave të ndaluar?

## 3 Fëmijët e moshës shkollore kanë qasje në shkollim, mundësisht nëpër shkolla lokale, pavarësisht nga kohëzgjatja e ndalimit të tyre

Burimet: [KDF 28\(1\)\(a\)](#); [UNHCR-UN \(xiii\)](#); [KPM 17\(7\)](#), 30, 43, 45; [RPJDL](#) , 38, 59, 79; [ACHR AP 13](#); [KADNJP 17](#); [RREB 28.3](#); [DPBE 14](#); [PPMMPPLKA XIII](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë nivelesh të shkollimit ofrohen? A mbahen orët e mësimi në gjuhë të ndryshme?
- Kush ofron shkollimin?
- Cili është raporti mësimdhënës/nxënës?
- Ku mbahen aktivitetet edukative? Brenda objektit? Jashtë? Përshtatshmëria e objekteve?

## 4 Fëmijët dhe të rinjtë e moshës madhore mbi moshën e shkollimit të detyrueshëm të cilët nuk e kanë mbaruar shkollën lejohen dhe inkurajohen që ta vazhdojnë shkollimin

---

Burimet: [RPJDL](#) 39; [RRSM](#) 77(1); [ACHR AP](#) 13(3)(d); [KADNJP](#) 7; [PPMMPPLKA](#) XIII

#### **Këshilla për monitoruesit:**

- A përfitojnë të rinjtë e moshës madhore të cilët mbahen në dalim nga programet e shkollimit?
- Çfarë lloj shkollimi ofrohet për ta?

### **4.5.3 Puna dhe aktivitetet që paguhen**

Duke pasur parasysh se të imigrantët në mbajtjenuk janë duke vuajtur dënim, atyre nuk mund t'u kërkohet që të punojnë dhe, për më tepër, disa persona në mbajtjemund të jenë të paaftë për punë edhe në qoftë se duan të punojnë. Megjithatë, duhet të bëhen përpjekje për të siguruar mundësi punësimi. Kur është e mundur, imigrantët e mbajtur duhet të ketë mundësi për të gjetur punë në komunitetin lokal.

---

#### **1 Personat e ndaluar mund të punojnë në vendin e ndalimit**

Burimet: [AT P](#) 6(3)(d); [RRSM](#) 89; [RPJDL](#) 45; [BPTP](#) 8; [BR](#) 60; [KPM](#) 17(7); [PPMMPPLKA](#) XIV; [RREB](#) 26

#### **Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë lloj punësh janë në dispozicion?
- A paguhet puna?
- Kush është përgjegjës për ndarjen e punëve? A është procesi i drejtë dhe i barabartë?
- A ka mundësi për të gjetur punë në komunitetin lokal?

---

#### **2 Puna nuk është e detyrueshme**

Burimet: [ILO-C29](#); [ILO-C105](#); [RRSM](#) 89; [PPMMPPLKA](#) XIV

#### **Këshilla për monitoruesit:**

- A punohet në baza vullnetare?
- Cilat janë kushtet e punës dhe si krahasohen ato me kushtet e punës në botën e jashtme?
- A mbrohen të drejtat e atyre të cilët punojnë brenda ose jashtë vendit të ndalimit?

- A u jepet personave në mbajtjetë cilët nuk dëshirojnë të punojnë ose janë të paaftë për punë ndihmë financiare në para të gatshme e mjaftueshme për t'i plotësuar nevojat esenciale?
- A ka ndonjë dëshmi të punës së detyrueshme dhe/ose të fëmijëve?

### 3 Mundësitë për punë janë të sigurt, të mira dhe joeksploatuese

Burimet: [RRSM](#) 72, 76; [PPMMPPLKA](#) XIV

#### Këshilla për monitoruesit:

- A ka ndriçim natyror, qarkullim të ajrit dhe ndriçim artificial të mjaftueshëm nëpër vendet e punës?
- A është adekuat kompensimi?
- Sa ditë pushimi në javë u jepen personave në mbajtje?

#### 4.5.4 Ushtrimet në ajër të pastër, aktivitetet rekreative dhe kulturore

Duke pasur parasysh statusin jopenal të imigrantëve në mbajtje, ata nuk duhet të duhet të qëndrojnë në dhomën e tyre gjatë tërë ditës por duhet të jenë në gjendje të lëvizin lirisht brenda objektit.

Rëndësia që kanë ushtrimet në ajër të pastër për mirëqenien mendore dhe fizike është e njohur gjerësisht. Ashtu si të gjithë të tjerët të cilët janë privuar nga liria, imigrantët në mbajtjeduhet të kenë qasje në aktivitete dhe mjedise të përshtatshme për stërvitje në ajër të pastër në përputhje me rrethanat. Hapësirat për këtë qëllim duhet të jenë të mëdha dhe mundësisht me pamje të natyrës dhe bimësisë. Kjo do të thotë që, për shembull, një oborr i vogël i rrethuar me mure nuk ofron mundësi të mjaftueshme për ushtrimin në ajër të hapur.

Përveç dobive të përgjithshme shëndetësore, stërvitjet dhe aktivitetet në ajër të pastër mund të kenë dobi të shtuar të uljes së tensioneve dhe nxitjes së marrëdhënieve të mira mes personave në mbajtje. Aktivitete të tilla kanë vërtetë kapacitet që të nxisin vetëbesimin tek të gjithë. Çdokush ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë dhe për të marrë pjesë në jetën kulturore. Imigrantët në mbajtjenuk përbëjnë

---

përrjashtim. Aktivitetet e tilla janë të rëndësishme për zhvillimin personal, shëndetin fizik dhe mendor, si dhe gjithpërfshirjen sociale dhe kulturore. Gjithashtu, ato janë mënyrë e mirë e thyerjes së barrierave. Shkalla e inkurajimit institucional të pjesëmarrjes në aktivitete të strukturuar dhe të pastrukturuar rekreative, të kohës së lirë dhe kulturore është një tregues i fuqishëm i asaj nëse mjedisi i ndalimit në mënyrë aktive mëton të minimizojë efektet negative të privimit të lirisë.

---

## **1 Imigrantët në mbajtje mund të lëvizin lirisht nëpër objekt dhe kanë të paktën një orë në ditë për ushtrime të përshtatshme në ajër të hapur**

Burimet: [RRSM](#) 21(1); [RPJDL](#) 47; [UNHCR-UN](#) 8(viii); [KPT/Inf](#) (97) 10 §29; [RREB](#) 25, 27; [DPBE](#) 10.2

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Nëse koha që kalohet jashtë dhomës është e kufizuar, çfarë arsyes japin personeli për kufizime të tilla?
- Sa orë në ditë mund të qëndrojnë jashtë personat në mbajtje?
- Çfarë aktivitesh ose ushtrimesh janë të dispozicionit?
- A kanë apo a u sigurohen veshmbathje për ushtrime në ajër të hapur që janë të përshtatshme për kushtet klimatike?

---

## **2 Fëmijët dhe të rinjtë e moshës madhore në ndalim mund të marrin pjesë në aktivitete fizike dhe rekreative që janë të përshtatshme për nevojat e tyre zhvillimore dhe fizike**

Burimet: [RRSM](#) 21(2); [RPJDL](#) 47

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë aktivitesh rekreative janë në dispozicion?
- Çfarë aktivitesh të organizuara u ofrohen personave në mbajtje (sportive, kulturore)?
- A kanë të drejtë në kohë shtesë për përdorimin e hapësirave?

---

## **3 Personat e ndaluar kanë qasje në hapësira të mëdha, të sigurta, të pastra dhe të mirëmbajtura për ushtrime**



---

Burimet: [PPMMPPLKA XIII](#); [UNHCR-UN](#) 8(viii)

**Këshilla për monitoruesit:**

- A kanë personat në mbajtjeqasje në hapësira të dedikuara për ushtrime?
- Çfarë hapësira ofrohen?
- Çfarë madhësie ka hapësira e dedikuar për ushtrime?
- A janë hapësirat në ajër të hapur të përshtatshme për sport, ushtrime fizike dhe aktivitete të kohës së lirë?
- A ka alternativa të përshtatshme për ushtrime brenda objektit?

---

**4 Personat në mbajtje kanë qasje në sasi të arsyeshme të materialit kulturor dhe informativ**

Burimet: [BPP](#) 28; [RRSM](#) 78, 90; [PPMMPPLKA XIII](#); [UNHCR-UN](#) 8(xii); [RREB](#) 27.6

**Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë lloj aktiviteteesh kulturore janë në dispozicion?
- A ka qasje në televizor? Nëse po, në c' vend dhe në cilat gjuhë?

---

**5 Gjithë personat në mbajtje kanë qasje në një bibliotekë të furnizuar në mënyrë adekuate**

Burimet: [RRSM](#) 40; [RPJDL](#) 41; [PPMMPPLKA XIII](#)

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ka kushte për qasjen në bibliotekë?
- Çfarë lloj materialesh (libra rekreative dhe udhëzues, gazeta, fjalorë, material për referencë juridike dhe video/DVD në gjuhë të huaja) janë në dispozicion?
- A janë materialet në dispozicion në gjuhët të cilat i flasin personat në mbajtje?

---

## **6 Gjithë personat në mbajtje, në veçanti fëmijët dhe të rinjtë e moshës madhore, kanë mundësi adekuate për t'i zhvilluar interesat dhe shkathtësitë e tyre, përfshirë në fushën e artit dhe atë artizanale**

Burimet: [RPJDL](#) 47

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë mundësi kanë personat në mbajtje për t'u marrë me art dhe artizanate? Po për muzikë?

### **4.5.5 Besimi fetar**

Në kontekstin e ndalimit të imigrantëve, është vendimtare që përkatësia fetare ose besimet fetare të çdo lloji të respektohen dhe të mbrohen, madje edhe ushtrohen nga pakicat fetare të cilat mund të jenë në armiqësi me ndonjë komunitet dominant fetar brenda ose jashtë vendit të mbajtjes.

Sipas nenit 18 të PNDCP, “secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë”. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit. Këto liri janë aq thelbësore sa që nuk mund të mohohen, madje edhe në kohë emergjencash publike.

Si e tillë, liria e adhurimit shtrihet në rite dhe akte ceremoniale që i japin shprehje të drejtpërdrejtë besimit, si dhe praktika të ndryshme përbërëse të akteve të tilla. Në kontekstin e mbajtjes të imigrantëve, kjo mund të përfshijë si shembull krijimi i një vendi për lutje, përdorimin e formulave dhe objekteve rituale, shfaqjen e simboleve, si dhe respektimin e festave dhe ditëve të pushimit.

Feja ose besimi shpesh përcaktojnë dietën, veshjen dhe ritualet e lidhura me faza ose pikëarritje të caktuara në jetë. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit “mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve” (PNDCP, neni 18 (3)). Në lidhje me këtë, si pikënisje duhet të shërbejë nevoja për mbrojtjen e të gjitha të drejtave të gjithë personave në mbajtjetë garantuara me Paktin.

### 1 E drejta e çdo personi në mbajtje për ta ushtruar fenë e vet në plotni, qoftë individualisht ose së bashku me të tjerët, respektohet

**Burimet:** [PNDP](#) 18; [KPM](#) 12; [KSR](#) 4; [CSSP](#) 4; [ACHR](#) 12; [UNHCR-UN](#) 8(ix); [PPMPPPLKA](#) XV; [RREB](#) 29

#### Këshilla për monitoruesit:

- A plotësohen nevojat fetare të imigrantëve në mbajtje?
- Çfarë përkatësisht fetare janë të përfaqësuara në vendin e mbajtjes (numri i feve, numri i besimtarëve)? A respektohen besimet dhe praktikat e pakicave fetare?
- A respektohen kohët e lutjeve?
- A ka kufizime ose kushtëzime të qasjes në adhurimin fetar dhe kujdes pastoral?

### 2 Mbështetja dhe kujdesi privat pastoral është në dispozicion me kërkesë të personit në mbajtje, rregullisht dhe në kohë të nevojës, përfshirë në kuadër të përgatitjes për lirim, largim ose transfer

**Burimet:** [RRSM](#) 41(3)

#### Këshilla për monitoruesit:

- Në çfarë shkalle janë në dispozicion kujdesi dhe mbështetja pastorale?
- Cilat janë kriteret për emërimin e përfaqësuesve fetarë (kush i emëron, kush i paguan)?

- 
- Sa është shpeshtësia dhe niveli i pjesëmarrjes në shërbesa fetare?

### 3 Të gjithë personat e ndaluar mund të marrin pjesë në shërbesa fetare

Burimet: [RRSM](#) 42; [PPMMPPLKA](#) XV

#### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë lloje të shërbesave fetare janë në dispozicion?
- Ku mbahen shërbesat fetare? Me çfarë shpeshtësie?
- A mund t'i festojnë festivalet e tyre kryesore kulturore dhe fetare personat në mbajtje?

---

### 4 Personat në mbajtje mund të sigurojnë, mbajnë dhe përdorin gjësende me domethënie fetare, përfshirë libra për parimet fetare dhe të mësimbesimit

Burimet: [PNDCP](#) 18; [KPM](#) 17(7); [KSR](#) 4; [CSSP](#) 4; [RRSM](#) 42; [RPJDL](#) 48; [ACHR](#) 12; [KDTHBE](#) 10; [KEDNJ](#) 9; [PPMMPPLKA](#) XV

#### Këshilla për monitoruesit:

- A ka dëshmi të dëmtimit ose konfiskimit të gjësendeve me domethënie fetare?
- A janë bërë ankesa në këtë drejtim? Cili ka qenë rezultati i tyre?

---

### 5 Personat në mbajtjetë cilët nuk i përmbahen asnjë besimi fetar dhe nuk dëshirojnë të praktikojnë ndonjë fe nuk janë të detyruar ta bëjnë këtë dhe nuk diskriminohen

Burimet: [PNDCP](#) 18; [ACHR](#) 12; [KDTHBE](#) 10; [KEDNJ](#) 9

#### Këshilla për monitoruesit:

- A ka dëshmi të diskriminimit ndaj personave të tillë? Nga ana e autoriteteve? Nga ana e personave tjerë të ndaluar?
- A janë marra masa mbrojtëse në këtë drejtim?

---

#### 4.5.6 Mirëqenia dhe këshillimi

Imigrantët në mbajtëkanë nevojë të vazhdueshme për ndihmë dhe këshillim<sup>70</sup>, gjë që mund të jetë vendimtare për sigurimin e një tranzicioni sa më të lehtë që të jetë e mundur në mjedisin në mbajtëdhe me rastin e lirit nga ai. Gjithë imigrantët në mbajtëdhet të përfitojnë nga mbështetja përmes ndihmës dhe këshillimit gjatë ndalimit dhe sidomos në mbarimin e tij, veçanërisht në qoftë se rezultatet e procedurës së mbrojtjes ose imigrimit nuk dihen me siguri. Mbështetja përmes ndihmës dhe këshillimit mund të jetë e formës sekulare ose të përfshijnë mbështetjen e punonjësve të kujdesit pastoral, dhe do të jetë shpeshherë e dobishme për t'ju ndihmuar personave në mbajtje që të pajtohen me rezultatet e rasteve të tyre.

Është e rëndësishme që të sigurohet se punonjësit mbështetës për mirëqenie, këshilltarët dhe punonjësit e kujdesit pastoral të mos komprometohen profesionalisht ose të implikohen në ndonjë mënyrë tjetër në rezultatin apo pasojat e procedurave, dhe që roli i tyre të mos shihet si një zëvendësim i këshillave ose ndihmës së përshtatshme juridike.

---

#### **1 Shërbimet e ndihmës dhe këshillimit për mirëqenien ofrohen për t'ju ndihmuar personave në mbajtjenë lidhje me problemet praktike të shkaktuara nga ndalimi si imigrantë dhe për t'ju ndihmuar personave në mbajtje që të përkatiten (përfshirë dhe psiçikisht) për lirin, transferin ose largimin**

**Burimet:** [AT.P](#) 6(3)(b); [BR](#) 60; [UNHCR-UN](#) 8 (vi)

#### **Këshilla për monitoruesit:**

- A ka në dispozicion shërbime të mirëqenies, punëve sociale dhe këshillimit? A ka punëtorë social të pranishëm në objekt? Çfarë roli kanë ata? A mund të bëjnë vlerësime psikologjike?
- A janë në dispozicion këshillues të kualifikuar dhe të njoftuar me aspektet kulturore?

- 
- A respektojnë shërbimet e mirëqenies dhe këshillimi të drejtën e personit të ndaluar për privatësi dhe konfidencialitet?
  - A u ndihmojnë ata personave në mbajtje për kontaktimin e këshilltarëve të vet ligjorë?
  - A u ndihmojnë ata personave në mbajtjen e komunikimit me familjen, miqtë dhe grupet mbështetëse?
- 

## **2 Nëse një gjë e tillë kërkohet, personat në mbajtjeshoqërohen nga punonjësit e shërbimeve të mirëqenies dhe këshillimit në kohën e lirit, transferit ose largimit**

**Burimet:** [ÇoE-TGFR](#) 15.2; [RRSM](#) 60(2); [RPJDL](#) 79; [BR](#) 46; [BPTP](#) 10

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A u jepen personave në mbajtjetë cilët lirohen, transferohen ose largohen informatat e kontaktit të profesionistëve për mirëqenie dhe këshillimit në vendin pritës?
- A shoqërohen personat në mbajtjetë lirit, transferit ose largimit?

## **4.6 KUJDESI SHËNDETËSOR**

Shëndeti fizik dhe mendor i imigrantëve në mbajtje është i një rëndësie të veçantë për disa arsye. Në radhë të parë, heqja e lirisë ua mohan mundësinë për t'u kujdesur vet për shëndetin e tyre. Në radhë të dytë, ata mund të kenë nevoja shëndetësore fizike dhe mendore të veçanta që rrjedhin nga keqtrajtimi në të shkuarën, si dhe cenueshmëri si nga e kaluara ashtu edhe në të tashmen. Në radhë të tretë, ka gjasa të mëdha që ndalimi në mbajtje mbajtja në ndalim si imigrantë të ketë ndikim të dëmshëm mbi shëndetin fizik dhe mendor të personave në mbajtje. Përgjegjësia për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e së drejtës për shëndet të imigrantëve në mbajtje gjëthen domosdoshmërisht kujdesin dhe trajtimin e gjendjeve shëndetësore ekzistuese dhe duhet të jetë e cilësisë dhe standardi të njëjlojtë me kujdesin që u ofrohet gjithë të tjerëve të cilët jetojnë në komunitet.

Fëmijët, përfshirë fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë, kanë të drejtë për ekzaminime periodike, jo vetëm përkujdes mjekësor reagues.

Sjellja e profesionistëve mjekësor në një mjedis të mbajtjes është thelbësore për ndjenjën e sigurisë dhe respektit tek personat në mbajtje. Në lidhje me këtë, një nga aspektet më të rëndësishme të sjelljes etike të profesionistëve mjekësorë është respektimi i parimeve të pëlqimit të pacientit dhe konfidencialitetit. Këto çështje që duhet të jenë me interes të veçantë për ekipin e monitorimit.

### 4.6.1 Qasja në kujdes mjekësor

Personat në mbajtje duhet të kenë qasje në kujdes mjekësor falas të njëjlojtë për nga cilësia me atë që ofrohet në botën e jashtme. Kujdesi mjekësor është i një rëndësie të veçantë ngaqë heqja e lirisë në vetvete mund të shtojë nevojën e një individi për kujdes mjekësor.

Në kohën e arrestimit fillestar dhe ndalimit, të gjithë imigrantët e ndaluar duhet të kontrollohen nga një mjek me kualifikime të duhura, në mënyrë që të zbulohen sëmundjet ose gjendja shëndetësore ekzistuese, si dhe lëndimet që mund të jenë pësuar gjatë arrestimit ose ndalimit. Procedura e ekzaminimit është po ashtu e rëndësishme për identifikimin e sëmundjeve ngjitëse ose të transmetueshme. Më pas , kujdesi mjekësor duhet të jetë në dispozicion, i qasshëm, i pranueshëm (d.m.th. etik dhe i përshtatshëm nga ana kulturore), i përshtatshëm nga ana shkencore dhe mjekësore, dhe i cilësisë së mirë. Kjo do të thotë se qasja në kujdesin mjekësor dhe informatat e nevojshme për të përfutur nga ai duhet të jepen pa diskriminim të çfarëdo lloji, duhet të jenë fizikisht të qasshëm, dhe duhet të jetë falas.

#### **1 Ekzaminimi mjekësor me rastin e pranimit bëhet nga një doktor me kualifikimet e duhura (ose nga një motër medicinale me kualifikim të plotë e cila i raporton mjekut privatisht dhe sa më shpejt që të jetë e mundshme pas pranimit)**

Burimet: [KDF](#) 24; [BPP](#) 24-25; [RRSM](#) 24; [UNHCR-UN](#) 8 (vi); [PPMMPLKA](#) IX(3); [KPT/Inf](#) (97) 10 §30, 31; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §82; [RREB](#) 42.1

---

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A kanë personat në mbajtjeqasje në mjek që nga fillimi i ndalimit të tyre?
- Cila është procedura për ekzaminimin mjekësor me rastin e arritjes?
- A përfshin ekzaminimi mjekësor kontrole për sëmundje të transmetueshme, përfshirë tuberkulozin?
- A janë në dispozicion përkthyes pa pagesë, të kualifikuar dhe të paanshëm?
- Si transmetohet dosja mjekësore në rast të transferit?

---

## **2 Gjithë personat në mbajtje kanë qasje të plotë dhe të barabartë në shërbime shëndetësore falas**

**Burimet:** [KDF](#) 24; [BPP](#) 24; [RRSM](#) 25; [RPJDL](#) 50; [BR](#) 6, 9; [ACHR AP](#) 10; [UNHCR-UN](#) (vi); [PPMMPPLKA](#) X; [RREB](#) ; [DPBE](#) ; [KADNJP](#) ; [KPT/Inf](#) (97) 10 §31; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §87

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Cila është procedura për të fituar qasje në shërbime shëndetësore?
- Sa kohë personat në mbajtje duhet të presin për konsulta mjekësore?
- A përfshihen këtu nevojat specifike shëndetësore të grave shërbime gjinekologjike, kujdes për shëndetin riprodhues)?
- A ka dëshmi të diskriminimit në qasjen në shërbime mjekësore?
- A plotësohen nevojat lidhur me diagnozat e mëhershme ose regjimet e kujdesit shëndetësor sikurse recetat e barnave (p.sh. antidepressivë, protokollat për HIV)?
- A është e mundur të merret mendim i dytë mjekësor ose stomatologjik?
- A janë në dispozicion shërbimet e përkthimit pa pagesë, të kualifikuara dhe të paanshme për konsulta mjekësore?
- Çfarë sistemi ekziston për raste të urgjencave mjekësore?

---

## **3 Shërbimet mjekësore ofrohen në kushte që respektojnë dhe ruajnë mirësjelljen, privatësinë dhe dinjitetin, dhe mundësisht përmes shërbimeve në komunitet**



---

Burimet: [ICESCR](#) ; [RPJDL](#) ; [ACHR AP](#) ; [KADNJP](#) ; [PPMMPPLKA X](#); [RREB](#) ; 42; [DPBE](#) 19; [UNHCR-UN](#) 8 (vi)

**Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë kushte kanë objektet shëndetësore?
- A dalin personat në mbajtje jashtë vendit të ndaluar për konsulta mjekësore?
- A përmendet statusi i ndalimit gjatë vazhdës së konsultës mjekësore?

---

**4 Ndalimi dhe veçimi për shkaqe të shëndetit publik rregullohet me politikat dhe legjislacionin për futjen në karantinë dhe kontrollin e sëmundjeve**

Burimet: [RRSM](#) 24; [RREB](#) 42.3(f)(g)

**Këshilla për monitoruesit:**

- Cila është procedura për vendosjen e një personi në mbajtjeveçan nga të tjerët për shkaqe shëndetësore? (Kush e merr vendimin? Si rishikohet ai?)
- Sa persona në mbajtje kanë qenë duke u mbajtur ndaras të tjerëve për shkaqe të shëndetit publik gjatë kohës së vizitës?
- A ka ndonjë mbikëqyrje shëndetësore?
- A është i pajisur akomodimi i veçantë me pajisjet e nevojshme për trajtim mjekësor?

---

**5 Ekzaminimet mjekësore bëhen privatisht, në konfidencë dhe në mënyrë të respektueshme, profesionale dhe të kujdesshme, duke treguar ndjeshmëri nga llojllojshmërisë së nevojave dhe cenueshmërive**

Burimet: [KDPAK](#) 22(2); [PPMMPPLKA X](#); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §92

**Këshilla për monitoruesit:**

- A kryhen ekzaminimet mjekësore privatisht dhe a respektohet konfidencialiteti?
- A kryhen ekzaminimet mjekësore nga mjeku i së njëjtës gjini, nëse kërkohet një gjë e tillë?

- 
- A janë në dispozicion përkthyesit?
  - A është i pranishëm ndonjë autoritet ndalues gjatë ekzaminimit mjekësor?
  - A mbahen dosjet mjekësore të personave në mbajtjetë mbyllura në dry dhe të paqasshëm për personelin joshëndetësor?
- 

## **6 Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat në mbajtjenur rezikohet apo ndalohet pa arsye për shkak të masave ose procedurave të sigurisë**

Burimet: [UNHCR-UN](#) 8; [CoE-TGFR](#) 16

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A mund të kenë qasje në ekzaminim shëndetësor personat në mbajtjetë cilët mbahen në izolim nëse e kërkojnë?
  - A ndikojnë transferet e personave në mbajtjenga një vend ndalimi në tjetrin në qasjen në kujdes shëndetësor?
- 

## **7 Barnat janë lehtësisht të qasshme sipas recetës apo kërkesës, ruhen në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt, dhe hidhen pas kalimit të afatit të përdorimit**

Burimet: [CoE-TGFR](#) 9.4; [RRSM](#) 22(2); [RPJDL](#) 55; [PPMMPLKA](#) X

### **Këshilla për monitoruesit:**

- Cilat lloje të barnave përshkruhen më së shpeshti me recetë? Për çfarë arsye? A ka shenja të mbidozave?
  - Kush i shpërndan barnat?
  - A ka pasur raste të mungesës së barnave?
  - Kush menaxhon me stokun e barnave?
- 

## **8 Ekziston protokollin, në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare, për menaxhimin dhe trajtimin klinik të personave në mbajtjetë cilët refuzojnë ushqimin dhe/ose lëngjet dhe për rikuperim e kujdes psikologjik të atyre që kanë qenë në grevë urie**

Burimet: [PME](#) 1; [DOM](#); [DOT](#)

---

### Këshilla për monitoruesit:

- A ekziston një protokoll i veçantë për grevat e urisë? Nëse po, a është në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare?
- A respektohen zgjedhjet e informuara të personave në mbajtje bashkë me dinjitetin njerëzor të tyre dhe a është i ndaluar të ushqyerit me forcë (me kushtin që personat në mbajtje janë “në dijeni të plotë të pasojave të mundshme të agjërimit në shëndetin dhe jetën”)?
- A respektohen masat mbrojtëse klinike, përfshirë vërtetimin e kapacitetit të personit në mbajtje për t’i kuptuar pasojat e refuzimit të vullnetshëm të ushqimit nga ana e të paktën një mjeku tjetër të pavarur?
- A kanë personeli mjekësor pavarësi të plotë klinike për të vendosur lidhur me kujdesin ndaj personit i cili ndodhet në grevë urie?

---

### 9 Cenueshmëritë sociale, fizike dhe mjekësore të personave në mbajtje rishqyrtohen rregullisht

Burimet: [BR 6](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A ka në dispozicion kushte dhe kujdes të posaçëm për në mbajtje moshuar?
- A ka kufi moshor mbi të cilin lirohen personat në mbajtje?

## 4.6.2 Personeli mjekësor

Personeli mjekësor luan role të shumta në kontekstin e ndalimit të imigrantëve. Në radhë të parë, ata e vlerësojnë gjendjen shëndetësore të personave të ndaluar në mbajtje dhe sigurojnë çfarëdolloj trajtimi dhe kujdesi mjekësor për të cilin ata mund të kenë nevojë, duke përfshirë në rast se ata pësojnë keqtrajtim të një lloji ose tjetër. Në radhë të dytë, ata kanë rol këshillëdhënës sa i përket menaxhimit të vendit të mbajtjes dhe përshtatshmërisë së kushteve, duke përfshirë ushqimin, kushtet hidrosanitare dhe higjienike, strehimin dhe ushtrimet. Në fund, ata mund të kenë një rol në vlerësimet mjekësore të personave të cilët mund të kenë vuajtur nga keqtrajtimi në të kaluarën dhe mund të japin mbështetje për kërkesat e tyre për mbrojtje apo imigrim ose për kërkesën e tyre për lirim nga mbajtja. Ndërsa këto role të shumta nuk janë në konflikt me njëra-tjetrën në thelb, ekziston gjithmonë rrezikut që ato të shpërfaqin dilema politike, etike dhe klinike, sfida dhe presione. Kështu, personeli mjekësor që punon në kontekstin e ndalimit të imigrantëve duhet të sigurohet për sa i përket pavarësisë së plotë klinike dhe të mbështetet nga trupat përkatëse profesionale.

### 1 Shërbimi mjekësor përbëhet prej personelit me përgatitjet e duhura për ofrimin e kujdesit shëndetësor adekuat për shëndetin fizik dhe mendor të personave në mbajtje

Burimet: [RRSM](#) 22(1); [PPMMPPLKA](#) X; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §91; [UNHCR-UN](#) 8 (vi); [RREB](#) 41.1

#### Këshilla për monitoruesit:

- Sa mjekë/motra medicinale janë të pranishëm gjatë ditës, natën dhe gjatë fundjavës?
- Sa është raporti mes numrit të mjekëve dhe personave në mbajtje? A është adekuat?
- A ka zyrtari mjekësor përgjegjësi parësore sigurimin e kujdesit shëndetësor adekuat? Cilat janë detyrat kryesore të tij/saj?
- A ka pasur vonesa në ofrimin e trajtimit mjekësor?

- 2 Zytari mjekësor inspekton dhe i raporton rregullisht drejtorit sa i përket përshtatshmërisë së ushqimit, kushteve hidrosanitare, higjienës e pastërtisë, ngrohjes, ndriçimit e ventilimit, përshtatshmërisë së veshmbathjeve dhe çarçafëve e mbulojave, edukatës fizike dhe aktiviteteve sportive**

Burimet: [RRSM](#) 25(2), 26(1); [RPJDL](#) 73; [RREB](#) 43.3; 44

**Këshilla për monitoruesit:**

- A e inspekton zytari mjekësor vendin? Nëse po, sa shpesh?
- 

- 3 Nëse nevoja për ekspertizë mjekësore e tejkalon kapacitetin ekzistues, ekziston sistem efektiv dhe efikas i referimit tek profesionistët tjerë shëndetësorë, duke përfshirë spitalet civile dhe kujdes specialistik të jashtëm sipas nevojës**

Burimet: [RRSM](#) 22(2); [PPMMPPLKA](#) X

**Këshilla për monitoruesit:**

- Çfarë sistemi të referimit ka për të siguruar kujdes shëndetësor në periudha të kërkesave të madhe?
  - Në rastet e referimit në institucione mjekësore të jashtme, a janë në dispozicion përkthyesit?
  - Çfarë procesi ekziston për kujdes mjekësor specialistik, sikurse kujdesi stomatologjik dhe gjinekologjik?
  - A ekziston një listë e profesionistëve mjekësorë të disponueshëm?
- 

- 4 Personeli mjekësor ka përgatitjet dhe përvojën e duhur për identifikimin dhe trajtimin e nevojave të personave në pozitë të cënueshme**

Burimet: [PPMMPPLKA](#) X; [RREB](#) 41.4

**Këshilla për monitoruesit:**

- A kanë kryer personeli shëndetësor trajnime të posaçme për trajtimin e personave në pozitë të cënueshme?

## 5 Ka zyrtar mjekësor kujdestar për trajtime urgjente

Burimet: [PPMMPPLKA X](#); [RREB 41.2](#)

Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë sistemi ekziston në raste urgjencash?
- Çfarë sistemi ekziston për sigurimin e qasjes në dosjet mjekësore në raste të urgjencave, gjersa respektohet konfidencialiteti?

## 6 Personelit mjekësor i garantohet pavarësi e plotë klinike në trajtimin dhe kujdesin ndaj personave të ndaluar

Burimet: [RPJDL 53](#); [PPMMPPLKA IX\(3\), X](#); [DOT 5](#)

Këshilla për monitoruesit:

- Nën ombrellën e cilit autoritet vepron shërbimi shëndetësor? Kujt i raportojnë personeli mjekësor?
- A kanë profesionistët shëndetësorë autonomi në dhënien e vendimeve dhe rekomandimeve mjekësore?
- A ka dëshmi të shkeljes së kodit të konfidencialitetit?

### 4.6.3 Nevojat e veçanta të grave dhe foshnjave

Në kontekstin e ndalimit të imigrantëve, në mbajtje mbahen shpesh një numër jashtëzakonisht i madh i grave dhe fëmijëve, përfshirë gratë shtatzëna dhe gratë me foshnja. Kështu, çështjet shëndetësore të grave dhe kujdesi e trajtimi i grave shtatzëna, grave të cilat kanë fëmijë në gji dhe i foshnjave të tyre janë aspekte shumë të rëndësishme të ndalimit që duhet t'i shqyrtojë ekipi monitorues. Kujdesi specialistik do duhet të bazohet në informata të mira rreth prejardhjes kulturore dhe fetare të grave dhe foshnjave në mbajtje, si dhe çfarëdo torture apo traumash që ata mund të kenë vuajtur, duke përfshirë dhunën seksuale dhe në baza gjinore<sup>71</sup> dhe shfrytëzimit para ose gjatë mbajtjes. Në këtë drejtim, gratë të cilat janë ndodhur në situata konflikti ose të cilat kanë rënë ose kanë vënë veten në duart e trafikantëve ose kontrabandistëve të njerëzve konsiderohen si veçanërisht të rrezikuara. Bashkësitë familjare me kryefamiljare gram und të jenë në pozitë veçanërisht të

---

cenueshme, dhe nga përvoja e mbajtjes personeli mjekësor duhet të jetë po ashtu i vetëdijshëm për rrezikun e dhunës në familje që mund të përkeqësohet.

---

**1 Nëse ndalohen gratë, në vendin e ndalimit është në dispozicion një zyrtar mjekësor i cili ka njohuritë dhe përvojën specialistike për çështjet shëndetësore të grave dhe kujdesin e trajtimit prenatal e postnatal**

Burimet: [CEDAW](#) 12; [RRSM](#) 23(1); [BR](#) 10; [PPMMPPLKA](#) I; [RREB](#) 89; [DPBE](#) 21; [UNHCR-UN](#) 9.3

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ka specialist(ë) në ekipin mjekësor? Sa?
- A ka specialist në kujdes shëndetësor për nënat dhe fëmijët? Sa?
- A ka gjinekologë në dispozicion? Sa?
- A janë shërbimet shëndetësore specifike për gjini të paktën ekuivalente me ato që janë në dispozicion për gratë në komunitet?
- A janë gratë dhe foshnjat e tyre të shëndetshme?

---

**2 Nëse ndalohen gra shtatzëna, për aq sa mund të parashikohet, foshnjat e tyre lindin në spitale jashtë vendit të mbajtjes.**

Burimet: [RRSM](#) 23(1); [RREB](#) 34.3

**Këshilla për monitoruesit:**

- Ku janë kryer lindjet (vendi i mbajtjes, spital)?
- Nëse foshnja lind në mbajtje, a evidentohet ky fakt në certifikatën e lindjes së fëmijës?

---

**3 Nëse ndalohen foshnjat dhe nënat e tyre, në vendin e ndalimit është në dispozicion një zyrtar mjekësor i cili ka njohuri dhe përvojë specialistike në pediatri dhe kujdes shëndetësor për nënat dhe fëmijët**

Burimet: [KDF 24\(2\)\(d\)](#); [PPMMPPLKA X](#)

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ka në dispozicion pediatria?
- Sa pediatria? A është raporti pediatër për fëmijë adekuat?

---

**4 Ekzaminimet dhe kujdesi shëndetësor parandalues është në dispozicion të grave dhe fëmijëve të ndaluar si imigrantëve në nivel të njëjtë me atë që është në dispozicion të grave dhe fëmijëve në komunitetin pritës**

Burimet: [BR 17-18](#); [PPMMPPLKA X](#)

**Këshilla për monitoruesit:**

- Cfarë lloj ekzaminimesh specifike shëndetësore parandaluese janë në dispozicion për gratë në ndalim, përfshin ekzaminimin për GJGJF?
- A ka program të imunizimit?

---

**5 Profesionistët mjekësorë janë të trajnuar posaçërisht për identifikimin e cenueshmërive të grave në mbajtje, duke pasur parasysh përkatësitë e tyre kulturore dhe fetare**

Burimet: [UNHCR-UN 9.3](#); [PPMMPPLKA X](#); [BR 6-18](#)

**Këshilla për monitoruesit:**

- A janë profesionistët mjekësorë të vetëdijesuar për nevojat e grave të cilat janë përballur me dhunë në baza gjinore, përfshirë gratë ose vajzat e trafikuar?



---

#### 4.6.4 Personat me probleme të shëndetit mendor

Përveç grave dhe fëmijëve, nevoja të veçanta shëndetësore kanë po ashtu edhe personat e tjerë në mbajtje, veçanërisht personat të cilët vuajnë nga tortura ose trauma, ose sëmundje/aftësi të kufizuara mendore.

Këtyre personave duhet t'u kushtohet vëmendje në kohën e ekzaminimit fillestar shëndetësor për të siguruar marrjen e masave të menjëhershme (përfshirë edhe alternativa ndaj mbajtjes), por edhe rregullisht përmes procesit të rishqyrtimit të mbajtjes.

Kjo pjesë duhet të lexohet në lidhje me 4.8 Personat në pozitë të cenueshme/rrezik.

---

### 1 Ekzaminimi mjekësor përfshin ekzaminimin e gjendjes shëndetësore mendore të personit në mbajtje dhe është e integruar me vlerësimin e cenueshmërive tjera sociale, fizike dhe mjekësore

**Burimet:** [KDKPAK](#) 25; [BPP](#) 24-26; [RRSM](#) 24; [RPJDL](#) 50; [BR](#) 6(b); [PPMMPPLKA](#) IX(3); [DPBE](#) 22; [KPT/Inf](#) (2009) 27 §90

#### Këshilla për monitoruesit:

- A përfshihet vlerësimi i shëndetit mendor në kuadër të ekzaminimit mjekësor?
- Sa persona në mbajtjesfaqin simptoma të problemeve të shëndetit mendor (mosha, historia, arsytet)?
- A ka pasur raportime mjekësore për efektet negative shëndetësore të vazhdimit të mbajtjes në ndalim në raste individuale?
- A kanë rekomanduar profesionistët shëndetësorë lirin e ndonjë personi në mbajtje për shkaqe të shëndetit mendor (numri, reagimi institucional, përgjigja e organit shqyrtues gjyqësor ose e organit tjetër shqyrtues)?
- Sa është i përhapur përdorimi i alternativave ndaj mbajtjes për shkaqe të shëndetit mendor (në parim, në praktikë, numri, si dhe kushtet e liritit)?

## 2 Personat në mbajtjekanë qasje në trajtim të specializuar të shëndetit mendor nëse është e nevojshme, dhe në institucione të specializuara ose spitale civile, si të jetë më e përshtatshme

Burimet: [RRSM](#) 22(1), (2), 82-83; [RPJDL](#) 53; [PPMMPPLKA](#) III(3); [RREB](#) 47

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë lloj kujdesi i specializuar për shëndetin mendor është në dispozicion në vendin e ndalimit? Po me referim?
- A ka dëshmi të keqpërdorimit të barnave që jepen pa recetë? Si është adresuar kjo?
- Sa e përhapur është përdorimi i antidepressivëve, sedativëve, tabletave për gjumë dhe barnave psikotropike? Sa shpesh rishqyrtohen recetat e përshkruara?

---

## 3 Ekzaminimi shëndetësor fillestar i personave në mbajtje është përshtatur duke mbajtur parasysh mundësinë që një person në mbajtje mund të ketë qenë viktimë e torturës ose traumës

Burimet: [RRSM](#) 24; [BR](#) 6(e); [PPMMPPLKA](#) IX(3); [KPT/Inf](#) (2009) 27 §90

### Këshilla për monitoruesit:

- A trajnohen personeli për hetimin dhe dokumentimin efektiv të torturës dhe keqtrajtimit (Protokolli i Stambollit)?<sup>72</sup>
- A u ofrohet viktimave të torturës ose traumës ndihmë psikosociale?

## 4.7 PERSONELI / KUADROT

Lloji i institucionit përgjegjës për menaxhimin e vendeve të mbajtjes (p.sh. policia, policia kufitare, personeli i burgjeve, kontraktues privat, shërbimi i imigracionit) do të ndikojë në kulturën<sup>73</sup> e përgjithshme institucionale dhe atmosferën e përgjithshme .

Personeli përgjegjës për ndalimin e imigrantëve ka një detyrë sfiduese para vetes kur ballafaqohet me personat në mbajtje të cilët mund të mos i kuptojnë arsyet për ndalim/mbajtjen e tyre, duke ia shtuar këtu edhe vështirësit në komunikim. Prandaj, është e rëndësishme që monitoruesit të mos e anashkalojnë personelin, çfarëdo qoftë roli i tyre, meqë kualifikimet, trajnimi, zotësia dhe qëndrimi i tyre janë disa nga përcaktuesit kryesorë të mënyrës së trajtimit të personave në mbajtje. Veç kësaj, në qoftë se punonjësit janë të mbingarkuar, nuk paguhen dhe/ose vlerësohen sa duhet, atëherë kjo mund të ketë një efekt të dëmshëm në mjedisin e mbajtjes.

Monitoruesit duhet të mbajnë mend se kushtet e mbajtjes janë njëherësh edhe kushtet e punës të personalit. Personeli dhe drejtuesit nuk janë privuar nga liria, por mund të jenë të ngarkuar dhe të shqetësuar, mund të jenë dëshmitarë të incidenteve shqetësuese, dhe madje mund të kenë qenë viktimat e sjelljes agresive ose të dhunshme. Natyrisht që edhe personeli mund të ketë kryer ose të ketë heshtur para akteve të frikësimit, keqtrajtimit ose neglizhimit. Atyre mund t'u pëlqejë puna që bëjnë, ose t'ju duket jofalenderuese, e paguar keq dhe madje edhe depresive. Sidoqoftë, nuk ka asnjë dyshim se mirëqenia e personelit dhe menaxhmentit në vendet e mbajtjes jo vetëm që ka rëndësi për ta dhe në vetvete, por ka po ashtu ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien dhe sigurinë e të personave në mbajtje. Kështu, pikëpamjet e tyre mbi funksionimin e vendit të ndalimit dhe përmirësimet që ata i konsiderojnë të nevojshme, janë shumë të rëndësishme. Veç kësaj, personeli mund të jetë burim i rëndësishëm i informatave lidhur me trajtimin e të personave të ndaluar.

Në përgjithësi, punonjësit e vendeve të mbajtjes i ushtrojnë dy funksione: ruajtja e sigurisë dhe ofrimi i shërbimeve. Në varësi të madhësisë dhe natyrës së vendit të mbajtjes, këto funksione mund ose

nuk mund të kryhen nga dy grupe të ndryshme të personelit ose jo. Monitoruesit duhet ta kenë parasysh se disa anëtarë të personelit mund të jenë më të rezervuar se të tjerët, dhe mund ta shohin grupin e monitorimit si ndërhyrje. Megjithatë, është e rëndësishme që ekipi të jetë këmbëngulës. Sjellja dhe gatishmëria e stafit për të qenë objekt i shqyrtimit të hollësishtë mund të tregojë një histori në vetvete, duke treguar kulturën e mjedisit të ndalimit. Është me rëndësi të mbahet parasysh se anëtarët e personelit janë pjesë përbërëse e jetës së përditshme të personave në mbajtje.

#### **4.7.1** Marrëdhëniet e personelit me personat në mbajtje dhe siguria

Rëndësia e marrëdhënieve të mira mes personelit dhe personave në mbajtje në një ambient të mbyllur të mbajtjes vështirë se mund të tregohet duke u ritheksuar. Nëse personat në mbajtje mendojnë se personeli dhe menaxhmenti respektojnë humanitetin dhe dinjitetin e tyre, përfshirë edhe pasigurinë e gjendjes së tyre dhe prejardhjen e tyre kulturore, etnike dhe fetare, ka të ngjarë që kjo të ndikojë pozitivisht në ndjenjën e tyre të mirëqenies. Për shkak se marrëdhëniet pozitive qëndrojnë në themel të sigurisë dinamike, ka më gjasa që personat në mbajtje të marrin përgjegjësinë për veprimet dhe vendimet e tyre dhe të bashkëpunojnë me personelin dhe menaxhimin. Nga ana tjetër, nëse personeli dhe menaxhmenti ndjehen të respektuar si njerëz, dhe atë jo vetëm për shkak të fuqisë dhe autoritetit të tyre, është gjithashtu e mundshme që kjo të ketë një efekt pozitiv në mirëqenien e tyre dhe në të mundësuarit e një mjedisi të shëndetshëm të punës.

Puna në vendet mbajtjes të imigrantëve mund të jetë jashtëzakonisht e vështirë dhe nganjëherë shumë ndikuese, sidomos në rastet kur personat në mbajtje janë në një gjendje shumë të pikëlluar, ose të angazhohen në akte të protestës apo vetëlëndimit, ose përjetojnë ndonjë incident tjetër të papritur krize. I tërë personeli stafi duhet të janë i trajnuar në strategjitë e menaxhimit të krizave. Po ashtu, atyre duhet t'u ofrohen, e në disa rrethana edhe të obligohen, trajtime këshillimore periodike me personel të kualifikuar, si individualisht ashtu dhe si grup.

---

## 1 Marrëdhëniet mes personelit/zyrtarëve dhe personave në mbajtje karakterizohen nga mirësjellja dhe respekti gjatë tërë kohës

Burimet: [PNDÇP](#) 10(1); [KPM](#) 17(1); [KDF](#) 37(c); [ACHR](#) 5(1); [KADNJP](#) 5; [PPMMPPLKA](#) I, XX

### Këshilla për monitoruesit:

- Cila është atmosfera e përgjithshme mes personelit dhe personave në mbajtje?
- A inkurajohet ndërveprimi pozitiv mes personelit dhe personave në mbajtjenjega ana e menaxhmentit dhe autoriteteve qendrore?
- A merr personeli pjesë në aktivitete rekreative, sportive ose kulturore së bashkë me personat në mbajtje?
- A u drejtohet personeli personave në mbajtje emrin që personat në mbajtje parapëlqejnë? A i trajton personeli akomodimin e personave në mbajtje si hapësirë private?

---

## 2 Personeli i kryen detyrat me kujdes, i trajtojnë informatat private dhe/ose konfidenciale në posedim të tyrin me ndjeshmëri dhe respekt, dhe e kuptojnë se kanë për detyrë që të kujdesen për personat në mbajtje

Burimet: [KDKAK](#) 22(2); [CCLEO](#) 4; [PPMMPPLKA](#) XX; [RREB](#) 72

### Këshilla për monitoruesit:

- Cilat janë vrojtimet e ekipit sa i përket sjelljes dhe qëndrimit të personelit?
- A ka dëshmi të marrëdhënies jo të përshtatshme mes personelit dhe personave në mbajtje (p.sh. shfrytëzim seksual, korrupsion, sjellje manipuluese ose abuzive)?
- A e ka fituar personeli respektin e personave në mbajtje për shkak të mënyrës në të cilën sillen?

---

**3 Ekzistojnë të gjithë elementët e sigurisë dinamike, në kuptimin që: marrëdhëniet (personel/persona në mbajtje, personel/personel dhe persona në mbajtje/persona në mbajtje) janë pozitive, marrëdhëniet mes komunitetit lokal dhe personave në mbajtje janë pozitive, personat në mbajtje mbahen të angazhuar në aktivitete konstruktive, personat në mbajtje janë të përgatitur mirë për lirim, transferin ose largimin.**

Burimet: [PNDPC](#) 10(1); [RREB](#) 73; 74; 75

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ndjehen personat në mbajtje të sigurt (gjatë ditës, natën, në të gjitha vendet)?
- A kultivohen marrëdhëniet e mira mes personelit dhe personave në mbajtje nga ana e personelit dhe/ose menaxhmentit? Nëse po, në ç'mënyrë? A është efektive kjo?
- A ekzistojnë programe të vizitave për komunitetet lokale?
- A mbahen të zënë me aktivitete qëllimisht personat në mbajtje?

---

**4 Masat që merren për sigurimin ose ruajtjen e “sigurisë dhe rendit” dokumentohen me kujdes, me arsyetime, në regjistrin e sigurisë**

Burimet: [BPP](#)18(3), 25, 29(2); [PPMMPPLKA](#) XXII

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ekziston një regjistër i sigurisë? Në ç'mënyrë mbahet ai?
- A freskohet rregullisht regjistri?

## 4.7.2 Punësimi, trajnimi dhe sjellja e personelit

Në themel të çdo skeme humane të mbajtjes të imigrantëve qëndron punësimi dhe trajnimi i personelit në mënyrën e duhur. Sa i përket kësaj, zyrtarët e imigrimit, personeli i zbatimit, personeli mjekësor, si dhe çdokush tjetër që është i përfshirë në mbajtjen ose trajtimin e të imigrantëve të ndaluar, përfshirë kontraktuesit privatë, duhet të vijojnë mësimet e trajnimin dhe të kenë mbikëqyrje dhe mbështetje të duhur dhe të vazhdueshme.

Stafi duhet të ketë një qëndrim të përshtatshëm dhe duhur sa u përket marrëdhënieve të tyre me personat në mbajtje. Në radhët e personelit duhet të ketë njerëz me përgatitje dhe përvojë profesionale të shumënduarshme, sidomos punonjës me përvojë të punës në komunitet dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme kulturore ose fetare.

---

### 1 Përzgjedhja dhe punësimi i personelit bëhet me kujdes duke pasur parasysh integritetin, humanitetin, kapacitete profesionale dhe përshtatshmërinë e tyre si person për të punuar në një mjedis të mbajtjes së imigrantëve

Burimet: [RRSM](#) 46(1), 47; [RPJDL](#) ; [PPMMPPLKA](#) XX; [KPT/Inf](#) (97) 10 §29; [RREB](#) ; 77

#### Këshilla për monitoruesit:

- Cilat janë kriteret e punësimit të personelit i cili do të jetë në kontakt me personat në mbajtje?
- A merren parasysh gjatë procesit të punësimit kualifikimet profesionale, përvoja dhe tiparet e karakterit?

---

### 2 Personeli që punësohet vjen nga fusha të ndryshme profesionale dhe me shkathtësi gjuhësore të përshtatshme

Burimet: [RRSM](#) 49, 51(1); [RREB](#) 87.2

**Këshilla për monitoruesit:**

- Sa është përqindja e personelit që vjen nga mjediset e burgjeve?
- Sa është përqindja e punëtorëve social? Sa nga anëtarët e personelit flasin një gjuhë përkatëse për personat në mbajtje?
- Sa nga anëtarët e personelit kanë prejardhje kulturore ose fetare të njëjtë sikurse personat në mbajtje?
- A ka ndërmjetësues kulturorë, punëtorë social, përkthyes, psikologë etj?

**3 Përbërja gjinore e personelit është e përshtatshme për kohortën e personave në mbajtje**

Burimet: [BPP](#) 5(2); [RPJDL](#) 83; [RRSM](#) 53; [PPMMPPLKA](#) XX; [RREB](#) 85

**Këshilla për monitoruesit:**

- A është i mjaftueshëm për ta siguruar rendin dhe sigurinë numri i personelit në raport me numrin e personave në mbajtje?
- Sa është numri i grave në raport me atë të burrave në radhët e personelit?
- A ka gra në pozita të larta drejtuese?

**4 Personeli është trajnuar dhe demonstroi njohuri rreth çështjeve të diversitetit, përfshirë diversitetin social, kulturor, gjuhësor dhe fetar, si dhe nevojat e veçanta të personave në pozita të cënueshme**

Burimet: [CCLEO](#) 2; [BPP](#) 5 [BPP](#) 33; [RRSM](#) 47(2); [RPJDL](#) 83, 85; [UNHCR-UN](#) 8; [PPMMPPLKA](#) XX; [KPT/Inf](#) (97) 10 §29; [RREB](#) 81

**Këshilla për monitoruesit:**

- A kanë personeli aftësi të mira ndërpersonale dhe komunikimi?
- A vlerësohet një gjë e tillë nga ana e menaxhmentit, personelit, personave në mbajtje?
- A janë personeli të vetëdijshëm dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve, grave, personave LGBTI dhe njerëzve të moshuar?
- A janë të trajnuar personeli për identifikimin e simptomave të mundshme të stresit të cilat mund t'i shfaqin personat në mbajtje (qoftë post-traumatik apo i nxitur nga ndryshimet socio-kulturore) dhe për ndërmarjen e veprimeve të përshtatshme?



## 5 Ekzistojnë vija të qarta të llogaridhënies dhe raportimit për personelin, që sigurojnë se ata po e kryejnë detyrën e tyre duke i respektuar të drejtat dhe dinjitetin e personave në mbajtje

Burimet: [RRSM](#) 48; [RPJDL](#) 87; [PPMMPLKA](#) XXIV; [RREB](#) 83, 84

### Këshilla për monitoruesit:

- A ka kod të mirësjelljes për personelin, dhe a janë personeli në dijeni të kodit të mirësjelljes?
- A janë masat disiplinore dhe të llogaridhënies për personelit adekuate dhe efektive?
- A adresohet gjuha dhe sjellje a e pahijshme?

---

## 6 Kapacitetet profesionale të personelit vlerësohen dhe respektohen, orari i punës është i arsyeshëm, ndërsa paga është adekuate

Burimet: [RRSM](#) 46(3); [RPJDL](#) 83; [RREB](#) 78, 79

### Këshilla për monitoruesit:

- A janë adekuat koeficientët e pagave të personelit?
- A është punësimi i tyre i sigurt?
- A kanë ata qasje në mundësi të zhvillimit profesional dhe avancimit në karrierë?
- A janë kushtet e punës të pranueshme (rotacioni, pauzat, pushimi vjetor, pushimi mjekësor)?

---

## 7 Personeli ka qasje në shërbime këshillimore pa pagesë

Burimet: [BPUFF](#) 21

### Këshilla për monitoruesit:

- A mbështeten dhe mbikëqyrën në mënyrë adekuate në punë e sipër personeli?
- A kanë qasje dhe a inkurajohen të shfrytëzojnë shërbimet këshillimore?

## 4.8 PERSONAT NË POZITË TË CENUESHME/ RREZIKSHMËRI

Çdo person i cili është i privuar nga liria është i ndjeshëm ose në rrezik. Mirëpo, disa imigrantë në mbajtje janë në pozitë veçanërisht të cenueshme dhe për t'i adresuar nevojat e tyre të veçanta duhet të ndërmerren masa specifike. Shkalla e rrezikshmërisë në kontekstin e mbajtjes ndikohet sidomos nga vet mjedisi i (mbajtjes,<sup>74</sup> si dhe nga disa karakteristika personale, duke përfshirë moshën, përkatësinë seksuale/gjinore, nivelin e arsimit, gjuhën, gjendjen shëndetësore psikologjike dhe fizike, orientimin seksual ose identitetin gjinor, izolimin social dhe qëndrueshmërinë individuale apo faktorët mbrojtës të personit në mbajtje.

Organet monitoruese kanë një rol të rëndësishëm në:

- Vënien në dukje të politikaveose praktikave të ndalimit nëmbajtje të azilkërkuessve dhe migrantëve në pozitë veçanërisht të cenueshme të cilët nuk duhet të ndalohen në mbajtje :
- Sigurimin që individët në pozitë veçanërisht të cenueshme të përfitojnë ndihmë dhe mbrojtje adekuate; dhe
- Tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve për nevojat specifike të atyre me cenueshmëri të veçanta.

### 4.8.1 Parimet bazë

Për të siguruar se mbajtja është i domosdoshëm dhe proporcional, gjatë marrjes së vendimit përkitazi me vendin e mbajtjes në ndalim duhet të merren parasysh rrethanat dhe nevojat e veçanta të secilit individ (UNHCR - DG 4). Procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit mund të përdoret nga vendimmarrësit për të identifikuar personat në pozitë të cenueshme dhe për të identifikuar alternativat e duhura të mbajtjes. Kur mbajtja është i nevojshëm si mjet i fundit, procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit mund të ndihmojë po ashtu për të siguruar që kushtet e mbajtjes në ndalim të jenë të përshtatshme për rrethanat e veçanta të personit.



## 1 Mbjajta i personave në pozitë të cenushme është masë e jashtëzakonshme dhe përdoret vetëm si mjet i fundit, pas shqyrtimit të thukhtë të alternativave tjera të mbajtjes/lirimit

Burimet: [SRHRM §43](#); [UNHCR-UN 4, 9](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A ekzistojnë procese të shqyrtimit dhe vlerësimit për identifikimin e personave t në mbajtje) në pozitë të cenushme?
- A mbahen në qendrën e mbajtjes persona në pozitë të cenushme?
- Gjatë vendosjes për t'i ndaluar në mbajtje personat në pozitë të cenushme a merren parasysh nevojat dhe cenusshmëritë individuale dhe a përcaktohen rrethanat e jashtëzakonshme që arsyetojnë mbajtjen e tyre?
- A jepet arsyetim në këto vendime se përse nuk janë përdorur alternativa të mbajtjes?
- A prioritizohen personat në pozitë veçanërisht të cenushme për alternative ndaj mbajtjes/lirimit?

---

## 2 Qendra e mbajtjes ka një politikë aktive të barazisë dhe mosdiskriminimit

Burimet: [CEDAW 2](#); [CERD 7](#); [KDKPAK 4, 5](#); [BR 31](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A ka qendra e mbajtjes politikë të barazisë dhe mosdiskriminimit ku përvijohen mënyrat e identifikimit dhe adresimit të grupeve në pozitë të cenushme?
  - A janë personeli në dijeni të kësaj politike? A zbatohet ajo në mënyrën e duhur?
  - A bëhet ndonjë vlerësim me rastin e arritjes së personit në mbajtje në qendrën e mbajtjes me qëllim të identifikimit të cenusshmërive dhe mënyrën në të cilën mund të plotësohen nevojat e veçanta të këtyre personave në pozitë të cenushme?
  - Nëse bëhet vlerësim, si realizohet ai saktësisht në praktikë? A u jepen personave në mbajtje garanci se informatat do të trajtohen në mënyrë konfidenciale?
- 
- A regjistrohen cenusshmëritë dhe nevojat specifike?

---

### 3 Personeli trajnohet për barazi dhe mosdiskriminim dhe në ç'mënyrë duhen plotësuar nevojat e personave në pozitë të cënueshme

Burimet: [CCLEQ](#) 2; [CEDAW](#) 2; [CERD](#) 6, 7; [KDKPAK](#) 4, 5; [RRSM](#) 47; [RREB](#) 81.3

#### Këshilla për monitoruesit:

- A trajnohen personeli për çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit?
- A e kuptojnë në mënyrë të qartë se në ç'mënyrë duhen plotësuar nevojat e grupeve/individëve të ndryshëm në pozitë të cënueshme?

---

### 4 Personat kanë mundësinë e ushtrimit të ankesës për çfarëdo incidenti të diskriminimit apo abuzimit. (Shih gjithashtu 4.1.6)

Burimet: [BPP](#) 33; [RRSM](#) 36; [BR](#) 25; [RREB](#) 70

#### Këshilla për monitoruesit:

- A e kanë të mundur personat që të ushtrojnë ankesë anonime për çfarëdo trajtimi ose sjelljeje diskriminuese, në gjuhën e vet, pranë autoriteteve ndaluese, organeve të pavarura apo autoriteteve gjyqësore?
- A u sigurohet personave në mbajtje të cilët ushtrojnë ankesë mbrojtje, mbështetje dhe këshillim i menjëhershëm po të jetë e nevojshme? A marrin parasysh masat mbrojtëse mundësinë e hakmarrjes?
- A trajtohen ankesat menjëherë dhe a vendosen pa vonesë të tepërt?

## 4.8.2 Fëmijët<sup>75</sup>

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) përcakton parimin themelor udhëheqës se “në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese” (KDF, neni 3). Është e pranuar botërisht se, në parim, fëmijët azilkërkues dhe migrant nuk duhet të mbahen dhe se, në të gjitha rrethanat, mbajtja duhet të përdoret vetëm si masë e fundit dhe “për një kohë sa më të shkurtër” (neni 37 (b) i KDF).<sup>76</sup> Udhëzimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës përcaktojnë po ashtu se fëmijët kurrë nuk të jenë objekt i masave ndëshkuese për shkak të statusit të migrimit të prindërve të tyre dhe se mbajtja i fëmijëve imigrantë është në kundërshti me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe do të përbëjë shkelje të të drejtave të fëmijës. Nëse fëmijët mbahen në qendra të mbajtjes të imigrantëve, monitoruesit duhet të jenë posaçërisht vigjilent. Ndaj çdo fëmije në mbajtje duhen përmbushur obligime të veçanta për shkak të statusit dhe nevojave të tyre të ndryshme si fëmijë. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria (RRMMPL) përcaktojnë udhëzime të rëndësishme që në fokus kanë të drejtat dhe nevojat e fëmijëve në mbajtje.

Në praktikë, mbajtja i fëmijëve në kontekstin e imigracionit mbetet një realitet që sjellë në shprehje një numër çështjesh në kuptimin e mbrojtjes së integritetit fizik dhe mendor, si dhe në lidhje me lidhjet familjare, arsimin dhe (ri)integrimin social. Ka dëshmi të forta se mbajtja ka ndikim të thellë dhe negativ në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, pavarësisht nga kushtet në të cilat fëmijët mbahen. Madje edhe periudha shumë të shkurtra të mbajtjes mund të dëmtojnë mirëqenien psikologjike dhe fizike të fëmijëve dhe komprometojnë zhvillimin e tyre kognitiv. Fëmijët të cilët mbahen në ndalim janë në rrezik të vuajnë nga depresioni dhe ankthi, dhe shpesh shfaqin simptoma që përkojnë me çrregullimin e stresit post-traumatik (PTSD), të tilla si pagjumësia, ëndrrat e këqija dhe urinimi në gjumë. Ndjenja e humbjes së shpresës dhe e zhgënjimit mund të shpërfaqet në formë të akteve të dhunës ndaj vetes apo të tjerëve. Raportet mbi efektet e mbajtjes në imigrim të fëmijëve kanë gjetur numër tejet të madh të vetëvrasjeve, tentim vetëvrasjeve dhe vetëlëndimit, çrregullimeve mendore dhe problemeve zhvillimore, duke përfshirë çrregullim e varshmërisë së tepërt.

## 1 Fëmijët në parim nuk ndalohen në mbajtje. Nëse mbahen, mbajtja duhet të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër

Burimet: [KDF 37\(b\)](#); [RPJDL 1, 2](#); [UNHCR-UN 9.2](#); [KPT/Inf \(2009\) 27 §97](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- Çfarë politike ka shteti sa i përket mbajtjes së fëmijëve?
- A ka në vendin e mbajtjes fëmijë?
- Për sa kohë janë ndalur në mbajtje ata? Cila është kohëzgjatja mesatare?
- Sa shpesh rishqyrtohet mbajtja e fëmijëve?
- Çfarë alternative ndaj mbajtjes janë marrë në konsideratë në rastin e veçantë?
- Çfarë masa ndërmerren për të siguruar që mbajtja të bëhet për një kohë sa më të shkurtër (p.sh. procedurë e përshpejtuar e kërkesave për imigrim)?
- A kanë agjencitë e jashtme që punojnë me fëmijët qasje të fëmijët të cilët mbahen në ndalim?

---

## 2 Të gjitha vendimet merren duke pasur në konsideratë interesin më të lartë i fëmijës

Burimet: [KDF 3](#); [UNHCR 9.2](#); [DPBE 23\(1\)](#); [RREB 35, 36](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- Si janë ndikuar fëmijët nga mbajtja?
- A ka shenja të efekteve negative? Si adresohen ato?
- A kanë fëmijët e ndaluar qasje në arsim, rekreacion, aktivitete të kohës së lirë, mbështetje sociale dhe ndihmë materiale? A lirohen fëmijët përkohësisht (p.sh. në baza ditore) për të marrë pjesë në këto aktivitete?

---

## 3 Fëmijët nuk ndahen nga prindërit kundër vullnetit të tyre

Burimet: [KDF 9](#); [PNDGP 23](#); [ICESCR 10](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A është ndarë ndonjë fëmijë nga prindërit gjatë mbajtjes?
- A ekziston një procedurë për marrjen në konsideratë të interesit më të

---

#### 4 Fëmijët nuk mbahen për shkak të statusit të imigrimit të prindërve ose kujdestarëve të tyre

Burimet: [KDF](#) 2; [SRHRM](#) §40

##### Këshilla për monitoruesit:

- A mbahen fëmijët në ndalim për shkak të statusit të imigrimit të prindërve të tyre?
- A janë marrë në konsideratë aktivisht alternativat e mbajtjes për familjen?

---

#### 5 Fëmijët nuk vendosen bashkë me të rriturit, përveç nëse i përkasin së njëjtës familje

Burimet: [KDF](#) 3; [RPJDL](#) 28, 29; [RREB](#) 35.4; [DPBE](#) 23(5); [RRSM](#) 8(d)

##### Këshilla për monitoruesit:

- A akomodohen fëmijët me të rritur të tjerë (të cilët nuk i kanë anëtarë të familjes) nëmbajtje

---

#### 6 Çdo fëmije të cilit i është hequr liria i ofrohen këshilla ligjore të menjëhershme dhe e drejta për të ushtruar ankesë ndaj mbajtjes

Burimet: [KDF](#) 37(d)

##### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë fëmijët ndihmë juridike në procedurën e imigrimit dhe azilit dhe mundësinë që të ushtrojnë ankesë ndaj mbajtjes pranë gjykatës?

#### 4.8.3 Fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë

Ndonjëherë fëmijët do të emigrojnë apo të udhëtojnë vetëm, ose të ndahen nga prindërit ose kujdestarët gjatë imigrimit ose ikjes nga përndjekja apo situata të tjera të konfliktit dhe dhunës. Fëmijë pa prindër ose kujdestarë janë veçanërisht të cenueshëm ndaj shfrytëzimit seksual dhe ekonomik, trafikimit dhe abuzimit. KDF parasheh që përveç të drejtave të ofruara për të gjithë fëmijët imigrantë, fëmijët e pashoqëruar kanë nevoja të veçanta për mbrojtje dhe ndihmë. Komisioni për të Drejtat e Fëmijës ka deklaruar qartë se ata nuk duhet, si rregull i përgjithshëm, të mbahen (KP-KDF 6). Duke pasur parasysh alternativat ndaj mbajtjes, është e vështirë të përfytyrohet një situatë në



të cilën mbajtja i një fëmije të pashoqëruar do të justifikohet (GPNA A/HRC/13/30).

---

**1 Si rregull i përgjithshëm, fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë nuk mbahen. Mbjtja nuk arsyetohet me faktin se ata janë të pashoqëruar ose të ndarë ose në bazë të statusit të tyre të migrimit. Ata nuk penalizohen për hyrje ose prani të parregullt.**

Burimet: [KP-KDF](#) 6; [SRHRM](#) §40; UNHCR 9.2; [DPBE](#) 24

**Këshilla për monitoruesit:**

- A janë në mbajtje fëmijë të pashoqëruar ose të ndarë?
- A ekzistojnë procese për vlerësimin e moshës së fëmijëve moshë e të cilëve është kontestuar?
- Për sa kohë janë duke u mbajtur në ndalim ata?
- Cili është arsyeimi për mbajtjen e tyre? Çfarë lloj alternativash ndaj mbajtjes janë marrë në konsideratë?
- A jepet në vendimet mbi mbajtjen arsyeja përse nuk janë përdorur alternativat ndaj mbajtjes (p.sh. caktimi i kujdestarisë, qëndrimi më të afërm të moshës së rritur, zgjidhje alternative për kujdesin dhe akomodimin e tyre)?

---

**2 Gjithë fëmijëve të pashoqëruar ose të ndarë u caktohen kujdestarë të cilët mbikëqyrin gjithë vendimet që kanë të bëjnë me ta duke mbajtur parasysht interesin më të lartë të fëmijës**

Burimet: [KDF](#) 18(2), 20(1); [KP-KDF](#) 6 f.11; [SRHRM](#) §41; [DPBE](#) 24

**Këshilla për monitoruesit:**

- A u janë caktuar fëmijëve të pashoqëruar ose të ndarë kujdestarë të cilët mbikëqyrin që gjithë vendimet që merren janë në interesin më të lartë të fëmijës?
- Sa shpesh kontaktojnë fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë me kujdestarët?
- A janë kujdestarët aktivë në përfaqësimin e interesit më të lartë të fëmijës?

### **3 Ka proces të bashkimit familjar të fëmijëve refugjatë me prindërit e tyre. (Shih pjesën 4.5.1)**

Burimet: [KDF](#) 22

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ndërmerr shteti hapa për të bërë bashkimin familjar të fëmijëve refugjatë të pashoqëruar ose të ndarë me prindërit e tyre?

#### **4.8.4 Gratë**

Gratë në mbajtje për imigrim kanë nevoja të veçantë të cilat duhet t’ju plotësohen. Ndonëse disa kategori të grave, përfshirë gratë shtatzëna dhe nënat të cilat i kanë fëmijët në gji, nuk duhet të mbahen fare, në qoftë se ato janë në mbajtje në rrethana të jashtëzakonshme atëherë do t’u ofrohet mbështetje e posaçme mjekësore dhe lloje tjera të mbështetjes. Po kështu, duhet të përmbushen dhe nevojat higjienike femërore dhe çështjet lidhur me shëndetin riprodhues të grave. Autoritet e mbajtjes duhet të sigurojnë masa për parandalimin e abuzimit seksual dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, dhe t’u përgjigjen viktimave.

---

#### **1 Qendra e mbajtjes ka politika dhe rregullore të qarta për ofrimin e mbrojtjes maksimale për gratë në mbajtje ndaj dhunës seksuale dhe në baza gjinore, diskriminimit dhe abuzimit**

Burimet: [CEDAW](#) 2; [BR](#) 31; [IACPPVEAË](#) 3, 4; [RREB](#) 34

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ka qendra e mbajtjes politika dhe rregullore të qarta për mbrojtjen maksimale për gratë e ndaluara ndaj dhunës seksuale dhe në baza gjinore, diskriminimit dhe abuzimit?
- A është personeli në dijeni të këtyre politikave e rregulloreve?
- A zbatohen politikat siç duhet?

## 2 Personeli i cili punon me gratë në mbajtje është trajnuar lidhur me nevojat e posaçme të grave në mbajtje

Burimet: [CEDAW](#) 2; [BR](#) 33; [IACPEVAË](#) 7

### Këshilla për monitoruesit:

- A i kuptojnë qartë personeli i cili punon me gratë (në mbajtje) nevojat e veçanta të tyre (përfshirë gratë shtatzëna dhe nënat gjidhënëse)?
- A janë të trajnuar personeli për këtë gjë?

---

## 3 Gratë në mbajtje nuk mbahen në të njëjtën dhomë me burrat, përveç në rastin e familjeve. Personeli i cili punon me gratë në mbajtje janë po ashtu të gjinisë femërore.

Burimet: [RRSM](#) 8(a); [SRHRM](#) §36, 37

### Këshilla për monitoruesit:

- A mbahen gratë e ndaluara në dhomë të veçant nga burrat?
- A ka akomodim të posaçëm për familjet?
- A caktohen punonjëse femra për të punuar me femrat në mbajtje?

---

## 4 Gratë shtatzëna dhe nënat gjidhënëse nuk ndalohen, por zbatohen aktivisht alternative ndaj mbajtjes.

Burimet: [BR](#) §9; [UNHCR-UN](#) 9.3

### Këshilla për monitoruesit:

- A mbahen në vendin mbajtjesgratë shtatzëna ose nëna gjidhënëse?
- Cili është arsyeja për mbajtjen e tyre? A janë marrë në konsideratë alternativa ndaj mbajtjes para vendimit mbi mbajtjen e tyre?

---

**5 Sanksionet disiplinore të shqiptuara ndaj grave të ndaluar( në mbajtjenuk përfshijnë ndalimin e kontaktit me familjen, sidomos me fëmijët. Masa e izolimit ose veçimit disiplinor nuk zbatohet për gratë shtatzëna, gratë me foshnja ose nënat gjdhënëse në mbajtje**

Burimet: [BR](#) 22, 23

**Këshilla për monitoruesit:**

- A përfshijnë sanksionet disiplinore ndalesën e kontaktit me familjen?
- A përdoret veçimi si ndëshkim për gratë shtatzëna, gratë me foshnja ose nënat gjdhënëse?

---

**6 Akomodimi për gratë është i pajisur me hapësirat dhe materialet që u nevojiten atyre për t'i plotësuar nevojat higjienike vetanake dhe të fëmijëve të tyre, po të jetë e përshtatshme**

Burimet: [BR](#) 5; [RREB](#) 19.7

**Këshilla për monitoruesit:**

- A sigurohen peceta higjienike pa pagesë?
- A ka furnizim të rregullt me ujë të pastër për kujdesin personal të fëmijëve dhe grave, në veçanti grave të cilat janë shtatzëna, gjdhënëse ose kanë ciklin menstrual?

VINI RE: Kujdesi shëndetësor specifik për gjininë përfshihet në Pjesën 4.6.3.

#### 4.8.5 Personat me aftësi të kufizuara mendore ose fizike

Mbajtja për qëllime të imigrimit i personave me aftësi të kufizuara mendore ose fizike ndodhë më shpesh seç do të duhej, dhe vendet e mbajtjes të imigrantëve shpesh nuk posedojnë me burimet e nevojshme për të siguruar kujdes adekuat mjekësor për çdo person (SRHRM §46). Mbajtja si imigrantë përkeqëson problemet ekzistuese të shëndetit mendor dhe fizik dhe mund të shkaktojë dëme të tjera të përhapura dhe serioze për shëndetin mendor dhe fizik të personave në mbajtje.<sup>78</sup> Për këtë arsye, personat të cilët vuajnë nga aftësi të kufizuara mendore nuk duhet të mbahen. Në vend se të mbahen, ata duhet të vendosen në institucione të specializuara mjekësore ku do t'u ofrohet kujdes adekuat dhe mund të përcillet gjendja e tyre (RRSM 82). Në disa raste, mbajtja e vazhduar si imigrantë dhe moskërkimi i alternativave ndaj mbajtjes për azilkërkuesit dhe imigrantët me aftësi të kufizuara mendore apo fizike mund të përbëjë torturë dhe trajtim a dënim mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.<sup>79</sup> Në rastin e personave me aftësi të kufizuara fizike, rrethanat e tyre duhet të akomodohen në mënyrë të arsyeshme.

---

### 1 Ekzistimi i aftësisë së kufizuar në asnjë rast nuk e justifikon heqjen e lirisë. Personat të cilët vuajnë nga aftësi të kufizuara mendore nuk mbahen në parim dhe kanë qasje në alternativat e mbajtjes në komunitet, si të jetë më e përshtatshme

Burimet: [KDKPAK](#) 14, 19; [BR](#) 60; [PPMPPPLKA](#) III(III); [UNHCR-UN](#) 9.5

#### Këshilla për monitoruesit:

- A mbahen në vendin e mbajtjes persona me aftësi të kufizuara mendore ose fizike? A ka në mbajtje persona me paaftësi të rënda?
- A ka dëshmi të privimit të personave me aftësi të kufizuara nga liria e tyre për shkaqe të aftësisë së tyre të kufizuar (p.sh. u është mohuar qasja në alternative ndaj mbajtjes për shkak të paaftësisë për të raportuar tek autoritetet)?
- A janë marrë në konsideratë alternativa ndaj mbajtjes?

- 
- 
- 2 Çdo person vlerësohet sa më shpejtë që të jetë e mundshme pas pranimit në qendrën e mbajtjes dhe më pas sipas nevojës, sidomos për qëllimin e zbulimit të sëmundjes fizike ose mendore dhe marrjes së të gjitha masave të nevojshme. Zyrtari mjekësor ka për detyrë të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të personave në mbajtje**

Burimet: [RRSM](#) 24, 25

**Këshilla për monitoruesit:**

- A bëhet vlerësimi i nevojave mjekësore të personave me aftësi të kufizuara të cilë janë në mbajtje, dhe a identifikohet menjëherë dhe sistematikisht me rastin e arritjes në vendin e mbajtjes?
- A ofrohen shërbime dhe vlerësime klinike psikologjike ose psikiatrike me qëllim të konstatimit të sëmundjeve mendore në mesin e personave që janë në mbajtje?
- A ka profesionistë mjekësore ose shëndetësorë për diagnostikimin e gjendjes shëndetësore ose identifikimin e aftësisë së kufizuar dhe/ose rekomandimin e masave si përgjigje ndaj aftësisë së kufizuar?

- 
- 3 Personat me aftësi të kufizuara trajtohen në përputhje me të drejtat e tyre të njeriut dhe pa diskriminim, përfshirë përmes ofrimit të “akomodimit të arsyeshëm”**

Burimet: [KDKPAK](#) 6, 7, 14(3), 15-17, 18(1)(b); [BR](#) 1(b); [BPP](#) 5(2); [UNHCR-UN](#) 9.5

**Këshilla për monitoruesit:**

- A ka qendra e mbajtjes politika për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara gjatë mbajtjes në dalim si imigrantë?
- Çfarë përshtatje janë bërë për të akomoduar nevojat e personave me aftësi të kufizuara? A janë ato adekuate/të arsyeshme?

## 4.8.6 Personat e trafikuar

Ndërsa personat e trafikuar mund të hyjnë apo të qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në një shtet, si viktimat të shfrytëzimit ata nuk duhet të mbahen në ndalim apo forma tjera të burgimit si imigrantë.<sup>80</sup> Personat e trafikuar janë para së gjithash viktimat dhe nuk duhet të arrestohen, akuzohen ose të ndiqen penalisht për hyrje ose qëndrim të paligjshëm, apo për çfarëdo përfshirje në aktivitete të paligjshme që pasojë e drejtpërdrejtë e gjendjes së tyre si person i trafikuar.<sup>81</sup> Në vend të kësaj, rekomandohet që shtetet të miratojnë legjislacion ose masa të tjera të përshtatshme që lejojnë personat e trafikuar të mbeten brenda shtetit përkohësisht ose përgjithmonë (PKT 7 , §1).

### 1 Personat e trafikuar nuk mbahen në ndalim si imigrantë. Ata kurrë nuk mbahen në të njëjtin vend me trafikuesit e tyre.

Burimet: [AT.P](#) 7(1) (4); [OHCHR-TG](#); [SRTP](#) §95

#### Këshilla për monitoruesit:

- A ekziston ndonjë proces i vlerësimit dhe identifikimit të personave të trafikuar?
- A ka në mbajtje persona të cilët kanë qenë viktimat të trafikimit? Në çfarë rrethana janë trafikuar ata?
- A merret parasysh në vendimet mbi mbajtjen e personave në mbajtje përvoja e tyre e të qenit të trafikuar? A arsyetohet në vendime përse nuk janë përdorur alternative tjera në vend të mbajtjes (p.sh. shtëpitë e sigurta dhe menaxhimi e kujdesi i duhur)?
- A ekzistojnë masa (p.sh. verifikimi) për të siguruar që personat e trafikuar të mos mbahen në të njëjtin vend të mbajtjes sikurse trafikuesit e tyre?

### 2 Personave të trafikuar u ofrohet ndihmë dhe mbrojtje

Burimet: [AT.P](#) 6(3)(a); [OHCHR-TG](#) 8, 9

#### Këshilla për monitoruesit:

- A kanë personat e trafikuar qasje në këshilla juridike, procedura, mbështetje sociale dhe këshillim?

## 4.8.7 Viktimat e torturës apo traumës

Viktimat e torturës dhe formave tjera të dhunës së rëndë fizike, psikologjike ose seksuale janë tashmë të cënueshëm psikologjikisht për shkak të traumave që i kanë përjetuar. Mbjajtja ka të ngjarë t'i përkeqësojë edhe më simptomat e tyre dhe për këtë arsye kërkohet një etikë e kujdesit më tepër se sa mbajtja. Viktimat e torturës dhe traumës janë azilkërkues dhe refugjatë të shpeshtë. Mbjajtja e viktimave të torturës mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe poshtërues (SRHRM §44). Kjo pjesë duhet të lexohet së bashku me 4.8.5.

---

### 1 Viktimat e torturës ose formave tjera të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale nuk mbahen në parim

Burimet: [SRHRM §44](#); [UNHCR-UN 9.1](#)

#### Këshilla për monitoruesit:

- A marrin parasysh vendimet mbi mbajtjen historinë e torturës ose traumës?
- A arsyetojnë vendimet përse nuk janë përdorur alternativa të mbajtjes për të mbijetuarit e torturës/traumës?

---

### 2 Ka protokoll për trajtimin e rasteve ku personat në mbajtje zbulojnë informata në lidhje me keqtrajtimin, torturën ose traumë të mëhershme

Burimet: [PNDOP 7](#); [KBKKT 2](#); [DPBE 25](#)

#### Këshilla për monitoruesit:

- A përfshijnë historitë e rasteve vlerësime gjithëpërfshirëse lidhur me torturën/traumën?
- A kanë personat në mbajtje plan të kujdesit për torturë dhe traumë?
- A u transmetohen rastet e mëhershme të keqtrajtitimit autoriteteve përkatëse (nëse personat në mbajtje bëjnë kërkesë/japin pëlqimin)?
- Çfarë të dhëna statistikore ka në lidhje me personat e identifikuar si persona me histori të torturës dhe/ose traumës?



---

### 3 Ekzaminimi fillestar shëndetësor i imigrantëve në mbajtjeeshtë i përshtatur dhe ndjeshëm ndaj mundësisë që personi në mbajtjemund të ketë qenë viktimë e torturës ose traumës

Burimet: [PNDCP](#) 10; [BPP](#) 24; [RRSM](#) 24; [DPBE](#) 25; [PPMMPPLKA](#) IX(3)

#### Këshilla për monitoruesit:

- A janë profesionistët shëndetësorë të trajnuar për t'i trajtuar të mbijetuarit e torturës dhe traumave tjera?
- A janë në dispozicion regjistra mjekësorë? A regjistrohen rastet specifike në një regjistër të veçantë?

#### 4.8.8 Personat pa shtetësi

Për shkak se personat pa shtetësi në përgjithësi nuk përfitojnë nga mbrojtja diplomatike ose konsullore e një shteti, shpesh nuk posedojnë dokumente identifikimi ose nuk kanë një vend ku të kthehen, ata janë posaçërisht të pambrojtur ndaj mbajtjes së zgjatur si imigrantë. Në fakt, shumica e personave pa shtetësi banojnë në vendet e tyre të lindjes ose të vendbanimit të përhershëm, dhe nuk duhet për rrjedhojë të shihen si raste të imigracionit.

---

### 1 Pamundësia e largimit/deportimit të personave pa shtetësi duhet të merret parasysh në vendimet mbi mbajtjen. Mbajtja në afat të pacaktuar është e kundërligjshme.

Burimet: [CSSP](#) 26, 27; [UNHCR-UN](#) 6; [SRHRM](#) §47

#### Këshilla për monitoruesit:

- A mbahen persona pa shtetësi në ndalim? Për sa kohë janë duke u mbajtur në ndalim? Cila është kohëzgjatja mesatare e mbajtjes?
- Cili është arsyetimi për mbajtjen e tyre?
- A ka raste të personave pa shtetësi të cilët janë duke u mbajtur në ndalim për afat të pacaktuar për shkak të mungesës së dokumenteve ose shtetësisë? A kanë personat pa shtetësi qasje në procedurat për përcaktimin e shtetësisë?

---

## 2 Personat pa shtetësi trajtohen në përputhje me të drejtat e tyre të njeriut dhe pa u diskriminuar

Burimet: [CSP 3, 5](#); [UNHCR-UN §4](#); [SRHRM §47](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A përfitojnë personat pa shtetësi nga të njëjtat standarde të mbajtjes sikurse gjithë personat e tjerë në mbajtje? A ka tregues të trajtimit diskriminues?

### 4.8.9 Personat LGBTI

Personat lezbikë, homoseksual, biseksual, transgjitorë dhe interseksual ( LGBTI) janë në rrezik të shtuar që të kthehen në objekt të dhunës a abuzimit fizik, psikologjik dhe/ose seksual në mbajtje, si nga personeli ashtu dhe personat që janë në mbajtje.<sup>82</sup> Ata mund të kenë nevoja të veçanta mjekësore dhe këshillimore. Izolimi në vetmi apo veçimi administrativ, masa këto që përdoren shpesh nga autoritetet, nuk është një mënyrë e përshtatshme e garantimit të sigurisë së personave LGBTI në mbajtje. Nëse siguria e tyre nuk mund të sigurohet gjatë mbajtjes, atëherë personat LGBTI duhet të lirohen pa kushte ose të referohen për alternativa ndaj mbajtjes.

---

## 1 Personeli trajtohen lidhur me mosdiskriminimin dhe barazinë në lidhje me identitetin gjinor dhe orientimin seksual, dhe janë të vetëdijesuar për nevojat e veçanta të personave LGBTI

Burimet: [PNDGP 10\(1\)](#); [YP 9\(g\)](#)<sup>83</sup>; [UNHCR-UN 9.7](#)

### Këshilla për monitoruesit:

- A i kuptojnë personeli në mënyrë të qartë nevojat për mbrojtje dhe kujdes të personave LGBTI që janë në mbajtje?
- A janë trajnuar personeli lidhur me mosdiskriminimin dhe barazinë në lidhje me identitetin gjinor dhe orientimin seksual?
- A ka kod sjellje ose dokument të ngjashëm që mbulon orientimin seksual dhe identitetin gjinor? A sanksionohet diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor në të njëjtën mënyrë sikurse format e tjera të diskriminimit?

## **~~2~~ Personat LGBTI në mbajtje kanë qasje në kujdes të duhur shëndetësor dhe në shërbime këshillimore të përshtatura për nevojat e tyre të veçanta**

Burimet: [YP](#) 9(b)

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A kanë personat LGBTI në mbajtje qasje në kujdes të duhur mjekësor dhe shërbime këshillimore, duke përfshirë për shembull në lidhje me shëndetin riprodhues, ose qasjen në informata dhe barna për HIV/ AIDS?

---

## **3 Ka masa mbrojtëse për parandalimin e dhunës ose abuzimit ndaj personave LGBTI**

Burimet: [PNDCP](#) 7; [YP](#) 9(d); [UNHCR-UN](#) 9.7

### **Këshilla për monitoruesit:**

- A ka raste të dhunës ose abuzimit fizik, psikologjik ose seksual ndaj personave LGBTI në mbajtje?
- Si e siguron qendra e mbajtjes sigurinë e personave LGBTI në mbajtjen dhe dhunën dhe abuzimin?
- A përdoret ndonjëherë izolimi në vetmi ose veçimi administrativ për sigurinë e personave LGBTI në mbajtje? Si menaxhohen masat e tilla për të siguruar që të mos rrezikohet shkelja e të drejtave tjera?
- Çfarë procedura ekzistojnë në lidhje me preferencat e transgjinjorëve në lidhje me akomodimin e tyre?
- A janë në dispozicion lirim pa kushte dhe alternativat e tjera ndaj mbajtjes në rastet kur qendra nuk është në gjendje të ofrojë siguri për ta?

# SHTOJCAT

## SHTOJCA I: FJALORTH I TERMAVE KRYESORË

**Procedurat e përshpejtuara të azilit:** procedura të veçanta për trajtimin e përshpejtuar me kërkesat për azil tek të cilat është e qartë se janë të pabaza dhe si të tilla nuk meritojnë ekzaminim të plotë në çdo nivel të procedurës. Kërkesat e tilla janë quajtur ose me termin "keqpërdorim i qartë" ose "dukshëm të pabazuara" dhe përkufizohen si kërkesë për të cilat është e qartë se janë me qëllim mashtrimi ose nuk lidhjen me kriteret për dhënien e statusit të refugjatit të përcaktuar në Konventën për Refugjatët ose çfarëdo kriteresh tjera që arsyetojnë dhënien e azilit. Megjithatë, bazë për përpunimin e kërkesës me prioritet në procedurë të përshpejtuar mund të jenë dhe arsyet e forta për mbrojtje si, për shembull, në rastet të cilat janë qartazi të bazuara mirë, duke mundësuar vendosjen e shpejtë pozitive për kërkesën e azilit.

**Mbajtje administrative:** arrestimi dhe ndalimi në mbajtje pa akuzë ose proces gjyqësor i urdhëruar nga autoritetet administrative në vend të organeve gjyqësore/gjykatave. Në shumë vende, shkelje e ligjit për imigracionin rezultojnë në mbajtje administrative.

**Alternativat e mbajtjes:** nuk është term ligjor, por përdoret si referencë e shkurtër e "*çdo legjislacioni, politike apo praktike që u mundëson azilkërkuessve, refugjatëve dhe imigrantëve qëndrimin në mesin e komunitetit, me disa kushte ose kufizime të lirisë së tyre të lëvizjes.*" (Shih UNHCR - DG §8) Alternativat ndaj mbajtjes ngërthejnë ndalesa më pak shtrënguese ose ndërhyrëse në liritë apo lirinë e lëvizjes në krahsim me mbajtjen.

**Mbajtje arbitrare:** që mbajtja të jetë arbitrare, ajo duhet t'i ketë elementët e "*paarsyeshmërisë, padrejtësisë dhe paparashikueshmërisë.*" (Shih UNHCR-UN 4, §18) Për mbrojtjen nga arbitrariteti, mbajtja duhet të jetë e domosdoshme dhe proporcionale me qëllimin legjitim në çdo rast individual.

**Azili:** mbrojtje e dhënë nga një shtet në territorin e vet për personat të cilët ndodhen jashtë vendit shtetësinë e të cilit e kanë apo vendqëndrimin të përhershëm të tyre dhe rrezikohen nga përndjekja, shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut apo ndonjë tjetër serioz atje. Azili ndërthet komponentë të llojllojshëm, përfshirë mbrojtjen nga kthimi mbrapsht, lejen për të qëndruar në territorin e shtetit, gëzimin e të drejtave dhe përfundimisht një zgjidhje afatgjatë.<sup>84</sup> Në Shtetet të cilat janë palë të Konventës për Refugjatët të vitit 1951/Protokollit të vitit 1967, këtu përfshihet gëzimi i të drejtave të parapara në nenet 2 deri 34 të këtyre traktateve.

**Azilkërkuës:** azilkërkuës është personi i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare dhe është në pritje të vendimit për kërkesën.

**Mbrojtje shtesë:** mekanizma të ndryshëm administrativ ose legjislativ të përdorura nga shtetet për rregullimin e qëndrimit të personave të cilët bien jashtë sferës së veprimit të Konventës së Refugjatëve të vitit 1951 ose Protokollit të saj të vitit 1967, por që gjithsesi konsiderohen se kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Shih gjithashtu *Mbrojtjen subsidiare*.

**Ndalimi penal:** ndalimi për shkak të arrestimit ose dënimit të një personi në lidhje me një vepër penale që mbart një dënim me burgim.

**Mbajtja:** privimi nga liria në një vend të mbyllur nga i cila personi nuk lejohet ose nuk mund të pritët të largohet me vullnetin e tij ose pa autorizim (Shih UNHCR-UN §5).

**Mbajtja e imigrantëve:** privimi nga liria i individit, zakonisht i karakterit administrativ për një shkelje të pretenduar të kushteve të hyrjes, qëndrimit apo banimit në vendin pritës.

**Mbrojtje ndërkombëtare:** veprimet e bashkësisë ndërkombëtare në bazë të së drejtës ndërkombëtare, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave themelore të refugjatëve dhe kategorive tjera jashtë vendit të tyre të origjinës të cilëve u mungon mbrojtja kombëtare e vendeve të tyre. Veprimet e tilla përfshijnë: sigurimi i pranimit dhe qëndrimit, mbrojtja nga *kthimi mbrapsht*, qasja në procedura të drejta dhe efikase të azilit, stanrade njerëzore të trajtimit dhe realizimi i zgjidhjeve afatgjata.

UNHCR-i është agjencia e vetme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me mandatin për të siguruar mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve në nivel botëror.

**Rishikim gjyqësor:** rishikimi nga gjykata i vendimit për mbajtje ose zgjatjen e mbajtjes, ku gjykata ka autoritetin për t'i nxjerrë vendim të ndryshëm nga që ka nxjerrur organi administrativ.

**Migrant:** nuk ka një përkufizim të pranuar në mënyrë universale për migrantin. Termi migrant zakonisht konsiderohet se mbulon të gjitha rastet kur vendimi për të migruar është marrë lirisht nga individi dhe pa ndërhyrjen e një faktori shtërngues të jashtëm.

**Punëtor migrant:** “Një person që do të punësohet, është punësuar ose ka qenë i punësuar në një aktivitet të paguar në një shtet të ndryshëm nga vendi i shtetësisë së tij/saj.” Këtu nuk përfshihen “*personat e punësuar nga organizatat apo agjencitë ndërkombëtare, zyrtarë të punësuar nga një shtet jashtë territorit të tij, punonjësit shtetërorë të cilët marrin pjesë në programet e zhvillimit dhe programet e tjera të bashkëpunimit , investitorët, refugjatët dhe personat pa shtetësi (përveç nëse nuk është paraparë me legjislacionin kombëtar), studentët dhe të trajnuarit, detarëve dhe punëtorët në një platformë në det të hapur.*” (shih nenet 2 dhe 3, KPM)

**Monitorimi:** procesi i shqyrtimit të rregullt, përmes vizitave në vend, i gjithë aspekteve të mbajtjes së imigrantëve me kalimin e kohës. Shqyrtimi mund të përfshijë të gjitha ose disa kategori të personave të ndaluar të cilët mbahen në një ose më shumë vende të mbajtjes. Monitorimi përfshin transmetimin me gojë ose me shkrim të rezultateve të shqyrtimit, si dhe rekomandimeve për autoritetet përkatëse dhe akterët tjerë të përfshirë në mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ai gjithashtu përfshin përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve që u janë dhënë autoriteteve.

**Non-refoulement:** parim themelor i së drejtës ndërkombëtare për refugjatët dhe të drejtat e njeriut që ua ndalon shteteve t'i kthejnë individët në çfarëdo mënyre në territoret ku ata mund të jenë në rrezik të përndjekjes, torturës ose formave tjera të dëmit të rëndë a të pariparueshëm. Parimi i mos-kthimit është pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe kështu është i detyrueshëm për të gjitha shtetet palë pavarësisht se a janë nënshkruese të Konventës së vitit 1951 për

refugjatët ose instrumenteve tjera përkatëse apo jo.

**Persona me interes për UNHCR:** term i përgjithshëm që përdoret për t'i përshkruar gjithë personat për të cilët UNHCR-i ka mandate që t'ju ofrojnë mbrojtje dhe ndihmë, dhe të gjejë zgjidhje afatgjata bashkë me qeveritë. Këtu përfshihen refugjatët, azilkërkuesit, të kthyerit, personat pa shtetësi dhe, në shumë situara, personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV).<sup>85</sup>

**Mbrojtje:** Të gjitha aktivitetet që synojnë respektimin e të drejtave individuale në përputhje me përmbajtjen dhe frymën e së dretës ndërkombëtare për refugjatët, të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare. Mbrojtja përfshin krijimin e një mjedisi të favorshëm për respektimin e qenieve njerëzore, parandalimin dhe/ose zbutjen e efekteve të menjëhershme të një modeli të veçantë të abuzimit, dhe rivendosjen e kushteve dinjitoze të jetës përmes dëmshpërblimit, kthimit dhe rehabilitimit.<sup>86</sup>

**Refugjat:** një person i cili i plotëson kriteret që zbatohen në kuadër të përkufizimit për refugjatët, siç përcaktohet në instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale për refugjatët, sipas mandatit për refugjatët, dhe/ose në legjislacionin kombëtar. Neni 1A (2) i Konventës së vitit 1951 për Refugjatët, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Protokollin e vitit 1967, i përkufizon refugjatët si *"një person, i cili për shkak të frikës së bazuar nga persekutimi për arsye të racës, fesë, kombësisë, pjesëmarrjes në një grup të caktuar shoqëror ose mendimeve politike, është jashtë vendit, shtetësinë e të cilit ka dhe nuk është në gjendje apo, për shkak të kësaj frike, nuk dëshiron ta vërë veten nën mbrojtjen e atij shteti; ose i cili, duke mos pasur një shtetësi dhe duke qenë jashtë vendqëndrimit të mëhershëm të përhershëm si rezultat i ngjarjeve të tilla, nuk është në gjendje ose për shkak të frikës së tillë nuk është i gatshëm për t'u kthyer në të."*

**Status i refugjatit:** është status deklarativ, që do të thotë se dhënia e statusit të refugjatit deklaron ose konfirmon se personi është refugjat, por kjo nuk e bën atë refugjat.

**Azilkërkues i refuzuar:** është një person kërkesa për azil e të cilit është refuzuar pas një procedurë të drejtë të azilit, përfshirë qasjen në një procedurë të pavarur të ankimit.

**Fëmijë i ndarë:** një fëmijë i cili është ndarë nga të dy prindërit, ose nga kujdestari i tij/saj i mëparshëm ligjor apo zakonor, por jo domosdoshmërisht nga të afërmit e tjerë. Kështu, kjo mund të përfshijë një fëmijë i cili është i shoqëruar nga anëtarë të tjerë të rritur të familjes (Shih KDF GC 6 (2005), §7).

**Migrant i kontrabanduar:** një person i cili është objekt i veprës penale së kontrabandimit të migrantëve. Kontrabandimi i migrantëve është "marrja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e një përfitimi financiar ose material, për të realizuar hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet ku personi nuk është shtetas apo nuk ka leje qëndrimi të përhershme." (Shih nenin 3, PKK)

**Person pa shtetësi:** *"një person i cili nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet në kuadrin e ligjit të tij"* (Neni 1, CSSP). Kjo mund të jetë ose për shkak se ai/ajo nuk ka pasur kurrë shtetësi, ose e ka humbur atë pa marrë një të re.

**Mbrojtje subsidiare:** është një term që ndërlidhet më së shpeshti me Direktivën e Kualifikimit të Bashkimit Evropian,<sup>87</sup> dhe nënkupton statusin që i jepet një person i cili përballet me një rrezik të vërtetë të pësimi të dëmeve të rënda të tilla si do të kërkonin mbrojtje nga kthimi mbrapsht sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Mbrojtja subsidiare duhet të jetë mbrojtje shtesë dhe plotësuese për statusin e refugjatit në bazë të Konventës së vitit 1951 mbi statusin e refugjatit/Protokollit të vitit 1967. Shih gjithashtu *Mbrojtje plotësuese*.

**Tortura:** përkufizohet nga neni 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (OKBKKT) si: *"çdo veprim me të cilin personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhembje a vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me qëllim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë, informacione ose pohime për ta dënuar për veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e cillitdo lloji, kur dhembjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a nëlqimin e tij. Ky term nuk përfshin vuajtjet ose dhembjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej*



tyre.” Traktatet tjera ndërkombëtare ose rajonale, si dhe ligjet kombëtare, përmbajnë përkufizime më të gjera të torturës që përfshijnë një varg më të gjerë situatash, në veçanti neni 7 i PNDKP.

**Person i trafikuar:** një viktimë (ose i/e mbijetuar) veprës penale të trafikimit të personave. Trafikimi i personave është: *“Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave me anën e kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera shtrënguese, rrëmbimi, mashtrimi, abuzimi me pushtetin apo me një pozicion të pambrojtur ose duke dhënë apo marrë pagesa apo përfitime për të marrë pëlqimin e një personi për kontrollin e një personi tjetër me qëllimin e shfrytëzimit.”* Pëlqimi i viktimës është jorelevant. (Shih nenin 3 të PKT)

**Fëmijë i pashoqëruar:** fëmijë i cili është ndarë nga të dy prindërit dhe të afërmit e tij/saj, dhe i cili nuk është nën përkujdesjen e një personi më moshën madhore, i cili me ligj apo në bazë të traditës është përgjegjës për ta (Shih KDF GC 6 (2005), §7).

**Mbajtje e paligjshme:** mbajtje që bëhen në shpërputhje ose në kundërshtim me ligjin kombëtar. Mbajtja e cila është e ligjshme sipas ligjit vendor por që është në kundërshti me të drejtën ndërkombëtare konsiderohet po ashtu mbajtje e paligjshme. (Shih UNHCR-UN 3)

## SHTOJCA II: MATERIALE TË PËRZGJEDHURA PËR REFERENCË

### UNHCR

*Back to Basics: The Right to Liberty and Security of Person and 'Alternatives to Detention' of Refugees, Asylum-Seekers, Stateless Persons and Other Migrants*, by Alice Edwards, April 2011, PPLA/2011/01.Rev.1. <http://goo.gl/QrAIYp>

Global Consultations on International Protection, *Protection of Refugees in Situations of Mass Influx: Overall Protection Framework*, EC/GC/01/4, 19 February 2001. <http://www.unhcr.org/3ae68f3c24.html>

*'Lawfully Staying' - A Note on Interpretation*, 3 May 1988. <http://goo.gl/t9ËcGJ>

Global Consultations on International Protection/Third Track: *Reception of Asylum-Seekers, Including Standards of Treatment, in the Context of Individual Asylum Systems*, 4 September 2001, EC/GC/01/17. <http://www.unhcr.org/4e3944069.html>

UNHCR Statement on the right to an effective remedy in relation to accelerated asylum procedures', 21 May 2010. <http://goo.gl/YTa8QJ>

*Agenda for Protection*, (UNHCR, 3rd edn, 2003).

Global Roundtable on Alternatives to Detention of Asylum-Seekers, Refugees, Migrants and Stateless Persons: Summary Conclusions, May 2011 (ëith OHCHR). <http://www.unhcr.org/4e3944069.html>

### OHCHR

Training Manual on Human Rights Monitoring, Professional Training Series n°7, 2001 (under revision). <http://goo.gl/ohYNNH>

Manual on the Effective Investigation and Documentation of Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, Professional Training Series no. 8, 2001. <http://www.refworld.org/docid/4638aca62.html>

Manual on the Effective Investigation and Documentation of Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment ('Istanbul Protocol'), 2004, HR/P/PT/8/Rev.1. <http://www.refworld.org/docid/4638aca62.html>

Monitoring the Convention on the Rights of Persons with Disabilities: Guidance for human rights monitors, Professional training series No. 17, New York and Geneva, 2012. <http://goo.gl/hStTU>

Global Roundtable on Alternatives to Detention of Asylum-Seekers, Refugees, Migrants and Stateless Persons: Summary Conclusions, May 2011 (with UNHCR). <http://www.unhcr.org/4e3944069.html>

### **Procedurat e posaçme të OKB-së**

UN Human Rights Council, '*Report of the Special Rapporteur on the Human Rights of Migrants, François Crépeau, Detention of Migrants in an Irregular Situation*', A/HRC/20/24, 2 April 2012. <http://goo.gl/Y4a1r>

UN Human Rights Council, '*Interim Report by the Special Rapporteur of the Human Rights Council on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment*', Juan E. Mendez, A/66/268, 5 August 2011. <http://goo.gl/uUqyo>

UN Human Rights Council, '*Report of the Special Rapporteur on Trafficking in Persons, especially women and children*', Joy Ngozi Ezeilo, A/64/290, 12 August 2009. <http://www.refworld.org/docid/4aae4eee0.html>

UN Human Rights Commission, '*Report of the Working Group on Arbitrary Detention*', Principle 7, Deliberation No. 5, UN Doc. E/CN.4/2000/4, 28 December 1999 (GPNA-D5). <http://goo.gl/OMjFOf>

UN Human Rights Council, *Report of the Working Group on Arbitrary Detention*, UN Doc. A/HRC/7/4, 10 January 2008 (GPNA-2008).

<http://goo.gl/2eBomL>

UN Human Rights Council, *Report of the Working Group on Arbitrary Detention*, UN Doc A/HRC/13/30, 18 January 2010 (GPNA-2010).

<http://goo.gl/Jrjmes>

UN Human Rights Council, *Report of the Working Group on Arbitrary Detention*, UN Doc A/HRC/16/47, 19 January 2011 (GPNA-2011).

<http://goo.gl/mKodFu>

### **Organet e traktateve të OKB-së për të drejtat e njeriut**

HRC, General Comment No. 7, *Torture or cruel, inhuman or degrading treatment or punishment* (Art. 7), (1982). <http://goo.gl/ZAUEzL>

HRC, General Comment No. 15, *The position of aliens under the Covenant*, (1986). w<http://goo.gl/ZAUWzL>

HRC, General Comment No. 21, *Humane treatment of persons deprived of liberty* (Art. 10), (1992). W<http://goo.gl/ZAUWzL>

KDF, General Comment No. 6, *Treatment of unaccompanied and separated children outside their country of origin*, (2005).

<http://goo.gl/UyxBx>

HRC, General Comment No. 8, PNDPC Article 9: *Liberty and security of person* (1982). <http://goo.gl/9ynkYc>

HRC, Draft General Comment No. 35, PNDPC Article 9: *Liberty and security of person* (forthcoming to replace General Comment No. 8).

<http://goo.gl/QFST31>

### **Organet rajonale**

KPT, Summary KPT *Standards Relating to the Treatment of Persons Deprived of their Liberty* (KPT/Inf/E (2002) 1 - Rev. 2013).

<http://www.cpt.coe.int/en/docsstandards.htm>

## Organet kombëtare

Australia's Human Rights Commission (AHRC), *Human rights standards for immigration detention*, 2013. <http://goo.gl/0wcBvj>

Her Majesty Inspectorate of Prisons (HMIP), *Expectations: Criteria for Assessing the Conditions for and Treatment of Immigration Detainees*, version 3, 2012. <http://goo.gl/JDxxFs>

## OJQ-të

APT, *Monitoring Police Custody: A Practical Guide*, 2013. <http://goo.gl/ABD5j5>

APT and CoE, *Visiting Immigration Detention Centres: A Guide for Parliamentarians*, 2013. <http://goo.gl/TP8Oëy>

APT, *Monitoring Places of Detention: A Practical Guide*, 2004. <http://goo.gl/ABD5j5>

APT, *Monitoring Places of Detention: A Practical Guide for NGOs*, 2002. <http://goo.gl/ZRzAlq>

APT Detention Monitoring Briefing Paper No. 1: *'Making Effective Recommendations'*, 2008. <http://goo.gl/uOËtË1>

APT Detention Monitoring Briefing Paper No. 2: *'The Selection of Persons to Interview in the Context of Preventive Detention Monitoring'*, 2009. <http://goo.gl/D7gArd>

APT Detention Monitoring Briefing Paper No.3: *'Using Interpreters in Detention Monitoring'*, 2009. <http://goo.gl/DRiaPc>

APT, Detention Monitoring Briefing Paper No. 4: *'Mitigating the Risks of Sanctions related to Detention Monitoring'*, 2012. <http://goo.gl/P00NJd>

APT and Penal Reform International, *Detention Monitoring Tool – Addressing risk factors to prevent torture and ill-treatment*, 2013. <http://goo.gl/4IZCRa>

---

APT and Penal Reform International, *Women in detention: A guide to gender sensitive monitoring*, 2013. <http://goo.gl/5JE78h>

APT and Penal Reform International, *LGBTI Persons Deprived of their Liberty: A Framework for Preventive Monitoring*, 2013. <http://goo.gl/46nGq1>

IDC, *Legal Framework and Standards Relating to the Detention of Refugees, Asylum Seekers and Migrants: A Guide*, 2011. <http://goo.gl/RRhFwh>

IDC, *There Are Alternatives: A Handbook for Preventing Unnecessary Immigration Detention*, 2011. <http://idcoalition.org/cap/>

IDC, *Captured Childhood*, 2012. <http://goo.gl/yEUrZM>

Jesuit Refugee Service (JRS), *Becoming Vulnerable in Detention*, 2010. <http://www.refworld.org/docid/4ec269f62.html>

University of Nottingham Human Rights Centre, *Toolkit on Detention Monitoring and Human Rights Mechanisms*, 2008. <http://goo.gl/IMxSTo>





**UNHCR**  
The UN  
Refugee Agency

**Division of International  
Protection**

United Nations High  
Commissioner for Refugees  
Case Postale 2500  
1211 Geneva 2, S tzerland  
[www.unhcr.org](http://www.unhcr.org)



**Association for the  
Prevention of Torture – APT**

Centre Jean-Jacques Gautier  
Case Postale 137 CH  
1211 Geneva 19, S tzerland  
[www.appt.ch](http://www.appt.ch)



- 
- 1 Komisioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (CCPR), Komenti i përgjithshëm nr. 15: *Pozita e të huajve sipas Paktit*, 11 prill 1986, §5, në dispozicion në: <http://goo.gl/oiMW1M> Shih gjithashtu dhe *Moustaquim kundër Belgjikës* (1991), Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Parashtresa nr. 26/1989/186/246, §43, në dispozicion në: <http://goo.gl/xl0gD7> dhe *Vilvarajah dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1991), GJEDNJ, Parashtresa nr. 45/1990/236/302-306, §103, në dispozicion në: <http://goo.gl/wKOJJR>
  - 2 Për qëllime të këtij Doracaku, termet “azilkërkuës dhe migrantë” përdoren në kuptimin e gjerë të tyre për t’ju referuar kategorive të ndryshme të personave të cilët lëvizin nga njëri shtet, qoftë ai vendi i prejardhjes ose vendbanimi i përhershëm, në një tjetër. Ky koncept përfshin si personat të cilët lëvizin për shkak të nevojave për mbrojtje, siç janë refugjatët dhe azilkërkuësit, dhe përfshin në veçanti situatën e personave pa shtetësi, ashtu dhe ata të cilët e bëjnë këtë gjë për arsye ekonomike apo arsye tjera që nuk janë të ndërlidhura me mbrojtjen.
  - 3 Kategoritë e veçanta i përfshijnë refugjatët, azilkërkuësit, personat pa shtetësi, gratë shtatzëna dhe nënat gjidhënëse, fëmijët (përfshirë të miturit e pashoqëruar ose të ndarë), personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, viktimat e trafikimit me njerëz, personat e moshuar, personat LGBTI, të mbijetuarit e torturës dhe/ose traumave, dhe personat e tjerë me nevoja të posaçme shëndetësore. Këto kategori janë shtjelluar më hollësisht në Pjesën 4.8.
  - 4 Shih përkufizimin e *non-refoulement* (moskthimit) në fjalorth.
  - 5 PFKKT ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2006. Deri në nëntor 2013, ai ka 70 Shtete Palë, dhe shtete nënshkruese që ende nuk e kanë ratifikuar atë.
  - 6 UNHCR, *Shënim mbi mandatin e Komisionarit të Lartë për Refugjatët dhe Zyrën e tij*, tetor 2013, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/5268c9474.html>
  - 7 “Procedurat e veçanta” është emërtim i përgjithshëm që u është bërë mekanizmave të themeluar nga ana e Këshillit për të Drejtat e Njeriut për të adresuar qoftë ndonjë situatë në një vend specifik ose çështje tematike në të gjitha pjesët e globit. Aktualisht, ekzistojnë 6 mandate tematikë dhe mandate për vende të veçanta. Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) u ofron këtyre mekanizmave mbështetje me personel, politika, hulumtime dhe logjistikë për ushtrimin e mandatit. Procedurat e veçanta përbëjnë ose një individ (të quajtur “Raportues i posaçëm” ose “Ekspert i pavarur”) ose grup punues që zakonisht përbëhet nga pesë anëtarë (nga një prej secilit rajon). Mandatet e procedurave të veçanta vendosen dhe përkufizohen nga rezoluta me të cilën krijohen ato. Bartësit e mandatit të procedurave të veçanta i ushtrojnë funksionet në cilësi personale, dhe nuk marrin pagë ose kompensim tjetër financiar për punën e tyre. Statusi i pavarur i bartësve të mandatit është vendimtar që ata t’i kryejnë funksionet e veta në mënyrë të paanshme.
  - 8 Në Evropë, Ombuspersoni Evropian monitoron punën e FRONTEX (shih shënimin 15 më poshtë).
  - 9 Lista nuk përfshin organet administrative të brendshme në nivel vendor dhe përqendrohet tek organet më të rëndësishme në kontekstin e mbajtjes së imigrantëve, që janë plotësisht të pavarur nga autoritetet e mbajtjes.
  - 10 Shih APT dhe Këshilli i Evropës (KiE), “*Vizitimi i qendrave të ndalimit të imigrantëve: Udhëzues*

- 
- për parlamentarë*”, shtator 2013, në dispozicion në internet në: <http://goo.gl/pĚE8Xy>
- 11 Mbajtja e imigrantëve mund të lejohet nëse i shërben një qëllimi legjitim në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, sipër shembull për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit publik ose sigurisë kombëtare Për më shumë informata, shih Pjesën 2.6.
  - 12 Për shembull, objektet për mbajtjen e imigrantëve që ndodhen në lokacione të largëta mund të zgjidhen për të kufizuar shqyrtimin e jashtëm ose një gjë e tillë mund të jetë bërë thjesht për ndonjë arsye të nevojshme.
  - 13 “KKT-ja është e mendimit se mbajtja e zgjatur e personave sipas legjislacionit për të huajt, pa një afat kohor dhe me perspektivë të paqartë të lirim, mund të konsiderohet fare lehtë se përbën trajtim çnjerëzor.” (Raport i KKT-së për Qeverinë bullgare, vizita e vitit 2008, CPT/Inf (2010) 29, §29).
  - 14 UNHCR-UD 6.
  - 15 Për shembull, më 26 tetor 2004 u themelua Agjencia Evropiane për Menaxhim të Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (FRONTEX). FRONTEX promovon, bashkërendon dhe realizon menaxhimin e kufijve të BE-së. Për më shumë informata shih <http://goo.gl/mDLIjt>
  - 16 Shih UNHCR, *Tryeza globale e diskutimit rreth alternativave ndaj mbajtjes së azilkërkuesve, refugjatëve, migrantëve dhe personave pa shtetësi: Pëmbledhje e përfundimeve*, §14, korrik 2011, në dispozicion në: <http://goo.gl/XDKCEI>
  - 17 Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Raport i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për çështjen e të drejtave të njeriut dhe korporatat e ndërmarrjet tjera afariste transnacionale, John Ruggie, “Parimet udhëzuese mbi afarizmin dhe të drejtat e njeriut: Zbatimi i kornizës së Kombeve të Bashkuara “Mburo, respekto dhe korrigjo”, UN Doc A/HRC/17/31, 21 mars 2011, në dispozicion në: <http://goo.gl/iLHLU> Shih gjithashtu z. Carlos Cabal dhe z. Marco Pasini Bertran kundër Australisë, HRC, Comm. No. 1020/2001, [7.2], në dispozicion në: <http://goo.gl/6xvJuM>
  - 18 Shih UNHCR, *Tryeza botërore e diskutimit mbi alternativat*, §14.
  - 19 Neni 9(1) dhe 12(1), PNDCP. Shih gjithashtu Parimin 2, BPP, dhe UNHCR-UN 3.
  - 20 Neni 9(1), PNDCP. Shih gjithashtu UNHCR-UN 4.
  - 21 RPDNJM, §9. Shih gjithashtu, UNHCR-UN 4.1
  - 22 GPNA, A/HRC/7/4, §53.
  - 23 Grupi punues mbi mbajtjen arbitrare ka vënë në dukje se “ekzistojnë shqetësime në lidhje me parimin e proporcionalitetit kur mbahet parasysh se imigrantët e ndaluar në mbajtje nuk kanë kryer krim”, megjithatë mund t'i nënshtrohen kushteve të ngjashme me ato të burgjeve për periudha të gjata kohore . GPNA, Deklaratë me rastin e përfundimit të vizitës së tij në Hungari (23 shtator – 2 tetor 2013), në dispozicion në: <http://goo.gl/XRZgBU>
  - 24 *Van Alphen kundër Holandës*, KDNJ, Komenti nr. 305/1988, 23 korrik 1990, [5.8], në dispozicion në: <http://goo.gl/v7xcc2>; Shih gjithashtu UNHCR-UN 4.
  - 25 KDNJ, *Komenti i përgjithshëm nr. 18: Mosdiskriminimi*, 10 nëntor 1989, [1]; KDNJ, *Komenti i përgjithshëm nr. 5: Pozita e të huajve sipas Paktit*, 11 prill 1986, [1].

- 
- 26 *A kundër Australisë*, KDNJ, Komenti nr. 560/1993, 30 prill 1997, [9.4], në dispozicion në: <http://goo.gl/49tvvu>; Shih UNHCR-UN 7.
- 27 Mbatjtja është shpesh pjesë e proceseve të largimit dhe deportimit. Në disa vende praktikat e ndalimit në mbajtje dhe largimit janë të njohura se bien brenda kompetencave të funksionit të monitorimit gjithëpërfshirës. Në vende të tjera, ky aspekt i mbajtjes mund të neglizhohet. Monitorimi i trajtimit të personave të larguar dhe të depërtuar mund të konsiderohet si praktikë e mirë.
- 28 Shih Pjesën 4.8
- 29 Mundësia e kontestimit të ligjshmërisë së mbajtjes, keqtrajtimit të pretenduar dhe kushteve të mbajtjes është e drejtë themelore dhe e pamohueshme.
- 30 Parashihet po ashtu që ky Doracak të përdoret nga OJQ-të dhe të tjerët të cilët mund të kenë qasje të kohëpaskohshme, në diskrecion të tyre dhe për një qëllim të kufizuar.
- 31 Mbatjtja e imigrantëve është lidhur me nivele të larta të traumave, çrregullimit të stresit pas traumës, vetëlëndim dhe mendime vetëvrasjeje, sidomos në rastin e fëmijëve. Profesionistët shëndetësorë mund të jenë në gjendje që, për shembull, të monitorojnë ekzaminimin mjekësor të personave në mbajtje me rastin e mbërritjes ose para largimit; të intervistojnë personat në mbajtje ose t'i shqyrtojnë dosjet mjekësore me qëllim të identifikimit të rasteve të njerëzve me histori të traumës; të shqyrtojnë aspektet mjekësore të një sërë çështjeve të ndërlidhura me keqtrajtimin, siç janë kushtet e burgimit (përfshirë mungesën e ushqimit, ujit, ngrohjes, ndriçimit, ventilimit, kushteve hidrosanitare dhe ushtrimeve); të identifikojnë reziqet e vetëvrasjes, vetëlëndimit ose problemet tjera të shëndetit mendor; të identifikojnë shenjat e veçimit administrativ, izolimit disiplinor, përdorimit jo të duhur të forcës dhe kufizimit fizik, dhe problemet e shëndetit mendor.
- 32 Shih Pjesën 3.5.4 *Dhënia e rekomandimeve*
- 33 Shih Pjesën 3.2, Hartimi i strategjisë së monitorimit: *Elementet kryesore*.
- 34 Kjo është fushë se cilës duhet qasur me kujdes në varësi të kontekstit. Njëra alternativë është të merret emri dhe pozita e personit kontaktues i cili është përgjegjës për vendin që do të vizitohet.
- 35 Këtu mund të përfshihet një listë me informatat bazë lidhur me kombësinë, përkatësinë seksuale, moshën, statusin, duke përfshirë datën e mbërritjes së personave në mbajtje në vendin e mbajtjes.
- 36 Mbani parasysh që personave në mbajtjetë cilët janë të shurdhër ose të verbër mund t'ju nevojitet ndihmë me interpretimin në gjuhën brajl ose atë të shenjave. KDKAK, nenet 21(b) dhe 0(4).
- 37 Për shembull, UNHCR-i, MKP-të, OJQ-të, avokatët të cilët i përfaqësojnë personat në mbajtje, gjyqtarët, profesionistët shëndetësorë, ofruesit e shërbimeve të cilët punojnë në qendrën e mbajtjes ose bashkëpunojnë me të (p.sh. shërbimet shëndetësore, sociale dhe arsimore), ish-personat në mbajtje, familja, miqtë ose vizitorët e tjerë të rregullt.
- 38 Shih Pjesën 4.
- 39 Disa vende të mbajtjes kanë kode të veçanta të veshjes, si për shembull mbathja e këpucëve që nuk janë të hapura tek gishtat dhe pa taka.

- 
- 40 Analiza më e thellësishme dhe e thuktë do të bëhet nga ekipi pas vizitës – shih Pjesën 3.5, *Pas vizitës*.
- 41 APT, Dokument udhëzues për monitorimin e mbajtjes nr. 4: “Zbutja e rreziqeve të sanksioneve të lidhura me monitorimin e mbajtjes”, 2012, <http://goo.gl/P00NJd>
- 42 Sa u përket vendeve të mbajtjes ku mbahen numër shumë i vogël i njerëzve, është me rëndësi që monitoruesit ose t'i intervistojnë gjithë personat në mbajtje ose asnjërin. Dokumenti udhëzues për monitorimin e mbajtjes nr. 2 i APT-së: “Përzgjedhja e personave për t'i intervistuar në kontekstin e monitorimit parandalues të mbajtjes”, 2009 <http://goo.gl/D7gArd>
- 43 Këtu mund të përfshihen personat në mbajtjetë cilët e kanë kontaktuar tashmë organizatën monitoruese ose partnerët e saj para vizitës përmes sistemit të ankimit.
- 44 Shih PNDPCP 17; KPM 14; KDF 16; CRPD 22; PKT 6(1); Udhëzimet e OHCHR mbi trafikimin 3(7), 6(6), 8(9).
- 45 Disa janë shprehur të shqetësuar në lidhje me përdorimin e pajisjeve të regjistrimit gjatë intervistave në person. Në përgjithësi, është e vështirë të fitohet besimi i personave në mbajtje nëse përdoren pajisje të regjistrimit dhe ato mund të kenë një efekt negativ duke ua kujtuar personave në mbajtje intervistat në polici të cilave u janë nënshtruar në të kaluarën gjatë të cilave janë përdorur pajisje regjistrimi. Një gjë e tillë vlen sidomos për aparatet fotografike dhe videokamerat që mund ta “ngrijnë” kontaktin njerëzor .
- 46 Çështja e mënyrës se si mund të bashkëpunojnë monitoruesit me përkthyes është shtjelluar në hollësi në Dokumentin udhëzues për monitorimin e mbajtjes nr. 3 të APT-së: “Përdorimi i përkthyesve në monitorimin e mbajtjes”, në dispozicion në: <http://goo.gl/DRiaPc>
- 47 Në disa vende është në dispozicion shërbimi i përkthimit përmes telefonit. Ndonëse një shërbim i këtillë mund të jetë i domosdoshëm, madje dhe i dëshirueshëm, zakonisht preferohet që përkthyesi të jetë i pranishëm fizikisht. Nëse përdoret shërbimi i përkthimit përmes telefonit, ekipi i monitoruesve duhet t'i mbajë parasysh rreziqet dhe implikimet lidhur me dëgjimin dhe konfidencialitetin e bisedave.
- 48 Një taktikë është që të fillohet me vrojtimit pozitive dhe të procedohet me problemet vetëm pas kësaj. Kjo shmang krijimin e përshtypjes tek autoritetet se gjithnjë vetëm po kritikohen.
- 49 Standardet ndërkombëtare, praktikat e mira dhe treguesit e përmirësimit ose përkëqësimit u mundësojnë që të gjitha organeve vizituese që t'i përcjellë në mënyrë sistematike ndryshimet me kalimin e kohës të mënyrës se si personat në mbajtje përrjetojnë mbajtjen si imigrantë nëpër vendet që organi i viziton rregullisht.
- 50 Për shembull, UNHCR-it, që ka rol operacional në më se 120 shtete, mund të duhet t'i peshojë shqetësimet kundrejt prioriteteve operacionale, përfshirë sigurinë e personelit të tij, që mund ta bëjnë të domosdoshme mbajtjen konfidenciale të komunikimit/raportit të vizitës nga UNHCR-i tek autoritetet.
- 51 Për shembull, sipas PFKKT-së, nga MKP-të kërkohet shprehimisht që të dorëzojnë raporte vjetore, dhe Shteti Palë duhet ta publikojë dhe shpërmdajë atë.
- 52 Nganjëherë, monitoruesit do të detyrohen që të rekomandojnë mbylljen e një vendi të caktuar të mbajtjes. Nëse duhet bërë medoemos një gjë të tillë, ata duhet ta pyesin fillimisht veten nëse problemi qëndron tek vendi i mbajtjes apo problemi është i një natyre sistemore.

- 
- 53 Shih Dokumentin udhëzues për monitorimin e mbajtjes nr. 1 të SHPT-së: *“Dhënia e rekomandimeve efektive”*, në dispozicion në: <http://goo.gl/uOËtË1>
- 54 PFKKT, neni 19(c)
- 55 Intervenimet në nivel rajonal do të ishin po ashtu të përshtatshme nëse janë në dispozicion mekanizmat ekzistues për të drejtat e njeriut, për shembull në Kontinentin Amerikan dhe Evropë.
- 56 Neni 21, KBKKT; Neni 1, Protokollit fakultativ i I-rë i PNDCP. [Protokollit fakultativ i Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, GA res. 2200A (XXI), 21 UN GAOR Supp. (No. 16) at 59, UN Doc. A/6316 (1966), 999 UNTS 302, *ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976.*] Po ashtu mund t'i dërgohet ankesë individuale ose grupore GPNA-së në kuadër të OKB.
- 57 Në nivel rajonal, shih Gjykata Afrikane për të Drejtat e Popullit dhe të Njeriut, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Ndëramerikane për të Drejtat e Njeriut.
- 58 Me ligje të forta nënkuptohen traktatet dhe konventat. Me ligje të buta nënkuptohen, mes tjerash, standardet jo të detyrueshme sikurse deklaratat, rezolutat ose udhëzimet e organeve autoritative, raportet e Raportuesve të posaçëm ose mendimet këshillëdhënëse.
- 59 Në rastin e refugjatëve dhe azilërkuesve, autoritetet nuk duhet që t'i informojnë apo që t'ua përcjellin informatat e tyre vendit të origjinës ose vendbanimit të përhershëm të personit. Azilërkuesit dhe refugjatët duhet të mbrohen nga vizitat e autoriteteve konsullore të vendit të origjinës apo vendbanimit të tyre të përhershëm.
- 60 Termi “kontrolle trupore” ngërthen tri lloje të ndryshme të kontrollit: kontrolli jashtëm me prekje ose me detektor dorë; kontroll me zhveshje; kontrolli i zgavrave anatomike. Shih Listën e fakteve të SHPT-së dhe Penal Reform International (PRI) mbi *“Kontrollet trupore: adresimi i faktorëve të rezikut për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit”*, 2013, në dispozicion në: <http://goo.gl/Q3rT0s>
- 61 Termat “largim” dhe “deportim” përdoren në mënyrë të ndërkëmbyeshme për të cilësuar procesin e kthimit/dërgimi në vendin e origjinës apo vendbanimit të përhershëm. Termi “riatdhësim” do të thotë kthim që nuk është i detyruar fizikisht, madje edhe nëse nuk është vullnetar.
- 62 Shih dokumentin udhëzues të APT-së për “MKP-të: Monitorimi i fluturimeve të depërtimeve të detyruara të migrantëve”, 2012, në dispozicion në: <http://goo.gl/qyUyzë>
- 63 Sipas KPT: *“urdrat për largim duhet të secilin rast veç e veç të nxirren në bazë të një vendimi në pajtim me ligjet e procedurat kombëtare, dhe në pajtim me detyrimet të rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Personit në fjalë duhet t'i jepet urdhr për largim me shkrim.”* [CPT/Inf (2009) 27 §95].
- 64 *KPT konsideron se administrimi i barnave për personat të cilët janë objekt i urdhr për deportim duhet të bëhet në bazë të një vendimi mjekësor të nxjerrë për secilin rast të veçantë. Përveçse në rrethana të jashtëzakonshme të përkufizuara në mënyrë të qartë dhe strikte, mjekimi duhet të administrohet vetëm me pëlqimin e informuar të personit në fjalë.”* (CPT/Inf (2003) 35 §40). Sa i

---

përket pranisë së mjekut: *“Prania e mjekut në fluturimet e drejtpërdrejta në të cilat ndodhen personat që janë objekt i largimit (në vend t teknikut mjekësor ose infermierit) është shumë e dëshirueshme.”* (Raport i KPT-së për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar, vizita e tetorit 2012, CPT/Inf (2013) 14 §28

65 Sa i përket përzgjedhjes dhe trajnimit të personelit përcjellës: *“Mbarëvajtja e operacioneve të deportimit varet në masë të madhe nga cilësia e personelit i cili është caktuar për ta bërë përcjelljen. Është më se qartë që personeli duhet të përzgjidhet me kujdesin më të madh dhe duhet të kryejë trajnime të përshtatshme specifike të dizajnuara për të pakësuar rrezikun e keqtrajtimin në minimum.”* (CPT/Inf (2003) 35 §42).

66 Sa i përket dokumentimit të operacioneve të deportimit, KPT konstaton se *“Operacionet e deportimit duhet të dokumentohen me kujdes. Krijimi i një dosjeje dhe regjistri gjithëpërfshirës të depërtimeve, që duhet të mbahen për të gjitha operacionet e realizuara nga njësitë në fjalë, është kriter themelor. (...) Informatat e regjistruara duhet të përfshijnë çdo incident dhe çdo rast të përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik (...).”* (CPT/Inf (2003) 35 §44).

67 Në bazë të KPT-së, *“është plotësisht e papranueshme që personat të cilët janë objekt i urdhrimit për deportim të sulmohen fizikisht në mënyrë që të binden për të hipur në mjetin e transportit ose si ndëshkim sepse nuk e kanë bërë këtë.”* (CPT/Inf (2003) 35 §32). *“Forcat dhe mjetet e kufizimit fizik nuk duhet të përdoren më shumë seç është e nevojshme në mënyrë të arsyeshme.”* (CPT/Inf (2003) 35 §33). *“Përdorimi i teknikave të kontrollit dhe kufizimit fizik nga ana e përcjelljes gjatë transferit duhet të arsyetohet në secilin rast individual me vlerësim të rrezikshmërisë.”* (CPT/Inf (2013) 14 §17). *“KPT-ja e ka bërë të qartë që përdorimi i forcës dhe/ose mjeteve të kufizimit që mund të shkaktojnë asfiksi në pozicionim duhet të shmanget sa herë që të jetë e mundshme dhe se përdorimi i tyre në rrethana të jashtëzakonshme duhet të bëhet vetëm në përputhje me udhëzimet e hartuara për t'i pakësuar në minimum rreziqet ndaj shëndetit të personave në fjalë.”* (CPT/Inf (2003) 35 §34). *“Po ashtu (...), KPT ka rekomanduar në mënyrë sistematike që të ndalohet rreptësisht përdorimi i mjeteve që kanë të ngjarë të mbyllin pjesërisht ose tërësisht rrugët e frymëmarrjes (hundën dhe/ose gojën).”* (CPT/Inf (2003) 35 §36). *“[N]ë rast të ndonjë emergjence derisa aeroplani është në fluturim e sipër, (...) duhet të jetë i mundshëm largimi i menjëhershëm i mjeteve që kufizojnë lirinë e lëvizjes së personit të depërtuar me urdhër të ekuipazhit të fluturimit i”* (CPT/Inf (2003) 35 §37). *“Sipas mendimit të KPT-së, konsideratat për sigurinë asnjëherë nuk mund të shërbejnë për të arsyetuar bartjen e maskave nga personeli depërtues gjatë operacioneve të deportimit”* (CPT/Inf (2003) 35 §38).

68 *“Keqtrajtim” është formulim i shkurtuar i “trajtimit a dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës”.*

69 Raportuesi i posaçëm për torturën e përkufizon izolimit afatgjatë në vetmi si *“çfarëdo periudhe e izolimit në vetmi më e gjatë se 15 ditë.”* Shih Raportin periodik nga Raportuesi i posaçëm të Këshillit për të Drejtat e Njeriut për torturën dhe trajtimin a dënimin mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, Juan E. Mendez, A/66/268, 5 gusht 2011, §26 (SR Torture).

70 Duke përfshirë mbështetje psikologjike po të jetë e përshtatshme.

---

(74)Shih Shoqata Mjekësore Botërore, Deklaratat e Maltës dhe Tokios, që të dyja të rishikuara në vitin 2006: *“Nëse i burgosuri refuzon ushqimin dhe konsiderohet nga ana e mjekut se është në gjendje të gjykojë në mënyrë të shëndoshë dhe racionale për sa u përket pasojave të refuzimit të këtyllë vullnetar të ushqimit, ai ose ajo nuk duhet të ushqehet në mënyrë artificiale. Vendimi për sa i përket zotësisë së të burgosurit për të formuar një gjykim të këtyllë duhet të vërtetohet nga të paktën edhe një mjek tjetër i pavarur. Mjeku ia shpjegon të burgosurit pasojat e refuzimit të ushqimit”*. Shih po ashtu qëndrimin e IKDF-së për grevat e urisë (FAQ): <http://goo.gl/9Nq2JE>

<sup>71</sup> Sikurse gjymtimi i organeve gjenitale të femrave (GJOGJF).

<sup>72</sup> Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së (OHCHR), *Doracak për hetimin dhe dokumentimin efektiv të torturës dhe trajtimit a dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës (“Protokolli i Stambollit”)*, 2004, HR/P/PT/8/Rev.1, në dispozicion në:

<sup>73</sup> “Kultura në vendet e mbajtjes” nënkupton supozimet dhe vlerat e përbashkëta të personelit dhe personave në mbajtje që udhëheqin me sjelljen në organizatën ndaluese. Shih SHPT dhe Penal Reform International, *“Kultura insiticionale në mbajtje: Kornizë për monitorimin parandalues”*, në dispozicion në: <http://goo.gl/MnDgKt>

<sup>74</sup> Shih, p.sh. Shërbimi Jezuit për Refugjatët, Evrope: Të bërit të cenusëm gjatë mbajtjes , 2011, në dispozicion në:<http://www.refworld.org/docid/4ec269f62.html>

<sup>75</sup> Sipas të drejtës ndërkombëtare, me fjalën fëmijë nënkuptohet çdo njeri nën moshën 18 vjeçe, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara (KDF, neni 1).

<sup>76</sup> Shih po ashtu UNHCR, EXCOM *Përfundim mbi fëmijët në rrezik*, 5 tetor 2007, nr. 107 (LVIII) - 2007, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/471897232.html>

<sup>77</sup> Shih, UNHCR, *Udhëzime për përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës*, maj 2008, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/48480c342.html> Shih po ashtu, UNHCR, *Doracak i terrenit për zbatimin e Udhëzimeve për PIL të UNHCR-it*, nëntor 2011, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/4e4a57d02.html>

<sup>78</sup> Shih IDC, Ekzistojnë alternativa: Doracak për parandalimin e ndalimit të panevojshëm të imigrantëve, 2011.

<sup>79</sup> Në komunikatën *C. kundër Australisë*, nr. 900/1999, Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut (CCPR) ka konstatuar që mbajtja e vazhduar e migrantit kur Shteti ka qenë në dijeni të gjendjes së tij mendore dhe nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmirësimin e gjendjes së tij të përqësuar mendore përbën shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 7 të Paktit (ndalimi i torturës dhe trajtimit a dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës) (§8.4).

<sup>80</sup> Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin me njerëz, shih në pjesën e referencave.

---

<sup>81</sup> *Po aty, shih po ashtu Raportuesi i posaçëm për trafikimin e personave, në veçanti të grave dhe fëmijëve, A/64/290, në Shtojcën II: Materiale të përzgjedhura për referencë.*

<sup>82</sup> APT dhe Penal Reform International, *Personat LGBTI të privuar nga liria: Kornizë për monitorim parandalues*, 2013, në dispozicion në <http://goo.gl/46nGq1>

<sup>83</sup> Parimet e Yogyakarta të janë në grup parimesh mbi zbatimin e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ata janë hartuar dhe miratuar njëzëri në vitin 2007 nga një grup i ekspertëve të shquar të të drejtave të njeriut, prej rajoneve dhe me përgatitje të ndryshme, përfshirë gjyqtarë, akademikë, një ish-Komisionet i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Procedurat e posaçme të OKB-së, anëtarë të organeve të traktateve, OJQ-të dhe të tjerë. Shih <http://www.yogyakartaprinciples.org>

<sup>84</sup> Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR), *Fjalor udhëzues i temave të UNHCR-it*, qershor 2006, Rev.1, në dispozicion në: <http://ëëë.refworld.org/docid/42ce7d444.html>

<sup>85</sup> Shih, *Shënimi rreth mandatit të Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët dhe Zyrën e tij*, tetor 2013, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/5268c9474.html>

<sup>86</sup> Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR), *Fjalor udhëzues i temave të UNHCR-it*, qershor 2006, Rev.1, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/42ce7d444.html>

<sup>87</sup> Shih Këshilli i Bashkimit Evropian, *Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 31 dhjetorit 2011 për standardet e kualifikimit të shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status të njësuar për refugjatët ose për personat të cilët i plotësojnë kushtet për mbrojtje subsidiare, si dhe për përmbajtjen e mbrojtjes*, 20 dhjetor 2011, Gazeta Zyrtare L 337, §9-26, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/4f197df02.html>